Zona ekonomike veriore e qytetit konkretisht zona përgjat rrugës Nacionale M-25 në zonën kadastrale Konjuh, në kuadër të cilës zonë veprojnë numër i konsiderueshëm i bizneseve, në bazë të vlerësimeve kjo zonë përmbush kriteret e një zone ekonomike duke pasur parasysh lidhejn e kësaj zone me komunën e Prishtinës duke krijuar një vazdhimësi të një korridori ekonomik.

Gjithashtu ky korridor zhvillimor vazhdon të shtrihet edhe në pjesën qendrore të komunës së Lipjanit dhe ka një shtrirje lineare përgjatë rrugës magjistrale M25 në drejtim të Prizrenit. Kjo zonë ka sipërfaqe 69 ha dhe shtrihet 200m thellësi në të dy kahet e rrugës M25 dhe përqendrohet në dy zona kadastrale, siç janë: ZK Grackë e Vjetër dhe ZK Grackë e Re. Në kuadër të kësaj zone ushtrojnë veprimtari një numër i konsiderueshëm i bizneseve, kryesisht biznese tregtare dhe përpunimit të lehtë, ky korridor për arsye të infrastrukturës së përshtatshme ofron kushte të mira për zhvillim ekonomik.




Figura 3. Korridori Zhvillimore N-25

Zona biznesit M2, zonë e planifikuar për zhvillim të veprimtarive ekonomike dhe banimit. Kjo zonë mikse shtrihet pothuajse në pjesën qendrore të komunës së Lipjanit dhe ka një shtrirje lineare në drejtimin veri-jug. Për nga sipërfaqja është një ndër zonat e propozuara ekonomike më të mëdha me sipërfaqe 276 ha dhe shihet në 6 zona kadastrale (Banullë, Gumnasellë, Marevc, Llugaxhi, Gadime e Ulët dhe Babushë i Muhaxhirëve). Kjo zonë shtrihet përgjat

rrugës Magjistrale M2 në një gjatësi lineare prej 7.02 km, ndërsa gjersia e kësaj zone është 200 m nga aksi I rrugës në një anë, që d.m.th 400m e gjer.




Figura 4. Korridori zhvillimor N-25

1.2.5 REMITENCAT

Remitencat në vitin 2022 në nivel vendi ishin mbi 3 miliardë euro, dhe kjo është 5.5 për qind më shumë se në vitin 2021. Vetëm nga Zvicra në total të hyrat për periudhën janar-shtator janë 570.7 milionë euro, përfshirë këtu shpenzimet e udhëtimeve 267.8 milionë euro, remitencat 171.4 milionë euro dhe investimet e huaja direkte 132.5 milionë euro. Kjo ngritje e madhe e dërgesave nga emigrantët është rezultat i zvogëlimit të të ardhurave të qytetarëve, për shkak të pasojave ekonomike që po ndodhin në nivel global, si kriza ekonomike, ngritja e inflacionit, ngritja e nivelit të papunësisë, zvogëlimi i fuqisë punëtore, etj. Numri i madh i remitencave si dhe frekuenca e tyre janë ndër arsyet e shkallës ekzistuese të papunësisë dhe numrit të ulët të fuqisë punëtore.

Sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19 në remitencat nga diaspora, të dhënat nga Banka Qendrore tregojnë se në vitin 2021 ato ishin 1.153,4 milion euro dhe ishin më të lartat ndonjëherë, që nga viti 2012. Ndërsa në vitin 2020 remitencat ishin 980.0 milionë euro, 173.4 milionë euro më pak se në vitin 2021.

Vlerësimet e komunës janë se sfidat politike dhe paqëndrueshmëria e saj, papunësia e madhe, zhvillimi i ngadalshëm ekonomik po ndikojnë në vazhdimësi që emigrimi të thellohet. Destinacionet kryesore të emigrimit të popullatës janë Gjermania, Zvicra, Anglia dhe shtete të tjera perëndimore.

1.2.6 SEKTORI BANKAR

Sektori bankar është ndër kontribuuesit kryesorë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Rreth 75% e kredive të sektorit bankar ndaj ekonomisë vendore janë të drejtuara tek bizneset. Shuma e përgjithshme e kredive të aprovuara nga sektori bankar i Kosovës në vitin 2021 arriti në 3,748.6 milionë euro, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit 2020 shuma e kredive vjetore ka qenë 3,246.6 milionë euro. Pra, rritja vjetore e kredive në vitin 2021 është 502 milionë euro, apo 15.4% krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2021 kreditë e korporatave financiare arritën shumën prej 2,324.4 milionë euro, ndërsa kreditë e ekonomive familjare kishin shumën prej 1,399.1 milionë euro.

Në Kosovë, në dhjetor të vitit 2022 ishin 200 njësi bankare dhe ato kanë të punësuar gjithsej 3,781 punëtorë. Nuk ka të dhëna të sakta se sa njësi bankare operojnë në Komunën e Lipjanit por në Regionin e Prishtinës, ku përfshihet edhe Komuna e Lipjanit, veprojnë 70 njësi bankare. Bankat komerciale në vazhdimësi i mbështesin bizneset të cilat paraqesin

plane të mira investive në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke i kushtuar një vëmendje edhe kreditimit të sektorit të prodhimit. Kreditimi bankar për sektorin prodhues në vend në vitin 2018 kishte arritur në 210 milionë euro.

1.2.7 TREGËTIA

Ekonomia në Lipjan si tërësi dhe posaçërisht sektori i NVM-ve dukshëm dominohet nga tregtia (shitja me pakicë) dhe shërbime. Struktura ekonomike në Lipjan është e dominuar me ndarjen e ndërmarrjeve të vogla që kanë më pak se 10 punëtorë, që përbëjnë kufij të vegjël në shitjen e prodhimeve standarde ose shërbime. Vetëm një pjesë e vogël e NVM ofrojnë prodhime të sofistikuara dhe shërbime. Në të shumtën e rasteve NVM-të janë firma familjare që involvojnë investim të vogël të kapitalit.

Në gjithë sektorin e tregtisë zhvillohen 78 aktivitete të ndryshme. Me numrin më të madh janë dyqanet ushqimore dhe të pijeve, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, shitja e tekstilit me pakicë, etj. Në Komunën e Lipjanit pothuajse gjysma e tërë këtyre aktiviteteve kanë numër një shifror të ndërmarrjeve, që do të thotë se ndërmarrjet janë më shumë të koncentruara në një numër të caktuar të shërbimeve tregtare.

Tabela 30. Aktivitetet e tregtisë me numrin me të madh të ndërmarrjeve, 2022

Nr.	Aktiviteti i tregtisë	Nr. i ndërmarrjeve
1	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani	531
2	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	182
3	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara	117
4	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara	81
5	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara	72
6	Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve	64
7	Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara	61
8	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare	60
9	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël	47
10	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara	45

Në aspektin e tregtisë së jashtme, ndërmarrjet e Komunës së Lipjanit eksportojnë produktet e tyre në vendet e BE-së dhe CEFTA-së që përfshijnë produktet bazë të metaleve, pijeve, prodhimit të letrës dhe produkteve të saj, produkte të gomës dhe plastikës, produktet nga përpunimi i drurit etj. Megjithatë, tregtia e brendshme është më e përhapur se sa tregtia e jashtme.

Eksportuesit përballen me disa sfida të cilat pengojnë zhvillimin normal të tregtisë dhe rritjen më të shpejtë e cila do të mund të ndodhte në rast se këto pengesa nuk do të ekzistonin. Sfidat përfshijnë:

- Barrierat jotarifore që përfshijnë kërkesat e tepërta për dokumentacion dhe kontrolle të tepërta në kufij
- Pengesat institucionale siç janë përgaditja e dokumenteve dhe pagesa shtesë për eksport
- Informaliteti
- Kufizimet nga vizat
- Mungesa e llojllojshmërisë së produkteve të prodhuara
- Progres i kufizuar në cilësinë dhe inovacion të produkteve

Prandaj për rritjen e tregtisë së brendshme lokale dhe rritjen e eksportit është e nevojshme zvogëlimi sa më i madh i mundshëm i këtyre barrierave dhe eliminimi i tyre. Kjo të bëhet përmes krijimit të politikave tregtare që zvogëlojnë minimalisht procedurat administrative, kontrollet e tepërta të produkteve që mund të konsiderohen të panevojshme, heqja e pagesave shtesë që ekzistojnë për produktet për eksportit. Krijimi i favorshëm i një politike monetare dhe fiskale

do të stimulonte bizneset prodhuese të rrisnin inovacionin dhe llojlojshmërinë e produkteve të tyre. Këto politika përfshijnë përmirësimin e mundësive kreditore dhe heqjen e obligimeve fiskale komunale.

1.2.8 INDUSTRIJA

Komuna e Lipjanit ka një histori të pasur të industrisë dhe sektorit biznesor, sidomos sektorit të prodhimtarisë. Pas viteve të 70-ta një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve shoqërore kanë qenë aktive, si nxjerrja dhe përpunimi i magnezit, prodhimi i letrës dhe produkteve të saj, përpunimi i metaleve të ngjyrosura, etj. Kanë ekzistuar kooperativa të shumta bujqësore, si dhe miniera e thëngjillit në Babush dhe Feronikeli. Ndërmarrje të mëdha veçohen nxjerrja dhe përpunimi i Magnezitit në Golesh, Fabrika e letres dhe kartuçit dhe e ambalazhit, përpunimi i metaleve të ngjyrosura “Metalac” në Janjevë, Kooperativa Bujqësore me njësitë e saj, Miniera e thëngjillit Babush, ferma e pulave dhe peshkataria, mbushtorja e Coca-Colës, seperacioni i gurthyesit në Gadime, Feronikeli, Termoventi etj. Të gjitha këto kanë dhënë kontribut domethënës në zhvillimin ekonomik të Komunës.

Pas viteve 2000, me privatizimin e shumicës prej ndërmarrjeve nuk është vazhduar veprimtaria e tyre dhe si rrjedhojë sektori i bizneseve ka marrë kahje tjetër, duke u orientuar në tregti, ndërtim dhe bujqësi, përderisa edhe industria përpunuese vazhdon të zgjerohet. Ky ndryshim i ndërrimit të industrive ka pasur ndikim në rritjen e papunësisë, në uljen e nivelit të zhvillimit ekonomik, dhe të mirëqenies së qytetarëve në përgjithësi.

Strukturat udhëheqëse komunale u angazhuan në kuadër të kompetencave të veta rreth stimulimit të bizneseve që të krijojnë ndërmarrje të reja private duke i favorizuar e në disa raste duke ju dhuruar edhe token në shfrytëzim për krijimin e kapaciteteve të reja prodhuese përpunuese dhe shërbyese, me qëllim të vetëm që të stimulojnë zhvillimin ekonomik, zbutjen e papunësisë, krijimin e një jete më të mirë për qytetarët e komunës.

Aktualisht në Komunën e Lipjanit zhvillohen veprimtari të ndryshme të prodhimtarisë në industrinë ushqimore, prodhimi i letrës, përpunimin e metalit, drurit, në fushën e energjisë së ripërtëritshme, etj. Ndër fabrikat më të mëdha janë fabrikat e letrave dhe paketave, tekstilit, fabrika e rrjetave metalike, ajo e Coca-Colës, e sheqerit, mishit, kërpudhave, fabrika për përpunimin e drurit, fabrika për prodhimin e materialeve të ndërtimtarisë, etj.


Numri i ndërmarrjeve prodhuese është më i lartë se ai i ndërmarrjeve përpunuese. Në vitin 2022 janë krijuar 13 ndërmarrje prodhuese të veprimtarive të ndryshme të cilat kanë punësuar 27 punëtorë, dhe nuk është krijuar asnjë ndërmarrje përpunuese.

Tabela 31. Trendet e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese dhe numri i punëtorëve¹⁰

	2018		2019		2020		2021		2022	
	Ndërmarrje	Punëtorë	Ndërmarrje	Punëtorë	Ndërmarrje	Punëtorë	Ndërmarrje	Punëtorë	Ndërmarrje	Punëtorë
Prodhim	70	171	74	175	80	186	83	195	83	195
Përpunim	233	634	251	697	272	753	301	841	310	856
Gjithsej	303	805	325	872	352	939	384	1036	393	1051

Nga viti 2018 deri në vitin 2022 numri i ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese është rritur për 30.9%, ndërsa numri i punëtorëve për 29.7%.

¹⁰ ARBK



Grafikoni 10. Trendet e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese dhe numri i punëtorëve

Gjatë 5 viteve të fundit trendi i punësimit në sektorin e industrisë me të gjitha aktivitetet e saj kishte rritje mesatarisht prej 4.8%.

Tabela 32. Trendet e fuqisë punëtore në sektorin e industrisë

	2018	2019	2020	2021	2022
Total	979	1056	1130	1229	1259

Projeksionet për periudhën e ardhshme 8 vjeçare presin rritje prej 5% të fuqisë punëtore në sektorin e industrisë.

Tabela 33. Projeksionet e fuqisë punëtore në sektorin e industrisë

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Total	1322	1388	1457	1530	1607	1687	1772	1860	1953

Industria e përpunimit të metaleve - Në komunën e Lipjanit veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e konstruktiveve metalike (dyer, dritare, tavolina, karrige edhe konstruksione kulmi e ndërtimi) kombinim i llamarinës dhe hekurit në sektorin privat, pastaj fabrika Termovent në Lipjan, Metallaci në Janjevë, etj.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashme të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mundë të zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të metaleve ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit, kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

Industria e përpunimit të drurit - Në komunën e Lipjanit veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të drurit: dyer, dritare, tavolina, karrige, por edhe konstruksione prej druri me të gjitha elementet konstruktive.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashme të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mundë të zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të drurit ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit, kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

Industria e përpunimit të plastikës - Në komunën e Lipjanit veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të plastikës kryesisht : dyer, dritare ndërsa vlenë të veqohet fabrika e plastikës në Janjevë e cila ka një seri bukur të madhe prodhimi me përdorim të gjerë.

Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj dege industriale do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashme të ndërtuara por edhe me ndërtimin e atyre të reja në pajtim me mundësitë dhe nevojat e tregut.

Kjo industri në të ardhmen mundë të zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin industrial të kësaj komune, meqë industria e përpunimit të plastikës ka asortiman mjaft të gjerë të prodhimit, kurse teknologjia e re krijon mundësi mjaft të gjera të aplikimit të këtyre prodhimeve, pothuajse në të gjitha degët industriale.

Industria e material-ndërtimit. - Në komunën e Lipjanit edhe se deri tani përpos në disa njësi që prodhohet zhavori nuk kemi zhvillime tjera. Në perspektivë mund të pritët një shtim i konsiderueshëm i llojit dhe i volumit të prodhimit në industrinë e materialit ndërtimor. Në teritorin e komunës ka rezerva të konsiderueshme të dunitëve të cilat janë shum cilësore dhe mundësojnë perspektivë reale të zhvillimit të industrisë ndërtimore.

Aktualisht kjo industri është e zhvilluar kryesisht në zonën kadastrale të Konjuh, ku kompani Po-Phix ka një asortiman të larmishëm të prodhimit të materialit ndërtimorë i përdorur si izolatorë dhe të tjera. Në të ardhëm parashihet zhvillimi i kësaj industrie edhe në Magure, Medvec, Sllovi, Gadime dhe Konjuh përshkak të rezervave të konsiderueshme të lëndës së parë siq janë: rezervat e dunitëve, rrës kuarcite, argjilës, etj dhe përshkak të pozitës së favorshme për të zhvilluar këtë lloj industrie.

Kjo do të realizohet me anë të shtimit të prodhimit në kapacitetet ekzistuese, si dhe me ndërtimin e kapaciteteve të reja, kur për këtë gjë krijohen kushtet përkatëse. Kushtet natyrore për një zhvillim me dinamik të kësaj industrie ekzistojnë.

Duhet bëhet zgjedhja e prodhimit e duke pasur parasysh veprimtarinë intensive të ndërtimit dhe kërkesën e përhershme, plasmani edhe për një kohë të gjatë nuk duhet te jete faktor kufizues ne zhvillimin e kësaj dege industriale.

Sfidat me të cilat përballët Komuna e Lipjanit në sektorin e industrisë kryesisht janë:

- Struktura industriale e pa definuar
- Infrastruktura e dobët e afarizmit afarizmin për shkak të kufizimit të faktorëve kryesorë që drejtojnë zhvillimin industrial
- Qasje e kufizuar në financa që mbështet bizneset
- Logjistikë e dobët dhe infrastrukturë e dobët energjetike
- Zhvillimi kufizuar i burimeve njerëzore dhe mungesë e punëtorëve të aftë
- Mungesa e një kornize të caktuar industriale nga ana e politikës institucionale

Nevojat

- Krijimi i qasjes më të lehtë në financa përmes reformimit të vazhdueshëm të sektorin financiar për të mbështetur në mënyrë më efektive zhvillimin industrial, veçanërisht NVM -të.
- Zhvillimi dhe funksionalizimi i zonave Ekonomiku (Qylagë, Vrellë Goleshit).
- Zhvillimi i korridoreve ekonomik (korridori N-25 në drejtim të Prishtinës, dhe N-2 drejtim të Ferizajt).
- Eksplorimi i potencialeve të zhvillimit të infrastrukturës për përdorim industrial
- Forcimi i koordinimit ndër-ministror përmes krijimit të një organi të pavarur që ndërton dhe mirëmban infrastrukturën për zhvillim më të lehtë industrial.
- Lehtësimi i procedurave administrative të cilat kërkojnë shumë kohë
- Përmirësimi i ambientit biznesor për investime të huaja direkte (IHD)
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të përgatitura përmes rritjes së buxhetit që është i dedikuar për trajnimin e tyre
- Krijimi i një baze të fortë për lehtësimin e kërkimit dhe zhvillimit dhe inovacionit
- Marrja e hapave për zgjerimin e tregut në lehtësimin e integritet të ekonomisë së Komunës së Lipjanit në tregjet globale.
- Zhvillimi i zonave turistike si potencial për zhvillim ekonomik;
- Promovimi dhe zhvillimi i agro-turizmit në zonat si: Vërbicë, Hanroc, Krojmir, Kleqkë, Divjakë, Gadime e Epërme, Zllakuqan, Kraishtë.

Struktura industriale e Komunës nuk është e larmishme. Siç u përmend më lart, industria e tanishme e është shumë e përqendruar në sektorë të kufizuar si bujqësia dhe disa industri prodhuese që kërkojnë fuqi punëtore. Ato janë të angazhuara në aktivitete që krijojnë vlerë të ulët të punës, siç është industria e tekstilit. Shumë pak është investuar në sektorin e prodhimit, pjesërisht për shkak të importit dhe gjithashtu për shkak të mungesës së përgjithshme të një klime të favorshme për investime. Si pasojë, Komuna tregon një varësi të konsiderueshme të importit në shumë materiale dhe pjesë industriale. Komuna duhet të prodhojë mallra me vlerë më të lartë në mënyrë që përfundimisht të arrijë diversifikimin industrial në sektorin e prodhimit, i cili duhet të stimulojë rritjen ekonomike afatgjatë.

1.2.9 RESURSET TURISTIKE

Komuna e Lipjanit është ndër komunat me turizmin kulturor dhe natyror më të pasur në vend, të cilat njëherit paraqesin edhe potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës. Rrjedhimisht, ky sektor është ndër prioritetet kryesore të komunës për hartimin e politikave zhvillimore. Ekonomia e vizitorëve luan një rol të rëndësishëm në GDP-në e komunës, dhe kur menaxhohet mirë, rritja e numrit të vizitorëve mund të rris ndjeshëm mundësinë për investime dhe rritjen mirëqenies së qytetarëve. Turizmi i brendshëm kulturor dhe natyror është ndër përparësitë më të mëdha të komunës, së bashku me resurset nëntokësore.

Komuna e Lipjanit karakterizohet me një sërë kapacitetesh të veçanta turistike të cilat frekuentohen si për aspektin edukativ, po ashtu edhe për kulturë dhe rekreacion. Ndër veçoritë më karakteristike turistike natyrore janë: Shpella e Mermertë e Gadimes, Parku nacional “Blinaja”, Lumi Sitnica, bukuritë e peisazheve Shalë-Kleqkë dhe vargmalet e Zhegovcit.

Gjithashtu Komuna e Lipjanit në aspektin kulturor është shumë e pasur me asete kulturore me vlerë të lartë. Fshati Janjevë është një vendbanim shumë i vjetër me kultura të ndryshme dhe infrastrukturë dhe potencial të madh turistik.

Vlerësimi në aspektin e shfrytëzimit dhe zhvillimit të këtyre zonave, vërehet një menaxhim i dobët në aspektin e ofrimit të infrastrukturës, mungesë e zhvillimit të aktiviteteve në këto zona.






Figura 5. Potencialet turistike

Turizmi natyror: - Zona malore e komunës shquhen me potencial të madh. Në këto zona parashikohet të zhvillohet infrastruktura dhe përmbajtjet për sporte malore si shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërim. Këto aktivitete të rekreacionit planifikohen së bashku me shërbimet e akomodimit privat nëpër fshatra duke ofruar me qira shtëpitë në fermat të cilat mund të sjellin të ardhura shtesë për fermerët. Po ashtu dhe planifikohen disa vikend zona në Janjevë, Brusë, Akllap, Hanrofc, Shisharë, Gadime, Plitkoviq, Ribarë i Madhë, Kraishtë, Vërshevc, Krojmirë, Shalë, Kleçkë, etj.

Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqesin pikat e atraksioneve turistike.

Gadimja si qendër e kosovare e monumentit natyror paraqet një atraksion të veçantë kombëtar dhe ndërkombëtar. Mundësitë e mira të zhvillimit të zonës në tërësi kombinohen me turizmin malor, kulturor, me turizmin e gjuetisë në malet e Zhegovcit si dhe atraksionet tjera që dalin nga ndërtimi i liqenit të Gadimes. Resurset të pasura natyrore janë uji, uji termal dhe termo mineral, pyjet, biodiversiteti, etj. **Trashëgimi e pasur kulturore** me rëndësi të madhe në nivel kombëtar janë Janjeva, Kleçka, Shala, Gadimja, Lipjani etj.

Trashëgimi arkeologjike gjinden në Gadime dhe Bainscë, pastaj **trashëgimi arkitektuale** në Janjevë, Kleçkë, Gadime, etj.

Komuna e Lipjanit posedon **Trashëgimi shpirtërore** shumë të pasur, e cila përfshinë format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.

Trashëgimia e pasur natyrore (peizazhe, monumente të natyrës, trungje të vjetra, monumente gjeomorfologjike etj), Fenomene gjeomorfologjike në Gadime, si Shpella e Mermertë në Gadime, Epigjenia e lumit Gadime, etj. Pastaj, trungje të vjetra, Kapacitetet për turizëm rinor dhe kongresial, Në Janjevë arkitektura e vjetër e cila është duke u rikonstruuar, është një mundësi ideale e zhvillimit të turizmit rural, pastaj mbajtja e orëve letrare “Shtjefën Gjeqovi” si dhe monumente dhe objekte tjera e bëjnë Janjevën një lokalitet të shkëlqyeshëm turistik.

Resurset njerëzore vetëm sa e zgjerojnë ofertën turistike. Prandaj në të ardhmen duhet parashihet rrjeti i pikave atraktive turistike të lidhura mirë në mes veti.

Turizmi rural - është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e lartpërmendura kemi edhe fermerë të cilët mund të ofrojnë shërbime të akomodimit duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë dhe blegtorisë, natyrës dhe gjahut.

Turizmi agrar – dallon në masë të vogël nga turizmi rural në atë mënyrë turizmi agrar është i fokusuar në zonat me perimkulturë të zhvilluar dhe peisazhe që mund të krijohen nga kjo kulturë bujqësore. Mundësi e mirë e këtij turizmi mund të bëhet në Banullë, Konjuh, etj.

1.2.10 BUJQËSIA

Komuna e Lipjanit karakterizohet si vend bujqësor dhe bujqësia është dege e rëndësishme e ekonomisë në nivel komunal.

Ekonomi familjare bujqësore është një familje ose komunitet i njerëzve, ku anëtarët e saj janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor ose dytësor, që kanë një menaxhim të vetëm, duke përdorur mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Ekonomia Familjare Bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, për konsum vetanak ose për të dyja.

Komuna e Lipjanit karakterizohet si vend bujqësor dhe prandaj është degë shumë me rëndësi e ekonomisë në nivel komunal. Me sipërfaqe të përgjithshme të territorit komunal prej 33,847.75 ha, sipërfaqja e tokës bujqësore është 15,138.91 ha, apo më saktësisht 44.28% e tërë sipërfaqes së territorit të Komunës. Bazuar në sipërfaqen totale për shfrytëzim të Tokës si tokë bujqësore vërejmë që Lipjani si komunë është mjaft e pasur me sipërfaqe për Tokë bujqësore dhe gjithashtu një meritë të veçantë ka edhe forma kompakte e vendbanimeve në zona rurale me një shtrirje shumë të vogël në toka bujqësore.

Komuna e Lipjanit ka 10,304 ha sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore, ndërsa rreth 5,000 ha janë sipërfaqe të mbuluar për kullosa.

Kompanitë bujqësore që operojnë në Komunën e Lipjanit janë kryesisht pronësi individuale, pa ndonjë strukturë të përcaktuar e të qartë organizative. Arsyet kryesore pse janë krijuar këto biznese janë tradita familjare, mungesa e punësimit, dhe identifikimi i mundësive për fitim.


Shumica e prodhuesve bujqësorë janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël janë ndërmarrje bujqësore. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore është në pronësi private dhe përdoret nga familjet për bujqësi ekzistenciale.

Bujqësia është degë e rëndësishme e ekonomisë së komunës së Lipjanit, vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël i prodhuesve janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Përkundër potencialit, sektori i bujqësisë përballët me sfida dhe pengesa zhvillimore, një pjesë e të cilave janë potencuar në vazhdim. Barrierat mund të grupohen në produktivitetin e ulët, çmimet e ulëta dhe kosto të larta. Trendi i humbjes së tokës bujqësore, madhësia e kufizuar e parcelave të tokës se punueshme, papunësia e lartë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, si dhe mungesa e shkathtësive profesionale në shfrytëzimin e makinerisë dhe teknologjisë bujqësore paraqet një pengesë kryesore në zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, edhe blegtoria ballafaqohet me kufizime zhvillimore për tu përballur me kushtet dhe konkurrencën e tregut, për shkak të ekzistimit të fermave të vogla. Me madhësinë e fermës ndërlidhet shumë edhe mundësia e shfrytëzimit të teknologjive të reja, implementimi i teknikave dhe të arriturave të reja shkencore, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e koston dhe në shtimin e prodhimit bujqësor.

Ashtu si është potencuar me lartë bujqësia është e orientuar në ekonomi të vogla familjare, është një numër i vogël i ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari bujqësore me rreth 238.

Në Komunën e Lipjani sipas regjistrit të ndërmarrjeve bujqësore të ARBKS kemi rreth 238 ndërmarrje bujqësore dhe 438 ferma familjare, por nëse ndalemi të statistikave të vitit 2014, komuna kishte 9,497 ekonomi familjare apo 6,412 ekonomi bujqësore.



Grafikoni 11. Numri i ndërmarrjeve bujqësore në komunën e Lipjanit

Tabela 34. Projektionet e numrit të ndërmarrjeve bujqësore

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Ndërmarrje	260	284	311	340	372	407	445	487	533

Sipas burimeve të njëjta për vitin 2014, deri në atë vit të punësuar të rregullt në ekonominë shtëpiake bujqësore dhe bizneset individuale ishin 14,338 punëtorë, të kategorizuar në disa kategori, punëtorë sezonal ishin 1,175 punëtorë.

Tabela 35. Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (ASK 2014)

	Numri i të punësuarve
Fuqia punëtore - Gjithsej	14,338
Bartësit	6,211
Anëtarët e familjes së bartësit	6,748
Të punësuarit e rregullt në ekonominë familjare bujqësore dhe bizneset individuale	141
Të punësuarit e rregullt në subjektet juridike bujqësore	57
Fuqia punëtore jofamiljare, që nuk punon rregullisht (punëtorët sezonalë)	1,175
Fuqia punëtore, që nuk është e punësuar drejtpërdrejt nga ekonomia bujqësore (punëtorë të kontraktuar)	6

Potenciali bujqësor akoma nuk shfrytëzohet sa duhet. Kjo për arsye të mungesës së politikave të duhura dhe mungesës së angazhimit në masë të duhur. Ndër të tjera, pasojë është edhe buxheti i kufizuar i ndarë për këtë sektor, qoftë në formë të subvencioneve, investimeve, trajnimeve, apo në mënyra të tjera. Shkaqet e rendimenteve të ulëta të bimëve janë: mos aplikimi në masë të duhur i masave bashkëkohore agroteknike, mosnjohja e duhur e teknologjisë së proceseve të prodhimit, përdorimi në përmasa jo të mjaftueshme i farës me potenciale të larta gjenetike, përdorimi jo i mjaftueshëm i mjeteve teknike bashkëkohore si dhe tokat e parregulluara bujqësore.

Me analizimin e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin më të shpejtuar të prodhimit bujqësor, është konstatuar se një ndër faktorët me rëndësi limituese është toka e pa rregulluar, të cilën e karakterizojnë ngastrat e vogla dhe të shpërndara të ekonomisë në sektorin individual. Kjo gjendje e tokës nuk mundëson aplikimin e masave bashkëkohore agroteknike në masë të duhur si dhe përdorimin e makinave dhe stabilimenteve tjera në procesin e prodhimit në formë racionale.

Humbja e tokës bujqësore: Sfida më e madhe si në nivelin nacional dhe atë lokal është mbrojtja e tokës bujqësore nga humbja apo ndryshimi i destinimit, duke ditur se zhvillimet më të madha kanë ndodhur dhe po ndodhin përkatësisht në tokat më të mira bujqësore. Sipas analizave të bëra në komunën e Lipjanit çdo vite humbet tokë bujqësore e kualitetit të

lartë përkatësisht klasa 1-4 si pasojë e zhvillimeve hapësinore si: objekte banimi, objekte komerciale/afariste, infrastrukturës rrugore dhe si rezultat i saj niveli nacional ka hartuar ligje në aspektin e mbrojtjes së tokës bujqësore ku komunat obligon që me dokumente hapësinor të definojë dhe planifikoj tokën bujqësore.

Sipërfaqja e mbetur prej 15,138.91 ha tokë bujqësore është e ndarë në parcela me sipërfaqe jashtëzakonisht të vogla, të cilat gjenden pothuajse të tërta në pronësi private. Vlerësohet se rreth 36 ha tokë bujqësore humben me ndërrim të destinimit respektivisht me ndërtime. Gjithashtu, tokat pjellore përgjatë lumenjve i nënshtrohen konkurrencës së zgjerimit të vendbanimeve dhe industrisë. Në të njëjtën kohë është prezentë edhe dukuria e shpyllëzimit, për shkak të prerjes së pakontrolluar të pyjeve.

Nga analizat hapësinore presioni më i madh i humbjes së tokës bujqësore apo vendbanimet që kanë presionin në vazhdimësi me vite të tëra janë: Grackë e Vjetër, Hallaqë i Vogël, Rufv i Vjetër, Banullë, Glllogoc, Gumnasellë, Gadime e Eperme dhe Poshtme, Llugaxhi etj, në këto vendbanime duhet të merren masa më rigorozë në aspektin e parandalimit apo ruajtjes së tokës bujqësore.



Figura 6. Demtimi i tokës bujqësore nga ndërtimet

Duke pasur parasysh humbjen e tokës bujqësore kryesisht tokat kualitative klasës I-IV atëherë propozohet që në disa zona do të bëhet edhe rritja apo hapja e tokave të reja për shfrytëzim bujqësor (hapja e sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje të ulëta, rrafshinat dhe bregoret e mundshme) Intensifikimi i zhvillimit të bujqësisë, krahas investimeve kërkon edhe zoonimin e sipërfaqeve bujqësore i cili është bërë me këtë planë (ruajtja e tokës bujqësore dhe reduktimi i shndërrimit të saj për destinime tjera e sidomos për ndërtim është trajtuar gjatë fazave të më hershme dhe janë planifikuar kufijtë ndërtimor të vendbanimeve, sipërfaqet të cilat nuk gjenden brenda kufijve ndërtimor apo kufijve që përcaktojnë ndonjë zhvillim të mundshëm jo bujqësor do të konsiderohet si tokë bujqësore dhe do të ruhet e zhvillohet si e tillë).

Për ruajtje të drejtë të tokës bujqësore propozohet që disa zona me tokë kualitative të zhvillohet komasacioni bujqësor në menyrë që të aplikohet shfrytëzim racional të tokave bujqësore. Zona të përshtatshme për aplikim të komasacionit bujqësor janë: Topliçan, Babush i Muhaxherve, Gumnasellë, Hallaq i Madh, Ribar i Vogël, Kraishtë.

Fragmentimi i tokës bujqësore: Fragmentimi si proces në komunën e Lipjanit është i theksuar dhe si rezultat i saj sjell probleme të mëdha në ruajtjen menaxhimin dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore në formë racionale.

Fragmentimi i tokës dëshmon të jetë pengesa kryesore kur bëhet fjalë për përdorimin e tokës përkundrejt politikave për zhvillim bujqësor në vend. Më pas, ekziston një sektor i polarizuar bujqësor me disa prona të mëdha dhe një sektor të madh të pronave të vogla. Struktura e shpërndarjes së madhësisë ilustron me rreth 80% të numrit të fermave që janë më pak se 4 ha dhe të fragmentuara. Vetëm 0,6% e fermave janë më shumë se 10 ha. Për këtë mund të shtohet se procesi i nënndarjes në trashëgimi po vazhdon. Madhësia mesatare e një ferme për një ekonomi familjare është 2-3 ha tokë bujqësore e punueshme, zakonisht e fragmentuar në 6- 8 parcela kadastrale. Madhësia mesatare e parcelës kadastrale është 0.30 ha.

Si rezultat i zhvillimeve në aspektin e fragmentimit ministra e bujqësisë dhe zhvillimit rural ka hartuar ligjin për mbrojtjen e tokave bujqësore ku në kuadër të këtij ligji ka parashtruar masat që duhen të aplikohen në këtë aspekt.

Masat kundër fragmentuese janë:

- toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e se cilës është ≤ 0.50 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela;
- toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela.





Figura 7. Fragmentimi i tokave bujqësore Lipjan

Drithërat - Prodhimi i drithërave në Lipjan është rritur në dy vitet e fundit, sipas të dhënave statistikore kultivimi i Grurit dhe Misrit si dy kulturat kryesore, Gruri dhe Misri në shumicën e vendeve të botës konsiderohet si kulturë strategjike, si kultura të tillë ka edhe rëndësi të madhe ekonomike, sidomos nëse kultivohet në sipërfaqe të mëdha. Me rritjen e subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë kemi një rritje të drithërave të cilët dominojnë sipërfaqet e mbjellura si Gruri dhe Misri duke pasur nga Elbi dhe Tërshëra. Sipërfaqja e mbjellur me Grurë në vitin 2022 ka qene 4,354 ha, ndërsa Misri ka qene me 3060 ha, Elbi me 25 ha, dhe Tërshëra me 73 ha. Duke analizuar të dhënat e dy viteve të fundit të kultivimit të drithërave në Komunën e Lipjanit vërehet një rritje me një mesatare prej rreth 40%.

Kryesisht gruri është kulturë e klimës kontinentale, temperaturat më të favorshme për mbirje të farës janë 14-20 C, ku mbin për 5-7 ditë. Në temperaturë 7-8 C mbin për 17-20 ditë, ndërsa në temperatura më të ulëta mugullon dhe mbin edhe më ngadalë.

Pra, të dhënat mbi prodhimtarin e drithërave në Komunën e Lipjanit japin një indikacion të qartë të orientimit të sektorit të bujqësisë në kultivim të drithërave, andaj ky sektorë duhet të prioritetizohet duke mundësuar zhvillimin e sipërfaqeve të reja dhe rritjen e prodhimtarisë për ha.




Grafikoni 12. Trendet e prodhimitarisë së drithërave

▪ **Prodhimi dhe përpunimi i pemëve dhe perimeve**

Prodhimi vendas i pemëve dhe perimeve është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite, Pemëtaria si një sektor strategjik çdo ditë e më shumë gjen rritje të sipërfaqes si dhe rendimentit në nivelin kombëtar por edhe në atë lokal. Kultivimi i mollës, dardhës, kumbullës, lajthisë, arrës çdo vite ka një rritje të sipërfaqeve të kultivimit kjo duke falënderuar granteve qeveritare si dhe atyre lokale.

Komuna e Lipjanit ka të zhvilluar Pemëtarin, sa i përket prodhimitarisë se pemëve ekziston një sipërfaqe prej 119 ha. Dhe me këtë shihet një interesim me i madh dhe për çdo vit kemi ngritjen e pemishteve të reja. Prej pemëve kryesisht kultivohet molla, dardha, kumbulla, qershia, vishnja etj. Pjesa tjetër e prodhimitarisë se pemëve i takon kultivimit të tyre në kopshte dhe oborre për konsum familjar. Problemi kryesor i këtij sektori është plasmani jo i sigurt i prodhimeve dhe mënyra e ruajtjes në depo. Komuna e Lipjanit, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë duhet të fokusohet në ndërtimin apo bashkëpunimin me pikat grumbulluese, ku fermerët mund të kenë të lehtë sigurimin e tregut për produktet e tyre bujqësore të prodhuara



Grafikoni 13. Trendët e prodhimit të pemëve

Prodhimi i arrorëve dhe pemëve të imëta është rritur gjithashtu ndjeshëm dhe pritet të rritet ende si rezultat i mbjelljeve së fundmi, të nxitura nga skema e mbështetjes nga qeveria dhe donatorë të ndryshëm.


Shumica e prodhimeve të freskëta mbledhen nga grumbullues/shitës shumice dhe shiten në tregjet e pemëve-perimeve dhe dyqanet tradicionale të pakicës. Krijimi i një rrjeti tregjesh shumice ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e prodhuesve që ndodhen larg zonave kryesore urbane për të tregtuar produktet e tyre. Qarkullimi i produkteve të freskëta të vendit në zinxhirët e super-marketeve është relativisht i vogël.

Perimtaria ka potencial të madh për zhvillimin ekonomik të Lipjanit. Tradicionalisht sektori perimor ka qenë më i organizuar dhe më i zhvilluar krahasuar me sektorët tjerë të bujqësisë. Zhvillimi i perimtarisë është i mundshëm si rezultat i kushteve të volitshme klimatike. Ndërsa, perimtaria ofron mundësi për të gjeneruar punësim dhe të ardhura për një numër të madh të familjeve.

Prodhimi i perimeve është njëra nga degët kryesore të prodhimtarisë bimore, viteve të fundit sipas të dhënave të DBZHR, kultivimi i perimeve ka një ngritje të kultivimit të kulturave kryesore të perimeve si: Patatja, Lakra, Shalqini, Pjepri etj.

Perimet sipas të dhënave të nxjerra nga programi i pagesave direkte kemi këtë trend të zhvillimit prodhimit të perimtarisë e cila ka një rritje graduale vite pas viti në sipërfaqen e mbjellura në Komunën e Lipjanit. Sipërfaqja e mbjellur me patate ka qenë 80 ha, ku ka një rritje të sipërfaqes nga viti 2021. Sipërfaqja me specë ka qenë e mbjellur rreth 17 ha, nëse ndalemi tek viti 2022 ka një rritje të sipërfaqes të kësaj kulture në raport me vitin 2021. Sipërfaqja e mbjellur me lakër ka qenë rreth 14 ha. Domatja po ashtu ka një rritje në vitin 2022, ku sipërfaqja e mbjellur me domate ka qenë vetëm rreth 0.77 ha. Qepa nuk ka ndonjë lëvizje të madhe në raport me vitin 2021, në vitin 2022, sipërfaqja e mbjellur ka qenë rreth 73 ha.

Andaj, duke ditur rendësinë e kultivimit të kulturave perimtare në aspektin e të ushqyerit të qytetarëve të Lipjanit por edhe në aspektin ekonomik atëherë komuna duhet të orientojë investimet dhe përkrahjen e fermerëve me potencial të lartë të kultivimit të perimeve.



Grafikoni 14. Trendët e kultivimit të perimeve

Infrastruktura dhe shërbimet përkatëse të pasvjeljes (ambientet e dhomave frigoriferike, linjat e ambalazhimit/paketimit etj.), janë të kufizuara, por megjithatë ka pasur rritje të numrit të tyre si rrjedhojë e mbështetjes së ministrisë së bujqësisë dhe donator të ndryshëm. Ndërsa ambientet e kufizuara të dhomave frigoriferike dhe humbjet e mëdha të produkteve si rrjedhojë e mungesës së tyre kanë qenë për vite me radhë shkaku kryesor i deficitit të lartë në tregtinë e produkteve pemtarë dhe perimtare, kapacitetet e ruajtjes në dhoma frigoriferike janë rritur në vitet e fundit. Skemat e subvencionit të qeverisë dhe forcimi i konsoliduesve, një kategori tregtarësh më afër fermerëve (e përfshirë si në shitjen e inputeve bujqësore fermerëve, ashtu edhe në grumbullimin e produkteve nga fermerët), po kontribuon ngadalë në përmirësimin e situatës. Aktualisht, grumbulluesit janë akteret më aktivë në zinxhirin e vlerës.

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve përbëhet nga disa ndërmarrje formale dhe disa punishte informale gjysmë industriale që ofrojnë një gamë të gjerë frutash dhe perimesh të përpunuara.

Sektori ka një fokus të qartë të plotësimit të kërkesës së brendshme dhe të zëvendësimit të importeve. Megjithatë, nisur nga mundësitë që ekzistojnë, prioritet duhet të marrë gjithashtu promovimi i eksporteve.

Sektori i pemëve dhe perimeve karakterizohet nga kushte të përshtatshme klimatike që mundësojnë prodhimin e hershëm të disa lloje frutash dhe perimesh, të cilat përbëjnë gjithashtu një **potencial** të rëndësishëm për sa i përket mundësive të eksportit, ky është sot një realitet i prekshëm i provuar me eksporte në rritje të pemëve dhe perimeve.

Prodhimi i pemëve dhe perimeve përballet ende me **sfida** të ndryshme, përfshi informalitetin e sektorit të materialit mbjellës, kostot e larta të inputeve të blera dhe lëndës djegëse (që prekin veçanërisht serrat me ngrohje), produktivitetin e ulët dhe humbjet e mëdha të pasvjeljes, sidomos në rastin e pemëve. Standardet e sigurisë ushqimore të pemëve dhe perimeve janë gjithashtu një sfidë për t'u adresuar që të rriten eksportet drejt tregjeve të shteteve anëtare të BE.

Zhvillimi i industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve është penguar nga vështirësitë për të siguruar lëndën e parë për industrinë e përpunimit në sasi të mjaftueshme dhe cilësinë e kërkuar. Me rritjen e ofertës nga ferma, kjo vështirësi është më pak e rëndësishme se në të kaluarën, por industrinë në këtë sektor po ndeshen akoma me mjaft vështirësi; menaxhimi i dobët i zinxhirit të vlerës - kontratat formale ose joformale mes industrisë dhe fermave - nuk ka ndihmuar për sa i përket sigurimit të ofertës së lëndës së parë nga ferma për industrinë e përpunimit. Çmimet e larta të energjisë dhe lëndës djegëse dhe të ambalazhimit (kryesisht i importuar) janë një shqetësim i madh për përpunuesit. Ndërkohë që zinxhirët e shkurtër të vlerës kanë qenë një avantazh deri tani, zgjerimi i zinxhirit të supermarketeve pritet të transformojë zinxhirin e vlerës duke shkaktuar konkurrencë më të drejtpërdrejtë nga furnizuesit e huaj, çfarë nënkupton se prodhimi dhe përpunimi në komunën e Lipjanit ka nevojë për mbështetje të mëtejshme në rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e zinxhirit zhvillimor të sektorit të bujqësisë.

▪ **Industria bujqësore, përpunimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore**

Agrobiznesi në Lipjan për rëndësinë e madhe që ka për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe të gjitha hallkave kryesore të zinxhirit ushqimor vitet e fundit i është kushtuar një rëndësi më e madhe për investime si nga sektori publik dhe nga sektori privat veçanërisht qendrave të grumbullimit.

Qendrat e grumbullimit, standardizimit, ambalazhimit, paketimit, ruajtjes në kushte të përshtatshme dhe tregtim me destinacion tregun vendas dhe për eksport janë shtrirë në të gjithë territorin e komunës. Numri dhe investimet në këto qendra që shërbejnë për të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor kanë një rritur nga viti në vit.

Industria agro-përpunuese në Lipjan është në zhvillim e sipër nga potencialet të qenësishme për investime, veçanërisht për perimet, frutat dhe prodhime blegtorale. Ndër produktet e zgjedhura, Prodhuesit primar të lëndëve të para aktualisht po bashkëpunojnë me kompanitë agro-përpunuese, për t'u dhënë zgjidhje disa problemeve që lidhen kryesisht me: Kostot e larta të lëndëve të para vendase, mungesa e likuiditetit, standardet dhe cilësia, fragmentimi dhe mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit. Ndërsa në lidhje me përpunimin dhe marketingun e produkteve problematike është informaliteti në tregun e brendshëm. Përsa i përket "Menaxhimit të Biznesit" në këtë hallkë të zinxhirit ushqimor, problemet kryesore lidhen me gjetjen e punonjësve të specializuar dhe qasja në financim. Gjithashtu, mungesa e certifikatave të pronës dhe pasiguria e lartë në lidhje me pronësinë e tokës ka penguar e ndaluar disa nga kompanitë e agropërpunimit, që të investojnë dhe zgjerohen.

Momentalisht sektori i bujqësisë ballafaqohet me sfida dhe probleme të ndryshme duke filluar nga prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore.

Zingjiri prodhues i sektorit të bujqësisë sipas vlerësimit të gjendjes has në vështirësi gjatë hallkave duke mos funksionuar për arsye të mos kompletimit të zingjirit në mungesë të planifikimit mbi investimet në industrinë bujqësore.

Sektori i industrisë bujqësore sipas vlerësimit të gjendjes ekzistuese është relativisht pak i zhvilluar për kundër rritjeve ndër vite por, duke ditur potencialet bujqësore të cilat posedon kjo komunë, realisht ekziston një numër i vogël i bizneseve që ushtrojnë veprimtarin në përpunimit dhe ruajtjes së produkteve bujqësore, më shumë ky sektor është i orientuar në grumbullim dhe pastaj produktet e grumbulluara eksportohen në kompani më të mëdha jashtë komunës apo edhe jashtë vendit.

Mungesa e një zonë të agro-biznesit në komunë ka ndikim që ky sektor të jetë jo i zhvilluar dhe me një decentralizim apo shtrirje të bizneseve bujqësore në hapësira të ndryshme të komunës ku qasja e fermerëve është me vështirë.

Komuna e Lipjanit si nyje kryesore e zhvillimit ekonomik, sipërfaqeve të mëdha të tokave bujqësore të kualitetit të mirë posedon potencial në zhvillimin e sektorit të industrisë bujqësore si përpunimin e pemëve dhe perimeve, përpunimin e qumështit, përpunimi i drurit dhe sektorë tjerë bujqësor.

Potencialet mbi zhvillimin e agrobiznesit në komunën e Lipjanit:


- Mundësi në rritja e nr. bizneseve me karakter bujqësor;
- Planifikimi i zonës të agro-biznesit si nyje ekonomike;
- Potencial në diferencimi i agro-biznesit;
- Traditë e fermerëve në prodhim dhe përpunim të produkteve bujqësore.
- Zhvillimi i pikave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve;
- Zhvillimi i fabrikave për përpunim të dridhërave.

Blegtoria - Momentalisht fondi i bagëtisë mbahet kryesisht për qumësht, për majmëri (mish) dhe produkte të tjera. Ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare të cilat kultivojnë kafshë për nevoja familjare dhe një font 1,614 krerë gjedhe, me ferma të mesme dhe ato komerciale. Nga të dhënat e siguruar nga komuna numri i kafshëve është në ulje viteve të fundit pra me një trend negativ të fondit blegtoral, por duke pasur parasysh kushtet gjeografike të cilat i ka komuna e Lipjanit numri i fondit blegtoral pa dyshim mund të dyfishohet apo trefishohet.


Ekzistojnë kushte ideale për zhvillimin e blegtorisë ngase Lipjani ka sipërfaqe te mjaftueshme bujqësore dhe me një bonitet të lartë, pastaj kullosa te pasura dhe te pashfrytëzuara. Edhe ne këtë sektor edhe pse ka përmirësime ka mjaft probleme të cilat duhet evituar. Sektori gjendemi në fazën ekstensive të prodhimtarisë. Infrastruktura jo e mirë e

shtallave, përqindja e racave të mira ende është e ulët dhe prodhimtaria jo e standardizuar e qumështit dhe e mishit. Kostoja e prodhimit ende është e lartë, çka i bën fermerët të mos jenë konkurrent në treg. Viteve të fundit sektori i bujqësisë ka filluar të ketë përmirësime ndoshta jo të mëdha por ka hapa përpara në këtë drejtim duke filluar me rritjen e buxhetit të Drejtorisë së Bujqësisë, rritja e subvencioneve, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, rregullimi i kanaleve që parandalon përmbytjen e tokave bujqësore apo erozionin. Krijimi i politikave bujqësore, për ruajtjen dhe menaxhimin e tokës bujqësore.

Duke ditur rendësin e blegtorisë në zhvillim ekonomik, krijim të vendeve të punës, duhet të ndërmerret masa që ky trend negativ të ndërpritet dhe të fillohet investime konkrete në përkrahjen e fermerëve në rritjen e numrit kafshëve përkrahje në përmirësimin racor si dhe përf forcimin e zingjirit prodhues dhe përpunues të këtij sektori.



Grafikoni 15. Koncentrimi i krerëve të gjedheve në komunën e Lipjanit



Grafikoni 16. Koncentrimi i krerëve të kafshëve të imta në komunën e Lipjanit

Në bazë të analizave sfidat kryesore në kuadër të sektorit të blegtorisë dhe industrisë së përpunimit të produkteve blegtorale është decentralizimi i ndërmarrjeve përpunuese, zgjidhja me e mirë në aspektin e funksionimit të këtyre veprimtarive është centralizimi përmes krijimit të politikave dhe strategjive zhvillimore duke krijuar hapësira dhe

infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive, standardet e sigurisë ushqimore dhe të mjedisit duhet që të përmirësohen dhe të respektohen. Cilësia e qumështit të papërpunuar dhe gjendja mikrobiologjike është problematike, ndërkohë që kushtet e transportit janë të papërshtatshme, shpesh pa përdorur tanke ftohës. Në shumicën e rasteve nuk ka trajtim të ujërave të përdorura dhe të mbetjeve të përpunimit të qumështit (p.sh. laktozës). Mungesa e specialistëve të kualifikuar (teknologjia e përpunimit të qumështit, laboratorit etj.) në zonat rurale është një nga faktorët që ka penguar dhe do të vazhdojë të pengojë, përveç zbatimit të dobët të ligjit, zbatimin e standardeve të sigurisë dhe të mjedisit.

Për sa u përket aspekteve ekonomike të sektorit, ka disa kufizime, përfshirë përmasën e vogël të fermave, konkurrueshmërinë në rritje nga importet (pjesë e liberalizimit të tregtisë dhe zgjerimit të zinxhirëve të supermarketeve).

Prioritet sektori blegtorisë për këtë sektor do të jetë krijimi i strategjisë për centralizimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese, rritja prodhimi për plotësimin e kërkesës së tregut të brendshëm, investime në zinxhirin e ruajtjes dhe përpunimit në fermë, mbështetja do të synojë edhe përmbushë standardet e sigurisë së ushqimit, edhe ato të mjedisit, ndërtimi i pikave grumbulluese të qumështit, ndërtimi i fabrikave për përpunim të produkteve blegtorale (jogurti, djathi, gjiza, mishi etj.).

Të gjeturat kyçe në sektorin e Bujqësisë:

- Bujqësi ekstensive familjare, numër shumë i vogël i fermerëve komercial;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për qasje me te lehte për fermerët.
- Hapja e kanaleve dhe parandalimi i erozionit të tokave nga vërshimet.
- Humbje të vazhdueshme të tokave kualitative bujqësore, mos menaxhim i duhur i tyre (nevoja për zonim);
- Rritje e prodhimit të drithërave dhe perimeve, por jo mjaftueshëm me potencialet që ka Lipjani;
- Mungesa e pikave grumbullimi dhe përpunimi të pemëve dhe perimeve, mos kompletimi i zingjirit prodhues;
- Fondi i ulët blegtoral;
- Përpunim i produkteve blegtorale në shkallë të ulët;

Prioritetet nevojat për zhvillim:

- Fuqizimi i agro-industris në komunën e Lipjanit (pikave grumbulluese dhe përpunuese);
- Fuqizimi i sektorit të drithërave si potencial në komunën e Lipjanit (rritja e sipërfaqeve me drithëra dhe krijimi i hapësirave për grumbullim dhe përpunim të drithërave);
- Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore (rrugëve bujqësore, kanaleve drenazhese dhe ujitjes, fermave etj);
- Përkrahje në fuqizimin e blegtorisë (rritja e fondit blegtoral dhe përmirësimi racor);
- Fuqizimi i sektorit të përpunimit të produkteve blegtorale (pika grumbulluese të qumështit, përpunimi i produkteve blegtorale);
- Fuqizimi i agro-turizmit (planifikimi dhe zhvillimi i zonave me potencial turistik).

Analiza SWOT - BUJQËSIA	
Përparësitë	Dobësitë
- Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike shumë të favorshme për zhvillimin të bujqësisë (agrobiznesit); - Resurset natyrore: 44% tokë bujqësore, 44.20% tokë pyjore, dhe resurse ujore të bollshme; - Toke bujqësore kualitative; - Sipërfaqe të mëdha të kullosave; - Ndërmarrje për përpunim dhe grumbullim të produkteve bujqësorë; - Potenciale të mjaftueshme njerëzore me përgatitje	- Humbje rreth 36 ha tokë bujqësore çdo vite; - Ndotje e tokave bujqësore; - Mungesa e organizimit të fermerëve (kooperativa bujqësore); - Prodhimtaria e ulët dhe cilësia jo e kënaqshme e produkteve bujqësore; - Mungesë e informimit apo vëdiqjesimit për ruajtjen e tokës bujqësore; - Edukimi i pamjaftueshëm i fermerëve në përputhje

profesionale dhe me moshë të re; - Kapacitetet të konsiderueshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale; - Kapacitetet e prodhimit të fidanëve të pemëve, analizimi dhe kontrolli i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale; - Potencial për zhvillim të agroturizmit; - Qasja në rrugë nacionale dhe regjionale; - Potencial për zhvillim të shpeztarisë; - Organizim i panairëve për promovim të sektorit të bujqësisë.	me trendët dhe mënyrat e reja të prodhimit; - Aplikimi i teknologjisë së vjetruar në prodhimin e produkteve bujqësore; - Pamjaftueshmëria e përkrahjes teknike për fermerë; - Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore - fragmentimi i tokave bujqësore; - Ndotja e kanaleve të ujitjes; - Mungesa e qasjes në tregje – mos funksionimi i pikave grumbulluese në tërë territorin e komunës; - Pamjaftueshmëria e shërbimeve këshillimore profesionale; - Mungesa e politikave dhe përkrahjes në zhvillimin e agroturizmit; - Mungesa e kompetencave në menaxhim të resurseve pyjore;
Mundësitë	Rreziqet
- Mundësi të shumta për prodhime finale; - Ndërtimi i infrastrukturës rrugore rurale në funksion të bujqësisë. - Futja e teknologjive të reja; - Dhenja e pronave komunale në funksion të bujqësisë; - Hapja e tregjeve të reja; - Konsolidimi i tokës bujqësore; - Mundësi qasje në programe e projekte për përfitim nga fondet dhe skemat mbështetëse të qeverisë dhe donatorëve; - Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e bujqësisë duke përfshirë subvencionet. - Mundësi e plasimit të mallrave në tregun e jashtëm; - Organizimi i fermerëve (bashkërendimi, koordinimi); - Mbrojtja e ekosistemit dhe biodiversitetit; - Rritja e subvencioneve për fermer	- Ndotja e tokës dhe resurseve të ujit; - Braktisja e fshatrave, interesimi i ulët i rinisë për veprimtari bujqësore; - Kosto e lartë, për realizimin e projekteve nga Komuna; - Mungesa e kredive të favorshme afatgjata; - Fuqia blerëse e popullsisë është e ulët; - Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore; - Qasja e kufizuar në mjete financiare për investime në Agrobiznes; - Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në bujqësi; - Konkurrenca e tregut nga importi; - Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; - Mungesa e fondeve; - Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në sektorin e Bujqësisë;

1.2.11 EKONOMITË PYJORE

Toka pyjore në Komunën e Lipjanit wshtw nw sipërfaqe prej 14,846.04ha apo 43.86% të gjithë territorit të Komunës. Kjo sipërfaqe ndahet në tri lloje të shfrytëzimeve ekzistuese, si:

- tokë pyjore 11480.76 ha
- zona të mbrojtura (Rezervati i Gjuetisë Blinaja) me sipërfaqe 2391.24 ha, dhe
- zona të veçanta (Kleçkë dhe Divjakë) me sipërfaqe 974.04 ha

Dëmet e shkaktuara pyjore në vitin 2022 ishin 220.16m³. Duke marrë parasysh nivelin e ulët të pyllëzimit që bëhet në

Komunën e Lipjanit, kjo sipërfaqe e dëmtuar brenda një viti është vlerësuar të jetë e madhe.

Tabela 36. Dëmet pyjore të shkaktuara gjatë vitit 2022

Lloji i paraqitjes	Nr. i fletëparaqitjeve	Vëllimi në m ³	Dëmi në €
Kundërvajtëse	133	207.14	29117.00
Penale	5	13.02	2100.00
Gjithsej	138	220.16	31217.00

Pylltaria është degë specifike e ekonomisë, në të cilën proceset e prodhimit janë të ngadalshme dhe ato nuk mund të ndryshohen shpejt. Kusht primar i zhvillimit afatgjatë të ekonomisë pyjore, në radhë të parë të prodhimit pyjor, është programimi më real i vëllimit dhe i strukturës së konsumit të prodhimit të nxjerrur nga eksploatimi i pyjeve dhe shtimi i funksioneve të përgjithshme të dobishme të pyllit.

Komuna e Lipjanit zonat e saj pyjore i ka të ndara në 7 terrene pyjore për të cilat kujdesen 7 pylltarë. Degradimi i pyjeve është një dukuri ekzistuese, ndonëse jo në masë të madhe, prandaj ekziston nevoja e pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura me këto lloje të fidanëve: pishë e zezë, bagrem, hartinë, hormoz, dhe dugllazi. Masat që duhet të merren në pyjet e reja artificiale janë tretmanet si prashitja, pastrimi dhe çlirimi i pyjeve.

Shndërrimi gradual i shkurreve në pyje të rregullta është masë tjetër që duhet të ndërmerret. Realizimi i këtij qëllimi mund të bëhet përmes pyllëzimeve meliorative, ndërsa vendet apo zonat në të cilat mund të bëhen këto veprime dhe se është e domosdoshme në fazën fillestare janë: Ribar i Madh, Qylagë, Akllap, Bregzi, Janjevë, Kraishtë, Teqe, dhe Varigoc.

Shndërrimi gradual (natyral, artificial) i pyjeve të ulëta në pyje të larta – Një veprim i tillë mund të bëhet përmes metodës së konversionit të pyjeve të ulëta në pyje të larta (me prejardhje prej farës), dhe përmes pyllëzimeve. Një punë e tillë merr kohë dhe mjete financiare.

Mirëmbajtja intensive e pyjeve të larta të ruajtura – për të pasur një menaxhim të mirë dhe pyje të qëndrueshme e sidomos ato me kualitete të larta, atëherë pyjet ekzistuese duhet të ruhen, përthihen dhe menaxhohen në atë mënyrë që për vitet në vijim të mbeten së paku në gjendjen e tanishme e mundësisht edhe në gjendje të avancuar. Kjo arrihet përmes dy qasjeve:

Menaxhimi profesional i grumbujve pyjor pa marrë parasysh presionet e jashtme për prerje të shtuar

Dhe mbrojtja nga prerjet ilegale, zjarret, sëmundjet etj.


Zonat pyjore në të cilat duhet pasur kujdes dhe angazhim maksimal profesional me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të gjendje së pyjeve të larta janë zonat e pyjeve të: Kleçkës, Divjakës, Shalës, Krojmit, Ribarit, Vërshevcit, Blinajës, Koznicës, Hanrovcit, Brusit, Shisharës, Bukovicës, Shishicës, Akllapit, Janjevës, Slllovisë dhe Gadimes.

Kuadri profesional është një domosdoshmëri e cila duhet të jetë e realizueshme në mënyrë konsistente.

1.2.12 NDËRTIMTARIA

Sektori i ndërtimit në Kosovë vlerëson gjendjen aktuale të biznesit si shumë të mirë. 90 përqind e bizneseve të këtij sektori e vlerësojnë gjendjen aktuale si të mirë dhe të kënaqshme. Në vitin 2020 në kuadër të sektorit të ndërtimtarisë në Kosovë operonin 7,799 biznese aktive. Për dallim nga viti 2019 kishte pasur rritje të bizneseve aktive për 15%. Ndërsa shikuar nga aspekti i pjesëmarrjes së bizneseve aktive të sektorit të ndërtimtarisë në totalin e bizneseve aktive të gjithë sektorëve, bizneset e kësaj kategorie merrnin pjesë me 8%.

Numri i punëtorëve të deklaruar gjatë vitit 2020 nga kjo kategori e bizneseve është mbi 20 mijë dhe të deklaruar nga 3,269 biznese. Në formë grafike janë paraqitur krahasimet mes viteve 2018-2020 për numrin e punëtorëve të deklaruar dhe të numrit të bizneseve që kanë deklaruar për punëtorë.



Grafikoni 17. Numri i tatimpaguesve që kanë deklaruar për punëtorë dhe numri i punëtorëve në nivel vendi¹¹

Në Komunën e Lipjanit ndërtimtaria është veprimtaria e tretë më e madhe, me gjithsej 541 ndërmarrje të regjistruara dhe 692 punëtorë të deklaruar në vitin 2022. Në dekadën e fundit ajo ka pasur një zhvillim të vonshëm duke u rritur për 135.2% gjatë periudhës 2012-2022.

Tabela 37. Trendet e sektorit të ndërtimtarisë

Nr.	Lloji i njësisë	2019		2020		2021		2022	
		Njësi	m ²	Njësi	m ²	Njësi	m ²	Njësi	m ²
1	Apartamente	2675	224145	2804	239217	2859	244895	2460	207121
2	Bujqësore	15	2441	15	2441	15	2441	15	2441
3	Depo/magazinë	75	37722	75	37722	76	37962	76	37747
4	Dyqan	1245	325080	1235	327012	1233	326973	1224	325773
5	E braktisur	18	1983	13	1643	32	3127	30	3127
6	E paklasifikuar	13	1877	13	1877	20	2591	20	2591
7	E papërfunduar	1689	352065	1662	349695	1634	347090	1627	347543
8	Fabrikë	95	67096	100	69659	97	68959	97	68959
9	Fushë sportive	1	60	1	60	1	60	1	60
10	Fushë sportive e hapur	3	1474	3	1474	3	1474	3	1474
11	Fushë sportive e mbyllur	8	7873	9	7843	8	7088	8	7088
12	Garazhë/parking	56	9650	168	20385	174	21726	170	20673
13	Hotel	10	4203	10	4203	10	4203	10	4203
14	Komerciale e pashfrytëzuar	263	78255	294	78114	292	78197	288	77837
15	Pasuritë e pashfrytëzuara	357	36518	242	27434	243	27655	241	27494
16	Pishinë dhe fushë sportive	8	5751	8	5751	8	5751	8	5751
17	Punishte	113	14908	108	14699	108	14699	107	14644
18	Restorant	12	3893	12	3893	12	3893	12	3893
19	Shtëpi	10617	1377693	9990	1336531	10109	1350986	10731	1375154
20	Zyre	169	32081	333	78705	1545	233762	2422	370051
21	Të tjera	328	41902	399	64902	400	65231	407	65917
	Gjithsej	17770	2626670	17494	2673260	18879	2848763	19957	2969541

¹¹ Analizë mbi sektorin e Ndërtimtarisë – ATK, Prishtinë, 2021

Ndërtimtaria zë vend me rëndësi në ekonominë e komunës së Lipjanit. Ajo duhet të fuqizohet në kuptimin e inkuadrimin të numrit të madh të të punësuarve në profile të ndryshme. Funkcionalisht ndërtimtaria duhet të jetë ngushtë e lidhur me zhvillimin e të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe joekonomike. Zhvillimi intensiv i ndërtimtarisë do të vazhdojë të jetë i kushtëzuar edhe në pajtim me kapacitetet investive për zhvillimin e ekonomisë dhe të veprimtarive sociale.

Prognozat në sektorin e ndërtimtarisë me të gjitha kategoritë e saj janë pozitive. Deri në vitin 2031 njësitë do të kenë rritje prej 13% me 6% rritje të m².

Tabela 38. Projektionet e sektorit të ndërtimtarisë deri në vitin 2031

Nr.	Lloji i njësisë	2023		2026		2031	
		Njësi	m ²	Njësi	m ²	Njësi	m ²
1	Apartamente	2780	219548	4011	261485	7390	349927
2	Bujqësore	17	2587	24	3082	45	4124
3	Depo/magazinë	86	40012	124	47655	228	63773
4	Dyqan	1383	345319	1996	411281	3677	550387
5	E braktisur	34	3315	49	3948	90	5283
6	E paklasifikuar	23	2746	33	3271	60	4377
7	E papërfunduar	1839	368396	2653	438765	4888	587167
8	Fabrikë	110	73097	158	87059	291	116505
9	Fushë sportive	1	64	2	76	3	101
10	Fushë sportive e hapur	3	1562	5	1861	9	2490
11	Fushë sportive e mbyllur	9	7513	13	8948	24	11975
12	Garazhë/parking	192	21913	277	26099	511	34927
13	Hotel	11	4455	16	5306	30	7101
14	Komerciale e pashfrytëzuar	325	82507	470	98267	865	131504
15	Pasuritë e pashfrytëzuara	272	29144	393	34711	724	46451
16	Pishinë dhe fushë sportive	9	6096	13	7261	24	9716
17	Punishte	121	15523	174	18488	321	24741
18	Restorant	14	4127	20	4915	36	6577
19	Shtëpi	12126	1457663	17497	1736100	32236	2323294
20	Zyre	2737	392254	3949	467181	7276	625193
21	Të tjera	460	69872	664	83219	1223	111365
	Gjithsej	22551	3147713	32539	3748977	59952	5016977

Ndërtimtaria do të vazhdojë të zhvillohet me ritëm të shpejtë sikur deri tani, e cila po ashtu do të ketë rëndësi në rritjen e punësimit. Sigurimi i infrastrukturës së duhur duhet të jetë i dobishëm për të udhëhequr zhvillimin urban nga investitorët privatë. Zonat e reja të banimit do të zhvillohen përreth zonës së qendrës duke shfrytëzuar potencialet e zhvillimit.

Krahas zhvillimit të ndërtimit duhet bërë të mundshme prodhimin serik të materialeve të ndërtimit dhe të elementeve ndërtimore, në shumë lokalitete ka lëndë të parë mjaft cilësore. Modernizimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të tashme si dhe ndërtimi i të rejave mund t'i plotësojnë në tërësi nevojat edhe për një territor shumë më të gjerë. Lipjani ka edhe kompani ndërtimore me renome kombëtare siç janë kompania ndërtimore “Dino”, “Stubla”, “POFIX” e disa të tjera më të vogla.

1.2.13 PASURITË NATYRORE

Në Komunën e Lipjanit ekzistojnë pothuajse të gjitha lëndët e para minerale, në sasi dhe cilësi të lartë. Më të rëndësishme janë lëndët e para minerale energetike dhe pikërisht linjiti. Pastaj ekzistojnë lëndët e para minerale të metaleve, rezervat

e xehes së Nikelit, pjesërisht Hekurit, Kromit, Kobaltit. Ekzistojnë edhe rezervat e lëndëve të para jo metalore, rezervat e magnezitit, dunitëve, materialeve të ndërtimit gëlqerorëve, rërave kuarcore, rërave dhe zhavorreve, etj.

Duke qenë se të dhënat për rezervat e të gjitha llojeve të resurseve minerale janë të viteve të më hershme, ato duhet të merren me një rezervë të caktuar. Megjithatë, të gjitha resurset dhe rezervat e lëndëve të para minerale qofshin ato energjetike, metalore dhe jo metalore, të cilat janë premtuese për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Nga ana tjetër, këtë e vënë në dukje problemi i gjendjes jo të mirë të minierave ekzistuese, si dhe problemet lidhur me rezervat e disa lëndëve minerale dhe mundësitë e eksploatimit të tyre për një periudhë më afatgjatë. Kjo parashtron nevojën urgjente që të bëhen programe dhe këto programe të vihen në prioritet të Komunës së Lipjanit që përmes financimit të projekteve për kërkimin-hulumtimin dhe eksploatimin e këtyre resurseve minerale të gjenerohet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Vendburimet e qymyrit ndodhen në vendbanimin Babush. Eksploatimi i qymyrit në Minierën e Babushit ishte bërë gjatë viteve të 80-ta. Po ashtu rezerva të konsiderueshme të qymyreve në komunën e Lipjanit janë vazhdimësi e Basenit qymyror të Kosovës.

▪ Lëndët e para minerale të metaleve

Xeheroret e Hekurit – Nikelit silikat

Eksploatimi më intensiv i xeherorit silikat të Fe-Ni në vendburimin e Gllavicës ishte nga viti 1985 e deri në vitin 1990. Në vitin 1997 e deri 2005, kjo minierë pushoi aktivitetet e saj. Në vitin 2005, vendburimi Fe-Ni „Gllavica” u privatizua dhe pas fazës së përgatitjeve dhe revitalizimit të infrastrukturës filloi eksploatimi e kësaj xeheje. Vendburimi “Gllavica” përfshinë sipërfaqe prej 1.008.000 m², por nuk kufizohet vetëm brenda këtij kufiri. Mineralet kryesore të xeherorit në këtë vendburim janë: pumeliti, nontroniti, garnjeriti dhe serpentiniti. Llojet e xeherorizmit janë: limoniti, garnjeriti dhe serpentini. Ky vendburim është vendburim i korës së prishjes që lidhen me masivet ultramafik. Rezervat e xehes së Hekurit – Nikelit në vendburimin „Gllavica” janë:

- Kategoria B: 4.608.720.00 ton
- Kategoria C1: 2.746.621.00 ton
- Gjithsej: B + C1 7.355.341.00 ton

Tabela 39. Përmbajtja e metaleve sipas kategorive

Lloji i metalit	Kategoria B	Kategoria C1
Nikel (Ni)	1.35%	1.30%
Kobalt (Co)	0.07%	0.042%

▪ Xeheroret e Kromit

Në masivin ultramafik të Goleshit janë zbuluar disa shfaqje mineralizuese të xeherorit të Kromit, por hulumtime më të detajuara mbi mineralizimet e këtij lloji mungojnë. I gjithë masivi i Goleshit është i mbuluar në një masë të madhe me punimet hulumtuese të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara për hulumtime të xeherorit silikat të Nikelit dhe Magnezitit, por një gjë e tillë nuk është bërë për kërkimin e mineralizimeve të Kromit.

Sa i përket mineraleve të jometaleve, ato kanë një përhapje të konsiderueshme në Komunën e Lipjanit, të cilat gjithashtu janë të dislokuara në pjesën perëndimore të Lipjanit.

Në masivin e Goleshit ndodhen po ashtu gurë, më saktësisht në Opali, në serpentinite.

▪ Dunitet

Në pjesën juglindore të shpateve të masivit ultramafik të Goleshit, në afërsi të vendbanimit Medvec, gjendet vendburimi i Dunitëve. Ky vendburim ndodhet në largësi rreth 14km nga qendra komunale e Lipjanit. Ky shkëmb paraqet një resurs mjaftë me interes për zhvillimin e Komunës së Lipjanit për shkak të vetive mjaftë cilësore për prodhimin e tullave zjarrruduese fosterike.

Të dhënat lidhur me sasinë e Dunitit ende mbeten të pa njohura. Në këtë drejtim, në të ardhmen do të ishte mirë që të

përgatiten projekte hulumtuese dhe verifikuese për cilësinë dhe sasinë e Duniteve në masivin ultramafik të Goleshit.

- **Lëndët minerale për prodhimin e xhamave të ngjyrosur dhe për ndërtimtari**

Në Komunën e Lipjanit ekziston një vendburim i rërës kuarcore në fshatin Sllövi. Sasia e kësaj lënde minerale sillet rreth 7 milionë ton. Punimet gjeologjike në hulumtimin dhe shfrytëzimin e saj janë kompanitë private të cilat kanë të siguruar edhe tregun për prodhimin e bllokave të silikaporit.

Në industrinë e qelqit dhe prodhimin e pajisjeve sanitare deri më tani janë verifikuar këto rezerva:

- Katetgoria A: 1.382.000.00 ton
- Kategoria B: 5.165.000.00 ton
- Kategoria C: 2.126.000.00 ton
- **Gjithsej: A + B + C 8.673.000.00 ton**
- **Lëndët minerale për prodhimin e materialeve zjarrduruese**
- **Vendburimi i Magneziti, „Golesh”- Magurë**

Miniera dhe industria e magnezitit „Golesh” ndodhet në vendbanimin Magurë, rreth 12m në pjesën perëndimore të qytetit të Lipjanit. Kjo minierë cilësohet si njëri ndër vendburimet më cilësore të magnezitit, jo vetëm në Ballkan por edhe më gjerë. Pjekja e magnezitit në këtë minierë daton që nga viti 1928. Në bazë të njohjes së minierës, vlerësohet se në këtë vendburim ekzistojnë 2.500.000.00 ton rezerva të kategorisë C2.

- **Vendburimi i Magneziti në vendbanimin Leletiq**

Është vendburim i llojit rrjeto. Ndodhet në shpatin jug-perëndimor të masivit ultramafik të Goleshit. Përfshinë një zonë 300 – 400 m, dhe shtrihet nga vendbanimi i Leletiqit deri te punimet e vjetra minerare të vendbanimit Mirenë. Rezervat gjeologjike në këtë vendburim janë:

- Kategoria A: 59.851.00 ton
- Kategoria B: 184.747.00 ton
- Kategoria C1: 264.420.00 ton
- **Gjithsej: A+ B+ C1 509.018.00 ton**
- **Vendburimi i Magneziti „Gropa e Arushës” në Medvec**

Është vendburim i tipit damaror. Me anë të punimeve hulumtuese gjeologo –minerare është ndjekur damari kryesor nga sipërfaqja dhe pjesërisht me një galeri të ndërtuar në katin 781.50m. Rezervat gjeologjike të magnezitit në këtë vendburim janë:

- Kategoria C1 186.426.00 ton
- Kategoria C2 125.729.00 ton
- **Gjithsej : C1 + C2 321.156.00 ton**

Lënda e parë e magnezitit përdoret kryesisht për prodhimin e zjarrdruësve magnezial dhe magnezit kaustik. Kjo industri konsumon gati 90% të prodhimit të përgjithshëm të magnezit. Me cilësinë e lëndës zjarrdruëse, magneziti përdoret për prodhimin e pluhurit metalurgjik, tullave magneziale, kromomagneziale e të tjera. Këto prodhime përdoren gjerësisht në industrinë e shkrirjes së çelikut të acidit sulfurik, të çimentos etj.

Magneziti në Golesh ekziston në sasi prej 3,000,000 ton. Në industrinë kimike magneziti përdoret për prodhimin e sulfatit të magnezit për prodhime farmaceutike, në industrinë e letrës të gomës, ngjyrës, sheqerit, në keramikë etj. Në industrinë e ndërtimit përdoret për prodhimin e çimentos speciale magneziale (çimentos soret) si dhe për materiale termo-izoluese, produkte abrazive, ngjyrë zjarrdruëse etj.

- **Lëndët e para ndërtimore**
- **Vendburimi i mermerëve të dollomitizuara**

Ky vendburim ndodhet në vendbanimin Babush i Muhaxherëve, në pjesën jugore të Komunës. Vendburimi mermerit të dollomitizuar ndodhet në lartësi mbidetare nga 580 – 650m, lartësi e cila ka krijuar kushte të favorshme për eksplotimin

sipërfaqësor. Përveç që përdoret si material mbushës për rrugë etj., përdoret edhe si shkëmb ndërtimor në ndërtime të ulëta.

Sipas analizave kimike, mermeri i dollomotizuar përmbanë: oksid të kalciumit, oksid të manganit dhe dioksid karboni (CaO, MgO, CO₂)

Vendburimi i shkëmbit gëlqerorë në Shalë

Ndodhet në lokalitetin "Klisura", në largësi nga vendbanimi i Shalës vetëm 200m. Ndodhet në pjesën perëndimore të Lipjanit në largësi rreth 25km. Vendburimi i shkëmbit gëlqeror "Klisura", detajisht është hulumtuar nga Enti për Hulumtime Gjeologjike dhe Gjeofizike "Geozavod" nga viti 1959.

Rezervat gjeologjike të shkëmbit gëlqerorë janë:

- Rezerva të kategorisë A: 1.822.937.6 ton
- Rezerva të kategorisë B: 9.013.458.3 ton
- **Gjithsej: A + B 10,836,396.50 ton**

- **Vendburimi i gëlqerorëve „ Pojata”- Shalë**

Rezervat gjeologjike gjithsej: 1.002.788.28 m³

- **Vendburimi i gëlqerorëve të mermerizuar „ Mirena”- Mirenë**

Rezervat gjeologjike gjithsej: 1.451.234.12 m³

- **Vendburimi i gëlqerorëve „ Baicë”- Baicë**

Rezervat gjeologjike gjithsej: 1.191.998.38 m³

Rezerva të konsiderueshme të shkëmbit gëlqeror në komunën e Lipjanit ndodhen në vendbanimet Krojmirë, Baicë në Malet e Blinajës (Lipovicë) të cilat do të kenë një perspektivë në të ardhmen për Komunën e Lipjanit.

- **Aluvionet e Lumit Sitnica**

Trasat e aluvioneve të lumit Sitnica kanë shtrirje të rëndësishme hapsinore përgjatë rrjedhjes së tij, dhe burimet e dala në formimet e tyre. Mund të jenë të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijes të kësaj ane të Kosovës. Trashësia e formimeve është e ndryshme; në afërsi të Vushtrisë sillet deri në 10m, përderisa në tërë sipërfaqen e Lipjanit arrin trashësinë deri në 15m, ose edhe më afër Batuses trashësia shkon deri 33 m. Ndonjë hulumtim më i detajuar i këtij tereni nuk është bërë në këto aluvione.

Përpos lëndëve të para minerale dhe jominerale, në fshatin Torinë të Komunës së Lipjanit ekziston edhe gaz natyror i cili është zbuluar në dy puse. Origjina e këtij gazi natyror është produkt i prezencës së qymyrove dhe vendi i paraqitjes së gazrave i përket zonës periferike në pjesën jugë-perëndimore të pellgut qymyrbajtës të Kosovës. Ky gaz natyror ka përmbajtje të metanit, nuk është në sasi të mëdha dhe ka presion të ulët, prandaj është vlerësuar se nuk paraqet mundësi për zhvillim ekonomik.

Rezerva më të mëdha potenciale të gazit natyror nuk mund të priten duke u bazuar në kushte dhe ndërtimin gjeologjik në të cilën ndodhet baseni qymyrbajtës i Kosovës.

Sipas të dhënave të Agjencionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve të Kosovës, në Komunën e Lipjanit operojnë 18 operatorëve aktiv në nxjerrjen dhe shfrytëzimit të pasurive nëntokësore. Këto ndërmarrje gjinden në vendbanime të ndryshme, si Gadime, Mirenë, Aklap, Plitkoviq, Glavic, etj.

1.2.14 INFRASTRUKTURA ENERGETIKE

Nëpër territorin e Komunës së Lipjanit kalojnë largpërçuesit e niveleve të tensioneve të larta 400KV; dhe 110 si dhe të nivele të tensionit të mesëm 35KV. Komuna fillimisht është furnizuar përmes LP 110kv radial, ndërsa më vonë është ndërtuar edhe një LP 110KV i dyfishtë 110KV i cili tashmë furnizon Lipjanin në mënyrë alternative nga TS 220/110KV Prishtina 4 dhe 400/220/110KV Kosova B.

Rrjeti energjetik në Komunën e Lipjanin nuk funksionon me kapacitetet e veta si pasojë e rrjetit të vjetërsuar të instalimit i cili është bërë shumë vite më herët. Si pasojë e ndërprerjeve të shpeshta, shkaktohen dëme në procesin prodhues dhe

në procesin e zhvillimit të aktiviteteve të tjera të ndërmarrjeve të Komunës. Prandaj, përmirësimi i këtij rrjeti duhet të jetë ndër prioritetet e para të Komunës, në mënyrë që të krijohet stabilitet në këtë fushë dhe të mos jetë sfidë për investimet potenciale në të ardhmen.

Konsumi i energjisë në Komunën e Lipjani edhe në të ardhmen do të vazhdojë të mbështetet në Termocentralin në Obiliq. Megjithatë, Komuna duhet të tentojë të arrijë një shkallë të furnizimit të pavarur me energji, përmes alternativave të energjisë së ripërtëritshme që i posedon mjaftë me bollëk.

Prania e rezervave të mëdha të linjit nën tokën e Lipjanit mundëson një zhvillim të mirë në fushën e energjetikës dhe sidomos në industrinë energjetike. Për këtë arsye dhe qëllim në komunën e Lipjanit propozohen 4 zona të shfrytëzimit të mundshëm të linjitet, këto zona janë:

ZL-I. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 105ha dhe shtrihet kryesisht në zonën kadastrale të Dobrajës së Madhe.

ZL-II. Kjo zonë ka një sipërfaqe 223.85ha dhe shtrihet në zonat kadastrale Rufc i Vjetër, Rufc i Ri, Dobrajë të Madhe dhe Torinë.

ZL-III. Sipërfaqja e kësaj zone është 158.1ha dhe shtrihet në zonën kadastrale Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël dhe Rufc i Ri.

ZL-IV. Kjo zonë shtrihet në pjesën jug-lindore të komunës së Lipjanit dhe ka sipërfaqe 69.96ha, ndërsa shtrihet në komunën kadastrale të Babushit të Muhaxhirëve dhe Gadime të Ulët. Në këtë zonë shtrihet edhe ish miniera e linjitet, ku linjiti është nxjerr deri në thellësi 100m.

Burime të mundshme potenciale janë biomasa (ashkla, mbeturina organike, mbetje të bimëve), energjia diellore dhe pa dyshim uji edhe gjeotermale. Për realizimin e të gjitha këtyre fillimisht është e nevojshme të bëhen studimet të fizibilitetit, të cilat duhet të përqendrohen në potenciale natyrore të zonave përkatëse.

Në vendbanimet e paraqitura në tabelën më poshtë përqindja e sipërfaqeve komerciale që nuk janë në shfrytëzim është e ulët. Prandaj nuk paraqitet nevoja për krijimin e sipërfaqeve shtesë që të zhvillohen aktivitete komerciale, sepse supozohet se ka sipërfaqe të mjaftueshme komerciale që i plotëson kërkesat e afaristëve.

Tabela 40. Sipërfaqet komerciale të shfrytëzuara nën 50%

Nr.	Numri i klientëve komercialë			
	Vendbanimi	Klientë aktivë	Klientë pasivë	Diferenca në %
1	Banullë	7	4	42.86%
2	Gllavicë	3	2	33.33%
3	Glllogoc	3	4	-33.33%
4	Hallaqi i Vogël	10	7	30.00%
5	Janjevë	42	63	-50.00%
6	Lipovicë	#N/A	#N/A	0%
7	Magurë	73	51	30.14%
8	Okosnicë	#N/A	#N/A	#N/A
9	Qylagë	10	8	20.00%
10	Ribar i Madh	15	8	46.67%
11	Rufc i Ri	13	7	46.15%
12	Silovi	41	31	24.39%
13	Smallushë	9	7	22.22%
14	Shisharkë	0	0	0%
15	Teqe	0	0	0%
16	Topliqan	8	6	25.00%
17	Vërshëc	5	5	0.00%
18	Zllakuqan	1	2	-100.00%
	Gjithsej	240	205	

Në pjesën më të madhe të vendbanimeve të Komunës së Lipjanit sipërfaqja e përgjithshme komerciale e pashfrytëzuar është e lartë, që do të thotë se këto sipërfaqe shfrytëzohen në masë të madhe për aktivitete komerciale. Prandaj, ka nevojë për destinim të sipërfaqeve të reja për zhvillimin e aktiviteteve komerciale.

Në fshatin Akllap p.sh. Bukovicë, Krojmir, etj. duhet të ketë më shumë sipërfaqe për destinim komercial, sepse ekziston sipërfaqe e madhe pasive.

Tabela 41. Sipërfaqet komerciale të shfrytëzuara mbi 50%

Nr .	Vendbanimi	Numri i klientëve komercialë			Nr .	Vendbanimi	Numri i klientëve komercialë		
		Klientë aktivë	Klientë pasivë	Diferenca në %			Klientë aktivë	Klientë pasivë	Diferenca në %
1	Akllap	19	2	89.47%	25	Lipjan	1148	181	84.23%
2	Babush i Muhaxherve	28	6	78.57%	26	Lipovicë	#N/A	#N/A	0%
3	Baicë	14	1	92.86%	27	Llugaxhi	69	12	82.61%
4	Breg i Zi	2	0	100.00%	28	Llugë	6	0	100.00%
5	Brus	3	0	100.00%	29	Marec	6	2	66.67%
6	Bujan	15	3	80.00%	30	Mirenë	6	2	66.67%
7	Bukovicë	8	2	75.00%	31	Okosnicë	#N/A	#N/A	0%
8	Divlakë	1	0	100.00%	32	Plitkoviq	1	0	100.00%
9	Dobrajë e Madhe	30	5	83.33%	33	Poturoc	19	8	57.89%
10	Dobrajë e Vogël	1	0	100.00%	34	Qellopek	17	1	94.12%
11	Gadime e Epërme	40	8	80.00%	35	Resinoc	6	1	83.33%
12	Gadime e Ulët	63	24	61.90%	36	Ribar i Vogël	5	2	60.00%
13	Gllanicë	2	0	100.00%	37	Rubofc	10	5	50.00%
14	Grackë e Vjetër	12	4	66.67%	38	Rufc i Vjetër	2	0	100.00%
15	Grackë e Vogël	7	0	100.00%	39	Shalë	39	11	71.79%
16	Gumnasellë	16	3	81.25%	40	Shisharkë	0	0	0%
17	Hallaç i Madh	3	1	66.67%	41	Teqe	0	0	0%
18	Hanroc	1	0	100.00%	42	Tërbuc	3	0	100.00%
19	Kleqkë	4	0	100.00%	43	Torinë	29	9	68.97%
20	Kojksë	5	2	60.00%	44	Varigoc	1	0	100.00%
21	Konjuh	13	2	84.62%	45	Vogaqicë	#N/A	#N/A	0%
22	Kraishtë	14	5	64.29%	46	Vrellë	2	0	100.00%
23	Krojmir	12	2	83.33%	47	Vrellë e Goleshit	2	0	100.00%
24	Leletiq	1	0	100.00%		Gjithsej	1688	304	

1.2.14.1 ENERGJIA EFIÇIENTE

Në fushën e efijencës së energjisë, komuna e Lipjanit ka zbatuar disa projekte renovimi me masat EE - përmirësimin e izolimit të ndërtesave, duke zëvendësuar një numër të kaldajave me kaldaja peleti dhe ndërrimin e ndriçimit publik me LED. Analiza e stokut të ndërtesave komunale, shërbimeve të ndriçimit publik dhe flotës komunale të automjeteve tregon se potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë në komunën e Lipjanit mund të vlerësohet në 2,796 MWh në vit, bazuar

në konsumin e raportuar të energjisë në vitin 2017.¹²

Komuna e Lipjanit në vitin 2018 ka publikuar “Planin Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) 2019-2021”, objektiva kryesore e të cilit ishte zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Lipjanit.

Një listë prioritare e projekteve për investime në fushën e EE në këtë plan përfshinte 5 projekte me një kursim të përgjithshëm të energjisë prej 166 MWh. Ky grup i projekteve prioritare ofronte një potencial të mirë për kurse me konsiderueshme të energjisë dhe kurse financiare. Projektet investive ishin të gjitha me prioritet komunal dhe që të pestat përfshinin ndërtesa arsimore.

Në Komunën e Lipjanit tashmë ekziston një kërkesë e madhe edhe për zhvillimin e bizneseve me panele solare. Përveç bizneseve, kërkesë e madhe ekziston edhe nga ekonomitë familjare. Krahas kësaj, energjia solare është ndër prioritetet e para të komunës dhe ajo ka bërë një shënim të vogël në këtë drejtim, ku së bashku me Drejtoratin për Planifikim në zonën Grackë është dhënë leje ndërtimore për ndërtimin e paneleve të energjisë solare, dhe janë duke u zhvilluar punime në 4 ha, për 3 MGW, dhe investitor është ProCredit Bank. Prandaj, nga komuna ka gatishmëri të madhe për përkrahje por që çështjet themelore ndërlidhen me Zyrën e Rregullatorit për Energji, prandaj roli i vendimmarrjes nuk është i tëri në duart e Komunës së Lipjanit.

Sfidë kryesore e investitorëve privat është mungesa e mundësisë së akumulimit të rrymës. Ata nuk i kanë të siguruara kanalet e shitjes, prandaj është sfiduese shitja e rrymës së prodhuar dhe kthimi i investimeve.

Përveç kësaj, ndër veprimet e para që duhet t’i ndërmerr Komuna është lehtësimi i procesit të marrjes së lejes nga ministria për zhvillimin e së drejtës për vendosjen e paneleve solare. Hapi i dytë duhet të jetë lehtësimi në hulumtimin e mundësive për sigurimin e kanaleve të shitjes së rrymës së prodhuar nga kjo mënyrë. Një mënyrë është krijimi i bashkëpunimit Biznes-Komunë, me ç’rast Komuna e blenë energjinë nga bizneset private dhe e përdorë për ngrohje qendrore në zonën urbane.

Një mënyrë tjetër më efiçiente e shfrytëzimit të resurseve natyrore në Komunë është prodhimi i energjisë së erës përmes mullinjeve të erës. Komuna e Lipjanit posedon ndër pjesët me të mira hapësinore, ku plotësohen të gjitha kushtet më të volitshme për ndërtimin e fluturakeve për akumulimin e erës për krijim të energjisë elektrike. Janë me mijëra hektarë ku me mbi 300 ditë kanë erë të mjaftueshme për krijimin e energjisë. Këto zona ndodhen në rrugën magjistrale Lipjan-Shitime. Prandaj paraqitet nevoja që Komuna të fillojë ta mbështesë dhe ta stimulojë këtë veprimtari. Në këtë mënyrë toka bujqësore nuk zaptohet me panele solare por shfrytëzohet për aktivitete bujqësore, sepse fluturaket apo mullinjtë e erës nuk pengojnë në zhvillimin e bujqësisë.

▪ Energjia solare

Meqenëse Lipjani ka kushte relativisht të mira klimatike me shumë ditë me diell, duhet të shqyrtohet mundësia e shfrytëzimit të energjisë diellore për energji termike si dhe përfitimi i energjisë elektrike përmes paneleve fotovoltike si qëllim afatgjatë. Në këtë kontekst është i preferueshëm shfrytëzimi i sipërfaqeve të kulmeve apo të ngjashme, me qëllim të kursimit të sipërfaqeve të lira tokësore.

Në këto raste duhet të praktikohet stimulimi i atyre që ndërtojnë objektet dhe shfrytëzojnë energjinë solare për ngrohje me lirime në përqindje nga taksat dhe pagesat për leje ndërtimi. Ndërsa zonat më të përshtatshme për këtë lloj energjie në Komunën e Lipjanit janë zonat që shtrihen në veri-lindje të Komunës, gjegjësisht në vendbanimet Sllavi, Akllap dhe Janjevë, por edhe në Babush të Muhaxherëve dhe Gadime ka mundësi të mira të ndërtimit të serave diellore.

▪ Biomasa

Në zonat rurale të cilat kanë nivel të lartë të prodhimtarisë bujqësore dhe pyjore, duhet të nxitet përdorimi i biomasës në mënyrë që të rriten mundësitë për energji, sidomos në fshatrat e largëta. Prodhimi i mëtutjeshëm i energjisë nga biomasa nxitë rritjen e prodhimtarisë bujqësore dhe i ruan vlerat vendore. Në këtë drejtim duhet mendohet edhe energjia e mundshme nga mbeturinat.

▪ Uji

¹² Komuna e Lipjanit, Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) 2019-2021

Komuna e Lipjanit është e pasur me resurse ujore nëntokësore dhe mbitokësore. Por, pasi që ekziston nevoja për ujitjen e tokave bujqësore, si dhe duke pasur parasysh edhe ndryshimet në mjedis siç është ngrohja globale që parashihet zvogëlimi i resurseve ujore, nuk preferohet ndërtimi i ndonjë hidrocentrali. Pra, burimet ujore nuk do të përdoren për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme.

▪ **Kursimi i energjisë**

Në kuadër të zonave urbane, e sidomos në ndërtesat që menaxhohen nga Komuna dhe ato të banimit kolektiv, konceptet e energjisë të bazuara në shembujt e kontraktimit ofrojnë forma efikase që iu mundëson autoriteteve vendore të zbatojnë masa bashkëkohore të kursimit të energjisë (p.sh. izolimi, sistemet efikase të ngrohjes etj). Përveç kursimit të mjeteve financiare, Komuna, përmes shembujve dhe përdorimit të energjisë, mund të ju ofrojë banorëve një potencial të madh në kursim.

1.2.15 INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Komuna e Lipjanit ka pozitë të volitshme gjeografike, të cilën e përshkojnë rrugët regjionale dhe autostradat, nyja kryesore hekurudhore dhe aeroporti ndërkombëtar, i vetmi në vend i cili gjindet në Komunën e Lipjanit. Duke e pasur parasysh këtë, strukturat udhëheqëse kanë krijuar zonat industriale në atë mënyrë që këto zona të kenë qasje direkte në infrastrukturë, njëherit që planet e caktuara zhvillimore t'i përfshijnë edhe zonat industriale. Kjo bën të mundur që këto lokacione të jenë pikë referuese mjaftë tërheqëse për investitorët potencialë. Në të ardhmen këto lokacione do të jenë jashtëzakonisht konkurrense në krahasim me lokalitetet e tjera dhe si kundërvlerë priten investime të drejtpërdrejta. Po ashtu, ndërtimi i hekurudhës, veçanërisht i stacionit hekurudhor qendror dhe sheshi i stacionit do të përshpejtojë potencialin e zhvillimit urban.

Ky është një koncept modern i qasjes dhe zhvillimit të të zonave industriale, ku mund të koncentrohen veprimtari të ndryshme prodhuese, shërbyese dhe financiare, etj. Komuna, përpos sigurimit të qasjes në infrastrukturë rrugore, investitorëve do t'ju sigurojë edhe infrastrukturë të gatshme teknike ku përfshihet kyçja në dhe qasja në rrymë, ujësjellës, kanalizim, dhe telefoni. Poashtu, investitorëve do t'u ofrohet edhe ndihmë në infrastrukturën ligjore, gjithëmonë sipas kapaciteteve të veta të cilat i posedon. Një koncept i tillë i qasjes bashkëkohore ka të bëjë me atë se mjeti e arsyetohet qëllimin.

1.2.16 BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL

Bashkëpunimi ndër komunal është i natyrshëm në një sistem administrativ territorial të decentralizuar. Sa më autonome të jenë komunat, aq më shumë mund të bashkëpunojnë.

Komuna e Lipjanit, duke qenë e kufizuar me 10 komuna të tjera, ka bashkëpunim të kënaqshëm me një pjesë të tyre. Këto bashkëpunime përfshijnë aktivitete në funksion të zhvillimit ekonomik më të shpejtë dhe të qëndrueshëm lokal, përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme qytetarëve dhe grupeve të interesit, kryesisht në aspektin afarist. Kjo ka rezultuar të jetë mënyrë më e mirë për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e funksionimit të komunave ndaj qytetarëve dhe kërkesave të palëve të ndryshme. Zgjerimi i bashkëpunimit qoftë komunal apo krijimit të incentivave për krijimin e bashkëpunimeve të sektorit privat, do të rriste zhvillimin e Komunës së Lipjanit dhe komunave të tjera të caktuara. Këto bashkëpunime mund të krijohen në trajnimin e fuqisë punëtore për zhvillimin e aftësive të tyre, koncentrimin e industrive në lokacione të përshtatshme për komunat përkatëse, shkëmbimi i punëtorëve që janë të përgaditur në profile të kërkuara, etj.

▪ **SWOT ANALIZA**

PËRPARËSITË

DOBËSITË

- Pozita e volitshme gjeografike, në raport me kryeqytetin dhe me qytet fqinjë,
- Shtrirja në territorin e komunës së Lipjanit i pjesës më të madhe të Aeroportit Adem Jashari,
- Privatizimi i Fero-Nikelit, Aeroportit dhe një sipërfaqe të tokës bujqësore,
- Ekzistimi i zonave të veçanta (zona e Blinajës, Shpellës së Gadimes, zona Kleqkë dhe Divjakës),
- Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, prodhuese, shërbyese etj.
- Ekzistimi i tokave të pëlleshme bujqësore,
- Ekzistimi i sipërfaqeve pyjore publike dhe privat -Ekzistimi i sipërfaqeve për kullosa ,
- Ekzistimi i minifermave,
- Ekzistimi i tregjeve javore,
- Ekzistimi i kushteve për turizmin rural,
- Ekzistimi i zonave dhe objekteve turistike të trashëgimisë,
- Ekzistimi i kushteve dhe objekteve për sport dhe rekreacion,
- Kapacitete njerëzore, humane dhe përgaditja profesionale e tyre,
- Ekzistimi i kapaciteteve për ndertim të hoteleve dhe bujtinave,
- Ekzistimi i resurseve për energji alternative (era, dielli etj),
- Ekzistimi i kapaciteteve tele-komunikuese dhe transportuese energjetike etj.
- Ekzistimi i linjës hekurudhore e cila kalon nëpër qytetin e Lipjanit dhe linjës Rrugore Prishtinë- Shkup,
- Aktiviteti ekonomik dhe Bruto produkti shoqëror është mbi mesataren e vendit,
- Një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve private dhe situata e favorshme për ndërmarrësi,
- Procedurat e thjeshta lokale për të hapur një biznes,
- Buxhet i qëndrueshëm i qeverisë lokale,
- Aktivitet të lartë në industrinë e ndërtimit,
- Prania e investitorëve të huaj,
- Sektori bankar i zhvilluar,
- Zonat industriale ekzistuese dhe disa zonave tjera për zhvillim ekonomik dhe pozicioni i tyre në kuadër të Trekëndëshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës,
- Kushtet e favorshme për dhënien e tokës për ndërtim në aktivitete ekonomike,
- Ekzistenca e një shumëllojshmërie të prodhimit industrial dhe bujqësor,

- Përkrahja jo e mjaftueshme institucionale për të mbështetur zhvillimin e bizneseve,
- Situata politike jo e favorshme për investime direkte,
- Objektet me kapacitete të vogla hoteliere,
- Mospërputhje në mes kërkesave të ekonomisë dhe të sistemit të arsimit,
- Ekonomi informale,
- Mungesa e fondeve,
- Industria përpunuese e pazhvilluar për mundësit që ka Komuna,
- Baza e të dhenave mbi regjistrimin e bizneseve jo e plotë.(Mungon ndarja në mes tv atyre aktive dhe pasive),
- Forma e privatizimit jo e favorshme e aplikuar në disa raste për bizneset,
- Modalitetet e bashkëpunimit të sektorit bankar, biznesit dhe të institucioneve publike,
- Mos shfrytëzimi i infrastrukturës hekurudhore në nivelin e Rajonit,
- Struktura e pavolitshme e bizneseve, kapaciteti Mos aktivizimi i plotë i ndërmarrjeve industriale,
- Politikat fiskale dhe kreditore jo të volitshme, për zhvillim ekonomik,
- Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve etj.
- Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve në zonat tjera të mundshme për zhvillimin e turizmit rural,
- Kufizimet energjetike në zhvillimin ekonomik,
- Mos shfrytëzimi adekuat i pozicionit të aeroportit,
- Mos shfrytëzimi adekuat i parkut të Blinajës dhe shpellës së Gadimes,
- Mos shfrytëzimi adekuat i trashëgimis si qytet i argjendët Janjeva dhe zona Kleqkë / Divjakë,
- Nuk është i zhvilluar sistemi i energjisë alternative,
- Mungesa e deritanishme e strategjisë kombëtare për zhvillimin ekonomik,
- Mungesa e mbështetjes dhe stimuluj për prodhimet për eksport,
- Mungesa e strategjisë dhe stimulimeve për eksport,
- Kuadri i dobët ligjor dhe zbatimin e legjislationit të miratuar,

- Tregti të zhvilluar dhe të shërbimeve,
- Punëtorë me përvojë në fusha të ndryshme tekniko teknologjike,
- Ekzistenca e burimeve natyrore,
- Bashkëpunimi i mirë me Odat Ekonomike,
- Traditë industriale, (Nxirrja e lëndës së parë për Feroniklin, përpunimi i gurit, Drurit, plastikës dhe fryteve natyrës etj).


1.3 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

1.3.1 UJËSJELLËSI

1.3.1.1 RRJETI I UJËSJELLËSIT, MBULUESHMERIA DHE MATERIALET E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Lipjanit bëhet nga burimet nëntokësore, i cili ka kapacitet prej 399.00 l/s, përfshirë edhe zonat rurale të cilat furnizohen nga pusët po ashtu nëntokësore. Aktualisht KRU „Prishtina” sh.a, e cila është ofruesi i vetëm me ujë të pijshëm në zonën e Lipjanit, ofron shërbime të ujit të pijshëm për qytetin e Lipjanit dhe disa vendbanime, ky shërbim ofrohet 24 orë pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme tjera (reduktime të energjisë) në stacionin e pompave dhe tubacionet – rrjetin shpërndarës të ujësjellësit. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit është rreth: 277500.0 m’ apo 277.50 km përfshirë edhe zonat rurale, të regjistruara në ArcMAP.

Diametri i gypave primar sillet nga Ø315mm Ø50mm për gypa primare dhe sekondare, kurse për gypat terciar për kucje kolektive dhe individuale sillen nga Ø40mm deri Ø25mm si dhe materialet e tyre janë nga Asbest Cement (AC), PVC, GIZË, HDPE dhe kohëve të fundit PE-100-RC.



Grafikoni 18. Materialet e përdorura sipas %

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm është 277.5 m, prej të cilave 65% HDPE, 7.1% PE-100-RC, 4.8% GIZ, 2.8% AC, 2.6% PE, 0.2% ZN dhe 17.6% të zbrazët.

Që do të thotë se 4.8 % të rrjetit në zonë urbane kemi ende gypa të Asbes Cement dhe 0.2 % janë Zn.

Tabela 42. Kapacitetet e rezervuara

Nr	Emri i rezervuarit	x	y	z	Komuna	Kapaciteti	Materiali	Viti i ndërtimit
1	Rez_Lipjan	7510574.90	4709405.32	538	Lipjan	250	Beton	1980

2	REZ_Gushterice_Eperme	7517591.00	4712690.62	631	Lipjan	500	Beton	1971
3	REZ_Janjeve	7520373.92	4714669.91	536	Lipjan	200	Beton	1970
4	REZ_Gadime	7517000.77	4704625.35	534	Lipjan	1000	Beton	2011
5	REZ_Gadime_1	7516954.21	4704936.62	645	Lipjan	100	Beton	2006
6	REZ_Gadime_2	7516971.68	4704942.23	652	Lipjan	100	Beton	2007
7	REZ_Babush_Muhaxhereve	7515730.60	4702884.39	680	Lipjan	100	Beton	2005
8	REZ_Konjuh	7512686.41	4710326.33	680	Lipjan	250	Beton	2010
9	REZ_Teqe	7519702.67	4714588.03	561	Lipjan	100	Beton	2011
10	REZ_Janjeve_1	7520770.86	4714928.54	538	Lipjan	100	Beton	1970
11	REZ_Vrelle	7501253.68	4714089.44	631	Lipjan	100	Beton	2006
12	REZ_Golesh	7500091.20	4712087.22	536	Lipjan	100	Beton	1970
13	REZ_Silovi	7515733.24	4712084.43	640	Lipjan	150	Beton	2009

1.3.1.2 KËRKESAT PËR UJË/ VLERËSIMI I NEVOJAVE NË TË ARDHMEN

Sipas udhëzimit Administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor janë përcaktuar kërkesat për ujë për kokë banori, ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri janë radhitur sipas kategorisë:

- për vendbanime ≥ 100001 banor: ≥ 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001 - 100000 banor: ≥ 250 - 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001 - 100000 banor: ≥ 200 - 250 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 5001 - 20000 banor: ≥ 150 - 200 litra/banor;
- për vendbanime < 5000 banor: ≥ 100 - 150 litra/banor.

Sipas prognozave të skenarit realist të demografisë për vitin 2031 komuna e Lipjanit ka një numër të banorëve prej 61406 duke përfshirë zonën urbane dhe rurale, dhe pas analizave të kërkesave për shpenzime, sipas këtij numri të banorëve, rezulton se KRUP duhet të sigurojë sasinë e ujit prej $Q=324.57$ l/s që relaishet sipas gjendjes së KRU Prishtina kjo sasi e ujit është e siguruar për 8-10 vitete e ardhshme. Që do të thotë se numbulon nevojat reale bazuar në trendin demografik dhe sasinë momentale të ujit që disponon KRUP në teritorin e Lipjanit $Q=399.0$ l/s.

Skenari-a: Me gjithësej 61,406 banorë në zonën urbane dhe zonën rurale për 10 vitet e ardhme deri në vitin 2031.

Bazuar në kapacitetet ekzistuese të burimeve të ujit me **$Q=399.00$ l/s** kapaciteteve të konservimit të rezervuarëve, kapacitetet e stacioneve të pompimit, numrit të prognozuar të banorëve prej për vitin 2031 të **Skenari-a**, përfshirë edhe banorët jo rezident, analizës së shpenzimeve me kërkesën mesatare prej **$q=150$ l/për banor** Komuna nuk ka nevojë për rritje të kapaciteteve të konservimit të ujit prej së paku 8-10 vitete e ardhshme.¹³

Skenari-b-Bilanci i kërkesës për ujë dhe kapacitetit të furnizimit sipas Skenarit të KRU "Prishtina"

Shtimi i popullsisë Meqenëse ASK nuk e ka bërë parashikimin e rritjes së popullsisë sipas komunave por vetëm në nivel të vendit, shtimi i parashikuar i popullsisë për komunat e zonës së shërbimit është kalkuluar duke marrë për bazë trendin e njëjtë të rritjes së parashikuar nga ASK për Kosovë.

Bazuar në këtë kalkulim, është vlerësuar se gjatë periudhës 8 vjeçare (deri në vitin 2031) popullsia në zonën e shërbimit të Kompanisë do të ketë një shtim relativisht të vogël prej rreth 2800 banorë në total krahasuar me popullsinë aktuale. ASK parasheh që trendi i popullsisë do të jetë në rritje deri në vitin 2027, ndërsa prej vitit 2028, trendi do të jetë në rënje.

Kërkesa për ujë Në anën tjetër, kërkesa për ujë gjatë periudhës planifikuese nuk do të rritet si rezultat i shtimit të popullsisë, si dhe nuk pritet të rritet edhe për mbulueshmëri sepse që në këtë moment përqindja e mbulueshmërisë

është 90% .

Për përlogaritjen e kërkesës për ujë janë bërë supozimet si vijon:

- 1) Është parashikuar ngritja e shkallës së mbulimit me shërbime të ujësjellësit prej 90% sa është aktualisht në 100% në vitin 2023 banorë,
- 2) Është parashikuar zvogëlimi i shkallës së ujit të pafaturuar (UPF) prej 54% sa është aktualisht në 48% për vitin 2028;
- 3) Është parashikuar rritja graduale e normës së konsumit të ujit nga 110 litra/ditë/banor (sa faturohet aktualisht) në 130 litra/ditë/banor në vitin 2028.

Kjo rritje e normës së konsumit pritet të ndodhë si rezultat i zvogëlimit të humbjeve komerciale të ujit (vjedhja e ujit, pasaktësitë e matjes dhe faturimit etj.). Alternativisht, kërkesa për ujë do të mund të vlerësohej edhe duke marrë (i) normën e konsumit prej 155 litra/ditë/banor dhe duke ia shtuar asaj (ii) sasinë e ujit të faturuar për konsumatorët komercial dhe institucional (14%) si dhe (iii) sasinë e humbjeve fizike të ujit (rreth 25%) të zvogëluar sipas planifikimit të Kompanisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit.¹⁴

Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Prishtina, KRU Prishtina dhe Komuna duhet të orjentohej në eliminimi e humbjeve teknike dhe komerciale.

1.3.1.3 KAPACITETET E NEVOJSHME TË INFRASTRUKTURËS SË ZGJERUAR APO TË RE NË RJETIN E UJËSJELLËSIT

Sipas **Skenarit a dhe b** parashihet që shkalla e mbulimit me shërbime gjatë 8 viteve të ardhshme të rritet për 2,800 banorë, nënkupton që duhet që, përpos në burimet e reja të ujit, të parashihen investime edhe për zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit që nevojitet për furnizim me ujë të këtyre banorëve. Prej këtij numri prej 2800 të popullsisë që planifikohet të përfshihen me shërbime, rreth 2800 banorë do të përfshihen me sistemet që do të financohen gjatë 8 viteve të ardhshme nga donatorët e jashtëm, brendshëm dhe KRUP.

Sipas analizës së vlersimit të gjendje të infrastrukturës së ujësjellësit, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2031, përfshirë edhe banorët jo rezident, kërkesës mesatare sipas udhëzimit administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe normave të BE-së, ndërtimit të hovshëm i njësive banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale:

Komuna ka nevojë që:

- Rritja e kapaciteteve prodhuese të ujit;
- Rritja e kapaciteteve të rezervarëve;
- Ndërtimi i rezervuarëve të rinjë në zonat e reja të zhvillimit të qytetit dhe fshatrave; (Vend Lokacioni, vëllimi i i nevojshëm i rezervuarit).
- Hapje e puseve të reja për rritje të kapaciteti të ujit në zonat rurale;
- **Për Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 5% çdo vit:**
- Krijimin e zonave dhe nënzonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit;
- Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësor;
- **Si dhe rritjen e mbulueshmeris me shërbime të furnizimit me ujë në zonat pa shërbime:**
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit.

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e ujit:

- Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme me ujë të pijes për gjithë qytetaret e komunës në veqanti zonat Urbane dhe rurale;

¹⁴ Plani Afatgjatë i Investimëve 2019-2028_KRU_Prishtina

- Mbajtja e qëndrueshmeris dhe përmirsimi permanent i furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës;
- Krijimi i DMA zonave dhe menaxhimi i humbjeve teknike e komerciale duke rivitalizuar rrjetet ekzistuese, duke përdorur praktikën më të mirë;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit ujësjellës në kuadër të KRU Prishtina

Nevojat zhvillimore për të ardhmen për furnizim me ujë

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm;
- Hapja e puseve të reja në vendbanime disa vendbanime rurale;
- Ndërtimi i stacioneve të pompave
- Rritja e vëllimit të Rezervuarëve dhe ndërtimi i rezervuarëve të ri;
- Mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellës;
- Krijimin e zonave dhe nënzonave për vendosjen e matësve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit.

1.3.2 KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA (ZEZA)

Shërbimi aktual ofron shërbime të kanalizimit rreth 60% të popullsisë (zona e përgjithshme e furnizimit). Ujërat e ndotura nga qyteti i Lipjanit rrjedhin pa u trajtuar në rrjedhat ujore përreth. Në qytetin e Lipjanit shkalla e kyçjes në sistemin e kanalizimeve është në masën 85%.

Gjatësia totale e sistemit ekzistues të kanalizimeve në Lipjan është rreth 160km përfshirë edhe zonat rurale. Diametrat e gypave janë midis DN 200 dhe DN 600, dhe materiali kryesor i gypave është azbest çimentoja (> 80 %, kryesisht diametrat më të vegjël). Material tjetër i gypave është PE dhe gypat e plastikës. Vlen të theksohet se përafërsisht 80% e banorëve që jetojnë në qytet, ujërat fekale i derdhen në rrjetin e kanalizimit fekal publik. Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha.

Deri më tani është vlerësuar se 80% e popullsisë së qytetit të Lipjanit është e kyçur në sistemin e kanalizimit, dhe një pjesë e vogël e popullsisë së fshatrave.

▪ Trajtimi i ujërave të ndotura

Implantini për trajtimin e ujërave të ndotura në (Medvec-Vrellë)- Lipjan, gypi prurës në Implant është D=400 mm. Implanti për trajtimin e ujërave të ndotura në Vrellë është implant me trajtim biologjik që përbëhet nga tre SBR reaktor (Sequencing Batch Reactors). Procesi i trajtimit kontrollohet përmes sistemit SCADA, uji i trajtuar me gravitet shkarkohet në receptor. Implanti tani është në menaxhim nga fillimi i muajit nëntor 2021, Kapaciteti i Implantit është 3047 PE (banor ekuivalent), Maksimumi ditore i ujërave të ndotur $Q_d = 1950 \text{ m}^3/\text{dite} = 22,4 \text{ l/s}$ Mesatarja ditore i ujërave të ndotur $Q_{24} = 750 \text{ m}^3/\text{dite} = 12,7 \text{ l/s}$

Shkarkimi i ujërave të zeza në të gjithë territorin përbën një tjetër burim kryesor të ndotjes së ujërave, ku 51 (83.60%) e vendbanimeve llogaritet të jenë të kyçur në rrjetin e kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit i ndërtuar në periudhën e pas luftës në disa fshatra, bëjnë shkarkimin e ujërave fekale në ambient të hapur duke iu nënshtruar trajtimit përmes gropave septike.

Vlerësim i përgjithshëm i mbulueshmërisë së vendbanimeve të kyçur në rrjetin e kanalizimit është përafërsisht:

- 34.50% të vendbanimeve, me popullsi mbi 1,000 banorë, janë të kyçur 100% në sistemin e kanalizimit, me përjashtim të vendbanimeve Janjevë (75%), Krojmir (75%), dhe Lipjan (80%);
- 49.20% të vendbanimeve, të cilat kanë më pak se 1,000 banorë, janë të kyçur 100% në sistemin e kanalizimit, me përjashtim të vendbanimeve Akllap (80%), Gllavicë (85%), Mirenë (75%), Resinoc (90%), dhe Varigoc (80%);
- 33 nga 51 vendbanime bëjnë shkarkimin e ujërave të trajtuar paraprakisht përmes gropave septike;
- Gjithsej 6 vendbanime janë të pabanueshme: Bukovicë, Divlakë, Hanroc, Okosnicë, Shisharkë, Vogaqicë;

- Parku Nacional Blinaja menaxhohet dhe shërbehet nga operator tjetër i kontraktuar nga niveli qendror;
- Rreth 6.5% apo në total 4 vendbanime nuk janë të kyçur në sistemin e kanalizimit: Brus, Kleqkë, Plitkoviq, Vrellë e Gadimes.

Lipjani ende nuk ka sistem të ndarë të evakuimit/largimit të ujërave të zeza/fekale nga evakuimi i ujërave atmosferik.

1.3.3 DRENAZHIMI-KANALIZIMI I UJËRAVE ATMOSFERIKE

Në qytetin e Lipjanit nuk ekziston rrjeti për largimin e ujërave të shiut në kuptimin e një sistemi të dizajnuar dhe të ndërtuar në parimet dhe normat inxhinierike, dhe i cili do të mirëmbahet rregullisht dhe në mënyre legale. Përveç në qendrën e ngushtë të qytetit ku ekziston sistemi gypor i kanalizimit të shiut, në rastet më të shpeshta ujërat e shiut vërshojnë rrugët dhe pronat e qytetarëve pas çdo reshje. Sistemi i kanalizimit nuk është i tipit të ndarë.

Rrjeti i kanalizimit atmosferik i gjithi është i orientuar në drejtim të lumenjve dhe derdhet në shumë pika pa trajtim adekuat.

- **Vlerësimi i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë të tillë-Kanalizimi i ujërave të ndotura**

Bazuar në gjendjen ekzistuese të rrjeteve të kanalizimit të ujërave të ndotura dhe atmosferike dhe numrit të prognozuar të banorëve, në pjesë të qytetit dhe vendbanimeve (fshatrave) të cilat kanë nevojë për rrjetë të reja të ujërave të ndotura si dhe Kolektorët kryesor të cilat dërgoj ujë deri te FTUZ.

-Ndërtimi i kanalizimeve të reja në zonën urbane të Lipjanit për të unifikuar rrjetet e fragmentuara ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në një pikë të vetme.

1.3.3.1 KAPACITETET E NEVOJSHME TË INFRASTRUKTURËS SË ZGJERUAR APO TË RE NË RJETIN E KANALIZIMIT

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2031, përfshirë edhe banorët jo rezident, ndërtimit të hovshëm të njësive banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale janë identifikuar disa vendbanime të cilat kanë nevojë për rrjetë të reja të ujërave të ndotura.

Komuna ka nevojë për secilin vendbanim përfshirë edhe zonën urbane që do të rritet, do të duhej planifikuar edhe një dimensionim i ri i tërë sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura duke u bazuar në UA për Normat Teknike të Planifikimit.

Infrastruktura e dobët e kanalizimit ka nevojë për investime të reja kryesisht në zonën Urbane dhe në disa zona rurale:

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetaret e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Mundësia e ndërtimit të kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit të kanalizimit në kuadër të KRU Prishtina;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Ndarja duhet të bëhet me identifikimin dhe hartimin e një projekti kryesor i cili do të bëhet në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit dhe KRU Prishtina.

Sfidat kryesore në menaxhimin kanalizimit:

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetaret e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit të kanalizimit në kuadër të KRU Prishtina;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Përfundimi impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Lipjanit;
- Kycja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferik;

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT - UJËSJELLËSI, KANALIZIMIT DHE UJITJA	
PËRPARËSITË	DOBËSITË
- 90% e popullatës furnizohet me ujë të pijes; - Burime të ujit të pijes; - Cilësia e mirë e ujit; - 90% e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit; - Ofrimi i ujitjes optimale përkundër kushteve minimale;	- Mos shfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; - 10% e popullsisë në nuk kanë qasje në ujësjellës - Disa vendbanime nuk kanë rrjet të ujësjellësit; - Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga materiali AC në disa zona; - Mungesa e ujëmatësve zonale në zona të caktuara të rrjetit ujësjellësit; - Dimensione joadekuate të gypave ekzistues; - 20% e qytetit ende nuk është i përfshirë në kanalizim publik; - Mospërfshirja e madhe e zones rurale në rrjetin e kanalizimit; - Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta); - Mungesa e kycjes së disa fshatrave në rrjetin kryesor të ujit; - Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet); - Mungesa e koordinimit ndërmjet kompanive publike dhe Komunes - Impianti për trajtimin e ujërave të zeza 50%; - Rrjeti i vjetruar i kanalizimit; - Përzjerje e rrjetit të kanalizimit me atë atmosferik; - Mungesa e rrjetit atmosferik të ri;
MUNDËSITË	RREZIQET
- Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; - Garantët qeveritarë; - Aplikimi i arritjeve teknologjike; - Trajnimi i stafit; - Ekzistenca e Legjislacionit përkatës; - Instalimi ujëmatësve digjital në tërë zonën e shërbimit, ashtu që do të kishte avantazhe të ndjeshme sa i përket rënies së humbjeve të ujit si dhe rritjes së faturimit në [m3] të ujit të shpenzuar;	- Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; - Cenimi i kualitetit/sigurisë së ujit si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; - Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; - Keqpërdorimi i ujit; - Politika joadekuate; - Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntoksore dhe sipërfaqësore - Mbrojtja e rezervuarëve dhe Stacioneve të pompave

	me rrethoj dhe siguri fizike - Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes;
--	---

1.3.4 RRJETIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Lipjani ka një rrjet të energjisë elektrike i cili është mjaft i dendur, i përbërë nga linjat dhe nënstacionet e tensionit të lartë dhe të mesëm. Rrjeti energjetik është në pronësi të kompanisë publike KOSTT-i dhe kompanisë private KEDS-i.

1.3.4.1 LINJAT E TENSIONIT TË LARTË

Në territorin e Komunës së Lipjanit kalojnë linjat e tensionit të lartë 400 kV dhe 110 kV, që menaxhohen nga kompania Kostt-i. Linja 400 kV ka një shtrirje prej 9.2 km dhe rezervon një sipërfaqe prej rreth 36.8 ha, ndërsa linjat 110 kV kanë shtrirje prej 37.5 km dhe rezervon një sipërfaqe prej rreth 75 ha.

Tabela 43. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike -linjat e tensionit të lartë

Kodi referues	Gjatësia (km)
Linja 400 kV	9.2
Linja 220 kV	0
Linja 110 kV	37.5

Tabela 44. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- nënstacionet dhe zonat mbrojtëse

Kodi referues#	Sipërfaqja (ha)	Zona mbrojtëse - gjerësia (m)
Nënstacion 400/220 kV	0	0
Nënstacion 400/110 kV	0	0
Nënstacion 220/110 kV	0	0
Nënstacion 110/10(20) kV	0.86	20

Tabela 45. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike-gjatësia dhe daljet e linjave të NS 110/35/10 kV

Nënstacioni	Emri i Daljes	Gjatësia e linjës kablllore	Gjatësia e linjës ajrore
TS 110/35/10kV Lipjani	Bablak	0.45	10.49
TS 110/35/10kV Lipjani	Banulla	5.81	27.10
TS 110/35/10kV Lipjani	Baza e Asfaltit	1.99	15.30
TS 110/35/10kV Lipjani	Bonita	0.68	
TS 110/35/10kV Lipjani	Burgu	0.50	2.00
TS 110/35/10kV Lipjani	Coca Cola	0.85	
TS 110/35/10kV Lipjani	Dajti	2.20	
TS 110/35/10kV Lipjani	Gadime	2.97	35.65
TS 110/35/10kV Lipjani	Graniti Sh.P.K -Ismet Loshaj	0.62	
TS 110/35/10kV Lipjani	Konjuh	3.32	13.89
TS 110/35/10kV Lipjani	Kraishta	0.51	37.08
TS 110/35/10kV Lipjani	Lipjan Qendra I	7.94	2.33
TS 110/35/10kV Lipjani	Lipjan Qendra II	4.77	0.68
TS 110/35/10kV Lipjani	Q.M.I	0.84	
TS 110/35/10kV Lipjani	Shkolla e mesme "Adem Gllavica"	0.66	
TS 110/35/10kV Lipjani	Silovia	3.08	20.08
TS 110/35/10kV Lipjani	Suhadolli	0.31	0.76
TS 110/35/10kV Lipjani	Zona Industriale	3.64	1.25
Totali		41.14	166.61

1.3.4.2 LINJAT AJRORE TË TENSIONIT TË MESËM

Sa i përket linjave të tensionit të mesëm, në Komunën e Lipjanit shtrihen linjat e tensionit 35 kV, me gjatësi prej 22.63 km, po ashtu shtrihen edhe linjat e tensionit 10 kV, me gjatësi prej 262.89 km.

Tabela 46. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- linjat ajrore të tensionit të mesëm

Kodi referues	Gjatësia (km)
Linja 35 kV	22.63
Linja 10 (20) kV	/
Linja 10 kV	262.89
Linja 6 kV	/

1.3.4.3 LINJAT NËNTOKËSORE TË TENSIONIT TË MESËM

Sa i përket linjave nën-tokësore të tensionit të mesëm në komunën e Lipjanit viteve të fundit ka një trend të rritjes së ndërtimit (shtrirjes) të linjave nën-tokësore, kryesisht të tensionit të mesëm, dhe kjo infrastrukturë ka një shtrirje rreth 8.2 km të linjave 10(20) kV, dhe 56.84 km të linjave 10 kV.

Tabela 47. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- linjat nëntokësore të tensionit të mesëm

Kodi referues	Gjatësia (km)
Linja 35 kV	/
Linja 10(20) kV	8.2
Linja 10 kV	56.84
Linja 6 kV	/

Tabela 48. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike - linjat kablore dhe daljet e tensionit të mesëm

Nënstacioni	Emri i Daljes	Gjatësia e linjës kablore	Gjatësia e linjës ajrore
TS 35/10 KV Magure	Aeroporti	3.80	
TS 35/10 KV Magure	Aeroporti 2	3.63	
TS 35/10 KV Magure	Burimi	2.27	1.73
TS 35/10 KV Magure	Drenica		24.98
TS 35/10 KV Magure	Feronikeli		0.93
TS 35/10 KV Magure	Fshatrat- Magure	0.26	26.87
TS 35/10 KV Magure	Halilaqi	0.25	2.96
TS 35/10 KV Magure	Miniera Golesh		2.65
TS 35/10 KV Magure	Transmetuesi	2.40	2.01
TS 35/10 KV Magure	Wind Power	2.63	
TS 35/10kV Badovci	Janjeva	0.47	21.84
TS 35/10kV Badovci	Mramor-Slivovë		7.86
TS 35/10 KV Shtime	Shtime		1.10
TS 110/10 kV Gjilani 5	Bresalci		0.85
TS 35/10 kV Parku i Biznesit	Llapushnik		2.53
TOTAL		15.71	96.31

Tabela 49. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- shpenzimi sipas kategorive të klientëve(2022)

Kategoria #	Pasqyra e klientëve sipas grupeve tarifore							
	Klient të amvisërisë		Klient publik		Klient komercial		Klient total	
	Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv
Rural	10636	1639	196	21	372	429	11204	2089
Urban	5580	314	153	16	1348	376	7081	706
Total	16216	1953	349	37	1720	805	18169	2525

Tabela 50. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- njësitë shërbyese sipas vendbanimeve (2022)

Nr.	Kategoria #	Numri i klienteve (nr.)						Nr.	Kategoria #	Numri i klienteve (nr.)					
		Klient te amviserisë		Klient publik		Klient komercial				Klient te amviserisë		Klient publik		Klient komercial	
		Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv			Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv	Aktiv	Pasiv
1	Akllap	351	43	2	0	19	2	32	Llugaxhi	312	38	3	0	69	12
2	Babush i Muhaxhërve	172	5	3	0	28	6	33	Llugë	60	8	2	0	6	0
3	Baicë	231	17	2	0	14	1	34	Magurë	450	141	6	0	73	51
4	Banullë	263	36	1	0	7	4	35	Marec	52	1	1	0	6	2
5	Breg i Zi	69	10	1	0	2	0	36	Medvec	237	16	1	0	5	7
6	Brus	52	18	0	0	3	0	37	Mirenë	96	15	2	0	6	2
7	Bujan	174	13	1	0	15	3	38	Okosnicë	0	0	0	0	0	0
8	Bukovicë	130	49	1	0	8	2	39	Plitkoviq	14	2	0	0	1	0
9	Divlakë	9	2	0	0	1	0	40	Poturoc	181	23	3	0	19	8
10	Dobrajë e Madhe	333	51	3	0	30	5	41	Qellopek	83	9	1	0	17	1
11	Dobrajë e Vogël	56	6	1	0	1	0	42	Qylagë	185	16	3	0	10	8
12	Gadime e Epërme	652	82	4	0	40	8	43	Resinoc	127	20	1	0	6	1
13	Gadime e Ulët	850	96	4	0	63	24	44	Ribar i Madh	472	63	4	0	15	8
14	Gllanicë	38	4	1	0	2	0	45	Ribar i Vogël	101	30	2	0	5	2
15	Gllavicë	159	17	1	0	3	2	46	Rubofc	175	35	2	0	10	5
16	Glllogoc	233	41	2	0	3	4	47	Rufc i Ri	220	26	2	0	13	7
17	Grackë e Vjetër	175	52	1	0	12	4	48	Rufc i Vjetër	171	13	2	0	2	0
18	Grackë e Vogël	113	13	1	0	7	0	49	Sillovi	781	108	7	1	41	31
19	Gumnasellë	258	23	2	0	16	3	50	Smallushë	275	49	4	0	9	7
20	Hallaç i Madh	78	13	1	0	3	1	51	Shalë	597	76	3	0	39	11
21	Hallaqi i Vogël	187	40	4	0	10	7	52	Shisharkë	6	11	0	0	0	0
22	Hanroc	7	5	0	0	1	0	53	Teqe	46	6	1	0	0	0
23	Janjevë	458	178	4	0	42	63	54	Tërbuc	4	3	0	0	3	0
24	Kleqkë	31	4	0	0	4	0	55	Topliqan	267	39	2	0	8	6
25	Kojskë	99	11	1	0	5	2	56	Torinë	150	10	3	0	29	9
26	Konjuh	234	49	1	0	13	2	57	Varigoc	44	5	0	0	1	0
27	Kraishtë	273	47	3	0	14	5	58	Vërshec	157	16	4	0	5	5
28	Krojmir	285	60	4	0	12	2	59	Vogaqicë	0	0	0	0	0	0
29	Leletiq	24	0	0	0	1	0	60	Vrellë	29	6	0	0	2	0
30	Lipjan	5580	314	23	1	1148	181	61	Vrellë e Goleshit	29	6	0	0	2	0
31	Lipovicë	0	0	0	0	0	0	62	Zllakuqan	61	1	1	0	1	2

1.3.4.4 TRANSMFORMATORËT E TENSIONIT TË MESËM

Në Komunën e Lipjanit janë të instaluar një numër i konsiderueshëm i nënstacioneve të tensioneve të ndryshme të cilat

Nënstacionet sipas nivelit të tensionit:

- Tabela 51. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike-nënstacionet dhe zonat mbrojtëse*

Tabela 52. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike-transformatorët e tensionit të mesëm

Tabela 53. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike -transformatorët dhe fuqia e instaluar

Nënstacionet	Konsumator	Fuqia e trafos	Fuqitë e trafove te instaluara									Fuqia e Instaluar (MVA)	Nr. i Trafove
			1600	1250	1000	630	400	250	160	100	50		
Lipjani 110/35/10 kV	14412	Nr.i trafove	2	3	25	32	52	110	110	61	29	125.56	424
		Fuqia e Instaluar(kVA)	3200	3750	25000	20160	20800	27500	17600	6100	1450		
Magure 35/10 kV	4398	Nr . trafove	1	1	1	4	14	36	27	31	4	28.59	119
		Fuqia e Instaluar(kVA)	1600	1250	1000	2520	5600	9000	4320	3100	200		
Badovci 35/10kV	1885	Nr . trafove	0	0	0	5	2	11	7	2	2	8.12	29
		Fuqia e Instaluar(kVA)	0	0	0	3150	800	2750	1120	200	100		
Total												162.27	572

Tabela 54. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike- fuqia e planifikuar konform rritjes se popullsisë

Vendbanimi	Popullsia 2011	Popullsia 2023	Popullsia 2031	Rritja e popullsisë(banor)	Konsumator	Fuqia e planifikuar (MVA)
Lipjan	6870	17693	25185	7492	1784	10.2
Janjevë	2137	3525	4486	961	229	0.62
Gadime e Ulët	3337	3281	3633	352	84	0.25
Vrellë e Goleshit	336	578	746	168	40	0.16
Grackë e Vjetër	383	592	737	145	35	0.16
Konjuh	628	790	901	111	26	0.1
Rufc i Ri	507	653	755	102	24	0.1
Banullë	1694	1814	1897	83	20	0
Babush i Muhaxherve	1206	1307	1376	69	16	0.1
Totali				9483	2258	12

Tabela 55. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike-planifikimi i fuqise se trafove konform rritjes se planifikuar

Vendbanimi	Fuqia e Trafove (kVA)	Nr.Trafove	Fuqia e planifikuar (kVA)
Lipjan	1000	4	10150
	630	5	
	400	5	
	250	4	
Janjevë	630	1	630
Gadime e Ulët	250	1	250
Vrellë e Goleshit	160	1	160
Grackë e Vjetër	100	1	100
Konjuh	100	1	100
Rufc i Ri	100	1	100
Banullë	100	1	100
Babush i Muhaxherve	100	1	100
Totali		26	11690

Tabela 56. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike-Rritja e konsumit sipa projeksioneve te rritjes se popullsisë deri me 2031.

Vendbanimi	Nr i banoreve dhe konsumatoreve sipas statistikave nëpër vite							Fuqia e planifikuar me rritjen e konsumit rezident (MVA)	Fuqia e planifikuar me rritjen e konsumit jo rezident (MVA)
	Banor Rezident				Jo Rezident				
	2011	2021	2023	2031	2021	2023	2031		
Lipjan	57605	58601	60211	63027	11721	14512	17303	11.690	10.25

Tabela 57. Infrastruktura për shpërndarjen e energjisë elektrike--planifikimi i trafove konform fuqisë së planifikuar duke marrë në konsideratë projeksionet edhe të banoreve jorezident deri në vitin 2023.

Vendbanimi	Fuqia e Trafove (kVA)	Nr.Trafave	Fuqia e planifikuar për konsumin sezonal (kVA)
Komuna e Lipjan	1000	4	4000
	630	5	3150
	400	6	2400
	250	4	1000
Totali		19	10550

1.3.5 ENERGJIA E NGROHJES

Komuna e Lipjanit në aspektin gjeografik shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, e cila sipas regjistrimit të vitit 2011 ka një popullatë prej 57,605 banorë dhe 9497 ekonomi familjare, ndërsa në parashikimet demografike të vitit 2031 kjo komunë do të ketë 61,401 banorë dhe 12,341 ekonomi familjare. Komuna e Lipjanit nuk posedon sistem të ngrohjes në mënyrë të organizuar ngrohja e ekonomive familjare bëhet në mënyrë individuale duke shfrytëzuar burime të ndryshme të energjisë si ngrohja me dru, thëngjill, energji elektrike etj.

Këto formë të ngrohjes në bazë të analizave dhe raporteve të shumta mbi shfrytëzimin racional të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit nuk është mënyra më e mirë për arsye të shumë faktorëve ekonomik, mjedisor social dhe organizativ.

Andaj, si komunë planifikojmë në një të ardhme të afërme të investojmë në ndërtimin e infrastrukturës së ngrohjes në mënyrë të organizuar të qytetit të Lipjanit si fazë të parë dhe pastaj duke u zgjeruar edhe në pjesët rurale me theks të veçantë fshatrat me dendësi më të lartë banimorë.

Planifikimi për zhvillimin dhe rritjen e sistemit të ngrohjes qendrore të është mbështetur kryesisht në dokumentin e master planit dhe në Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës (2017- 2026) si dhe Planin Hapësinor të Kosovës. Kërkesat për kycje të reja në rrjetin e ngrohjes qendrore, duhet të analizohen në bazë të të dhënave të këtyre planeve dhe të aprovohen nëse janë në përputhje me kriteret dhe arsyeshmërit e përcaktuara për këtë lloj të investimeve. Përcaktimi i prioritetëve të investimeve, qofshin ato donacione apo mjete vetanake, është vendimtar për të siguruar që përfundimi i këtyre investimeve të bëhet me sukses të plotë.

Komuna ka analizuar disa mënyra të ofrimit të shërbimeve të ngrohjes së qytetit duke u bazuar në burime të ndryshme të energjisë si:

- Ngruhja me gazifikim si burim të energjisë;
- Ngruhja me biomasë (ndërtimin e impiantit me burim të ngrohjes biomasën);
- Energjia e ri-përtrishme (djellore, gjeotermale, erës etj);

Ngruhja me gazifikim si burim të energjisë - Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (IPF9) - Plani për zhvillimin e gazit dhe korniza rregullative dhe asistencë – plani për zhvillimin e gazit, në Kosovë, aktualisht, nuk ka infrastrukturë funksionale të gazit dhe nuk ka lidhje me rrjetin rajonal të gazit (që rezultojnë në mungesë të tregut të gazit natyror). Objektivi strategjik i Qeverisë së Kosovës është diversifikimi i burimeve të furnizimit me energji për të rritur sigurinë e furnizimit me energji. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit mbulohet në Strategjinë për Energji të Kosovës 2017-2026. Kjo strategji në vetë përfshinë zhvillimin e sistemit të gazifikimit në ballkanin perëndimor ku në kuadër të saj përfshihet edhe Kosova, nga kjo strategji planifikohet shtrirja e kypit kryesor të gasifikimit, kyp i cili prek edhe komunën e Lipjanit. Andaj, në një të ardhme të afërme mundësitë e furnizimit me gaz dhe furnizimi me ngrohje është shumë reale.



Figura 8. Rrjeti kryesor i gazifikimit

Ngrohja me biomasë - Teknologjitë e Biomassës CHP (Combined Heat Power) - Duke marrë parasysh madhësinë tipike të impiantëve të ngrohjes qendrore, teknologjia më e përshtatshme për aplikim në sistemet e ngrohjes qendrore të Ballkanit Perëndimor për prodhimin e vogël të biomassës CHP është cikli organik Rankine (ORC). Kjo është deri tani teknologjia më e përdorur për CHP e biomassës në Evropë. Kapacitetet nominale elektrike të moduleve të ORC për impiantet e biomassës CHP variojnë nga 200 kilovat energji elektrike (kWe) në 15 megavat energji elektrike (MWe), Pasi që impiantet e biomassës CHP zakonisht veprojnë në një mënyrë të kontrolluar nga nxehtësia-për arsye ekonomike dhe energjike- sjellja e ngarkesës së pjesshme dhe efikasiteti i ngarkesës së pjesshme të procesit ORC është shumë i rëndësishëm. Në 40% të energjisë elektrike neto të njësisë ORC, efienca elektrike neto akoma arrin në 85% të vlerës nominale. Kjo rrethanë është një përparësi thelbësore e procesit ORC në krahasim me turbinat me avull, të cilat tregojnë një rënie më të fortë të efikasitetit në ngarkesë të pjesshme.

Mundësia e ndërtimit të impiantit të ngrohjes me biomasë të komunës së Lipjanit është shumë reale pasi ky sistem mund të jetë i kombinuar ku mund të përdoren disa lëndë për djegie si druri, mbeturinave industriale, bujqësore, naftës etj.

Mundësitë e reja të aplikimit të burimeve ripërtrishme gjeotermale dhe djellore -

Burimet e Ripërtërtrishme të Energjisë paraqesin një burim të rëndësishëm të energjetik, me një potencial ende të pashfrytëzuar sa duhet. Shfrytëzimi i këtyre burimeve për prodhimin e energjisë përbënë objektivat afatgjatë për realizimin e qëllimeve të politikës energjetike të vendit siç janë: mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtja e mjedisit. Në funksion të këtyre qëllimeve shtrohet nevoja për aplikimin e masave stimuluese fiskale dhe financiare për të gjitha llojet, duke përfshirë zbatimin e skemës mbështetëse bazuar në sistemin e certifikatës së origjinës.

Potenciali i madh për rritje të kërkesës për ngrohje në të ardhmen qëndron në furnizimin me ujë sanitar, për konsumatorët e ngrohjes qendrore. Uji i ngrohtë normalisht furnizohet me temperaturë në mes 50°C deri 60°C. Për Hotele dhe kuzhina profesionale uji me 65 °C mjafton për të përmbushur shumicën e standardeve higjienike.

Uji i ngrohtë sanitar në ndërtesat e reja mund të lidhet në sistemin e ngrohjes qendrore pasi që ato janë projektuar për të qenë kompatible për kyçe në sistemin e ngrohjes. Problemi mund të paraqitet të objektet e vjetra, të cilat nuk kanë sistem të instaluar të ujit të ngrohtë sanitar. Riparimi, natyrisht është i mundshëm, por nevojiten investime shtesë. Të gjitha këto investime varen nga faktorët e poshtëcekur:

- Planifikimi shkallë-shkallë i operimit vjetor të rrjeteve;
- Shkalla e instalimeve të rrjetit të ujit sanitar në ndërtesa (kryesisht objekte të banimit kolektiv, pasi që objektet komerciale kanë kërkesa më të vogla për ujë sanitar);
- Konsumi për apartament, duhet të jetë i matur në mënyrë që mënjanohet konsumi i panevojshëm.

Prandaj, në ndërtimet e reja preferohet instalimi i sistemeve të përshtatshme për shfrytëzim të ujërave sanitar nga ujërat termale.

Përveç mundësive termike për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes tjetër mundësi dhe potencial është shfrytëzimi i energjisë së djellit, duke ndërtuar impiante të paneleve solare duke shndërruar energji diellore në energji elektrike dhe ndërlihdjen e saj me infrastrukturë të ngrohjes. Ngrohja me panele solare mund të realizohet në dy mënyra, në mënyrë të organizuar kolektive duke ndërtuar impiante të mëdha me panele solare ku do të ofrohet shërbime në sipërfaqe të mëdha apo numër të madh të ekonomive familjare (lagje apo fshatra të ter), si dhe instalimet e impianteve të vogla apo individuale ku do të shërbeheshin njësit e banimit individual apo ndertës kolektive, praktika të cilat kohëve të fundit janë duke gjetur zbatim të madhe në vendet e zhvilluara por edhe tek ne. Këto sisteme janë shumë efikase dhe rentabile si në aspektin ekonomik dhe mjedisorë.

Zhvillimi i infrastrukturës së ngrohjes në komunën e Lipjanit do të zhvillohet nëpër faza duke filluar me zonën e parë apo qendrën e qytetit dhe duke vazhduar sipas fazave edhe prioriteteve. Aspektet financiare dhe kostot investive për ndërtimin e impiantit dhe shtrirjen e infrastrukturës (gypave) përcaktohen me plan të fizibilitetit.

Të gjitha konceptet e paraqitura në Planin Zhvillimorë Komunal të Lipjanit për ngrohjen kolektive përcaktohen me Plan të Fizibilitetit i cili do të orienton konceptin më të përshtatshëm në aspektin ekonomik dhe mjedisor.

1.3.6 TELEKOMUNIKACIONI DHE INSTALIMET E NGJAJSHME


Qëllimi i këtij dokumenti është analiza fillestare e gjendjes aktuale të shërbimeve telekomunikuese në qytetin e Lipjanit. Bëhet fjalë për shërbimet telekomunikuese mobile dhe fikse që operatorët e ndryshëm shtetëror dhe privat ofrojnë në qytetin e Lipjanit.

1.3.6.1 GJENDJA EKZISTUESE

Në Kosovë janë dy operator të licensuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mobile, Telekom i Kosovës si operator publik shtetëror dhe IPKO Telecommunication si operatori i vetëm privat.

1.3.6.2 SHËRBIMET QË OFROHEN DHE MBULUESHMËRIA



Të dy operatorët mbulojnë teritorin e Komunës së Lipjanit me shërbime të telefonisë mobile me zë “voice” dhe me të dhëna “data”. Mbulueshmëria me shërbimet e zërit “voice” në komunën e Lipjanit është e kënaqshme, përfshirë edhe zonat rurale.



Ngjyra e **kuqe**- Sinjali shumë i mirë,
 Ngjyra **Gjelbert** Sinjali i mirë,
 Ngjyra e bardhë- Nuk ka Sinjal


Në figurën e mësipërme është e paraqitur mbulushmeria e rrjetit me 2G në komunën e Lipjanit. Me ngjyrë të kuqe është e paraqitur pjeset ku sinjali është shumë i mire.

Shërbimet "data" që ofrohen janë një përfshirje e gjerë e teknologjive nga EDGE/GPRS, 3G/WCDMA dhe 4G/LTE. Mbulueshmëria me këto shërbime është e koncentruar në zonat më të banuara, ndërsa duhet të bëhen përmirësime në zonat rurale, dhe rritje e kapaciteteve në zonat urbane.



Nga figurat më lartë konkludojmë se mbulueshmëria me rrjetin 3G dhe LTE në Qytetin e Lipjanit dhe në zonat rurale është e kënaqshme, ndërsa në viset malore të pa banuara ose rrallë të banuara mbulueshmëria me rrjetin e 3G dhe LTE mungon.

Nga Figura e mësipërme mund të shihet shpërndarja e rrjetit 4G në pothuajse të gjitha pjesët qendrore të kryeqytetit për të dy operatorët VALA dhe IPKO, prej nga mund të konkludojmë një mbulueshmëri të kënaqshme me rrjetin 4G-LTE.



Shtrirja e BTS në territorit të Komunës së Lipjanit (Burimi: Atlasit Elektronik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit)

Sipas të dhënave nga Atlasi Eletronik numri I BTS në territorin e Komunës së Lipjanit është i mjaftueshëm, mirëpo nga hulumtimet në terren vërejmë se ndërtimi I BTS është bërë pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese dhe eksistojnë raste kur dy BTS të operatorëve të ndryshëm janë në distancë shumë të vogël nga njëri tjetri.

1.3.6.3 PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Duke parë që mbulueshmëria me shërbime “voice” është e kënaqshme, përmirësimet duhet të orientohen kryesisht në shërbimet “data”. Nevoja për kapacitete më të mëdha nga shfrytëzuesit është gjithnjë në rritje, kjo tregon që edhe zonat me mbulueshmëri të mirë në ditët e sotme, në një të ardhme jo të largët nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë nevojitet përmirësim në infrastrukturë dhe teknologji.

1.3.6.4 PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURË

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve për kapacitete të mjaftueshme, operatorët duhet që të:

- Rrisin numrin e BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve. Mënyrë me e përshtatshme për ta bërë këtë, rekomandohet që të ndërtohen BTS të përbashkët nga dy operatorët, gjë që kishte me i ul edhe kostot e tyre të operimit, njëkohësisht kishte me e përmirësu edhe mbulueshmërinë me shërbime për qytetarët.
- Rrisin kapacitetet duke zëvendësuar transportin me wireless, me ate me fije optike. Edhe ne këtë rast mund të përorin infrastrukturë të përbashkët nëntokësore që mund të jetë pronë e operatorëve, pronë publike komunale, apo edhe ndonjë operatori të shërbimeve FIX-e, të cilët do ta ndajnë të njëjtën infrastrukturë gjithashtu.

1.3.6.5 PËRMIRËSIMET DHE REZULATET NË SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE MOBILE

Përmirësimet duhet të bëhen në:

- Infrastruktura – mbi 80% e BTS-ve duhet që transporti të ndërrohet nga wireless në fiber optik. Fibra optike në zonat urbane duhet të bëhet në infrastrukturë nëntokësore, dhe duhet të jetë e përbashkët për të gjithë operatorët, përfshirë edhe operatorët që ofrojnë shërbime FIX-e.
- Në zonat rurale në mungesë të infrastrukturës nëntokësore, mund të shfrytëzohen trasetë e distribucionit të energjisë elektrike, për të shtrirë fibrin optik deri në destinacion. Edhe këtu duhet të shfrytëzohen asetet e përbashkëta për të gjithë operatorët mobil dhe FIX.
- Me këtë sigurohet kapacitet i mjaftueshëm për të ofruar shërbime të krenarshme “data” për qytetarët e komunës së Lipjanit

1.3.6.6 SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE FIX-E

Sa i përket rrjetit fikse të ofrimit të shërbimeve të qasjes në internet në Komunën e Lipjanit, bazuar në të dhënat e dërguara nga operatorët vërehet se Komuna e Lipjanit qëndron shumë mirë në ofrimin e shërbimeve të internetit, të cilat ofrojnë shpejtësi shumë të larta dhe nivele të garantuara të kualitetit të shërbimeve të internetit në krahasim me rrjetin mobil.

Edhe pse shërbimet me internet në Komunën e Lipjanit janë të mira, Problemi qëndron në infrastrukturën ekzistuese e cila është ndërtuar pa ndonjë koordinim me mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese dhe nuk është e unifikuar.

Gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në komunën e Lipjanit është relativisht e mirë, ekzistojnë disa kompani (operatorë ekonomik) që bëjnë shpërndarjen e rrjetit të internetit.

Shpërndarja e teknologjive dhe e rrjetave të avancuara në Lipjanit është zhvilluar me një ritëm jo të rregullt dhe në mënyrë të pakoordinuar

Infrastruktura e rrjetit të FIX-it (internet-it) nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e komunës, kryesisht fshatrat malore nuk posedojnë rrjet të kabllovikut nga asnjë operatorë që vepron në nivel komunal.

Zonat Rurale në të cilat ka mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve me internet janë:

1.3.6.7 SHËRBIMET QË OFROHEN DHE MBULUESHMERIA


Të gjithë operatorët që operojnë në komunën e Lipjanit ofrojnë shërbimet e internetit, TV digital, dhe disa prej tyre edhe telefoni FIX-e.

Operatorët të cilët ofrojnë shërbime të Internetit dhe rrjetit të TV kabllor janë:

- Telekom i Kosovës
- Rrjeti i kompanisë IPKO;
- Rrjeti i kompanisë KUJTESA;
- Rrjeti i kompanisë ARTMOTION.
- Rrjeti i kompanisë Telkos.

Operatorët e licensuar i ofrojnë këto shërbime kryesisht në zonat urbane dhe në disa zona rurale ku përqëndrimi i qytetarëve/banorëve është më i madh. Ndërsa në zonat e largëta dhe më pak të banueshme këta operatorë nuk ofrojnë shërbime. Në këto zona shërbimet ofrohen nga operatorë lokal, shpeshherë të palicensuar dhe me kualitet jo të kënaqshëm të shërbimit.

Ofrimi i shërbimeve bëhet përmes sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) në mbi 60% të rasteve, dhe në 40% të rasteve përmes GPON (Fiber)



Harta 2. Rrjeti i Telekomunikacionit

Sipas të dhënave të ofruara nga operatorët, ofrimi i shërbimeve në nivel të ekonomive familjare është relativisht i mirë duke përfshirë disa vendbanime apo qytetar të cilët jetojnë në vise më të thella rurale ku shërbimet janë më vështirë të arritshme, ndërsa pjesa më e madhe e qytetareve mbi 90% gëzojnë qasje në shërbime të cilat i ofrojnë operatorët.

1.3.6.8 SFIDAT NË PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE

Sfida më e madhe për përmirësimin e shërbimeve është infrastruktura. Për momentin shumica e operatorëve shfrytëzojnë shtyllat e distribucionit për shtrirjen e kabllave, qofte të rrjetit primar, apo të atij sekondar që i jep shërbim edhe qytetarit. Të pakëta janë rastet, kryesisht në zona urbane, ku operatorët kanë shfrytëzuar infrastrukturën nëntokësore për shtrirjen e kabllave të tyre.




Figura 9. infrastruktura Telekomunikuese në Komunën Lipjanit (Burimi: Atlasit Elektronik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

Sfidë tjetër të operatorët që operojnë në teknologjinë HFC, është jostabiliteti energjetik në vend. Shpesh kemi ndërprerje të energjisë elektrike, e kjo mund të shkaktojë edhe ndërprerje të shërbimeve për qytetarët. Për ta evituar këtë, operatorët duhet të sigurojnë backup të energjisë në stacionet e tyre.

Një sfidë tjetër është edhe numri i madhë i operatorëve kryesisht në zonat urbane. Me raste kemi edhe deri në 5 operatorë në të njëjtën shtyllë, që paraqet problem edhe për ekipet e mirëmbajtjes, dhe gjithashtu për nga ana estetike janë shumë keq.

1.3.6.9 PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Përmirësimi i shërbimeve lidhet direkt me infrastrukturën. Për të pasur shërbime të garantuara, duhet që operatorët, të kenë infrastrukturë nëntokësore të përbashkët. Infrastruktura nëntokësore mund të jetë edhe pronë komunale e dhënë në shfrytëzim për të gjithë operatorët.

Kjo ndihmon dukshëm në përmirësimin e shërbimeve, duke i eliminuar dëmtimet e shumëta që ndodhin për shkak të këputjeve të ndryshme në kabllo të ajrore, ose dëmtimet e shtyllave të distribucionit të cilat janë të stervjetëruara.

Menyrë tjetër e përmirësimit të shërbimeve është edhe ndarja “share” i infrastrukturës mes operatorëve, ku në vend të 5 kabllove të 5 operatorëve të ndryshëm, vendoset një kablo me shumë fije, që lehtëson edhe punët e ekipeve të mirëmbajtjes, dhe përmirëson edhe anën estetike.

Përmirësimi dukshëm më i madh bëhet nëse kalohet nga teknologjia HFC në GPON, ose nga rrjeta aktive në atë pasive, e që kishte me e rrit dukshëm cilësinë e shërbimit dhe kapacitetin e shërbimit.

Përmirësimet në infrastrukturë duhet të bëhen:

- Në zonat urbane dhe lidhja primare me zonat rurale të bëhet me infrastrukturë të përbashkët nëntokësore, ku të gjithë operatorët shfrytëzojnë të njëjtën infrastrukturë
- Në zonat më të largëta, të shfrytëzohet edhe infrastruktura ajrore – shtyllat e distribucionit, por të përmirësuar. Ato duhet të jenë prej betoni, që sigurojnë shërbime të sigurt dhe lehtësim të punës për operatorët.
- **Avansimet në teknologji**

Trendi global i shërbimeve telekomunikuese është përmes fibrës optike. Përparësitë e fibrës optike me teknologjitë tjera si HFC janë të shumëta si: kosto më e lirë të implementimit, kosto më e lira të mirëmbajtjes pasiqe është rrjeta pasive, kohë më e shkurtër e implementimit dhe më e rendësishmja cilësi dhe kapacitet i pakrahasueshëm kundrejt teknologjive tjera.

1.3.6.10 PËRMIRËSIMET DHE REZULATET NË SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE FIX-E

Përmirësimet duhet të bëhen në:

- Infrastruktura – Duhet të ndërtohet infrastruktura e përbashkët nëntokësore për të gjithë operatorët. Infrastruktura të përdoret edhe për operatorët që ofrojnë shërbime telekomunikuese mobile.
- Zgjidhja ideale do të ishte që infrastruktura primare të jetë pronë komunale apo një operatori, dhe të mirëmbahet nga vetëm një ekip, e cila pastaj jepet në shfrytëzim për operatorët.
- 100% e infrastrukturës në zonat urbane duhet të kalojë në infrastrukturë nëntokësore, ashtu sikurse edhe rrjetet primare, furnizimet në zonat rurale të bëhen me infrastrukturë nëntokësore, ndërsa në zonat e me banim më të ulët, të lejohet edhe infrastrukturë ajrore, por me shtylla të sigurt nga betoni.
- Të sigurohet që se paku dy operatorë që ofronë shërbime kualitative dhe kontent të licensuar, të ofrojnë shërbime për secilin qytetar të Lipjanit. Kjo për shkak se konkurrenca rrit cilësinë dhe jep lehtësime financiare për qytetarët.
- Të bëhen lehtësimë për operatorët që kalojnë nga HFC në GPON, pasi që me këtë veprim ju mundësojnë shërbime shumë më të mira dhe kualitative qytetarëve.

▪ ANALIZA SWOT

Analiza SWOT	
PËRPARËSITË	DOBËSITË
▪ Shërbimet eksistuese që ofrojnë mbulueshmëri; ▪ Mbulueshmëria e mirë me shërbime internet dhe DTV në zonat urbane. ▪ Nivel i kënaqshëm i konkurrencës në zonat urbane. ▪ Mbulueshmëri minimale edhe në zonat rurale. ▪ Përditësimi i infrastrukturës prej operatorëve. ▪ Shfrytëzimin e granteve (kombëtare e ndërkombëtare) për Përmirësimin e infrastrukturës.	▪ Rrjeti nëpër shtylla të KEDS – I pa kontrolluar ▪ Jostabiliteti energjetikë në vend ▪ Mungesa e shërbimeve të FIX-it nëpër fshatra; ▪ Mos unifikimi i rrjetave nga operatorët që ofrojnë shërbime Telekomunikuese. ▪ Rrjeti i vjetëruar ▪ Mbi 80% ofrojnë shërbime me kablo koaksiale ▪ Shërbimet “fiber to home” në nivel minimal ▪ Cilësia jo e kënaqshme e shërbimeve. ▪ Ndërprerje të shpeshta të shërbimeve, që lidhen me rrjetin e vjetëruar, dhe furnizimin jostabil me energji elektrike.
MUNDËSITË	RREZIQËT
▪ Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; ▪ Grantet qeveritare; ▪ Planifikimi dhe Ndërtimi i Infrastruktures nëntokësore nga Komuna. ▪ Shtrirja e gypave në të gjitha rrugët kryesore. ▪ Eliminimi i rrjetit nëpër shtylla. ▪ Infrastruktura e përbashkët për të gjithë operatorët. ▪ Infrastruktura nëntokësore të jetë pronë komunale, që mundëson rritjen e cilësisë dhe konkurrencës së mirëfillte. ▪ Realizimi i të hyrave nga shfrytëzimi i infrastrukturës. ▪ Të ofrohen grante për operatorët që zgjerojnë rrjetin	▪ Largimi i shtyllave nga KEDS pa shtrirjen e gypave nëntokësor për operatorët e telekomunikimeve, që mund të lërë qytetarët pa shërbim. ▪ Për shkak të mungesës së konkurrencës në zonat rurale, mundësohet ofrimi i shërbimeve pirate nga operatorë të pa-autorizuar dhe pa-licensuar. ▪ Vazhdimi i infrastrukturës së pa unifikuar nga operatorët ▪ Cilësia e shërbimit.

Gjetjet kyçe dhe nevojat për të ardhmen

- Përmirësimi dhe unifikimi i infrastrukturës telekomunikuese në të gjithë Komunën;
- Koordinimi i vendosjes së konstruksioneve mbajtëse të antenave për telefoni mobile dhe harmonizimi ndërmjet operatorëve të vendvendosjes së tyre në të gjithë Komunën;
- Integrimi i të gjithë operatorëve në rrjetin nëntokësor në të gjithë Komunën.

1.3.7 MENAXHIMI DHE GRUMBULLIMI I MBETURINAVE

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Lipjanit përbën një ndër sfidat më të mëdha sociale e mjedisore. Infrastruktura e pamjaftueshme dhe mekanizmat e vjetëruar, si dhe mungesa e zbatimit të nismave e bëjnë të vështirë menaxhimin dhe deponimin e duhur të mbeturinave. Një prej indikatorëve të infrastrukturës së kufizuar konsiderohet mungesa e ofrimit të shërbimit në disa prej vendbanimeve në zonat kodrinore të territorit, ku mund të aludojmë:

- Terreni i vështirë dhe qasja në vende të caktuara mund të jetë sfidues për kapacitetet e kompanisë (personel shtesë, pajisje të specializuara, etj);
- Mungesë e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e mbeturinave në këto zona;
- Zonave me popullsi më të madhe dhe me kërkesa më të larta për shërbime i ipet prioritet nga ofruesi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave;

Mungesa e ofrimit të shërbimit ka çuar në hedhjen pa kriter të mbeturinave dhe krijimin e venddepozitimeve të pakontrolluara dhe djegien, që vazhdojnë të shkaktojnë probleme mjedisore dhe shëndetësore. Sipas projeksioneve demografike, këto vendbanime pritet të pësojnë rënie të popullsisë, disa prej tyre rrezikojnë të mbeten pa asnjë banorë, ku grumbullimi i mbeturinave mund të bëhet akoma më sfidues, për të cilën duhen të merren masa për të siguruar grumbullimin e duhur të tyre.

- **Mbledhja, transportimi dhe asgjësimi**
 - Shërbimi për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave kryhet në 49 vendbanime dhe nuk është i plotë. Komuna e Lipjanit nuk ka objekte përkatëse për trajtimin e mbeturinave në mënyrë që të ndahen mbeturinat për depozitim përfundimtar në fushat e kontrolluara të grumbullimit të mbeturinave, dhe pjesa tjetër për ripërdorim. Që do të thotë mbeturinat nuk mblidhen në mënyrë të ndarë dhe as nuk trajtohen për përfitim të produkteve të reja, pavarësisht se ka pasur disa nisma të pauzuara, gjë e cila përgjithësisht ka sjellë probleme sa i përket rreziqeve mjedisore, rritjen e kostos, reduktimin e efikasitetit dhe uljen e shkallës së reciklimit.
 - Mbeturinat e gjeneruara dërgohen në pikën e transferit (ku aktualisht nuk ka një infrastrukturë të ndërtuar), ku qëndrojnë përkohësisht, deri në dërgimin përfundimtar për në deponinë sanitare rajonale në Mirash, ku shërbimi ofrohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, e licencuar në bazë të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
 - Në komunë ka disa aktivitete riciklimi nga sektori joformal, kryesisht për metal, plastikë dhe letër, me qëllim shitjen e këtyre materialeve te operatorët vendas. Një nismë për kompostimin e mbetjeve organike ka pasur për në Llugaxhi, ndonëse nuk ka informacione për zbatimin e saj.
 - Duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës së duhur për menaxhimin e mbetjeve dhe mungesën e progresit në nismat për ndarjen dhe trajtimin e mbetjeve, në të ardhmen komuna mund të përballet me rreziqe të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore publike.
- **Mbeturinat komunale**

Praktikisht, në menaxhimin e mbeturinave komunale në komunën e Lipjanit përfshihen kategoritë e listuara më poshtë, të cilat edhe pse të përfshira, në shumicën e rasteve si pasojë e devijimeve në sistemin e menaxhimit dhe rregulloreve, përfundojnë të akumuluar në hapësira publike duke krijuar kushte jo-sanitare dhe të pasigurta.

- Mbeturinat nga amvisëritë: mbeturinat ushqimore, letra, kartoni, plastika, qelqi, metalet;
- Mbeturinat e papërpunuara: ku hyjnë ato të djegshme (letra, kartoni, plastika, tekstili, druri) dhe të pa djegshme (qelq, alumin, hekur, etj.) që mbeten nga veprimtaria e institucioneve, aktiviteteve komerciale, etj.

Mbeturinat që rrjedhin nga djegia dukshëm nuk bëjnë pjesë në sistemin e menaxhimit dhe nuk ushtrohet asnjë lloj kontrolli. Përbëjnë rreth 10% të rasteve të zjarreve, ku kemi kryesisht djegien e mbetjeve plastike dhe gomave, duke përfshirë këtu edhe materialet e mbetura nga djegia e drunjve dhe materialeve tjera të djegshme.

Mbeturinat nga ndërtimi/demolimi, riparimet e banesave individuale, objekteve tregtare, dhe strukturave tjera, që kryesisht përmbajnë beton, tulla, hekur, pjesë nga plumbi, pajisje elektrike, vazhdojnë të mbeten të pa trajtuara dhe të hidhen pa kriter. Të dhënat aktuale tregojnë për një problem serioz me menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit/demolimit. Fakti që lokacioni i përcaktuar për deponim nuk është ende funksional do të thotë se nuk ka infrastrukturë të duhur për menaxhimin e këtij lloji të mbetjeve. Si rrjedhojë, mbetjet po derdhen pa kriter, gjë që ka gjasa të ndikojë negativisht në mjedis dhe në aspektin vizual të zonës. Zgjerimi i shpejtë i industrisë së ndërtimit ka bërë që kjo kategori e mbeturinave të rritet me shpejtësi dhe përfundojnë nëpër toka bujqësore dhe në lumenjtë që gjenden afër tyre.

Pavarësisht se investitorëve u ipet pëlqimi për ofrimin e shërbimit nga operatori, nuk ndodh e njëjta gjatë fazës së ndërtimit apo demolimit. Kjo tregon një problem tjetër për nga mungesa e llogaridhënies dhe përgjegjësisë nga ana e investitorëve dhe operatorëve të përfshirë në aktivitetet e ndërtimit dhe demolimit

Problemit të menaxhimit të mbetjeve të kësaj kategorie i shtohet edhe gjenerimi i mbetjeve nga aktiviteti i punonjësve që operojnë në kantieret e ndërtimit, si letra e kartoni, qelqi, plastika etj. Në përgjithësi, ekziston një nevojë e qartë për veprime të menjëhershme për të adresuar çështjet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit/demolimit në komunë.

▪ **Mbeturinat shtazore**

Mungesa e aktiviteteve të duhura të menaxhimit të mbetjeve shtazore përbën një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik dhe mjedisin, dhe sfidë jo të lehtë për komunën. Mbetjet e kafshëve mund të përmbajnë patogjenë të dëmshëm dhe kimikate që mund të kontaminojnë tokën dhe burimet e ujit, duke çuar në përhapjen e sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera shëndetësore. Mungesa e aktiviteteve të groposjes dhe dezinfektimit në zonë, si dhe mungesa e implantit për trajtim, e vështirëson menaxhimin efektiv të kësaj kategorie mbetjesh. Për më tepër, fakti që subjektet që merren me tregtimin e mishit dhe produkteve të tij, si dhe me prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e mishit, asgjësojnë këto kategori në mënyrë të paligjshme e përkeqëson më tej situatën.

Përveç subjekteve tregtare, në këtë problem kontribuojnë edhe amvisëritë, duke depozituar në mënyrë jo të duhur mbetjet shtazore. Për më tepër, mungesa e një sistemi menaxhimi për kafshët e ngordhura paraqet gjithashtu një problem të madh. Hedhja e mbetjeve të kafshëve nga familjet dhe ngordhja e kafshëve, nëse nuk menaxhohet siç duhet, mund të përbëjë një rrezik të konsiderueshëm.

▪ **Mbeturinat e vëllimshme**

Praktikisht, nuk ekziston një sistem formal i grumbullimit, ndërkohë që sistemi i licensimit gjithashtu nuk funksionon siç duhet. Mungesa e një sistemi për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme do të thotë se kjo kategori po shkarkohet si pjesë e mbeturinave shtëpiake, gjë që shkakton vështirësi për operatorin e mbeturinave komunale, duke zënë hapësirën dhe vështirësuar grumbullimin.

Kompanitë apo individët që i menaxhojnë automjetet e vjetëruara janë të mëdha në numër brenda territorit të komunës, mirëpo lidhur me këto nuk ka evidencë për sasinë që mbledhin, dhe sasitë e substancave të rrezikshme që largojnë. Aktualisht nuk ka një evidence dhe informacione nëse çmontohen dhe ripërdoren automjetet, mirëpo pjesë të tyre shpesh digjen dhe përbëjnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

▪ **Mbeturinat industriale**

Si një grup i madh dhe kompleks mbetjesh të krijuara nga procese industriale, komuna e Lipjanit ka dëshmi të kufizuara të praktikave të menaxhimit të kësaj kategorie. Me një sërë aktiviteteve industriale në zonë që i nënshtrohen proceseve të ndryshme teknologjike si djegia, shkrirja e metaleve, proceset kimike dhe të tjera, ka të dhëna të kufizuara të praktikave të menaxhimit për këto lloje mbetjesh, si evakuohen, ku grumbullohen dhe nëse i nënshtrohen ndonjë trajtimi.

Depozitat e mbetjeve industriale konsiderohen gjithashtu burime të ndotjes së ujërave për arsye të rrjedhjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore. Materialet e mbeturinave si hekurishtet, druri, plastika, etj, që mbeten nga procese prodhimi, zakonisht përfundojnë në hapësira publike.

▪ Mbeturinat medicinale

Duke qenë se një pjesë e mbeturinave dërgohet në sterilizatorin e vendosur në QKUK për trajtim kurse pjesa tjetër i nënshtrohet procesit të asgjësimit, mund të konkludohet se komuna po ndërmerr hapa për menaxhimin e duhur. Megjithatë, shqetësuese është mungesa e informacionit për menaxhimin e mbeturinave medicinale nga sektori privat, ku rreziku që ato të hidhen në mënyrë jo të duhur është shumë i madh.

Është thelbësore që të ekzistojnë protokollet dhe rregulloret e duhura për menaxhimin e mbetjeve medicinale për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve. Kjo përfshin jo vetëm spitalet, por edhe objektet private mjekësore dhe ofruesit e tjerë të kujdesit shëndetësor.

▪ Situata me depozitim të mbeturinave

Komunës së Lipjanit aktualisht i mungon infrastruktura për një stacion të duhur transferi të mbetjeve dhe mbetjet thjesht grumbullohen në një vend të përkohshëm përpara se të transportohen në deponinë sanitare rajonale në Mirash. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për ecurinë e nismës për ndarjen e mbetjeve në burim apo trajtimin e mbetjeve nga një operator i kontraktuar. Për adresimin e këtyre çështjeve, komunës i duhet t'i japë përparësi zhvillimit të një stacioni të duhur të transferimit të mbetjeve dhe të zbatojë nisma për ndarjen dhe trajtimin e mbetjeve.

Bazuar në të dhëna nga Raporti i Monitorimit dhe Vlerësimit të Gjendjes Mjedisore në Deponitë Sanitare dhe stacionet e transferit të mbeturinave në Kosovë (2018), sipas KMDK thuhet se Deponia Rajonale në Mirash planifikohet të mbyllet deri më 2026 për shkak se deponia do ketë përfunduar jetëgjatësinë e planifikuar. Për këtë është e rëndësishme që të fillohet sa më shpejt të jetë e mundur planifikimi për të ardhmen e depozitimit të mbetjeve në komunën e Lipjanit, si dhe ndërtimi i një stacioni transfer për konsolidimin e mbetjeve nga pikat e grumbullimit dhe transportimit të tyre në mënyrë efikase në deponinë sanitare.

▪ Deponitë ilegale

Fakti që në territorin e komunës janë eliminuar 40 deponi ilegale është një tregues pozitiv në ndërmarrjen e hapave për adresimin e kësaj problematike. Megjithatë, nuk ka informacion mbi sasinë aktuale të mbeturinave që hidhen ilegalisht duke e bërë të vështirë përcaktimin e shkallës së hedhjes ilegale.

Është e rëndësishme të theksohet se deponitë ilegale ekzistuese po gjenerojnë kryesisht mbetje të përziera dhe inerte, të përqendruara gjatë rrugëve, trotuareve dhe kanaleve ujore, gjë që tregon për sistemin jo adekuat të menaxhimit të mbeturinave. Në përgjithësi, është e qartë se hedhja ilegale është një problem në komunë dhe kërkon përpjekje nga autoritetet, industria dhe komuniteti për trajtim të mëtejshëm.

ANALIZA SWOT

Përparësitë	Dobësitë
▪ Komuna është në proces të hartimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave; ▪ Aktivitetet e riciklimit nga sektori joformal tregojnë potencial zhvillimi të ekonomisë qarkore në komunë; ▪ Ka pasur disa iniciativa për të adresuar çështjen e menaxhimit të mbetjeve, siç është nisma e kompostimit në Llugaxhi;	▪ Mungesa e një baze të dhënash për t'i shërbyer një menaxhimi më efikas të mbeturinave, inventarizim i lokacioneve problematike; ▪ Mbulim jo i plotë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ka çuar në hedhjen pa kriter të mbetjeve dhe krijimin e landfilleve të pakontrolluara dhe djegiet; ▪ Infrastruktura e kufizuar për menaxhimin e mbeturinave, trajtimin dhe riciklimin; ▪ Mungesa e zbatimit të nismave mbi kompostimin, ndarjen apo trajtimin e mbetjeve; ▪ Komuna nuk ka objekte përkatëse për trajtimin e mbetjeve për të ndarë mbetjet për deponim

	përfundimtar në zonat e kontrolluara të grumbullimit dhe pjesën tjetër për ripërdorim; ▪ Stacioni transfer, nuk ka infrastrukturë të ndërtuar, gjë që mund të sjellë kosto shtesë dhe joefikasitet; ▪ Ka prova të kufizuara të praktikave të menaxhimit për mbetjet industriale të krijuara nga procese të ndryshme industriale; ▪ Ndërtimet e vazhdueshme të objekteve të banimit kolektiv, ri-shikimi i nevojave aktuale për kontejnerë dhe planifikimi i të rejave për alokim, paraqet sfidë për ofrimin e shërbimit efikas për operatorin; ▪ Mungesa e ndriçimit në rrugë dhe rrugica, parkimi i automjeteve pranë pikave të grumbullimit, si dhe hedhja e mbeturinave të vëllimshme përbëjnë pengesë në grumbullimin efikas; ▪ Djegia e kontejnerëve nga pakujdesia (sidomos atyre të plastikës);
Mundësitë	Reziqet
▪ Investime në ndërtimin e pikave të përkohshme të grumbullimit me mundësi të ndarjes së mbeturinave; ▪ Krijimi i partneriteteve publiko-private për grumbullim dhe menaxhim efektiv; ▪ Përmirësimi i infrastrukturës dhe mekanizmave të menaxhimit të mbetjeve si integrimi i teknologjive dhe pajisjeve të reja; ▪ Zbatim i rregulloreve dhe ndëshkime më të rrepta për hedhjen ilegale; ▪ Bashkëpunimi me OJQ-të dhe kompanitë private për vënien në jetë të iniciativave të nisura; ▪ Rënia e mundshme e popullsisë në disa nga vendbanimet mund të jetë mundësi e mirë për rivlerësimin e sistemit aktual të menaxhimit të mbetjeve dhe hartimin e një sistemi më të qëndrueshëm; ▪ Aktivitetet e riciklimit nga sektori joformal mund të formalizohen dhe integrohen në sistemin e menaxhimit të mbetjeve komunale, duke kontribuar në gjenerimin e të ardhurave për popullatën lokale dhe në uljen e sasisë së mbetjeve për dërgim në deponi;	▪ Rritja e problematikave lidhur me gjenerimin dhe depozitimin e mbeturinave; ▪ Menaxhimi joadekuat i mbetjeve mund të çojë në probleme mjedisore dhe shëndetësore, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e popullatës lokale dhe mjedisin; ▪ Mungesa e menaxhimit ndikon gjithashtu në zhvillimin turistik dhe ekonomik të zonës; ▪ Hedhja jo e duhur e mbetjeve shtazore, mbetjeve të ndërtimit/rrënimin dhe mbetjeve industriale mund të çojë në përhapjen e sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera shëndetësore; ▪ Mungesa e informacionit për menaxhimin e mbetjeve mjekësore nga sektori privat mund të çojë në asgjësim jo të duhur; ▪ Djegia e mbetjeve, përfshirë gomat, drurin dhe plastikën, përbën rrezik për mjedisin dhe shëndetin e popullatës.


▪ Trendi i prodhimit të mbeturinave në Komunë

Trendi i prodhimit të mbeturinave në komunë është vlerësuar bazuar në indeksin e rritjes së popullsisë në nivel komunal prej 4.78% të vlerësuar për periudhën 2021-2031, sipas të cilës rrymë, është vlerësuar prirja e prodhimit të mbeturinave për po të njëjtën periudhë. Në tabelën më poshtë parashikohet një trend i rritjes së sasisë së mbeturinave komunale në komunën e Lipjanit gjatë 10 viteve të ardhshme:

Tabela 58. Trendi i rritjes së sasisë së mbetjeve për periudhën 2021-2031

Viti		2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Projeksioni i	Nr.	58,601	58,881	59,163	59,446	59,730	60,015	60,302	60,591	60,881	61,172	61,464

rritjes së popullsisë												
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton)	% sipas rrymave	13,033	13,095	13,158	13,221	13,284	13,348	13,412	13,476	13,540	13,605	13,670



Nga të dhënat, duket se popullsia parashikohet të rritet në mënyrë të qëndrueshme gjatë 10 viteve të ardhshme, me një rritje të vlerësuar prej rreth 4.8%, afërsisht 0.5% në vit.

Në të njëjtën kohë, sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithashtu parashikohet të rritet, me një rritje të vlerësuar prej rreth 640 ton nga viti 2021 në 2031. Kjo përfaqëson një rritje të përgjithshme prej rreth 4.89% gjatë periudhës 10-vjeçare, që është relativisht në përputhje me rritjen e parashikuar të popullsisë. Vlen të përmendet se parashikimet si për rritjen e popullsisë ashtu edhe për gjenerimin e mbetjeve bazohen në tendencat aktuale dhe mund të jenë subjekt i ndryshimeve në varësi të faktorëve të ndryshëm si ndryshimet në politikat qeverisëse, kushtet ekonomike dhe përparimet teknologjike. Prandaj, është e rëndësishme të monitorohen këto tendenca me kalimin e kohës për të siguruar që janë marrë masat e duhura për të menaxhuar sasinë në rritje të mbetjeve të gjeneruara nga popullsia në rritje.

▪ GJETJET KRYESORE

- Afërsisht 90% e vendbanimeve kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
- Infrastruktura joadekuata, mekanizma të vjetëruar dhe mungesë e zbatimit të iniciativave;
- Mungesa e ofritit të shërbimeve në disa vendbanime në zonat kodrinore të territorit ka sjellë hedhje pa kriter të mbeturinave, deponi të pakontrolluara dhe djegie;
- Mungesë e objekteve përkatëse të trajtimit dhe ndarjes së mbeturinave për asgjësimin dhe ripërdorimin përfundimtar;
- Menaxhimi i mbeturinave komunale në komunën e Lipjanit nuk është efikas, dhe mbeturinat shpesh grumbullohen në hapësira publike, duke krijuar kushte josanitare dhe të pasigurta;
- Mbetjet nga ndërtimi/demolimi mbeten të patrajtuara dhe të hedhura pa dallim;
- Kategoria mbetjeve të kafshëve është gjithashtu një sfidë e rëndësishme, me mungesën e aktiviteteve të duhura të menaxhimit që paraqesin rreziqe për shëndetin publik dhe mjedisin;
- Mungesa e një sistemi formal grumbullimi për mbetjet e vëllimshme do të thotë që kjo kategori shpesh

shkarkohet si pjesë e mbeturinave shtëpiake, duke shkaktuar vështirësi për operatorin e mbeturinave komunale;

- Ka mungesë informacioni në lidhje me menaxhimin e automjeteve të vjetruara dhe largimin e substancave të rrezikshme;
- Komunës së Lipjanit i mungon një stacion me infrastrukturë adekuate për transferimin e mbeturinave, dhe mbeturinat thjesht grumbullohen në një lokacion të përkohshëm para se të transportohen në deponinë sanitare rajonale;
- Deponia rajonale është planifikuar të mbyllet deri në vitin 2026, duke e bërë të rëndësishme fillimin e planifikimit për të ardhmen e depozitimit të mbeturinave në komunë dhe ndërtimin e stacionit të transferimit;
- Hedhja ilegale është problem në komunë dhe nuk ka të dhëna për sasinë reale të mbeturinave që hidhen ilegalisht, gjë që e bën të vështirë përcaktimin e masës së hedhjes së paligjshme;
- **NEVOJAT/KONSTATIMET**
 - Krijimi i një baze të dhënash gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbetjeve duke përfshirë informacion mbi gjenerimin, grumbullimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e llojeve të ndryshme të mbetjeve;
 - Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe plotësimi i tij në nivel territori;
 - Ndërtimi dhe funksionalizimi i stacionit transfer me infrastrukturën adekuate për ndarjen dhe grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave;
 - Ndarja në zona pilot me mundësi për funksionalizimin e sistemit për kompostimin dhe selektimin e mbetjeve të riciklueshme;
 - Rehabilitimi i pikave të deponive ilegale dhe revitalizimi i tyre në përputhje me normat e sigurisë (përfshirë edhe pikën aktuale të stacionit transfer);
 - Prioritet përbën menaxhimi i mbeturinave të ndërtim/demolimit përmes hartimit të një rregulloreje të veçantë për këtë kategori që përcakton detyrat, përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit;
 - Funksionalizimi i deponisë për mbeturinat e ndërtim/demolimit;
 - Funksionalizimi i sistemit për grumbullim dhe trajtim të veçantë të mbeturinave të rrezikshme;
 - Funksionalizimi i sistemit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave të ngurta komunale duke përfshirë, mbetjet voluminoze;
 - Rritja e kapaciteteve dhe mundësive për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave, ndër të cilat formalizimi i aktiviteteve të riciklimit nga sektori joformal dhe integrimi në sistemin e menaxhimit të mbetjeve komunale;
 - Hartimi i programeve vetëdijësuese për ndarje në burim të mbeturinave;
 - Plotësimi me kapacitete njerëzore i sektorit për menaxhim të mbeturinave në komunë.

1.4 INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

- **Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese**

Sipas Ligjit mbi rrugët, varësisht nga rëndësia e tyre shoqërore, ekonomike dhe e qarkullimit rrugët publike, kategorizohen në: autoudhë; rrugë nacionale, rrugë rajonale dhe rrugë lokale

Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim të auto rrugëve, rrugëve magjistrale dhe regjionale, ndërsa Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime.

	Kategoria	Përgjegjësi
1	Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës

Rrugët kryesore që kalojnë në territorin e Komunës së Lipjanit janë:

▪ Autoudhat

Nëpër territorin e Komunës së Lipjanit kalon autoudha ‘Arbën Xhaferi’ (R6) e cila lidhë Prishtinen me Shkupin, si dhe mundëson lidhje të mëtejme në korridorin e VIII-të panevropian. Gjithashtu, në ndërtim e sipër është edhe segmenti tjetër i autoudhës R7.1 që lidhë Lipjanin me pjesën lindore të Kosovës.

Njëherit, përmes autoudhes “Arbër Xhaferi”, në të cilën është planifikuar të lidhet autoudha “Agim Ramadani” (R7.1), u mundësohet qasje e lehtë dhe lidhje me kryeqendrën edhe zonave të pjesës lindore të Kosovës.

Karakteri i këtyre rrugëve është me rendësi kombëtare dhe ndërkombëtare, sepse përmes tyre përveç se mundësohet lidhja me shtetet fqinje, mundësohet qasja në korridoret pan evropiane me karakter ndërkombëtar: korridorin 8 dhe korridorin 10.

Parametrat teknik të autoudhëve i plotësojnë standardet e projektimit dhe ndërtimit. Përgjatë këtyre rrugëve, jashtë zonave të banuara është respektuar brezi mbrojtës rrugor në harmoni me normat teknike të planifikimit hapësinor.

Kyçja e Lipjanit në autoudhen “Arbën Xhaferi” në dy pika mundësohet përmes rrugëve nacionale N25 dhe N2. Përmes rrugës nacionale N25 dhe udhëkryqit në disnivel të formës “buri” mundësohet kyçja në Konjuh dhe përmes rrugës nacionale N2 Lipjanit i mundësohet kyçja në Babushtë Muhaxherëve (Fig.1).




Figura 10. Kyçjet e Lipjanit në autoudhën R6 “Arbën Xhaferi”

▪ Rrugët nacionale

Lipjani është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme nacionale dhe evropiane **N 25 (E 752)** dhe **N2 (E 65)**. Lidhja e Lipjanit me kryeqendrën Prishtinën dhe me qytetin e Prizrenit si dhe pikat kufitare në Morinë dhe Merdare, mundësohet përmes rrugës nacionale N25. Përmes rrugës nacionale N2, Lipjani lidhet me qytetin e Mitrovicës dhe Ferizajt, gjegjësisht përmes kësaj rruge mundësohet qasja në pikat kufitare Jarinjë, Bërnjak dhe Han i Elezit.

▪ Rrugët rajonale

Nëpër territorin e Komunës së Lipjanit kalon rruga rajonale **R208 (Lipjan –Magurë-Kleqkë dhe rruga RLipjan – Janjevë dhe Lipjan –Gadime - Vrellë)**. Kjo rrugë kalon nëpërmes të qendrave të gjitha fshatrave, dhe poashtu nëpërmes të qendrës së qytetit të Lipjanit. Rrugët nacionale dhe rajonale janë të plotësuara nga rrjeti i rrugëve lokale.

Tabela 59. Shtrirja e rrugëve sipas kategorive në territorin e Komunës së Lipjanit

Nr.	Kategoria e rrugëve	Gjatësia (km)	%
1	Autoudhë		

2	Rrugë nacionale	16,9	4
3	Rrugë rajonale	52,1	12,7
4	Rrugë lokale	253,3	61,2
5	Rrugë të pakategorizuara	90,5	22,1




Figura 11. Autoudha, rrugët nacionale dhe rajonale në Komunën e Lipjanit

Parametrat teknik të rrugëve nacionale në përgjithësi i plotësojnë kriteret e projektimit dhe në aspektin infrastrukturor ofrojnë kushte të mira për qarkullim të mjeteve motorike.

Ne pjesën urbane ku kalojnë rrugët nacionale, duhet të kontrollohen kycjet të cilat në aspektin e sigurisë nuk i plotësojnë kushtet për të mundësuar kycje të sigurt të automjeteve nga rrugët e rangut më të ulët apo zonat afariste. Gjithashtu shpejtësia e lëvizjes së mjeteve në këto pjesë të rrjetit rrugor të Lipjanit duhet të kufizohet në harmoni me kushtet e sigurisë për lëvizje dhe kërkesat për lëvizje nga përdoruesit e tjerë të rrugës.

Përmes rrugëve rajonale dhe rrugëve tjera lidhëse, disa prej të cilave kanë qasje në rrugët nacionale, u mundësohet qasje e lehtë në kryeqendër edhe komunave fqinje.

Përgjithësisht rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike, të gjitha janë të asfaltuara, por kanë nevojë për mirëmbajtje, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese me qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete.

▪ Rrugët lokale- urbane

Rrugët lokale ku përfshihen edhe rrugët urbane, kryesisht janë dy shiritore (me nga një korsi trafiku për kahe), përveç rrugës Avdi Kelmendi e cila shtrihet në brendi të qytetit me një gjatësi rreth 1.6 km e cila është me nga dy korsi trafiku për kahe dhe lidhë qendrën e qytetit dhe institucionet kryesore janë me nga dy shirita qarkullues për kahe. Kjo rrugë përveq automjeteve motorike ofron kushte të mira për akomodimin e të gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Rrugët tjera urbane brenda qytetit, në aspektin e funksionalitetit përgjithësisht ofrojnë qasje të mire për pjesëmarrësit në trafik, përveç lëvizjeve të pa motorizuara, por për shkak të kërkesës së madhe për trafik të automjeteve në orët e pikut vështirësohet operimi i trafikut dhe shoqërohet me bllokime trafiku.

Gjithashtu në zona të caktuara në brendi të lagjeve të qytetit paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak të parametrave teknik të rrugëve të cilën rezultojnë të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat për qarkullim të automjeteve si dhe për shkak të kërkesave të mëdha për parkingje në afërsi të rrugës.

Rrugët tjera lokale te cilat mundësojnë lidhjen me zonat periferike dhe fshatrat e komunës së Prishtinës në disa raste nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për qarkullim, sidomos mungesa e sinjalistikës, trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për automjete, këmbësorë dhe çiklist.

Rrugët lokale, urbane shërbejnë si rrugë ushqyese dytësore te cilat drejtpërsëdrejti ose çojnë në rrugët e rangut me ta larte (rajonale apo nacionale) si mundësojnë lidhjen me zonat e periferike.

Është e nevojshme të rivlerësohet funksionaliteti i formave të kontrollit të trafikut dhe të merren masa konkrete, në mënyrë që të mundësohet akomodim me i mire i të gjithë përdoruesve të rrugës, rritje e nivelit të sigurisë, operim me i lehte të transporti publik dhe në përgjithësi kualitet me i mire në qarkullim.

- **Infrastruktura rrugore në zonat kadastrale, fshatrat e komunës së Lipjanit**

Viteve të fundit Komuna e Lipjanit ka bërë disa investime të mira në përmirësimin e rrugëve nëpër fshatra, duke investuar në asfaltimin e disa rrugëve dhe shtrimin e zhavorrit në disa të tjera, kryesisht ato të nivelit të katër. Këto investime janë bërë fillimisht në rrugët kryesore që lidhin fshatrat me njëra-tjetrën dhe mund të konsiderohen si rrugë lokale. Përqendrimi më i madh i vendbanimeve është në cepin e rrugëve magjistrale dhe rajonale, ndërsa një fenomen i tillë ndodh kryesisht për shkak të ndërtimeve të bizneseve individuale, me qëllim punësimi dhe gjenerimit të të ardhurave për nevojat familjare.

Një pjesë e rrugëve lokale që lidhin fshatrat me rrugët kryesore janë të asfaltuara kryesisht në brendësi të fshatrave, ndërsa rrugët mes objekteve të banimit mbesin të paasfaltuara. Këto investime janë bërë gjatë viteve të fundit nga Komuna e Lipjanit, dhe ky fakt e ka lehtësuar trafikun për automjetet rrugore dhe vërehet përmirësimi i shërbimit dhe komunikimit mes këtyre fshatrave. Mirëmbajtja e këtyre rrugëve nga Komuna e Lipjanit nuk është në nivelin e duhur, për shkak të buxhetit të limituar dhe zgjerimit të rrugëve të tilla. Mirëmbajtja dimërore bëhet kryesisht në pastrimin e borës dhe përmirësimin e pjesshëm të kushteve të tyre. Zakonisht kërkesat më të mëdha për asfaltim apo rregullim të rrugëve vijnë nga fshatrat që ndodhen sa më larg zonës urbane. Kërkesat domethënëse akoma mbeten rregullimi i investimeve në rrjetin e rrugëve të lagjeve nëpër zonat rurale. Investimi në ndërtimin e rrugëve të shtruara bëhet kryesisht në fshatrat më të dendura ku janë përqendruar vendbanimet, veçanërisht në fshatrat që ndodhen më pranë zonës urbane.




Figura 12. Rrugët lokale

1.4.1 SHTRIRJA DHE KATEGORIA E RRUGËVE TË PLANIFIKUARA NGA NIVELI QENDROR

Rrjeti rrugor i komunës së Lipjanit përbehet nga rrugët me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, si autoudhë, rrugë nacionale dhe rrugë rajonale. Përmes këtyre rrugëve sigurohet lidhje e lehtë me qytetet dhe rajonet e Kosovës, shtetet fqinje dhe qasje në rrugët me rendësi ndërkombëtare siç janë korridoret pan evropiane 8 dhe 10. Këto rrugë janë në kompetencë të nivelit qendror, respektivisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajta e infrastrukturës rrugore në kompetencë të nivelit qendror (MMPHI), kohet e fundit ka qenë në proces të vazhdueshëm.

Integrimi i rrjetit rrugor nacional në rrjetin e auto-udhëve duke u siguruar qasje sa më të lehtë dhe të sigurte mjeteve, funksionalizimi dhe modernizimi i lidhjes hekurudhore dhe zonat tjera me të cilat ekziston lidhja hekurudhore, sigurimi i lidhjes sa më të lehtë me aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”, janë disa prej objektivave strategjike të nivelit qendror¹⁵.

Niveli qendror përveç masave të ndërmarra në rrugët nacionale, ka planifikuar që bashkërisht me nivelin komunal të jetë pjesë e implementimit të projekteve për:

- **Rehabilitimi rrugës Nacionale N25, Segmenti QMI – Lipjan**
- **Rehabilitimi i rrugës rajonale Shtime – Lipjan.**
- **Ndërtimi i rrugëve në fshatrat: Sillovi, Gadime, Smalluzhë, Gomnasellë, Llugaxhi dhe Babush.**
- **Rregullimi i infrastrukturës në Janjevë.**

Ndërtimi dhe zgjerimi i këtyre rrugëve duhet të bëhet në harmoni me standardet e projektimit dhe ndërtimit duke

¹⁵ Strategjia sektoriale dhe transportit multimodal-MI

respektuar po ashtu brezin mbrojtës për zonat jashtë urbane të përcaktuar me normat teknike të planifikimit hapësinor. Zgjerimi i këtyre rrugëve, funksionalizimi i lidhjeve të reja do të mundësojë qasje më të lehtë në auto-udhën Arber Xhaferi” jo vetëm për Komunën e Lipjanit por edhe Komunat tjara fqinje dhe do të ndikoj në përmirësimin e performancës së operimit të trafikut në rrjetin rrugor të qytetit të Liojanit.

1.4.2 RRUGËT E PLANIFIKUARA, ATO NË NDËRTIM DHE TË PËRFUNDUARAT

Sipas planifikimit buxhetor 16 për Komunën e Lipjanit janë paraparë investime të konsiderueshme në ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore. Përpos planifikimit të ndërtimit të rrugëve për automjete motorike në tërë territorin e Komunës, është planifikuar ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për lëvizje jomotorike (Këmbësorë dhe çiklist), si dhe përmirësimi i kushteve të sigurisë në trafik me ndërtimin e trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta.

- **Rrugët e planifikuara nga niveli Lokal janë si në vijim:**

Ndërtimi i nenkalimit dhe vazhdimi i ndërtimit të sheshit
Ndërtimi i rruges Hallaq i Madhe-Rufc i Ri
Ndërtimi i rruges Ribar i Madh-Ribar i Vogel
Ndërtimi i trotuarit me ndriqim publik në Akllap
Ndërtimi i trotuarit me ndriqim publik në Gllavic-Marevc
Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime, Smallush, Gomasselë, Llugaxhi, Babushe.
Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr.Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi.
Rikonstruimi i rruges Poturovc- Dobraje të Madhe
Shtigjet e ecjes në Sllovi
Shtigjet e ecjes në Gadime faza e dytë
Rikonstruimi i rruges Zylfie Gashi në Lipjan
Ndërtimi i Rruges Bujan- me rrugën për Kraishtë
Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja brenda në Qytetin e Lipjanit (Rruga Arfim Zhitia, Rr.Bashkim Krasniqi-të rr.Haradin Bajrami- rr.Haxhi Kleqka,
Ndërtimi i trotuarit në rrugën Gadime-Llugaxhi
Ndërtimi i trotuarit në Krojmir
Rikonstruimi i rruges së shkolles në Dobraj të Madhe dhe rrugicat tjera
Asfaltimi i rrugicave në Krojmir, Shale, Resinoc, Qylage, Magure, Vershevc, Baice, Kraishtë Faza III

1.4.3 VLERËSIMI I INTENSITETIT DHE KAPACITETIT TË KRYQËZIMEVE DHE KORSIVE KRYESORE

Të dhënat për flukset e trafikut në rrjetin rrugor, respektivisht për pjesët e rrugëve paraqesin informacion bazë për menaxhimin e rrjetit rrugor ekzistues dhe planifikimin e rrjetit të infrastrukturës rrugore në të ardhmen. Një nga qëllimet e regjistrimit të këtyre të dhënave është përshkrimi i situatës ekzistuese të qarkullimit të trafikut në rrjetin rrugor, përfshirë të gjitha problemet aktuale si një bazë fillestare e njohur për krahasim.

Pas analizës së të dhënave nga matjet e fluksit të qarkullimit në rrjetin rrugor të qytetit të Lipjanit¹⁷, është vlerësuar se rrugët më të ngarkuara nga qarkullimi i automjeteve janë: Rrugët nacionale N25 dhe N2 (që lidh qytetin e Lipjanit me Prishtinën dhe Ferizajn në drejtim të Shkupit). Në këto rrugë brenda 12 orëve (nga 06: 00-18: 00) qarkullojnë rreth 25000-35000 automjete / 12h në të dy drejtimet.

Ndërsa në qendër të qytetit, ngarkesa më e madhe nga qarkullimi i automjeteve paraqitet në rrugën: “Avdi Kelmendi”

¹⁶ Buxheti për vitin 2023- Infrastruktura Publike

¹⁷ Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Lipjanit 2016-2020

në të cilin qarkullojnë rreth 2000 - 3000 aut/h.

Kapaciteti është vlerësuar sipas elementeve geometrike të rrugëve.

Kapaciteti i autoudhës “Arbën Xhaferi”. Në aspektin e projektimit, kjo autostradë është ndërtuar sipas standardeve dhe me elemente geometrike sipas kriterëve teknike për autostrada. Bazuar në shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve në autostradë, gjerësinë e korsive dhe numrin e tyre (2+1), kapaciteti potencial sillet 3500 – 4000 aut/h/kahe.

Kapaciteti i rrugëve nacionale N25 dhe N2 - Këto dy rrugë kanë karakter nacional dhe është nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës (MI). Bazuar në gjerësinë dhe numrin e korsive (nga një korsi për secilën kahe), kapaciteti potencial për kahe sillet rreth 1200 - 1500 aut/h.

Kapaciteti i rrugës rajonale R208 (Lipjan –Magurë-Kleqë dhe rruga RLipjan – Janjevë dhe Lipjan – Gadime - Vrellë). Bazuar në gjerësinë dhe numrin e korsive të trafikut (nga një korsi për secilën kahe), kapaciteti potencial për rrugët rajonale për kahe sillet rreth 1100 - 1300 aut/h.

Kapaciteti i rrugëve lokale - Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor në qytetin e Lipjanit është e përbërë nga rrugë lokale. Bazuar në gjerësitë dhe gjendjen e rrugëve, kapaciteti i rrugëve lokale sillet nga 500 – 800 aut/h/kahe.

Është shumë me rëndësi që të menaxhohet rrjedha e trafikut duke përdorur kontrollin e menaxhimit të trafikut urban për të rritur kapacitetin dhe për të menaxhuar dhe ruajtur në mënyrë efikase asetet e qytetit. Infrastruktura e transportit të qytetit duhet të mirëmbahet në mënyrë efektive për të siguruar vlerën për para dhe për të menaxhuar punën e nevojshme të mirëmbajtjes, për të minimizuar ndërprerjet për përdoruesit në rrjetin rrugor. Është gjithashtu e rëndësishme të merren në konsideratë mundësitë për të përsheptuar përdorimin e “masave të vështira”, të tilla si rialokimi i hapësirës rrugore për mënyra më të qëndrueshme të udhëtimit, korsi për çiklistë dhe shtigje të zgjeruara për këmbësorë. Është e rëndësishme të përmirësohet siguria rrugore në qendër të qytetit, si dhe në lagjet lokale, qendrat periferike, me shtigje të cilësisë së lartë për çiklistë dhe këmbësorë që kanë ndriçim më të mirë rrugor dhe karakteristika të tjera të sigurisë.

Pas analizës së ngarkesës dhe problemeve me kapacitetin në udhëkryqet kryesore është konstatuar se për këto udhëkryqe është e nevojshme të ndërmerren masa adekuate të cilat ndërlidhen me përmirësimin e kapacitetit, shtimin e numrit të korsive të reja në hyrje të udhëkryqeve, kontrollimin dhe koordinimin e kontrollit të trafikut.

1.4.4 MODELET E QARKULLIMIT TË TRAFIKUT

Pas analizës së rezultatetve nga anketimet e realizuara për nevojë të hartimit të PMU për Komunën e Lipjanit¹⁸ lidhur me mënyren e udhëtimit, është konstatuar se, forma më e përhapur e udhëtimit realizohet me automjete personale.

▪ Linjat transportuese ndërkomunale dhe brenda komunës urbane dhe rurale

Sipas Ligji për transportin rrugor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e:

- transportit të udhëtarëve brenda territorit të Kosovës;
- transportit të udhëtarëve jashtë territorit të Kosovës;
- transportit të udhëtarëve për qasje dhe kalim transit nëpër territorin e Kosovës.

Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban dhe urban-periferik brenda kufijve administrativë të komunës.

Sipas Neni 17 të këtij Ligji, dy komuna mund të arrijnë marrëveshje për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve në mes veti. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse aprovohet nga Ministria.

Trafiku urban në komunën e Lipjanit, gjegjësisht në qytet, tash për tash nuk ekziston, ndërsa me zgjerimin dhe rritjen e qytetit, urbanizimin e vendbanimeve dhe me ndërtimin e rrugëve urbane dhe ndërrurbane, duhet pritur zhvillimin e tij, por që zhvillimi i paraparë ekonomiko-social dhe mjedisor do të kërkojë qarkullim më të madh dhe më cilësor të pasagjerëve brenda qytetit, vendbanimeve dhe drejt qendrave tjera komunale.

Në komunën e Lipjanit nuk ka kompani publike të transportit publik. Transporti publik organizohet nga kompani private

¹⁸ Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Lipjanit

të specializuara për ofrimin e shërbimeve të këtij lloj transporti. Shërbime të transportit publik kanë të gjitha vendbanimet e mëdha dhe fushore, ndërsa vendbanimet e largëta kodrinoro-malore të tipit të shpërndarë dhe me numër të vogël të banorëve nuk kanë shërbime të transportit publik. Këto vendbanime janë: **Kleçka, Divjaka, Vrella, Plitkoviqi, Tërbovci, Brusi, Kosnica, Vogoçica dhe Shishari**. Ndërsa ndër vendbanimet e mëdha të cilat kanë shërbime të kufizuara dhe problematike të transportit janë: **Janjeva, Akllapi, Rubovci dhe Krojmiri**. Në këto vendbanime duhet të rritet ose shtohet numri i linjave të transportit, ndërsa në vendbanimet e thella kodrinoro-malore duhet që të investohet në infrastrukturën rrugore përmes asfaltimit të rrugëve ose përmes rregullimit të tyre me zhavorr, si dhe duke shtuar patrullat policore.

Komuna e Lipjanit ka hartuar një Plan të orareve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus për tërë territorin e Komunës¹⁹. Në përgjithësi, plani i orareve të udhëtimit përfshin gjithsej 27 linja të shërbime të autobusëve me linjat që ofrojnë mbulueshmëri të mirë në të gjithë territorin e Komunës së Lipjanit.

Plani i orareve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus është paraqitur më poshtë.

Linja nr. 2

Relacioni	Vrellë e Magurës-Magure-Lipjan
Pikënisja në nisje	Vrellë e Magurës
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Vrellë e Magurës

Linja nr.3

Relacioni	Leletiq - Lipjan
Pikënisja në nisje	Leletiq
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Leletiq

Linja nr.4

Relacioni	Blinajë - (Vërshec)- Lipjan
Pikënisja në nisje	Blinajë – (Vërshec)
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Blinajë – (Vërshec)

Linja nr.5

Relacioni	Teqe – Janjevë - Lipjan
Pikënisja në nisje	Teqe
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Teqe

Linja nr.6

Relacioni	Akllap - Lipjan
Pikënisja në nisje	Akllap
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Akllap

Linja nr.7

¹⁹ Plan i orareve të rrethave të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së lipjanit

Relacioni	Gadime e Epërme – Lipjan
Pikënisja në nisje	Gadime e Epërme
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Gadime e Epërme

Linja nr.8

Relacioni	Shalë - Lipjan
Pikënisja në nisje	Shalë
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Shalë

Linja nr.9

Relacioni	Krojmir - Lipjan
Pikënisja në nisje	Krojmir
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Krojmir

Linja nr.10

Relacioni	Zllakuqan- Ribar i Madh, Kraishtë, Hallaq i Madh, Grackë e Vjeter, - Lipjan
Pikënisja në nisje	Zllakuqan
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Zllakuqan

Linja nr.11

Relacioni	Kraishtë- Ribari i Madh – Lipjan
Pikënisja në nisje	Kraishtë
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Kraishtë

Linja nr.12

Relacioni	Dobrajë e Vogël-Dobrajë e Madhe – Lipjan
Pikënisja në nisje	Dobrajë e Vogël
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Dobrajë e Vogël

Linja nr.13

Relacioni	Lluga-Dobrajë e Madhe – Lipjan
Pikënisja në nisje	Lluga
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Lluga

Linja nr.14

Relacioni	Sllovijë – Lipjan
Pikënisja në nisje	Sllovijë – Shkolla e Re
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Sllovijë- Shkolla e Re

Linja nr.15

Relacioni	Smallushë-Magjistrale–Lipjan
Pikënisja në nisje	Smallushë
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Smallushë

Linja nr.16

Relacioni	Gadime e Epërme -Babush – Lipjan
Pikënisja në nisje	Gadime e Epërme
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Gadime e Epërme

Linja nr.17

Relacioni	Rubofc - Lipjan
Pikënisja në nisje	Rubofc
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Rubofc

Linja nr.18

Relacioni	Grackë e Vogël-Topliqan - Lipjan
Pikënisja në nisje	Grackë e Vogël
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Grackë e Vogël

Linja nr.19

Relacioni	Varigoc-Bregu i Zi - Lipjan
Pikënisja në nisje	Varigoc
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Varigoc

Linja nr.20

Relacioni	Bujan - Lipjan
Pikënisja në nisje	Bujan
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Bujan

Linja nr.21

Relacioni	Lipjan- Konjuh
Pikënisja në nisje	Lipjan
Pikënisja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikëarritja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Lipjan

Linja nr.22

Relacioni	Vrellë e Gadimes - Gadime
Pikënisja në nisje	Vrellë
Pikëarritja në këthim	Gadime e Ulët
Pikënisja në këthim	Gadime e Ulët

Pikëarritja në këthim	Vrellë
-----------------------	--------

Linja nr.23

Relacioni	Kleqkë-Shalë
Pikënisja në nisje	Kleqkë
Pikëarritja	Shalë-Shkolla
Pikënisja në këthim	Shalë-Shkolla
Pikëarritja në këthim	Kleqkë

Linja nr.24

Relacioni	Gllanicë-Dobrajë e Madhe - Lipjan
Pikënisja në nisje	Gllanicë
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Gllanicë

Linja nr.25

Relacioni	Ribari i Vogël - Rufci i Vjetër - Lipjan
Pikënisja në nisje	Ribari i Vogël
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Ribari i Vogël

Linja nr. 26

Relacioni	Glllogovc - Lipjan
Pikënisja në nisje	Glllogovc
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Glllogovc

Linja nr. 27

Relacioni	Banullë- Lipjan
Pikënisja në nisje	Banullë
Pikëarritja	Stacioni i autobusëve-Lipjan
Pikënisja në këthim	Stacioni i autobusëve
Pikëarritja në këthim	Banullë

1.4.5 SHFRYTËZIMI I RRUGËVE NGA MAKINAT, KËMBËSORËT, BIÇIKLETAT DHE METODAT TJERA TË TRANSPORTIT

Rrugët e qytetit të Lipjanit në kuadër të zhvillimit të transportit (lëvizjeve) karakterizohen me përdorues të ndryshëm:

- lëvizjet e motorizuara (veturat për përdorim personal dhe autobusët) dhe
- të pamotorizuara (lëvizja e këmbësirëve dhe biciklistëve).

Formë tjetër të transportit- lëvizjeve në kuadër të qytetit nuk realizohet. Duke analizuar dimensionet dhe shtrirjen e rrjetit rrugor të qytetit të Lipjanit, rezulton se në shumicën e gjatësisë së rrjetit përgjatë rrugëve primare prioritet i është dhënë lëvizjeve të motorizuara në kuptimin e akomodimit të lëvizjeve.

Shfrytëzimi i këtyre rrugëve nga lëvizjet e pamotorizuara –këmbësorët, në përgjithësi është adaptuar pjesa e jashtme e rrugës – trotuari pa marrë në konsideratë madhësinë e fluksit të lëvizjeve si dhe lëvizjet e personave me aftësi të kufizuara. Në shumicën e gjatësisë së trotuareve, paraqiten pengesa fizike konstruktive, automjete të parkuara në mënyrë gjatësore.

Nga analiza e gjendjes së tanishme e mobilitetit të çiklistëve në qytetin e Lipjanit, rezulton se lëvizshmëria e çiklistëve

është shumë e vogël. Sipas analizës hapësinore të qytetit të Lipjanit, ekzistojnë parakushtet për një planifikim të mirëfilltë për të krijuar hapësirë të mjaftueshme për shtigje të çiklistëve, në mënyrë që qytetarët e komunës së Lipjanit të ndihen komod dhe të sigurt gjatë lëvizjes së tyre.

Kjo gjë mund të arsyetohet me disa nga specifikat e qytetit të Lipjanit:

- mungesa e shtigjeve për lëvizje të biçiklistëve,
- përceptimi për mungesë të sigurisë së lëvizjes me biçikletë,
- mungesa e informimit për benefitet e lëvizjes me biçikletë,
- mungesa e inkurajimit në përdorimin e biçikletës dhe
- terreni i përthyer (në distancë të shkurtër, këmi ndryshim të lartësisë).

Përgjatë rrugëve dytësore, pothuajse në tërë gjatësinë paraqitet mungesa e lëvizjes komode të lëvizjeve të pamotorizuara (këmbësorëve dhe biçiklistëve) ku ekzistojnë trotuare në gjerësi të pamjaftueshme, si dhe në pjesët ku nuk ekzistojnë trotuaret lëvizja realizohet në hapësira të përbashkëta të qarkullimit me automjetet.

Kalimi i rrugës nga këmbësorët dhe biçiklistët realizohet në të njëjtin nivel, ku në pjesë të caktuara mungojnë sinjalizimet përkatëse për vendkalim të këmbësorëve. Vështirësitë paraqiten sidomos gjatë lëvizjes natën nga këmbësorët dhe biçiklistët.

Në përgjithësi rrjeti rrugor i qytetit të Lipjanit shfrytëzohet nga automjetet për përdorim personal, transport urban, këmbësorët dhe biçiklistët. Formë tjetër e lëvizjes nuk aplikohet. Shikuar gjendjen e rrjetit rrugor, formën, dimensionin dhe rregullimin e qarkullimit, mund të konstatojmë se prioritet për akomodim i është dhënë lëvizjes së motorizuar.

1.4.6 VLERËSIMI I HAPËSIRAVE EKZISTUESE PËR PARKIM

Sikurse në tërë Kosovën, në vitet e fundit Lipjani ka pasur një rritje të konsiderueshme në përdorimin e automjeteve private dhe të dhënat sugjerojnë se kjo rritje është duke vazhduar edhe në ditët e sotme.

Qyteti i Lipjanit ka një hapësirë të konsiderueshme të parkingjeve të hapura publike, të cilat në masë të madhe plotësojnë nevojat e qytetarëve. Parkingje publike janë gjithsej 38. Nga numri i përgjithshëm i parkingjeve publike 10 prej tyre janë në qytet, ndërsa hapësirat tjera për parkim të mjeteve ndodhen në QKMF, AMF, Stacionet Policore dhe hapësirat e shkollave me 974 vendparkingje.

Lipjani nuk ka ndonjë vendim të miratuar që rregullon çështjen e parkimit. Në tërësi, dhe veçanërisht në qendër të qytetit, parkingjet e automjeteve janë në dispozicion pa pagesë.

Duke qenë e pakontrolluar, kërkesa për parkim pa pagesë ka tejkaluar kapacitetin në dispozicion në Lipjan, dhe me rritjen e vazhdueshme të numrit të automjeteve, rrjedhimisht rritjen e udhëtimeve me automjete, pritjet presion shtesë në hapësirën tashmë të mbingarkuar të parkimit, gjë që do të pengojë jetët e banorëve dhe bizneset që operojnë në këto zona të prekura.

1.5 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE DHE SOCIALE

1.5.1 SHËRBIMET PUBLIKE SHËNDETËSORE

- Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH), nuk ka staf të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të kujdesit parësor me stafin aktual dhe në 8 vitet e ardhshme.
- Ka mbulueshmëri të mjaftueshme në fshatra me Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF).
- Aparatura mjekësore e mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sipas UA 04/2020.
- Qendra Kryesore Mjekësore Familjare (QKMF) aktuale nuk i përmbush nevojat e ofrimit të shërbimeve mjekësore për të gjitha shërbimet e KPSH.
- Nuk ka QMF në qytet dhe Objekti i QKMF-së nuk i plotëson nevojat mjaftueshëm në implementimin e plotë të konceptit të mjekësisë familjare.

1.5.1.1 SWOT ANALIZA

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Shtrirja e rrjetit të QMF-ve dhe AMF-ve në komunën e Lipjanit	Mungesa e QMF-ve në qytetin e Lipjanit
Renovimi i të gjitha QMF-ve dhe AMF-ve	Mungesa e mjeteve për stimulimin e punëtorëve në punkte (QMF dhe AMF)
Furnizimi me inventar, aparatura dhe pajisje mjekësore sipas UA 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor nga MSh	Mungesa e parkingut të mjaftueshëm për pacient dhe staf në QMF dhe AMF (Kanë vetëm nga 8-10 vende parkimi)
Infrastruktura rrugore e mirë dhe e asfaltuar deri te secila QMF dhe AMF (Qasje të lehtë edhe me pjerrina për persona me nevoja të veçanta)	Pa mundësia e punësimit me kohë të caktuar të infermierëve dhe mjekëve të licencuar/a me paga për mbulimin e nevojave me staf infermierë kur ka mungesa të shumta nga puna (pushimet e lehonisë, pushime mjekësore etj.)
Ordinancat mjekësore së bashku me infermier/e, ekipi i plotësuar e mjekësisë familjare	Stafi i mirëmbajtjes me moshë mesatare mbi 55 vjeç dhe me sëmundje të ndryshme kronike, shkakton mungesa të shumta nga puna
Numri i mjekëve familjar i mjaftueshëm për mbulimin e 2000-2500 banorëve.	Lëvizja e mjekëve të rinj për në specializime tjera, e jo në mjekësi familjare.
Numri i mjaftueshëm i infermierëve në raport me nr. banorëve Një infermier/e në 800-1000 banorë	Motivim i ulët i mjekëve të rinj për të specializuar në mjekësi familjare
Zhvillimi i programeve: Vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë, Kujdesi Paliativ, Shërbime shëndetësore të integruara, vizita shtëpiake dhe transporti i pacientëve në QKUK (pacientët e palëvizshëm)	Mungesa e automjeteve për kryerjen e kujdesit paliativ, vizita shtëpiake, shërbime shëndetësore të integruara
Prezenca e ashensorit në QKMF Lipjan për personat e moshuar, dhe nevoja të veçanta	Mungesa e stafit të mirëmbajtjes QKMF ,QMF dhe AMF.
Zhvillimi i pilot-projektit të telemjekësisë	
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Ndërtimi i një QKMF-je me ISO standarde, për objekte shëndetësore, e cila plotëson nevojat e qytetarëve të komunës së Lipjanit	Mos interesimi i mjekëve të ri për të zgjedh specializimin e mjekësisë familjare
Zonimi i komunës së Lipjanit dhe krijimi i listës së pacientëve për një mjekë familjar në 2000-2500 banorë.	Ikja e stafit (mjekëve) të rinj në specializime tjera dhe jashtë vendit.
Funksionalizimi i ekipeve të mjekësisë familjare 1 mjek Familjar: 2 Infermiere familjare	Mosha mesatare e stafit mjekësor mbi 53 vjeç.
Trajnimi i stafit me nivel baçelor për kujdesin ndaj të sëmurëve me sëmundje kronike jo ngjitëse	Infrastruktura e QKMF-së nuk ka shkallë emergjente në rast të shpërthimit të zjarrit
Trajnimi i stafit për shërbimin e Emergjencës	Ndërprerja e ofrimit të vizitave në shtëpi dhe kujdesit paliativ në mungesë të stafit dhe automjeteve.
	Mbingarkesa e QKMF-së me pacientë!
	Mungesa e kuzhinës për punëtorët në objektin e QKMF.
	Mungesa e dhomave zhveshtore

1.5.1.2 VLERËSIMI I NEVOJAVE AKTUALE

1.5.1.2.1 VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË KRITEREVE LIGJORE

Bazuar në UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 08/2017 - ORGANIZMI, STRUKTURA, PËRCAKTIMI I SHËRBIMEVE DHE VEPRIMTARISË SË KPSH-së, komuna ka kompetencë të ofrojë shërbimet e KPSH sipas kriterëve vijuese:

- 1 AMF për 2,000 banorë;
- 1 QMF për 10,000 banorë;
- 1 QKMF për 100,000 banorë;
- 1 mjek familjar dhe dy infermierë për 2,000 banorë;
- 1 stomatolog për 6,000 banorë.

Aktualisht në komunë janë të punësuar:

- 32 mjekë, 18 në zonë urbane, 14 në zonë rurale, në QKMF Lipjan janë edhe 8 mjekë në urgjencë. Gjithsej 40 mjekë familjar/të përgjithshëm;
- 80 infermier dhe staf i mesëm mjekësor, 32 infermier, 12 mami, 10 laborant, 4 tek. farmacist, 6 tek. të stomatologjisë 4 teknik rëntgeni, 12 infermierë në urgjencë në zonën urbane, 31 infermier, 4 laborant, 1 teknik të stomatologjisë në zonë rurale; dhe
- 10 stomatologë, 6 në zonë urbane dhe 4 në zonë rurale.

Rrjedhimisht, bazuar në numrin e përgjithshëm të banorëve rezidentë të supozuar 17,693 në zonë urbane dhe 42,382 në zonë rurale vijues, rezulton që aktualisht ka:

- 10 mjek familjar dhe 20 infermierë më tepër se sa nevojitet për të ofruar shërbime të KPSH; dhe
- Stomatolog të mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë për stomatolog shtesë.

Sa i përket infrastrukturës fizike të institucioneve, me një 1 QKMF, 5 QMF 7 AMF, Komuna i plotëson kriteret e parapara ligjore për ofrimin e shërbimeve të KPSH.

1.5.1.2.2 VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË STRATEGJISË SË NIVELIT QENDOR

1.5.1.2.3 VLERËSIMI I SIPËRFAQEVE TË PARCELAVE TË INSTITUCIONEVE TË KPSH PËR VITIN AKUTAL

Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë është 60,075, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 24,800 m² dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelave për infrastrukturë të institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor, Komuna nuk nevojë për të caktuar sipërfaqe të parcelave kadastrale shtesë për të ofruar këtë shërbim.

Tabela 60. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave të institucioneve të KPSH kundrejt numrit aktual të banorëve

Vendbanimi	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Zonë urbane	17,693	12,500	0.20	3,539	8,961
Zonë rurale	42,382	12,300	0.20	8,476	3,824
Gjithsej	60,075	24,800	0.20	12,015	12,785

Në vijim është paraqitur vlerësimi i madhësisë së sipërfaqeve të parcelave për institucionet e KPSH-ve ekzistuese:

Tabela 61. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave të institucioneve të KPSH kundrejt numrit aktual të banorëve të zonës rrethuese të Gadimes

QMF - Gadime	Numri i vlerësuar aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
--------------	-------------------------------------	---	--	---	---

Gllavicë	285	800	0.2	57	743
Gadime e Epërme	1824	800	0.2	364.8	435.2
Gadime e Ulët	3281	800	0.2	656.2	143.8
Marec	335	800	0.2	67	733
Vrellë	24	800	0.2	4.8	795.2
Plitkoviç	9	800	0.2	1.8	798.2
Gjithsejtë	5758	800	0.2	1151.6	-351.6

Tabela 62. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave të institucioneve të KPSH kundrejt numrit aktual të banorëve të zonës rrethuese të Shalës

Tabela 126. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të varrezave publike kundrejt numrit aktual të banorëve

	Numri i vlerësuar aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Akllap	212	15428	1.5	318	15110
Babush i Muhaxherve	1,307	27653	1.5	1960.5	25692.5
Baincë	545	15612	1.5	817.5	14794.5
Banullë	1,814	17217	1.5	2721	14496
Breg i Zi	334	2843	1.5	501	2342
Brus	164	5038	1.5	246	4792
Bujan	616	542	1.5	924	924
Divlakë	19	6902	1.5	28.5	6873.5
Dobrajë e Madhe	1,716	19022	1.5	2574	16448
Dobrajë e Vogël	108	3770	1.5	162	3608
Gadime e Epërme	1,824	30474	1.5	2736	27738
Gadime e Ulët	3,281	49250	1.5	4921.5	44328.5
Gllanicë	19	0	1.5	28.5	-28.5
Gllavicë	285	7147	1.5	427.5	6719.5
Gllagoc	1,434	9393	1.5	2151	7242
Grackë e Vjetër	592	18697	1.5	888	888
Grackë e Vogël	320	3907	1.5	480	480
Gumnasellë	992	9050	1.5	1488	7562
Hallaç i Madh	273	12425	1.5	409.5	409.5
Hallaqi i Vogël	479	9752	1.5	718.5	718.5

Hanroc	28	2335	1.5	42	2293
Janjevë	3,525	14446	1.5	5287.5	9158.5
Kleqkë	42	15673	1.5	63	15610
Kojskë	324	4766	1.5	486	4280
Konjuh	790	8048	1.5	1185	1185
Kraishtë	1,156	17200	1.5	1734	15466
Krojmir	733	48353	1.5	1099.5	47253.5
Leletiq	306	6229	1.5	459	5770
Lipjan	17,693	28240	1.5	26539.5	1700.5
Llugaxhi	1,090	15026	1.5	1635	13391
Llugë	193	4942	1.5	289.5	4652.5
Magurë	1,020	19371	1.5	1530	17841
Marec	335	4779	1.5	502.5	4276.5
Medvec	696	11162	1.5	1044	10118
Mirenë	174	15026	1.5	261	14765
Plitkoviç	9	2758	1.5	13.5	2744.5
Poturoc	588	7825	1.5	882	6943
Qellopek	329	5295	1.5	493.5	4801.5
Qylagë	639	11216	1.5	958.5	10257.5
Resinoc	395	6900	1.5	592.5	6307.5
Ribar i Madh	1,795	61253	1.5	2692.5	58560.5
Ribar i Vogël	324	10946	1.5	486	10460
Rubofc	766	15640	1.5	1149	14491
Rufc i Ri	653	5422	1.5	979.5	979.5
Rufc i Vjetër	451	5292	1.5	676.5	676.5
Shalë	1,697	28213	1.5	2545.5	25667.5
Silovi	2,947	26554	1.5	4420.5	22133.5
Smallushë	1,166	31877	1.5	1749	30128
Teqe	103	2621	1.5	154.5	2466.5
Tërbuc	0	0	1.5	0	0
Topliqan	1,772	17722	1.5	2658	2658
Torinë	545	6858	1.5	817.5	6040.5
Varigoc	103	3713	1.5	154.5	3558.5
Vërshec	790	12009	1.5	1185	10824
Vrellë	24	3809	1.5	36	3773
Vrellë e Goleshit	578	19902	1.5	867	19035
Vogaqicë	0	230	1.5	0	230
Zllakuqan	136	7536	1.5	204	7,332
Gjithsejtë	60,249	773,309	1.5	90,374	682,936

Në tabelën vijuese janë radhitur varrezat publike sipas përqindjes së shfrytëzueshmërisë:

Tabela 127. Përqindja e shfrytëzueshmërisë së varrezave publike sipas vendbanimeve

Lokacioni #	Sipërfaqja e parceses (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	% e shfrytëzueshmërisë
Vogaqicë	0.02	0.02	0.00	13.04%
Janjevë	0.09	0.07	0.02	18.89%
Brus	0.05	0.04	0.01	26.20%
Hanroc	0.23	0.15	0.08	35.76%
Pletkoviç	0.28	0.15	0.13	45.61%
Vrellë e Goleshit	0.19	0.10	0.09	46.09%

Bokovice	0.20	0.10	0.10	50.10%
Hallaq i Madhë	0.40	0.20	0.20	50.12%
Lipjan	2.01	1.00	1.01	50.24%
Lipjan	0.81	0.40	0.41	50.88%
Qallapek	0.53	0.26	0.27	50.90%
Varigocë	0.37	0.18	0.19	51.52%
Llugë	0.17	0.08	0.09	52.44%
Magurë	0.32	0.15	0.17	53.33%
Bregu i Zi	0.28	0.12	0.16	57.79%
Smallushë	0.36	0.15	0.21	57.81%
Gllavice	0.71	0.30	0.41	58.02%
Zllakuqan	0.75	0.30	0.45	60.19%
Teqe	0.26	0.10	0.16	61.85%
Rubovc i Vogël	0.53	0.20	0.33	61.90%
Magurë	1.62	0.60	1.02	62.86%
Medvec	1.12	0.40	0.72	64.16%
Grackë e Vogël	0.39	0.14	0.25	64.17%
Kraishtë	0.43	0.15	0.28	64.71%
Konjuh	0.23	0.08	0.15	64.93%
Konjuh	0.58	0.20	0.38	65.32%
Rubovc i Madh	0.30	0.10	0.20	66.96%
Topliqan	0.61	0.20	0.41	67.10%
Rufc i Ri	0.15	0.05	0.10	67.53%
Divjakë	0.69	0.22	0.47	68.13%
Marec	0.48	0.15	0.33	68.61%
Kraishtë	1.30	0.40	0.90	69.11%
Hallaq i Vogël	0.98	0.30	0.68	69.24%
Llugë	0.33	0.10	0.23	69.33%
Hallaq i Madhë	0.84	0.25	0.59	70.29%
Rufc i Vjetër	0.53	0.15	0.38	71.66%
Ribar i Madhë	0.54	0.15	0.39	71.99%
Gllgovc	0.94	0.25	0.69	73.38%
Shalë	2.82	0.75	2.07	73.42%
Dobrajë e Vogël	0.38	0.10	0.28	73.47%
Janjevë	1.36	0.35	1.01	74.23%
Rufc i Ri	0.39	0.10	0.29	74.24%
Baincë	1.56	0.40	1.16	74.38%
Ribar i Vogël	1.09	0.25	0.84	77.16%
Babush i Muhaxherve	0.44	0.10	0.34	77.45%
Brus	0.45	0.10	0.35	77.76%
Torinë	0.69	0.15	0.54	78.13%
Babush i Muhaxherve	2.32	0.50	1.82	78.46%
Kojuskë	0.48	0.10	0.38	79.02%
Slovi	2.05	0.42	1.63	79.56%
Rubovc i Madh	0.74	0.15	0.59	79.63%
Llugaxhi	1.50	0.30	1.20	80.03%
Silovi	0.60	0.12	0.48	80.04%
Topliqan	1.16	0.23	0.93	80.25%
Vërshecë	1.20	0.20	1.00	83.35%

Gumnasellë	0.91	0.15	0.76	83.43%
Akllap	1.54	0.25	1.29	83.80%
Leletiq	0.62	0.10	0.52	83.95%
Resinoc	0.69	0.10	0.59	85.51%
Mirenë	1.47	0.20	1.27	86.43%
Bujanë	0.97	0.13	0.84	86.54%
Qylagë	1.12	0.15	0.97	86.63%
Gadim e Epërme	3.05	0.36	2.69	88.19%
Banullë	1.72	0.20	1.52	88.38%
Vrellë e Goleshit	1.80	0.20	1.60	88.92%
Grackë e Vjetër	1.87	0.20	1.67	89.30%
Smallushë	2.83	0.30	2.53	89.41%
Putorovc	0.78	0.08	0.70	89.78%
Kleqkë	1.57	0.15	1.42	90.43%
Dobrajë e Madhe	1.90	0.15	1.75	92.11%
Vrellë e Gadimës	0.38	0.03	0.35	92.12%
Ribar i Madhë	5.59	0.30	5.29	94.63%
Krojmirë	4.84	0.20	4.64	95.86%
Gadime e Ulët	4.93	0.10	4.83	97.97%

1.5.8.3 VLERËSIMI I SIPËRFAQEVE TË PARCELAVE PËR VARREZA PUBLIKE PËR VITIN 2031

Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë për vitin 2031 do të jetë 63,027, sipërfaqet aktuale të parcelave kadastrave prej 773,309 m² dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelave varreza publike në kuadër të vendbanimit, ekzistuese dhe të planifikuara, Komunës nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë:

Tabela 128. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave të varrezave publike kundrejt numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2031

	Numri i vlerësuar i banorëve 2031	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m2)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m2)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m2)
Akllap	137	15428	1.5	205.5	15222.5
Babush i Muhaxherve	1376	27653	1.5	2064	25589
Baincë	201	15612	1.5	301.5	15310.5
Banullë	1897	17217	1.5	2845.5	14371.5
Breg i Zi	286	2843	1.5	429	2414
Brus	50	5038	1.5	75	4963
Bujan	600	542	1.5	900	900
Divlakë	8	6902	1.5	12	6890
Dobrajë e Madhe	1363	19022	1.5	2044.5	16977.5
Dobrajë e Vogël	34	3770	1.5	51	3719
Gadime e Epërme	1258	30474	1.5	1887	28587
Gadime e Ulët	3633	49250	1.5	5449.5	43800.5
Gllanicë	89	0	1.5	133.5	-133.5
Gllavicë	288	7147	1.5	432	6715
Glllogoc	1429	9393	1.5	2143.5	7249.5
Grackë e Vjetër	737	18697	1.5	1105.5	1105.5
Grackë e Vogël	259	3907	1.5	388.5	388.5
Gumnasellë	831	9050	1.5	1246.5	7803.5

Hallaç i Madh	172	12425	1.5	258	258
Hallaçi i Vogël	352	9752	1.5	528	528
Hanroc	12	2335	1.5	18	2317
Janjevë	4486	14446	1.5	6729	7717
Kleqkë	21	15673	1.5	31.5	15641.5
Kojskë	296	4766	1.5	444	4322
Konjuh	901	8048	1.5	1351.5	1351.5
Kraishtë	1005	17200	1.5	1507.5	15692.5
Krojmir	155	48353	1.5	232.5	48120.5
Leletiq	275	6229	1.5	412.5	5816.5
Lipjan	25185	28240	2	23,300	23,299
Llugaxhi	1044	15026	1.5	1566	13460
Llugë	100	4942	1.5	150	4792
Magurë	570	19371	1.5	855	18516
Marec	379	4779	1.5	568.5	4210.5
Medvec	362	11162	1.5	543	10619
Mirenë	85	15026	1.5	127.5	14898.5
Plitkoviç	0	2758	1.5	0	2758
Poturoc	496	7825	1.5	744	7081
Qellopek	329	5295	1.5	493.5	4801.5
Qylagë	419	11216	1.5	628.5	10587.5
Resinoc	181	6900	1.5	271.5	6628.5
Ribar i Madh	1515	61253	1.5	2272.5	58980.5
Ribar i Vogël	174	10946	1.5	261	10685
Rubofc	796	15640	1.5	1194	14446
Rufc i Ri	755	5422	1.5	1132.5	1132.5
Rufc i Vjetër	55	5292	1.5	82.5	82.5
Shalë	1129	28213	1.5	1693.5	26519.5
Silovi	2614	26554	1.5	3921	22633
Smallushë	1089	31877	1.5	1633.5	30243.5
Teqe	37	2621	1.5	55.5	2565.5
Tërbuc	0	0	1.5	0	0
Topliqan	1705	17722	1.5	2557.5	2557.5
Torinë	516	6858	1.5	774	6084
Varigoc	1	3713	1.5	1.5	3711.5
Vërshëc	716	12009	1.5	1074	10935
Vrellë	12	3809	1.5	18	3791
Vrellë e Goleshit	746	19902	1.5	1119	18783
Vogaqicë		230	1.5		
Zllakuqan	44	7536	1.5	66	7470
Gjithsejtë	63,205	773,309	1.5	94,808	678,502

1.5.8.4 VLERËSIMI I SIPËRFAQEVE TË PARCELAVE PËR VARREZA PUBLIKE PËR VITIN 2047

Duke marrë parasysh që një infrastrukturë e tillë parashihet të ketë jetëgjatësi së paku 25-vjeçare, bazuar në vlerësimin e mëposhtëm rezultojnë që Komuna nuk ka nevojë të caktojë sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrave për zhvillimin e infrastrukturës së varrezave publike:

Tabela 129. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelave për infrastrukturë sportive dhe rekreative kundrejt numrit të vlerësuar të banorëve për vitin 2047

	Numri i vlerësuar i banorëve 2047	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m ²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m ²)
Akllap	137	15428	1.5	205.5	15222.5
Babush i Muhaxherve	1376	27653	1.5	2064	25589
Baincë	201	15612	1.5	301.5	15310.5
Banullë	1897	17217	1.5	2845.5	14371.5
Breg i Zi	286	2843	1.5	429	2414
Brus	50	5038	1.5	75	4963
Bujan	600	542	1.5	900	900
Divlakë	8	6902	1.5	12	6890
Dobrajë e Madhe	1363	19022	1.5	2044.5	16977.5
Dobrajë e Vogël	34	3770	1.5	51	3719
Gadime e Epërme	1258	30474	1.5	1887	28587
Gadime e Ulët	3633	49250	1.5	5449.5	43800.5
Gllanicë	89	0	1.5	133.5	-133.5
Gllavicë	288	7147	1.5	432	6715
Gllogoc	1429	9393	1.5	2143.5	7249.5
Grackë e Vjetër	737	18697	1.5	1105.5	1105.5
Grackë e Vogël	259	3907	1.5	388.5	388.5
Gumnasellë	831	9050	1.5	1246.5	7803.5
Hallaç i Madh	172	12425	1.5	258	258
Hallaqi i Vogël	352	9752	1.5	528	528
Hanroc	12	2335	1.5	18	2317
Janjevë	4486	14446	1.5	6729	7717
Kleqkë	21	15673	1.5	31.5	15641.5
Kojskë	296	4766	1.5	444	4322
Konjuh	901	8048	1.5	1351.5	1351.5
Kraishtë	1005	17200	1.5	1507.5	15692.5
Krojmir	155	48353	1.5	232.5	48120.5
Leletiq	275	6229	1.5	412.5	5816.5
Lipjan	25185	28240	2	23,300	23,299
Llugaxhi	1044	15026	1.5	1566	13460
Llugë	100	4942	1.5	150	4792
Magurë	570	19371	1.5	855	18516
Marec	379	4779	1.5	568.5	4210.5
Medvec	362	11162	1.5	543	10619
Mirenë	85	15026	1.5	127.5	14898.5
Plitkoviq	0	2758	1.5	0	2758
Poturoc	496	7825	1.5	744	7081
Qellopek	329	5295	1.5	493.5	4801.5
Qylagë	419	11216	1.5	628.5	10587.5
Resinoc	181	6900	1.5	271.5	6628.5
Ribar i Madh	1515	61253	1.5	2272.5	58980.5
Ribar i Vogël	174	10946	1.5	261	10685
Rubofc	796	15640	1.5	1194	14446
Rufc i Ri	755	5422	1.5	1132.5	1132.5
Rufc i Vjetër	55	5292	1.5	82.5	82.5
Shalë	1129	28213	1.5	1693.5	26519.5

Silovi	2614	26554	1.5	3921	22633
Smallushë	1089	31877	1.5	1633.5	30243.5
Teqe	37	2621	1.5	55.5	2565.5
Tërbuc	0	0	1.5	0	0
Topliqan	1705	17722	1.5	2557.5	2557.5
Torinë	516	6858	1.5	774	6084
Varigoc	1	3713	1.5	1.5	3711.5
Vërshec	716	12009	1.5	1074	10935
Vrellë	12	3809	1.5	18	3791
Vrellë e Goleshit	746	19902	1.5	1119	18783
Zllakuqan	44	7536	1.5	66	7470
Gjithsejtë	63,205	773,309	1.5	94,808	678,502

1.5.8.5 VLERËSIMI I KAPACITETIT FINANCIAR DHE TEKNIK

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprake, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar për realizimin e projekteve kapitale të shërbimeve publike për vitin 2020-2022 ishte 7,544,095.00 € apo 2,514,698.33 € në vit.

Tabela 130. Vlerësimi i trendit për investime kapitale për shërbime publike për tre vitet e kaluara

Viti	2020	2021	2022	Mesatarja në vit	Trendi 2020-2023
Shuma e investimeve kapitale	3,395,043.00 €	2,087,820.00 €	2,061,232.00 €	2,514,698.33 €	-64.71%

Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022 investimet kapitale kanë shënuar rënie prej -64.71%.

Tabela 131. Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale për shërbime publike për 8 vitet e ardhme

Viti	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	Gjithsejtë
Shuma e investimeve kapitale	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698	2,514,698

1.5.8.6 GJETJET KYÇE PËR VARREZA PUBLIKE

Bazuar në vlerësimin e sipërm të hapësirave të hapura publike, numrin e vlerësuar të banorëve për vitin 2047 dhe shfritëzueshmërinë aktuale, Komuna ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë për varreza publike në vendbanimet vijuese:

	Numri i vlerësuar i banorëve 2047	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m ²)	Sipërfaqet e nevojshme (m ²)
Krojmir	78	48353	1.5	116
Resinoc	91	6900	1.5	136
Akllap	137	15428	1.5	206
Leletiq	182	6229	1.5	273
Qylagë	210	11216	1.5	314
Poturoc	220	7825	1.5	330
Dobrajë e Madhe	304	19022	1.5	456
Gumnasellë	348	9,050	1.5	522
Bujan	552	542	1.5	828
Gadime e Epërme	629	30474	1.5	944
Ribar i Madh	675	61253	1.5	1,013

Smallushë	858	31877	1.5	1,287
Llugaxhi	906	15026	1.5	1,359
Grackë e Vjetër	1,172	18697	1.5	1,758
Vrellë e Goleshit	1,250	19902	1.5	1,875
Topliqan	1,504	17722	1.5	2,256
Silovi	1,615	26,554	1.5	2,423
Banullë	2,146	17,217	1.5	3,219
Gadime e Ulët	4,689	49250	1.5	7,034

1.6 MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMERI

Çështjet e zakonshme mjedisore me të cilat përballen komunat, ashtu si edhe komuna e Lipjanit, përfshijnë ndotjen e ajrit, ujërave, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, dhe humbjen e habitateve natyrore, të cilat kryesisht rezultojnë nga aktivitete industriale dhe bujqësore, urbanizimi dhe transporti.

Fillimisht vlen të theksohet që komuna e Lipjanit ka mangësi të mëdha në monitorimin e burimeve të ndotjes së mjedisit dhe përpunimin e të dhënave të sakta nga terreni. Komuna e Lipjanit nuk është pjesë e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit nga AMMK dhe gjithashtu nuk ka ndonjë iniciativë të financuar për monitorimin e ajrit. E njëjta ndodh edhe me cilësinë e dheut, për të cilin AMMK nuk kryen monitorimin e rregullt, por kjo bëhet vetëm në bazë të projekteve të caktuara. Mangësi të tilla vështirësojnë analizimin dhe marrjen e masave të veprimit mbi rritjen e cilësisë së këtyre treguesve mjedisorë.

Sa i përket fatkeqësive natyrore, zjarret dhe vërshimet janë ngjarjet që më së shpeshti prekin pjesë të territorit të komunës. Edhe pse në territorin e komunës nuk ka liqene apo rezervuare me kapacitet të tillë që mund të shkaktojnë vërshime dhe përbëjnë kërcënim (të paktën nuk janë vlerësuar si të tillë), shpyllëzimi dhe erozioni përbëjnë shkaktarët kryesor të kësaj dukurie natyrore, pasuar nga mbushja e shtretërve me mbeturina të ndryshme, si faktorë dytësor. Nga ana tjetër, shtrirja e territorit të komunës në drejtimin lindje-perëndim, në shumë raste vështirëson reagimin në kohë të shërbimit emergjent apo zjarrfikësve. Gjithashtu, zjarret fushore paraqesin rrezik shumë të lartë, ku përveç ndotjes së mjedisit, kërcënojnë përfshirjen e objekteve e vendbanimeve përreth.

1.6.1 NDOTJA E AJRIT

Kontribuesit kryesor në emetimin e gazrave dhe aerosolëve në ajër konsiderohen aktivitetet industriale, burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme, vatrat e djegies përfshirë këtu edhe ngrohjen me lëndë djegëse. Aktiviteti i gurëthyesve mund të ketë një sërë ndikimesh negative në cilësinë e ajrit, me lëshimin e pluhurit dhe grimcave, që ndikojnë direkt në shëndetin e banorëve dhe punonjësve pranë gurëthyesit. Gjithashtu, procesi i nxjerrjes në shumë raste çliron SO₂ dhe NO duke kontribuar në formimin e smogut dhe shiut acid.

Qendrat për grumbullim dhe ç'montimin e automjeteve, si aktivitet mbizotërues në komunë, përbën burim potencial për lëshimin e materialeve të rrezikshme (plumbi, zhiva dhe bifenilët e poliklorinuar - PCB) nga automjetet e vjetra. Ndotës të tillë grumbullohen në nivele të ndryshme në ajër, ujë, tokë, me aftësi transportuese edhe në distanca më të largëta në ajër, dhe përbëjnë rrezik të madh nëse nuk trajtohen dhe asgjësohen në mënyrë adekuate. Ndotja e ajrit nga po i njëjti aktivitet me djegien e materialeve (çlirimi i grimcave, hidrokarbureve aromatika policiklike, etj) gjatë procesit të çmontimit.

Sasitë e përafërta të lëndëve ndotëse që lëshohen në ajër nga aktivitetet e zonës tregojnë për ndikimin e proceseve të djegies dhe motorrëve të automjeteve. Vlerat vjetore të NO₂, paraqiten në rritje e sipër, edhe pse në nivele të pranueshme. Tejkallimet e vlerës kufi për mbrojtjen e vegetacionit dhe ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve të larta të NO₂ mund të çojë në uljen e diversitetit të specieve bimore.

Nivelet e koncentrimin të grimcave PM, pasqyrojnë ndikimin e shkarkimeve në atmosferë nga veprimtaritë industriale. Pavarësisht se nga viti 2020 paraqitet një rënie e vlerave (në baza mujore) të PM₁₀, prapë grimcat e pluhurit përbëjnë shqetësim në afate të caktuara kohore, me tejkallime të ditëve.

Koncentrimet e grimcave PM_{2.5} në ambient janë dukshëm më të larta gjatë muajve të dimrit për shkak të kushteve të

pafavorshme meteorologjike që kufizojnë dispersionin atmosferik, shoqëruar me rritje të emetimeve veçanërisht nga djegia e karburanteve të ngurta për ngrohje të shtëpive dhe ndërtesave tjera. Të dhënat ekzistuese dhe analiza tregojnë se ndotja nga PM duhet adresuar si problem në Rajonin e Prishtinës dhe në Kosovë në përgjithësi.

Një inventar i përafërt i shkarkimeve në ajër nga aktivitetet e motorizuara (burime të lëvizshme) dhe përdorimi i lëndëve djegëse (burime të palëvizshme) do të ishte i mundur, mirëpo në mungesë të të dhënave për një vlerësim të tillë, është shumë e vështirë të kemi një pasqyrë të qartë të koncentrimin të ndotësve aktual dhe vlerësimin e emisioneve.

1.6.2 NDOTJA E UJIT

Kontaminimi i trupave ujqor ndodh kryesisht nga lëshimi i mbeturinave dhe kimikateve nga aktivitetet minerare brenda komunës, në burimet më të afërta ujore. Ndotës të zakonshëm nga këto aktivitete përfshijnë metalet e rënda, sedimentet, dhe jo vetëm. Shkarkimi direkt i ujërave të zeza sanitare dhe industriale në trupat ujorë pa një trajtim paraprak, gjithashtu ka një ndikim domethënës në koncentrimet e ndotësve.

Vlerësimi i nivelit të ndotjes së ujit zakonisht bazohet në monitorimin e cilësisë së ujërave, me ç'rast të dhënat janë siguruar nga IHMK, dhe përfshijnë parametrat fiziko-kimik të ujërave për Lumi Sitnica me vendmostrim – Vragoli, dhe Lumi Shtime me dy vendmostrime – Petrove dhe Muzeqinë.

Nga vlerat vjetore (2019,2020,2021) për parametrat në dispozicion, përgjithësisht Lumi Sitnica rezulton me koncentrimin më të lartë të ndotësve. Nivelet e larta të KBO5 janë indikatorë të sasisë së lartë të lëndës organike nga shkarkimet e ujërave të zeza, mbetjet industriale dhe rrjedhjet bujqësore, ku rrjedhimisht kemi nivele të ulëta oksigjeni. Vlerat vjetore mbi VKL të jonit nitrit dhe fosforit total (ortofosfat dhe polifosfat), gjithashtu përbëjnë shqetësim. Koncentrimet tregojnë që nivelet e ndotësve (me fokus Sitnica) mund të kontribuojnë në formimin e dëmshëm të algave, varfërimin e oksigjenit, duke e bërë ujin të papërshtatshëm për shumicën e jetës ujore.

Të dhëna mbi vlerat e metaleve të rënda (Pb, Cd, Hg, As) si tregues për ndotjen nga shkarkime industriale, aktivitetet minerare apo bujqësia, nuk janë regjistruar. Në këtë pikë është e pamundur të bëhet një vlerësim i ndotjes nga metalet e rënda, dhe rrjedhimisht pjesa e ujërave të zeza merr peshë për at kohë sa një inventarizim nga shkarkimet industriale nuk ekziston.

▪ Prodhimi i parashikuar ditor i ujërave të zeza

Sipas një vlerësimi, bazuar në numrin e banorëve, normën e konsumit të ujit prej 170 l/person/ditë dhe kthimin e ujit si ujëra të zeza, qyteti i Lipjanit parashikohet të ketë mesatarisht 935,000 l/ditë (935 m³/ditë) prodhim ditor të ujërave të zeza shtëpiake, ku faktori i pikut vlerësohet 3.12 dhe pikui i rrjedhës për orë 121.5m³/h.

Kontaminimi organik i ujërave është tregues i rëndësishëm për derdhjen e pakontrolluar të ujërave të ndotur në to. Përveç qytetit të Lipjanit, ku 80% e popullsisë vlerësohet të jetë e kyçur në sistemin e kanalizimit dhe një pjesë e vogël e fshatrave, për pjesën e mbetur nuk ka një inventar nëse përdorin ose jo sisteme individuale për ujërat e përdorur.

Deri më tani nuk ka dëshmi të kontrollimit të tyre dhe ruajtjes nga ndotja e mëtejshme. Idealisht, ndotësit nga burime jo-industriale komunale të natyrës fizike apo kimike, duhet parandaluar të futen në sistemin komunal me një urdhëresë për para-trajtim të ujërave, mungesa e të cilave çon në ndotjen e tokës dhe burimeve të furnizimit me ujë të pijshëm.

Për më tepër, sistemet e vjetra të kanalizimit vështirë ballafaqohen me sasinë e shiut, ku në raste të caktuara stërngarkohen dhe vjen deri te vërshimi i kanaleve dhe rrjedhjen e ujërave të zeza të patrajtuara në sipërfaqe.

Depozitat e ngurta (landfillet) publike, private dhe industriale konsiderohen gjithashtu burime të ndotjes së ujërave për arsye të rrjedhjeve sipërfaqësore dhe nëntokësore. Normalisht, rregullat e landfilleve kërkojnë mbulim ditor, mirëpo gjatë ditës, reshjet shkaktojnë ndotjes si rezultat i shpëlarjes së sipërfaqes.

1.6.3 NDOTJA E TOKËS

Efektet negative të shtrirjes urbane të ushtruara në tokat pjellore, ashtu si në të gjithë vendin, përfshijnë humbjen e përhershme të tokës me zgjerimet e vendbanimeve, rrjedhimisht zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, ndërtimin e kapaciteteve industriale dhe objekteve ndihmëse.

Nga ana tjetër, siç është shprehur edhe më lartë, mungesa e monitorimit të cilësisë së treguesve mjedisor vlen edhe për

dheun/tokën, ku si rrjedhojë duhet të aludojmë për disa burime potenciale ndotëse bazuar në aktivitetet që funksionojnë në këtë territor.

Shkarkimet e ujërave të ndotura dhe pa trajtim janë problem kyç në degradimin e tokave dhe pjellorinë, duke ndikuar në nivelet e reduktuara të oksigjenit në tokë nga prania e lëndës organike. Gjithashtu ndryshimet në pH e tokës që mund të ndikojnë në uljen e aftësisë së tokës për të mbështetur rritjen e llojeve bimore.

Deri më tani nuk janë hasur testime për ndotës të mbetur, që mund të jenë gjetur për shkak të përdorimit historik të tokës, përdorimit të pesticideve dhe plehrave, prodhimi, ruajtja dhe përdorimi i produkteve të thëngjillit, ruajtja dhe përdorimi i produkteve të naftës, aktivitetet minerare, produktet minerare dhe aktivitetet që lidhen me to, trajtimi i drurit, etj.

Erozioni i tokës nga proceset e nxjerrjes, ngjeshja e tokës, kontaminimi, formimi i tokave acide, etj, të koncentruara kryesisht në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës, nga aktivitetet minerare, vazhdojnë të sjellin efekte afatgjata në mjedis dhe komunitetin lokal, si rezultat i largimit të shtresës së sipërme dhe shtresave tjera për zbulimin e shtresave të mineralit. Gjithashtu këto hapësira përbëjnë burim potencial të lirit të partikulateve, në masë më të **theksuar gjatë verës**. Veprimet e mëparshme të pa dekontaminuara paraqesin **çështje të rëndësishme mjedisore, me ç'rast është më se e nevojshme të bëhen përpjekje për masa rehabilituese të tokës si rivejetimi, restaurimi dhe menaxhimi i zonave të tilla, për adresimin e problemeve pas përfundimit të procesit të nxjerrjes**.

Aktiviteti i qendrave për grumbullimin dhe ç'montimin e automjeteve mbeturinë përbën një ndikim tjetër potencial të ndotjes së tokës dhe ujit nga shkarkimi i vajrave nga automjetet, të cilat mund të jenë të dëmshme edhe për biodiversitetin e zonës.

1.6.4 NDOTJA NGA ZHURMA

Burimi më i rëndësishëm i zhurmës nga mjetet lëvizëse konsiderohet ai i prodhuar nga ndërveprimi i rrotave hekurudhore. Duke qenë se përmes territorit të komunës së Lipjanit kalon hekurudha e linjës 10, një nyje hekurudhore që lidh këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi, identifikimi i niveleve të zhurmës nga transporti hekurudhor është shumë i rëndësishëm. Deri më tani, nuk ka pasur iniciativa për llogaritjen e zhurmës nga transporti hekurudhor, marrë parasysh edhe kushtet hekurudhore, dhe si rezultat është shumë e nevojshme të përcaktohen metoda llogaritjeje për emetimin e zhurmës, ku shpejtësia e trenit është parametër i rëndësishëm i cili duhet marrë parasysh. Aktualisht linja është në riparim e sipër dhe normalisht përveç kushteve më të mira hekurudhore, është e pritshme që nivelet e zhurmës të mos tejkalojnë vlerat limite për shqetësimin e popullatës. Rol të madh luan mirëmbajtja, që në rastet e keq mirëmbajtjes, vlerësohet që dallimi i niveleve të zhurmës të jetë mbi 10 dB.

Infrastruktura rrugore në përgjithësi rezulton me cilësi të ulët, pjesa më e madhe nën nivelin e standardeve teknike, gjë që kontribuon në emetimin e zhurmës veçanërisht gjatë lëvizjes së shpejtë të automjeteve. Reduktimi i zhurmës nga trafiku rrugor, në rastin e hekurudhave, rrugëve kryesore dhe aeroportit, masat konsolidohen në plane veprimi pranë zonave potencialisht burime të zhurmës.

Funksionimi i makinerive të rënda në industri gjithashtu mund të kontribuojë në këtë lloj ndotje, për të cilat nuk ka një inventar emetimesh dhe gjithashtu nëse funksionimi i tyre është në harmoni me rregullat dhe kërkesat teknike që i dedikohen nivelit të lejuar të zhurmës të cilën ato gjenerojnë.

Në rastet si kjo, ku mundësitë efektive për reduktimin e zhurmës duke kufizuar apo rregulluar burimin e saj janë të vështira, ndërtimi i pengesave të zhurmës dhe/ose brezave të gjelbër është një formë shumë efikase për zbutjen e zhurmës gjatë rrugës së përhapjes, kryesisht në seksionet e rrugëve apo shinat hekurudhore.

ANALIZA SWOT PËR MJEDISIN

Kjo analizë SWOT ofron një pamje gjithëpërfshirëse të sfidave mjedisore me të cilat përballen komuna e Lipjanit dhe mund të ndihmojë në zhvillimin e strategjive efektive për adresimin e këtyre sfidave. Komuna e Lipjanit mund të punojë drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke shfrytëzuar pikat e saj të forta, duke adresuar dobësitë, duke shfrytëzuar mundësitë dhe duke zbutur kërcënimet.

Përparësitë	Dobësitë
- Tipet e tokave me potencial të lartë pjellor; - Resurse dhe rezerva të lëndëve të para minerale, energjetike, metalore dhe jometalore; - Botë e pasur bimore e shtazore – Rezervati i Blinajës; - Terreni i rrafshët, i përshtatshëm për prodhimtarinë bimore; - Trashëgimi e pasur kulturore dhe burimeve natyrore; - Industria e turizmit në rritje	- Ndotja e ajrit dhe ujit nga aktivitetet industriale; - Gjendja jo e mirë e minierave ekzistuese; - Mungesa e monitorimit të niveleve të ndotjes dhe shkarkimeve në mjedis; - Përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje - Nuk ekzistojnë praktika funksionimi apo teknologji kontrolli nga operatorët industrial, që plotësojnë kërkesat për nivelet e lejuara të ndotëse; - Kontaminimi i trupave ujqor nga kimikatet nga aktivitetet minerare; - Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak - Vatrë e djegies ilegale të mbetjeve kryesisht plastike dhe gomave; - Zjarrevëniet, mungesë inspektimi dhe marrjes së masave të rrepta; - Zbatim dhe pajtueshmëri e kufizuar me rregulloret e mjedisit.
Mundësitë	Rreziqet
- Rezervati i Blinajës mundësi për rekreacion; - Prioritizimi i programeve dhe financimi i projekteve për eksploatimin e resurseve minerale në mënyrë që të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; - Zhvillimi i teknologjisë së re dhe inovacionit për menaxhimin e mjedisit; - Krijimi i partneriteteve me sektorin privat dhe aktorë tjerë për adresimin e sfidave mjedisore; - Vetë-monitorimi i shkarkimeve në ajër dhe ujë nga operatorët që kryejnë aktivitete ndotëse dhe kanë leje operimi; - Marrja e masave rehabilituese të tokave ku ka përfunduar nxjerrja e lëndës minerare; - Investime në sisteme monitorimi të ndotësve, përkatësisht: - Ndotës nga shkarkimet e ujërave - Ujërat nëntokësore afër zonave të shkarkimit - Ndotësit në ajër, etj. - Rivegjetimi i tokave të kontaminuara dhe rritja e hapësirave të gjelbra në tërësi	- Projektet infrastrukturore çojnë në copëtimin e zonave pyjore dhe prishjen e habiteteve të kafshëve të egra; - Nxjerrja e mineraleve dhe lëndëve tjera mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme në ekosistemet pyjore; - Urbanizimi dhe ndryshimet në përdorimin e tokës - degradimi; - Kontaminimi i ujit të pijshëm, eutrofikimi dhe përhapja e sëmundjeve nga derdhja e ujërave të zeza pa trajtim paraprak; - Varfërimi i burimeve natyrore; - Ndryshimet klimatike dhe ndikimi në mjedis;

1.6.5 SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

1.6.5.1 RRËSHQITJET DHE EROZIONI

Erozioni i dheut është një nga faktorët me rol më të madh në degradimin e tokës dhe ndodh si pasojë e heqjes së shtresës

së sipërme të tokës nga sipërfaqja, e cila dihet se përmban materie të nevojshme organike për fertilitet dhe rritje të qëndrueshme të vegetacionit. Me heqjen e kësaj shtrese, toka humbet përbërësit organikë që si pasojë zvogëlojnë biomasën bimore dhe e kthejnë atë në tokë djerrë.

Zjarret kanë pasur dhe do të kenë ndikim të rëndësishëm në erozionin e dheut, ku si pasojë me djegien e bimësisë toka lihet e ekspozuar dhe e pambrojtur ndaj erozionit. Situata aktuale në pjesën lindore kodrinoro-malore të territorit është një shembull konkret i ndikimit të zjarreve malore, ku me rritjen e numrit të zjarreve dhe degradimin e shtresës së vegetacionit (përveç djegies, edhe nga prerja e pakontrolluar), toka rrjedhimisht humb aftësinë e thithjes dhe mbajtjes së ujit, që gradualisht çon në rritjen e rrjedhjeve dhe erozionit. Përveç kësaj, mbetjet e degëve të thara, hiri dhe mbetjet nga zjarri, gjithashtu mund të bllokojnë rrugët ujore me ç'rast përkeqësojnë më tej erozionin dhe rrisin rrezikun e përmbytjeve.

Sa i përket rrëshqitjeve, pjesa më e madhe e territorit përbën territor të rrafshët ose me pjerrtësi relativisht të ulët, e cila rëndomtë nuk preket nga rrëshqitjet. Ana më lindore dhe perëndimore e territorit me terren kodrinoro-malor, kryesisht e pyllëzuar me lloje gjetherënëse, që deri më tash nuk ka treguar prirje për rrëshqitje masive, përpos aty ku ka pësuar prerje të drunjve dhe gërryerje nga dora e njeriut kanë ndodhur rrëshqitje me karakter lokal.

Ka pasur disa raste, ku si rezultat i gërryerjeve të terrenit për qëllime qoftë zgjerimi të truallit, zgjerim dhe asfaltim i rrugëve dhe nevoja të tjera, në periudhat e reshjeve disa ditore ka ardhur deri te rrëshqitja e sasive të konsiderueshme të dheut e gurëve që bllokojnë akset rrugore dhe me raste mund të transportohen deri në drejtim të lumenjve. Në 2-3 raste të gërryerjes së truallit për qëllime zgjerimi të oborreve individuale, si në Krojmir, Kleçkë dhe Brus, rrëshqitjet kanë dëmtuar edhe struktura si mure, garazhe dhe objekte të tjera ndihmëse.

Pa çka se ky lloj kërcënimi në territorin e komunës së Lipjanit nuk ka pasur shtrirje shumë të madhe, nuk eliminojmë rrezikun se mund të ndodhë në të ardhmen me një shtrirje më shqetësuese dhe të shpeshtë, nëse nuk do ketë vetëdijësim dhe praktika parandalimi të rreziqeve.

1.6.5.2 TËRMETET

Kosova përfaqëson një zonë aktive sizmike (veçanërisht rajoni perëndimor) ku shtrihen shumë zona të burimeve sizmike, të cilat paraqesin shkëputje ose zona të shkëputjeve aktive shaktare të tërmeteve. Janë pikërisht shkëputjet aktive, që shkojnë thellë nëntokë, ku lindin tërmetet e në veçanti të ashtuquajturat nyje sizmotektonike, vendet e kryqëzimit të shkëputjeve aktive me drejtime të ndryshme të shtrirjes.

Komuna e Lipjanit paraqet rajon me aktivitet të lartë sizmik, i ndodhur mes zonave sizmogene Kamenicë-Novobërdë-Gjilan. Dy tërmete shumë të forta mund të kujtohen që kanë përfshirë edhe Lipjanin, me të njëjtin intensitet duke u përsëritur pas 166 vjetësh. Tërmete të kohë pas kohshme ka pasur në afërsi, mirëpo kanë qenë relativisht të vogla me magnitudë që variojnë nga 2.1 në 3.7 të shkallës Rihter. Ndonëse nuk janë mjaft të fortë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme, tërmete të tilla ndjehen nga banorët.

1.6.5.3 RESHJET E BORES DHE ORTEQET

Densiteti i mbulesës së drunjve dhe shkurreve gjetherënëse (vrazhdësi më komplekse në sipërfaqen e tokës) ka pasur një ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë e borës, grumbullimin, ngjeshjen, dhe zvogëlimin e rrezikut të orteqeve.

Pavarësisht kësaj, qëndrueshmëria afatshkurtër e shtresës së borës në disa zona, shpjegohet lehtë me faktin e prerjes masive të drunjve dhe zjarret që rregullisht përfshijnë terrene të zones.

Raste të rrëshqitjes së borës nuk është konstatuar se paraqesin ndonjë rrezik të madh për ekonominë dhe popullatën, por nuk do të thotë të eliminohet mundësia për rreziqe në të ardhmen.

Prerja e drunjve në shpatie, gërryerja e kodrave për qëllime ndërtimesh dhe zgjerimesh, aktivitetet e eksploatimit të gurëve pa përfillur kriteret ligjore, krijojnë parakushte për rreziqe të tilla, veçanërisht kur pas periudhës së reshjeve intensive dhe shtresëzimit të borës përdoren eksplozivë.

Me zhvillimet e fundit, në rast të reshjeve intensive dhe shtresëzimit të bores, në pjesën jugore të Gadimes së Ulët, me gërryerjen e kodrës dhe zhveshjen e vegetacionit, mund të krijohen kushtet për krijimin e orteqeve, që potencialisht mund të përbëjë rrezik për shtëpitë e banimit, dhe punonjësit që kryejnë aktivitetin e eksploatimit në minierë.

Muajt më kritik për kushtet klimatike vlerësohet të jenë Shkurt dhe Mars.

1.6.5.4 ERËRAT

Erërat me shpejtësinë më të madhe vjetore vlerësohen të jenë ato jug-perëndim (SW) me vlerë 4,0 m/s, sipas të dhënave nga IHMK. Mirëpo, nga plani i vlerësimit të rrezikshmërisë nga Komuna e Lipjanit, erërat e forta që shkaktojnë dëme janë vlerësuar ato në drejtimin veri-perëndimor, jug-lindor dhe anasjelltas. Në raste të caktuara, kryesisht gjatë muajve të verës, erërat shoqëruar me reshje shiu kanë shkaktuar dëme të mëdha, duke çuar në dëmtimin e shtyllave elektrike, zhvendosjen e pjesëve të kulmeve të ndërtesave, dëmtime në rrjetin e energjisë elektrike dhe dëmtimin e drunjve, etj. Terrenet fushore të hapura të komunës u ekspozohen më shumë erërave të forta, veçanërisht pjesët ku ka pak pemë apo pengesa të tjera natyrore për të ngadalësuar shpejtësinë e erës, duke lejuar që erërat e forta të rrjedhin relativisht të papenguara. Në përgjithësi, kombinimi i terrenit fushor, ndryshimet e temperaturës dhe presionit, gjeografia rajonale i bën këto terrene fushore të prirura ndaj erërave të forta.

1.6.5.5 THATËSIRA

Si në nivel vendi, ashtu edhe komuna e Lipjanit është e prirur ndaj thatësisë përgjithësisht gjatë periudhave të nxehta (muajt e verës). Reshjet e pakta padyshim që çojnë në kushte të thata dhe mungesë të ujit, mirëpo deri tani nuk është raportuar për humbje të konsiderueshme të të korrave apo mungesë uji. Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në thatësira më të shpeshta, dhe të sjellë efekte shkatërruese, mungesë të ujit të pijshëm, dëmtimin e ekosistemeve natyrore, dëme në prodhimin industrial, etj, nëse vazhdohet me ritmin e mos-promovimit të praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe përmirësime në infrastrukturën e menaxhimit të ujit.

1.6.5.6 SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT-SPOTET)

Në fazën e profilit të gjendjes, është identifikuar prania e pikave të nxehta mjedisore, duke përfshirë burime të ndryshme të të dhënave, dhe vlerësuar këto zona me një incidencë apo përqendrim më të lartë të një problemi të caktuar. Në mungesë të mekanizmave matës nuk dihet specifikisht shkalla e ndotjes, mirëpo nga njohuritë lokale prania e tyre përbën rrezik për komunitetin, përfshirë minierat sipërfaqësore të cilat lehtësisht evidentohen edhe nga imazhe satelitore.

Aktivitetet e gurëthyesve mbizotërojnë, të koncentruara më shumë në anën lindore dhe jug-lindore të territorit.

Hot-spotet e identifikuar përbëjnë sfida nga ana mjedisore, sociale e ekonomike. Duke nisur nga dy pika që kanë shtrirje relativisht të gjerë - miniera sipërfaqësore nga nxjerrja e metaleve në ZK Magure dhe ZK Medvec, dhe miniera sipërfaqësore në ZK Babush i Muhagjerëve dhe ZK Gadime e Ulët, ky proces ka sjellë heqjen e sasive të mëdha të tokës të cilat rezultojnë në erozionin e tokës, sedimentimin e rrugëve ujore dhe humbjen e biodiversitetit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj pluhurit, kimikateve dhe ndotësve tjerë ka bërë që specifikisht zona Magure dhe Medvec të bëhet e papërshtatshme për banim, ndikim i cili mund të prek dhe vendbanime tjera fqinje, mirëpo nuk mund të dihet shtrirja nëse deri më tani nuk ka një vlerësim ndotjeje. Një gjë e tillë vlerësohet të jetë një ndër faktorët kyç edhe në zhvendosjen e komunitetit lokal.

Si rezultat i proceseve teknologjike të mëparshme, në rajonin e Lipjanit ekzistojnë materiale të rrezikshme të pranishme të cilat nuk monitorohen dhe nuk kemi qasje në një inventar të tyre. Njohja e llojit dhe sasisë së materialeve të rrezikshme të pranishme mund të ndihmojë që në të ardhmen të zhvillohen masa të duhura sigurie për parandalimin e aksidenteve, derdhjeve dhe ndotjes së mjedisit si pasojë mos trajtimit, asgjësimit dhe ekspozimit të vazhdueshëm.

1.6.5.7 VËRSHIMET

Pavarësisht se lumi Sitnica, i cili grumbullon ujërat e të gjithë lumenjve, përrockave e rrjedhave të tjera dhe ka potencialin më të madh për vërshimin e sipërfaqeve më të mëdha, kjo nuk ka ndodhur deri më tani. Pranë rrjedhës së tij nuk ka ndërtesa apo sipërfaqe tjera të ndërtuara e që vlen të theksohen, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqeve të papërshtatshme, dhe ka ndihmuar në ngadalësimin e rrjedhjes gjatë kushteve me të reshura intenzive dhe zvogëlimin e rrezikut të vërshimeve.

Bazuar në të dhënat e së paku 25 viteve të fundit, pas zjarreve, vërshimet janë fenomeni që më së shpeshti godet pjesë të territorit të komunës së Lipjanit. Në shumicën e këtyre rasteve vërshimet kanë qenë të shpejta dhe koha për reagim

shumë e shkurtër, që përbën një tjetër problematikë.

Pas ndryshimeve klimatike, shpyllëzimet dhe erozioni i dheut konsiderohen faktorë kryesor që po shkaktojnë gjithnjë e më shpesh këtë dukuri natyrore. Me rritjen e volumit dhe shpejtësisë së shirave, gjatë reshjeve intensive, zonat e ekspozuara ndaj vërshimeve ofrojnë kushtet për transportimin dhe depozitimin e dherave dhe materialeve tjera, duke bllokuar rrjedhat ujore dhe respektivisht duke shkaktuar vërshimin e ujit dhe përkeqësimin e përmbajtjeve.

Pavarësisht faktit që së fundmi, me pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve që kalojnë nëpër vendbanime, është vërejtur një ulje e rrezikut për vërshime, bllokimet në rrjedhën e ujit shkaktohen gjithashtu nga struktura apo pengesa fizike si urat, që kufizojnë rrjedhën natyrale të ujit. Në disa raste, nuk është lejuar zëvendësimi i urave ekzistuese me ura përkatëse, duke krijuar “fyta të ngushtë” dhe ndikuar në rrjedhën normale të lumit. Urat ekzistuese nuk janë të projektuara, dhe rrëshimisht nuk mjaftojnë për të përballuar rritjen e rrjedhës së ujit, duke çuar në vërshime të lokalizuara.

Përveç kësaj, hedhja e materialeve inerte në lumenj përbën shqetësim shumë serioz. Rast konkret cilësohet ura kryesore mbi lumin Sitnica, përkatësisht afër ETC-së, ku përveç hedhjes së jashtëligjshme, këto materiale gradualisht mblidhen dhe përfundojnë në pengesat fizike duke krijuar reduktimin e rrjedhës ujore, vërshime sidomos gjatë reshjeve të mëdha dhe ndotjen e ujit.

1.6.5.8 ZJARRET


Shtrirja e gjerë e territorit të komunës së Lipjanit në drejtimin lindje-perëndim e bën shumë të vështirë sigurimin e shërbimeve emergjente, e në veçanti kur zjarret janë të koncentruara në dy skajet e kundërta, ku 75% e zjarreve malore përfshijnë pjesën më lindore të territorit dhe 25% tjetër pjesën perëndimore, specifikisht:

- Pjesa jug-lindore e Rezervatit të Blinajës, segmenti Varigoc – Kraishtë - Ribar i Madh deri në Vërshec
- Pjesa perëndimore e Rezervatit të Blinajës, segmenti Krojmir - Shalë në drejtim të Kleçkës, kufirit më perëndimor të komunës.

Prerja e pyllit dhe materialet e ndezshme në tokë çojnë në ndezjen e zjarreve sidomos në lindje të territorit. Materialet e ndezshme të mbetura përfshijnë gjethe, degë të thata dhe mbeturina të tjera që lehtësisht marrin flakë. Aq më tepër që kjo zonë përballlet me mungesën e rojeve të pyllit, ose ata nuk gjenden aty ku supozohet të jenë në rast të zjarreve. Prandaj, mobilizimi i burimeve si personeli dhe pajisjet për kontrollin dhe shuarjen e zjarrit përbën prioritet për këtë pjesë. Kjo nuk ndodh me zjarret në pjesët tjera të territorit prandaj dëmet janë dukshëm më të vogla.

Në aspektin numerik rastet e zjarreve fushore dominojnë, pa anashkaluar dëmet e shumëfishta nga zjarret në terrene malore. Pjesa qendrore dhe e rrafshët është tokë bujqësore, ku ka dhe infrastrukturën më të rëndësishme, pranë të cilës shtrihen edhe ndërtimet dhe bizneset më të mëdha.

Zjarret fushore janë shndërruar në një dukuri që si duket nuk e shqetëson askënd përveç atyre që janë të ekspozuar direkt nga ky fenomen. Ato ndodhin rregullisht pas korries së drithërave, që bashkë me hamulloren janë djegur edhe grunajat fqinje. Të dhënat e fundit (2021) tregojnë për gjithsej 450 raste të zjarreve prej ku, 47.1% e rasteve kishin të bëjnë me djegien e hamulloreve, 15.1% zjarre malore, 10.2% djegia e mbeturinave, dhe pjesa tjetër që përfshin zjarret nga procese teknologjike dhe të tjera si në grafikun më poshtë.



Grafikoni 19. Zjarret në komunën e Lipjanit sipas Planit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Komunën e Lipjanit

Numri më i madh i rasteve të zjarreve ka ndodhur gjatë muajve të nxehtë të vitit Gusht-Shtator, me ç’rast kushtet e zgjatura të thata rrisin rrezikun e zjarreve duke e bërë bimësinë e zonës më të ndjeshme për ndeje.

ANALIZA SWOT PËR SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Burimet natyrore po zvogëlohen dita ditës, duke ulur sipërfaqen nga ana fizike dhe njëkohësisht pjellorinë, kapacitetin e burimeve dhe shkatërrimin e ekosistemit. Nisur nga ajo se pjesë e madhe e territorit përbën terrene fushore, ku erozioni, rrëshqitjet dhe fatkeqësitë tjera supozohet të kenë shtrirje të vogël, dita-ditës dëme të tilla po shënojnë rritje për shkak të disa faktorëve. Humbja dhe zhveshja e tokës nga aktivitetet njerëzore (zjarrvëniet, shpyllëzimi, ndryshimet në përdorimin e saj, ndërtime, etj), po rrisin impaktin negativ të shiut në këto toka, duke shkaktuar njëkohësisht edhe ngjeshjen dhe uljen e kapacitetit infiltrues të tokës. Sasia e erozionit lidhet ngushtë me fuqinë e reshjeve dhe aftësinë e tokës për të mbajtur ato, gjë që po shënon rritje në mungesë të menaxhimit të kulturave bujqësore apo faktorit të vegjetacioni, kryesisht.

Përparësitë	Dobësitë
- Morfologjia sipërfaqësore ofron kushte të mira për parandalimin e erozionit, rrëshqitjeve, dhe rritjen e infiltrimit të ujit në tokë; - Terrenet malore të pasura me lloje gjetherënëse, luajnë rol të madh në strehimin e kafshëve të egra, rregullimin e burimeve ujore, reduktimin e erozionit dhe ofrimin e shërbimeve thelbësore të ekosistemit; - Komuna është në proces të përfundimit të Planit për Vlerësimin e Rrezikshmërisë në nivel lokal; - Deri më sot nuk ka pasur raste të rrëshqitjeve të borës apo orteqeve me ndikim në ekonomi dhe popullatë; - Pastrimi dhe hapja, rregullimi i shtretërve të lumenjve pranë vendbanimeve të kërcënuara nga vërshimet;	- Dëmtimi i shtresës së sipërme të tokës, humbja e përbërësve organik; - Prerja e pakontrolluar e pyjeve, zjarret pyjore dhe djegia e bimësisë krijon kushte të favorshme për erozion (rrjedhimisht humbjen e tokës), qëndrueshmërinë afat shkurtër të shtresës së borës dhe vërshime; - Mungesë inspektimi për gërryerjet e terrenit për qëllime individuale; - Zonat malore me ndjeshmëri të lartë të biodiversitetit u ekspozohen numrit më të madh të zjarreve; - Zjarrvëniet, mungesë inspektimi dhe marrjes së masave të rrepta; - Ekspozimi ndaj pluhurit, erozionit, sedimentimi, dhe humbje e biodiversitetit nga minierat e hapura sipërfaqësore; - Hedhja e materialeve inerte në lumenj; - Mungesë mobilizimi të personelit për kontrollin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje, si dhe reagimin në kohë të shërbimit emergjent;

	- Numër i madh i zjarreve fushore nga djegia e hamulloreve, djegia e mbeturinave;
Mundësitë	Rreziqet
- Mbrojtja e pyjeve të vjetra, parandalimi i shpyllëzimit dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme të pylltarisë; - Masa rehabilituese të tokave të degraduara dhe kontaminuara nga prerja e pyjeve, materiale të rrezikshme, aktivitete minerare, zjarret, erozioni, etj; - Implementimi i praktikave për menaxhimin e ujërave të stuhisë; - Depozitimi i duhur i mbeturinave; - Teknika kontrolli të erozionit – Mbulesa vegetative për mbrojtjen e dheut; - Stabilizimi i pjerrtësive përmes mureve mbajtëse në lokacionet e prirura nga rrëshqitjet; - Largimi i materialeve (p.sh. degëve) të thara të ndjeshme ndaj ndezjes; - Rritja e inspektimit për dëmet mjedisore, identifikimi i zonave dhe aktiviteteve që shkaktojnë dëme dhe gjobitja;	- Krijimi i orteqeve me gërryerjen e vazhdueshme të kodrës në disa lokacione dhe zhveshjen e vegetacionit; - Humbja e tokës bujqësore si rezultat i erozionit dhe vërshimeve (ulje e pjellorisë, ulje e redimentit të të korrave, ndotja e ujit, etj); - Bllokimi i rrugëve nga rrëshqitjet e tokës, dhe nga pikëpamja e sigurisë shkaktimi i aksidenteve; - Rritja e sedimentimit në rrugët ujore, dhe rritja e përmytjeve të mundshme; - Humbja e bimësisë dhe habitateve të kafshëve të egra; - Dëmtime strukturore të ndërtesave, urave dhe rrugëve; - Ndotja e ajrit nga ekspozimi ndaj zjarreve;

PERCAKTIMI I NEVOJAVE – KONSTATIMET PER MJEDISIN DHE SIPERFAQET ME RREZIKSHMERI

Përcaktimi i nevojave prioritare për mbrojtjen e mjedisit në komunën e Lipjanit përfshin një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale të mjedisit (burimet natyrore, identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e gjendjes së ajrit, ujit dhe tokës) dhe identifikimin e sfidave më të rëndësishme mjedisore me të cilat përballlet komuniteti.

Analizimi i të dhënave mjedisore në dispozicion, mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe asgjësimit të mbetjeve deri tani na ofron një pasqyrë të zonave me problem të rëndësishme mjedisore që duhet të adresohen. Bazuar në këto gjetje, komunës i duhet të prioritetizojë zonat ku duhet zbatuar masat për mbrojtjen e mjedisit.

GJETJET KRYESORE

Ndotja e ajrit

- Duhet bërë inventarizim i burimeve për identifikimin e burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në komunë, përfshirë transportin, aktivitetet industriale dhe ngrohjen e banesave;
- Matja dhe monitorimi i emetimeve për vlerësimin e niveleve të ndotësve në ajër (sasitë dhe llojet e ndotësve) nga burimet e identikuara, dhe përcaktimi i kontributit të secilit burim në emetimet totale të komunës.

Nevojat/konstatimet

- Inkurajimi i përdorimit të transportit publik, çiklizmit dhe ecjes në vend të makinave private, duke ndihmuar në reduktimin e emetimeve nga transporti;
- Promovimi i përdorimit të sistemeve të ngrohjes me efikasitet energjetik në shtëpi dhe ndërtesa, përmes incentivave financiare, integritit si kërkesë në kushtet ndërtimore, apo formë tjetër;
- Zbatimi i rregulloreve për kufizimin e emetimeve nga aktivitetet industriale me qëllim rregullimin e emetimeve

industriale;

- Promovimi i përdorimit të lëndëve djegëse më të pastra, si gazi natyror, për uljen e emetimeve nga ngrohja dhe transporti;
- Inkurajimi i individëve, bizneseve dhe vetë qeverisjes lokale për mbjelljen e pemëve dhe krijimin/rritjen e hapësirave të gjelbra për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të pyllëzimit që synojnë maksimizimin e përfitimeve (hije, reduktimin e CO₂, thithjen e grimcave PM, reduktime në shpejtësinë e erës, etj).

Ndotja e ujit

- Identifikimi dhe adresimi i burimeve të lëndës organike në ujë, është një hap shumë i rëndësishëm në garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ujërave;
- Vlerat vjetore të parametrave ndotës kanë treguar për nivele të larta të lëndës organike që mund të vijnë nga shkarkime industriale, ujërat e zeza dhe rrjedhjet bujqësore, për të cilat nevojitet zbatimi i masave të kontrollit të burimit.
- Vlerësime të trupave ujqor, për sa i përket ndikimit të aktiviteteve të caktuara, janë të reduktuara në paraqitjen e vlerave të monitorimeve të disa parametrave fiziko-kimike, monitorime këto që në të shumtën e rasteve nuk kryhen sipas procedurave të caktuara ose nuk janë të plota.
- **Nevojat/konstatimet**
 - Ngritja e kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza, reduktimin e rrjedhjeve bujqësore dhe zbatimin e rregulloreve më të rrepta për asgjësimin e mbetjeve industriale;
 - Mundësi për planifikimin e sistemeve të menaxhimit të ujërave të zeza duke pasur parasysh ri-përdorimin (ripërdorim bujqësor, rimbushje, shkarkime në ujërat e brendshme, etj);
 - Zbatimi i praktikave adekuate të menaxhimit të mbetjeve, me theks të veçantë atyre industriale, përfshirë trajtimin e tyre para shkarkimit, trajtimin dhe ruajtjen e materialeve të rrezikshme, etj;
 - Kontroll i shtuar i përdorimit të plehrave dhe pesticideve dhe aplikimit adekuat të tyre për parandalimin e rrjedhjeve;
 - Zbatimi i praktikave të kontrollit të erozionit si mbjelljet e kulturave mbulesë me qëllim thithjen e lëndëve ushqyese të tepërta dhe reduktimin e sasisë së rrjedhjes;
 - Aplikimi i teknikave si ajrimi, për rritjen e sasisë së oksigjenit në ujë;
 - Rregulloret dhe zbatimi i ligjit mbi kufinj të shkarkimeve të ndotësve, pajisja me leje për shkarkim dhe zbatimi i gjobave në raste të mospërputhjes;

Planifikimi i sistemeve të menaxhimit të ujërave të zeza, mund të përfshijë aplikimin e ligatinave të ndërtuara, si sisteme të thjeshta, të menaxhueshme në nivel lokal dhe me kosto efektive për trajtimin biologjik (largimin e përbërësve organik) përmes bimëve ligatinore.

▪ **Ndotja e tokës**

Është shumë e rëndësishme të kryhen testime të rregullta, në veçanti në tokat përreth minierave, të cilat mund të çlirojnë metale të rënda, okside të azotit, grimca në ajër dhe ujë, etj, me qëllim të identifikimit dhe adresimit të burimeve të ndotjes dhe ndërmarrjen e hapave të duhur për zbutjen e ndikimit në mjedis.

▪ **Nevojat/konstatimet**

- Zbatimi i kontroleve më të rrepta të ndotjes, kufizime në zonat e ndjeshme dhe krijimi i tampon zonave rreth minierave për mbrojtjen e komunitetit pranë tyre;
- Masat e kontrollit të erozionit si tarraca, mbulimi vegjetativ dhe praktikatat e mulçimit për ngadalësimin e rrjedhës së ujit dhe bllokimin e sedimenteve;
- Plane apo teknika rehabilitimi/rikultivimi në vendet ku ka përfunduar nxjerrja e lëndëve minerare apo zonave tjera të “trazuara” për shkak të aktiviteteve njerëzore, duke specifikuar qartë përdorimin e propozuar të tokës,

kthimin e vegjetacionit vendas, ekosistemet dhe habitatet që synohen të zhvillohen;

- Nevoja për kanale infiltrimi, pellgje të sedimenteve dhe masa tjera kontrolli të rrjedhjeve;
- Ruajtja e tokës në kontekstin hapësinor dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime ndërtimore;
- **Ndotja nga zhurma**

Deri më sot nuk janë bërë vlerësime të niveleve të zhurmës edhe përkundër faktit që brenda komunës ekzistojnë burime potenciale të ndotjes akustike;

Mungesë e dokumenteve/planeve të veprimit për uljen e niveleve të zhurmës.

Masat parandaluese të listuara më poshtë fokusohen kryesisht në zhurmën e trafikut rrugor, pasi konsiderohet si një çështje kryesore, për më tepër autoritetet lokale janë përgjegjëse dhe vendimet për këtë fushë mund të ndërmirren më lehtë. Masat për reduktimin e zhurmës janë natyrisht të nevojshme edhe në sektorin e trafikut hekurudhor dhe ajror, megjithatë autoritetet lokale kanë hapësirë shumë të kufizuar për veprim në këtë fushë, për shkak të përfshirjes së autoriteteve të nivelit qendror. Megjithatë niveli lokal dhe ekspertët duhet të kenë parasysh këtë çështje gjatë hartimit të planit për reduktimin e zhurmës.

- **Nevojat/konstatimet**

- Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Zhurmat;
- Inkurajimi i çiklizmit, ecjes dhe menaxhimi i trafikut dhe parkimit, me qëllim reduktimin e dendësisë së trafikut rrugor;
- Reduktimi/shmangja e trafikut përmes decentralizimit të komoditeteve lokale në nënqendrat e vendbanimeve;
- Përcaktimi i rrugëve të veçanta për mjetet e rënda, dhe ndalime/kufizime për këto mjete në periudha të caktuara;
- Rregullore për reduktimin e kufinjve të shpejtësisë në zonat e ndjeshme dhe ato të banimit;
- Instalimi i barrierave të zhurmës (sidomos përgjatë rrugëve);

- **Rrëshqitjet dhe erozioni**

Degradimi i mbulesës bimore ka bërë që zona të caktuara, kryesisht ato me terren kodrinor, të jenë më të ndjeshme ndaj fenomenit të erozionit;

Humbja e vazhdueshme e tokës bujqësore kualitative;

Sasia dhe intensiteti i reshjeve dhe erës ka ndikuar në shkallën e erozionit, me formimin e grykave dhe kanaleve që rrisin mundësinë për erozion më të rëndë me kalimin e kohës;

Aktivitetet lokale njerëzore, të tilla si ndërtimet, minierat, bujqësia dhe shpyllëzimi kanë ndikuar në deformime të peizazhit natyror dhe heqjen e mbulesës bimore;

- **Nevojat/konstatimet (erozioni)**

- Mbjellja e bimësisë me qëllim stabilizimin e tokës, reduktimin e rrjedhjes dhe përmirësimin e shkallës së infiltrimit në zonat më të ekspozuara ndaj erozionit;
- Instalimi i strukturave të kontrollit të erozionit si muret mbajtëse, argjinatura;
- Mirëmbajtja e rregullt e vegjetacionit ekzistues përmirëson efektivitetin e bimësisë në parandalimin e ndikimeve;
- Zbatimi i kufizimeve në përdorimin e tokës në zonat me bimësi të degraduar, lejimi i rikuperimit dhe stabilizimit të tokës me reduktimin e erozionit;

- **Nevojat/konstatimet (rrëshqitjet)**

- Ruajtja dhe rivendosja e mbulesës bimore në zonat e prirura ndaj rrëshqitjeve;
- Kufizimin e zhvillimeve në këto zona;
- Në terrenet të prirura për rrëshqitje, planifikohet ndërtimi i mureve mbajtëse, kryesisht pranë rrugëve,

trotuareve, dhe infrastrukturës tjetër publike;

- Si ndikime me karakter lokal, praktika si tarracimi apo mulçimi janë lehtë të aplikueshme për stabilizimin dhe parandalimin e rrëshqitjeve;
- Iniciativa ndërgjegjësimi për rreziqet që kanosen;

- **Reshjet e borës dhe orteqet**

Deri më tash nuk ka pasur raste të rrokullisjeve, por zhvillimet e fundit krijojnë parakushte për orteqe në të ardhmen;

Zonat subjekt i gjërryerjeve dhe degradimit nga aktivitete ekonomike, shfaqen më të prirura ndaj pa-qëndrueshmërisë së borës dhe formimit të mundshëm të orteqeve.

- **Nevojat/konstatimet**

- Analiza të rregullta të grumbullimit të bores në zonat e paqëndrueshme, përcaktimi i nevojave për masat e kontrollit të orteqeve;
- Teknika stabilizimi për zvogëlimin e rrezikut të orteqeve si përdorimi i spirancave, gardheve të borës dhe metoda tjera në zonat si Gadimja e Ulët, dhe zonat tjera të rrezikuara;

- **Erërat**

Mungesa e pengesave natyrore në terrene fushore, ndikon në rrjedhjen e papenguar të erërave

- **Nevojat/konstatimet**

- Zbatimi i planit të gjelbërimit mbrojtës, dhe monitorimi i efektivitetit të gjelbërimit ndaj ngjarjeve të forta të erës;

- **Thatësira**

Ndryshimet klimatike dhe menaxhimi i dobët i ujit në të ardhmen mund të ndikojnë dhe lidhen ngushtë me rritjen e ngjarjeve ekstreme të motit, përfshirë edhe thatësinë.

- **Nevojat/konstatimet**

- Adoptimi i kulturave tolerante ndaj thatësisë nga fermerët, dhe praktika menaxhimi të tokës në ruajtjen e lagështisë së tokës;
- Inkurajimi i kursimit të ujit;
- Sisteme efikase të ujitjes dhe kontrolli i nxjerrjes së ujërave nëntokësorë, ku nxjerrja e tepërt mund të kontribuojë në kushtet e thatësisë;

- **Sipërfaqet me ndotje të lartë (hot-spotet)**

Aktivitetet e gurëthyesve dhe minierat sipërfaqësore kryesisht kanë pasur ndikim në cilësinë e tokës, ujit, ajrit, dhe ekosistem;

Prania e materialeve të rrezikshme;

Hot-spotet me shtrirjen më të gjerë dhe ndikimin më domethënës shtrihen në lokalitetet me numër relativisht të lartë të banorëve.

- **Nevojat/konstatimet**

- Përdorimi i proceseve efikase të nxjerrjes dhe procesimit të lëndës së parë;
- Pastrimi i zonave të kontaminuara – trajtimi i tokës dhe ujërave të kontaminuar;
- Zbatimi i standardeve të emetimit, taksave të ndotjes dhe masave tjera rregullative;
- Monitorimi i rregullt i materialeve të rrezikshme në Janjevë, për identifikimin e rreziqeve të mundshme;

- **Vërshimet**

Shpyllëzimet, erozioni, transportimi dhe depozitimi i sedimenteve deri në bllokimin e rrjedhave ujore përbëjnë faktorët kyç ndaj fenomenit të vërshimeve;

Për shkak të terrenit të gjerë, mundësitë reale për mbrojtje dhe shpëtim janë tejet të kufizuara;

- **Nevojat/konstatimet**

- Monitorimi i shtretërve të lumenjve, e në veçanti i segmenteve të rregulluara nëpër vendbanime;
- Projektimi dhe menaxhimi i duhur i urave të reja (me profil jo më të vogël se profili i shtratit të lumit) për zbutjen e rrezikut të vërshimeve;
- Ndërtimi i argjinaturave mbrojtëse përgjatë brigjeve të lumenjve, apo infrastrukturës tjetër për kontrollin e vërshimeve, mirëmbajtja dhe inspektimi i tyre;
- Komuna të sigurojë opsione të duhura depozitimi të mbetjeve, me qëllim parandalimin e hedhjes së paligjshme në shtretërit e lumenjve;
- Zbatimi i gjobave për hedhjen e paligjshme;
- Shqyrtimi i mundësive për krijimin e partneriteteve të reja me operatorë privat për reagimin në kohë dhe intervenime në rast vërshimesh;

- **Zjarret**

Zjarret fushore dominojnë, marrë parasysh edhe konfiguracionin e terrenit, është më se e kuptueshme, derisa zjarret fushore gjatë djegies së hamulloreve kërcënojnë përfshirjen në objektet dhe parcelat përreth;

75% e zjarreve malore përfshijnë pjesën më lindore të territorit, ku dëmet nga prerjet e pyjeve dhe materialet e ndezshme në tokë janë të shumfishta;

Si në rastin e vërshimeve, shtrirja e territorit e vështirëson intervenimin në kohë të shërbimit emergjent, sidomos gjatë periudhave të thata, shtuar këtu edhe pakujdesinë e rojeve të pyllit;

Rezervati i Blinajës vlerësohet i rrezikuar si pasojë e pozicionit në mes të segmenteve me 25% të zjarreve malore;

- **Nevojat/konstatimet**

- Të merren masa ndaj fermerëve lidhur me djegjen e hamulloreve, respektimin e distancës nga ndërtesat fqinje, rrugët, apo strukturave tjera për parandalimin e përhapjes së zjarrit;
- Zbatimi i rreptë i ligjeve dhe rregulloreve për pengimin e aktivitetit të shpyllëzimit të jashtë-ligjshëm dhe përdorimin e zjarrit për pastrimin e tokës;
- Pastrimi i bimëve të mbetura dhe të thata që përbëjnë material ndezës, si dhe mirëmbajtja dhe ujitja sistematike e bimësisë ekzistuese;
- Hartimi dhe zbatimi i planit të emergjencave, identifikimi i rrugëve të paralajmërimit të shpejtë dhe evakuimit;
- Shtimi i së paku 2 nënstacioneve me qëllim shkurtimin e kohës së reagimit;
- Investime në parandalimin dhe kontrollin e zjarrit, përfshirë shtimin e numrit të personelit dhe pajisjeve për shuarjen e zjarreve, trajnimet dhe vendosjen e sistemeve të paralajmërimit;
- Mobilizime shtesë sidomos gjatë periudhave të thata dhe temperature të larta.

1.7 ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE

1.7.1 ASETET E TRASHIGIMISË NATYRORE

Ruajtja e trashëgimisë natyrore është shumë e rëndësishme fillimisht për biodiversitetin e zonës, si habitate kritike për botën bimore dhe shtazore, luajnë një rol jetik në rregullimin e klimës përmes proceseve si sekuestrimi i karbonit dhe menaxhimi i ujit, si dhe mundësi për turizëm dhe rekreacion të kontrolluar.

Me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë natyrore, MMPHI konkretisht AMMK ka hartuar listën për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, në bazë të së cilës në komunën e Lipjanit janë nën mbrojtje 1 asete të kategorizuara si Zonë e Veçantë e Mbrojtur dhe 1 asete të kategorizuara si Peizazhe të Mbrojtura:

- Zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve (Ligatina e Hencit-Radevës);
- Vendgjueti me Rëndësi të Veçantë – Blinaja (Peizazh i Mbrojtur);

- Shpella e Gadimes (Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik).

Ndërsa në nivel lokal, Komuna ka nën mbrojtje edhe disa asete të trashëgimisë natyrore të cilat kanë vlerë në zingjirin natyror të komunës, këto asete janë të listuara si më poshtë:

- Lokaliteti i Boshtrës “Forsythia Europaea” (Monument natyror me karakter botanik);
 - Burimet e Ujit në Baicë (Monument Natyror me karakter hidrologjik);
 - 7 asete të tjera në kategorinë Monument Natyror me karakter botanik;
 - 1 aset Monument Natyror me karakter gjeomorfologjik.
- **Gjetjet kyçe:**
- Nevoja për mbrojtja dhe rivitalizimi i strukturave dhe hapësirave natyrore (Kleqkë dhe Divjakë, Shpella e Mermerit Gadime, Lokaliteti i Boshtrës, Peizazhi i mbrojtur Blinaja etj) të cilat paraqesin një potencial të trashëgimisë natyrore;
 - Mungesë e një plani të shfrytëzimit të zonave me potencial ekonomik si Shpella e Gadimës, Peizazhi i Blinajes, Kleçka dhe Divjaka;
 - Infrastruktura jo e kompletuar për hapësirat e aseteve trashëgimis natyrore duke marrë parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm;
 - Nevoja për rritjen e vetëdijes mbi vlerat që ka komuna në trashëgemi natyrore.

1.7.2 ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Asetet e trashëgimisë kulturore për mbrojtje janë përzgjedhur nga DB e trashëgimisë kulturore të MRKS, në të cilën janë të vendosur të dhënat e inventarizimit të realizuar nga institucionet e trashëgimisë kulturore që prej vitit 2001. Në kuadër të listës së aseteve të trashëgimisë kulturore të RKS dhe, nuk është vendosur asnjë aset i trashëgimisë kulturore jomateriale/shpirtërore në përkatësi të Komunës së Lipjanit.

Sipas të dhënave në DB e trashëgimisë kulturore të MKRS, asetet e vendosura në listen e trashëgimisë kulturore nuk kanë të përcaktuar vlerat atribuese që duhet ruajtur dhe asnjë kriter të rezhimit të mbrojtjes së tyre sipas parametrave që kërkojnë me legjislacionin në fuqi për trashëgimi kulturore dhe planifikim hapësinor.

Në kuptimin e slartëshënuar mungon përcaktimi i autenticitetit apo vecorive të dallueshme të aseteve; konturat e sipërfaqeve të hapësirave në mbrojtje, përfshirë kufiri i perimetrit të bërthamës/hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth tij; funksioni dhe përdorimi aktual i ndërtesave dhe parcelave; gjendja teknike me kërkesat për mirëmbajtje, riparim apo restaurim; si dhe kushtet e përdorimit dhe limitet/ndalesat ndaj zhvillimeve bashkëkohor në hapësirat në mbrojtje.²⁰

Tabela 132. Përmbledhja e të dhënave kryesore të aseteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Lipjanit

Kategoria	Asete & ZVM	Perimetri Zona mbrojtur ZVM		Sipërfaqja e mbrojtur		Statusi ligjor i mbrojtjes		Autenticiteti Kushtet e mbrojtjes& konservimit
		përcaktuar	pa përcaktuar	përcaktuar	pa përcaktuar	përhershme	perkohshme	pa përcaktuar
T. Arkeologjike	13	0	13	0	13	0	13	13
T. Arkitekturore	12	0	12	0	12	0	12	12
T. Luajtshme	6	0	6	0	0	0	6	16
T. Shpirtërore	0	0	0	0	0	0	0	0
Peiz. kulturore	0	0	0	0	0	0	0	0
ZV Mbrojtura	2	1	1	1	1	0	2	0
Total	35	1	34	1	34	0	35	35

²⁰ Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës <https://dtk.rks-gov.net>

Përzgjedhja e aseteve për mbrojtje është bërë nga institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore - Qendra Rajonale të Trashëgimisë Kulturore/QRK në Prishtinë, Instituti Arkeologjik i Kosovës/IAK dhe Muzeu i Kosovës/MK, me vlerësime të bazuar në kriteret e legjislacionin për trashëgimi kulturore.

Asetet të vendosura në listën e trashëgimisë kulturore kryesisht kanë statusin e mbrojtjes së përkohshme, të cilat trajtohen njëjtë sikurse ato me status të mbrojtjes së përhershme. Ndërsa, asetet e trashëgimisë kulturore dokumentimi i trashëgimisë kulturore për

Në mungesë evidente të përmbushjes së detyrimeve ligjore sipas kërkesave ligjore themelore të mbrojtjes, hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore arkitekturore dhe arkeologjike ende nuk janë të regjistruar në planet kadastrale dhe, as përcaktuar sipërfaqe të mbrojtura në Planin Hapësinor të Kosovës, Harta Zonale dhe Planin Zhvillimor të Komunës, përveç 2 aseteve të përcaktuara si zone e vecant të mbrojtur dhe zone e veçantë.

Si rrjedhojë e mangësive të specifikuar, sfondi i aseteve të trashëgimisë kulturore i përcaktuar në mbrojtje ligjore me të gjitha elementet e tyre përbërëse janë në rrezik nga zhvillimet e transformimeve të pakontrolluara bashkëkohore.

1.7.3 DETYRIMET E MBROJTJES

Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes efektive të trashëgimisë kulturore ka të vendosur sistemin ligjor, të administrimit dhe të financimit, nëpërputhje me parime, kriteret dhe praktikën ndërkombëtare. Në këtë relacion, Kushtetuta siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si pasuri e cmuar me interes nacional të Kosovës. Ndërsa, kuadri ligjor themelor i planifikimit hapësinor dhe të trashëgimisë kulturore, përcakton definicionet, kriteret e vlerësimit, procedurat, përgjegjësitë, detyrimet, të drejtat dhe obligimet institucionale dhe individuale. Në këtë kuadër, aktet themelore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë: 1) Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore (2006) me 9 Rregulloret ndërlidhëse të Ministrisë së Kulturës (MKRS) (2008/2017); 2) Ligji Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor (akti paraprak i shfuqizuar Ligji Nr. 2003/ 14 për Planifikim Hapësinor) me rregullore dhe udhëzues ndërlidhës4) Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtim, 5) Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 të MKRS dhe Planit Hapësinor i Kosovës dhe Planet Zhvillimore të Komunave.

Legjislacioni i trashëgimisë kulturore është i ndërlidhur me legjislacionin të planifikimit hapësinor që siguron zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Në këtë relacion, kuadri ligjor përcakton rregullat dhe detyrimet për ndërmarrjen e masave juridike të mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore, me qëllim harmonizimi të zhvillimeve bashkëkohore dhe kërkesave të ruajtjes së autenticitetit dhe integritetit të tyre hapësinor, fizik, historik, kulturor dhe estetik.²¹

Në kuptimin e dispozitave ligjore, potenciali i trashëgimisë kulturore përfshinë të gjitha dëshmitë materiale dhe jomateriale njerëzore të krijuar nga parahistoria dhe deri me sot, të cilat përmbajnë vecori të dallueshme dhe me rëndësi në aspektin e zhvillimit historik, shoqëror, kulturor, shkencor, teknologjik, ekonomik, etj. Përzgjedhja dhe vlerësimi i potencialit për mbrojtje bëhet sipas kriterëve ligjore dhe me objektivitet profesional e shkencor, pa dallim të gjendjes teknike, periudhës historike, të krijuesit, të religjionit, të përkatësisë etnike apo relacionit pronësor, posedues, shfrytëzues dhe të funksionit. Potenciali i trashëgimisë kulturore për mbrojtje, identifikohet dhe regjistrohet me dokumentim relevant sipas standardeve profesionale në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore. Ky potencial klasifikohet në 5 kategori: trashëgimi arkeologjik, arkitekturore, e luajtshme, shpirtërore/jomateriale dhe peizazhe kulturore. Në kuadër të këtyre kategorive dhe në vartësi të përmbajtjes së karakteristikave, asetet klasifikohen në nënkategori. P.sh. Asetit të trashëgimisë kulturore arkitekturore, klasifikohet në a) Monument (një ndërtesë apo strukture ndërtimore), b) Grup ndërtesa (ansambël) dhe 3) Fushat e konservuara arkitekturore.²²

Përzgjedhja e aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje bëhet nga Inventari i Trashëgimisë Kulturore, të cilat përcaktohen me status fillimisht në mbrojtje të përkohshme dhe pastaj në mbrojtje të përhershme. Statusi i aseteve në mbrojtje të përkohshme zgjatë në afat prej një viti. Ndërsa, asetet në mbrojtje të përkohshme mbajnë të njëjtin status

²¹ Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, Neni 1, 2, 3, 4, 6, 7,9;
Ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, Neni1,9,18.

²² Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, Neni 2, 3.

sikurse asetet në mbrojtje të përhershme. Asetet e përcaktuar në mbrojtje vendosen në Listën e Trashëgmisë Kulturore të Republikës së Kosovës, me vendime të përcaktimit të tyre në mbrojtje, të cilat vendime shpallen në Gazetën Zyrtare të RKS. Pronarët e aseteve të trashëgmisë kulturore në mbrojtje njoftohen me shkrim nga autoriteti i trashëgmisë kulturore, duke specifikuar të drejtat dhe obligimet, me limitet e përdorimit dhe të transformimeve.²³

Inventari i aseteve të trashëgmisë kulturore kompletohet me dokumentacion relevant në përmbajtje sipas standardeve profesionale dhe kriterëve ligjore, duke përfshirë të dhënat: lokacioni me adresë dhe kordinata gjeografike; përshkrimi i attributeve të vlerave që përmban, përcaktimi i autenticitetit dhe deklarata e rëndësisë; përshkrimi i gjendjes teknike, funksionit, pronësisë dhe shfrytëzuesit; kushtet e mirëmbajtjes, të mbrojtjes dhe mundësitë e rigjenerimit/restaurimit me limite të përdorimit dhe të ndërhyrjeve transformuese.

Lokacionet e aseteve të trashëgmisë arkitekturore, arkeologjike dhe peizazhet kulturorenë mbrojtje, pëcaktohen me kontura të kufirit të perimetrit të hapësirës së asetit në mbrojtje dhe të zonës së mbrojtjes rreth perimetrit, duke specifikuar kushtet dhe kriteret të përdorimit dhe ndalesat ndaj zhvillimeve bashkëkohore. Konturat e perimetrit të hapësirës/berthames së asetit në mbrojtje dhe kufiri i zonës së mbrojtjes përreth perimetrit paraqiten me plane grafike. Këto kontura të hapësirës së perimetrit dhe zonës së mbrojtjes rreth tij vendosen në distanca të arsyeshme që siguron ruajtjen e autenticitetit dhe të integritetit historik, fizik dhe hapësinor të aseteve të trashëgmisë kulturore nga zhvillimet bashkëkohore. Kontrura e perimetrit dhe zonës së mbrojtjes të asetit të trashëgmisë kulturore formësojnë sipërfaqen e mbrojtur. Ndërsa, këto përcaktime kërkojnë analiza dhe arsyetime me dokumentim relevant sipas kriterëve të përcaktuar në aktet ligjore të trashëgmisë kulturore dhe të planifikimit hapësinor.²⁴

Sipërfaqet e mbrojtura të hapësirave të aseteve të trashëgmisë kulturore arkitekturore, arkeologjike dhe peizazhet kulturore, me konturat e kufirit të perimetrit dhe zonës së mbrojtjes përreth tij vendosen në Planin Hapësinor të Kosovës, Harta Zonale Qendrore dhe të komunave, Plane Zhvillimore të Komunave dhe planet kadastrale. Këto sipërfaqe krijohen me qëllim kufizimi të ndërtimeve apo aktiviteteve të cilat mund të dëmtojnë veçoritë natyrore dhe të trashëgmisë kulturore. Zhvillimi i sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgmisë kulturore bëhet sipas kriterëve të përcaktuar Ligjit nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, në të cilin, neni 18 paragrafi 4 përcakton: 'Në sipërfaqe të mbrojtur nuk lejohet ndërtimi i godinave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje dhe as planifikimi hapësinor urban dhe rural nga niveli lokal.' Në vijim, neni 9 paragrafi 1.11 specifikon: 'Përcaktimi i kushteve ndërtimore dhe dhënia e lejes së ndërtimit për ndërtime brenda sipërfaqes së mbrojtur është në përgjegjësi dhe kompetencë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor (MMPH).'²⁵

Në vartësi të nevojave për zhvillim ekonomik apo të turizmit nga sektorët e Qeverisë apo të Komunës, një sipërfaqe e mbrojtur do të shpallet Zonë e Veçantë nga Qeveria përmes Hartës Zonale të Kosovës. Përderisa, rezervati arkeologjik dhe peizazhi kulturor përcaktohet si zonë e veçantë në pajtim me nenin 18 të Ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor. Menaxhimi i zhvillimeve në zonat e vecanta kërkon Planin Hapësinor të Vecant, hartimi i të cilit është në kompetencë të autoriteteve për planifikim hapësinor në bashkëpunim me institucionet e trashëgmisë kulturore dhe të komunave.²⁶

Në sipërfaqet e aseteve të trashëgmisë kulturore në mbrojtje, përfshirë hapësirën mbrenda perimetrit dhe zonës së mbrojtjes rreth perimetrit, ndërhyrjet restauruese dhe ndërtimore duhet zhvilluar sipas studimeve dhe planeve të miratuar dhe të lejuar nga institucionet përgjegjëse për trashëgmi kulturore dhe të planifikimit hapësinor. Studimi, hartimi dhe miratimi i planeve dhe zbatimi i punimeve të restaurimit apo konservimit dhe ato ndërtimore, duhet të realizohen sipas standardeve profesionale, kriterëve dhe procedurave ligjore, gjithëherë me angazhim të specialistëve dhe organizatave profesionale të licencuar.²⁷

Asetet që janë në gjendje të keqe teknike, duhet shpëtuar nga shembja apo avaritë e mundëshme përmes ndërmarrjes së masave të domosdoshme riparimi urgjent, në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore. Politikat për ruajtjen,

²³ Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, Neni 3.

²⁴ LIGJI NR. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, neni 2, 3, 4, 6, 7; rregullore nr.05/2008 mbi regjistrimi dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e trashëgmisë kulturore për mbrojtje/mkrs.

²⁵ Ligji nr. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, neni 2, 6, 7, 8; ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, neni 18.

²⁶ Ligji nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, neni 18, 9.

²⁷ Ligji nr. 02/L-88 për trashëgimisë kulturore, neni 3,4,5, 6, 7,8;

rregullore nr. 03/2008 mbi aktivitetet konservuese dhe restauruese të trashëgmisë kulturore mkrs.

menaxhimin dhe zhvillimin e fushave të konservuara arkitektuale përcaktohen së bashku nga Institucioni kompetent i trashëgimisë kulturore dhe autoritetet qendrore dhe lokale për planifikim hapësinor.²⁸

Finacimi i veprimtarisë së mbrojtjes, të aktiviteteve të konservimit, hulumitimit, gërmimeve shpëtimi dhe të restaurimit, bëhet nga buxheti i shtetit dhe të komunave, fonde ndërkombëtare, grante, sponsorime, investime private si dhe përmes lehtësirave fiskale, përveç të tjera, lirimi i pronarëve nga tatimi në pronë dhe trashëgimi.²⁹

1.7.4 PROBLEMATIKA

Sipas analizës së hollësishme të gjendjes aktuale, potenciali i trashëgimisë kulturore të Komunës së Lipjanit, kryesisht paraqitet në situatë të pafavorëshme, largë përkujdesjes së duhur ligjore dhe profesionale. Monumentet dhe lokalitetet me vlerat atribuese të tyre janë të nënshruar proceseve degraduese nga vjetërsia e ndërtimeve, braktisja, ndërhyrjet transformuese jocilësore, si dhe të rrezikuara nga ngulfatja e mjediseve rreth tyre nga ndërtimet e reja të paharmonizuar me kriteret dhe kërkesat e mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore. Kjo gjendje e potencialit të trashëgimisë kulturore, përfshinë game të gjërë të problemeve të ndërlidhura me shumë faktor dhe akter. Bazuar në faktet evidente, ndër kryesore theksohen ceshtjet sipas radhës së parashtruar.

CESHTJET DHE SFIDAT	
1	Komuna e Lipjanit posedon potencial të trashëgimisë kulturore përtej 35 asete të vendosur në Listën e Trashëgimisë Kulturore të RKS. Në Listë nuk janë përfshirë asnjë aset i kulturës tradicionale shpirtërore/jomateriale dhe peizazh kulturor.
2	Asetet e trashëgimisë arkeologjike shumështrësore të përcaktuar në mbrojtje, nuk janë në gjendje të mirë teknike, strukturat janë të shkapërderdhura, pa menaxhim, mbikqyrje, mirëmbajtje dhe pa kushte për visitor. Gjetjet arkeologjike janë të vendosura në depot të Muzeut Kombëtar apo Institutin Arkeologjik të Kosovës dhe QRTK Prishtinë.
3	Asetet e trashëgimisë arkitekturore në mbrojtje, kryesisht janë të rrezikuara nga restaurimet jocilësore që zhvillohen në trende të paharmonizuara me kërkesat e mbrojtjes dhe të konservimit të vlerave të tyre ndërlidhëse në aspektin kulturor, fizik dhe hapësinor. Mjedisi rrethues i monuenteve dhe lokaliteteve arkeologjike apo arkitekturore rrezikohen nga ngritja e ndërtimeve të reja të paharmonizuar me kushte dhe kriterë ligjore.
4	Në zonat e veçanta/ të mbrojtura zhvillimet bëhen pa plane konservimi dhe menaxhimi.
5	Asetet të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore nuk kanë të përcaktuar atributet e vlerave që përmbajnë, kushtet dhe kriteret e mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit të tyre, as përshkrimin e gjendjes me nevojat e ndërhyrjeve riparuese emergjente, si dhe as kufizimet/ndalesat ndaj zhvillimeve dhe shfrytëzimit bashkëkohor apo planet e menaxhimit me akterët përgjegjës.
6	Asetet të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore me status në mbrojtje të përkohshme, nuk kanë të përcaktuar kufirin e perimetrit të hapësirës/bërthamës së asetit në mbrojtje dhe zonën e mbrojtjes përreth perimetrit.
7	Lokacionionet e asete të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore me status në mbrojtje të përkohshme, nuk janë të paraqitur me të dhëna të parcelave kadastrale dhe koordinata gjeografike. Identifikimi i tyre për mbrojtje ndaj zhvillimeve bashkëkohore është i vështirë.
8	Lokacionionet e 134 asete të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore, nuk janë të përcaktuar sipërfaqe të mbrojtura në Hartën Zonale dhe Planin Hapësinor të Kosovës dhe as nuk kanë të vendosur kushtet për përdorim, dhe as mundësitë e zhvillimit dhe limitet të ndërtimeve të reja.
9	Infrastruktura mbrenda dhe jashtë aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje është e vjetërsuar dhe paraqet rrezik për avari. Në asetet e trashëgimisë kulturore, casja për vizitorë është e vështirë.
10	Komuna, krahas posedimit të potencialit të madhë të trashëgimisë kulturore, nuk ka strategji apo politika dhe institucion përgjegjës për menaxhimin e zhvillimit dhe të mirëmbajtjes së këtij kapitali si potencial për zhvillimin e turizmit kulturor dhe të punesimit, si dhe as Muze për përkujdesje, interpretim dhe prezantim të historisë dhe

²⁸ Ligji nr. 02/I-88 për trashëgimisë kulturore, neni 6. po këtu, neni 5.

trashëgmisë kulturore me vlera dhe rëndësi locale, nacionale dhe universale. Mungon politika e lehtësirave fiskale që përcaktohet si e drejtë ligjore për pronarët e trashëgmisë kulturore.

Çështjet problematike të identifikuar janë të natyrës komplekse që kryesisht ndërlidhen me ngecjet evidente të institucioneve përgjegjëse për trashëgmi kulturore dhe ato të planifikim hapësinor në përmbushjen e detyrimeve kryesore ligjore dhe objektivave strategjike të qeverisë të përcaktuar për masat e mbrojtjes efektive dhe të konservimit të qëndrueshëm të trashëgmisë kulturore. Megjithatë, në proceset e zhvillimeve dhe transformimeve për nevojat e intereseve individuale, nuk lejohet degradimi apo humbja e asnjë elementi të trashëgmisë kulturore.

Asetet e trashëgmisë kulturore të krijuar ndër breza dhe mileniume detyrimisht duhet ruajtur dhe rigjeneruar për përdorim të përshtatshëm bashkëkohor, sipas trendeve të sukseshme të konservimit në interes dhe me dobi të përbashkët shoqërore, ekonomike, kulturore, punësimi dhe ekologjike.

Ruajtja e potencialit të trashëgmisë kulturore është detyrim i shoqërisë bashkëkohore për brezat pasardhës që realizohet përmes vlerësimit, mbrojtjes dhe konservimit sipas parimeve dhe standardeve profesionale bashkëkohore. Në kuadër të vlerësimit të trashëgmisë kulturore, duhet të përfshihen edhe trashëgmia jomateriale dhe peizazhet kulturore. Monumentet dhe lokalitetet e trashëgmisë kulturore duhet ruajtur me të gjitha elementet ndërlidhëse që përbëjnë autenticitetin dhe integritetin e tyre hapësinor, fizik, historik dhe kulturor.

Konservimi dhe restaurimi si qëllim kryesor përcakton ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit të monumenteve dhe lokaliteteve të trashëgmisë kulturore. Proceset e vlerësimit dhe konservimit të duhur të potencialit të trashëgmisë kulturore në dobi dhe interes të përbashkët kolektiv, janë në vartësi të përmbushjes së detyrimeve dhe përgjegjësiwe institucionale dhe individuale të përcaktuara në legjislacionin e trashëgmisë kulturore dhe të planifikimit hapësinor.³⁰

Në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore të përcaktuara për ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e trashëgmisë kulturore, në dispozicion është dokumenti shtetëror Strategjia Kombëtare për Trashëgmi Kulturore e MKRS, që synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuar në parimin e qëndrueshmërisë, duke përfshirë avancimin e sistemit dhe mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgmisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.³¹

1.7.5 AUTORITETI I MENAXHIMIT

Pëmbushja e detyrimeve ligjore të mbrojtjes së trashëgmisë kulturore, ushtrohet nga institucione me përgjegjësi të ndarë në spektër të gjërë, duke përfshirë: Ministria e Kulturës (MKRS), Departamenti i Trashëgmisë Kulturore (DTK), Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM), Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK), Muzeu i Kosovës (MK), Qendrat Rajonale për Trashëgmi Kulturore, Inspektorati i Trashëgmisë Kulturore (ITK), Këshilli i Kosovës për Trashëgmi Kulturore (KKTK). Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Instituti i Planifikimit Hapësinor dhe Komunitatet.

Ministria e Kulturës dhe Departamenti i Trashëgmisë Kulturore janë përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësiwe të përcaktuar në legjislacion dhe Strategji Kombëtare për Trashëgmi Kulturore, përmes hartimit dhe zbatimit të rregulloreve me udhëzues të standardeve profesionale, si dhe politika dhe programe ndërsektoriale në linjë integruese me planifikim hapësinor, plane kadastrale dhe plane zhvillimore të komunave. Në këtë drejtim, një ndër detyrat më të rëndësishme shtetërore është krijimi i Inventarit të Trashëgmisë Kulturore, me të dhëna dhe dokumentacion në përmbajtje sipas kriterëve ligjore, si dhe ndërlidhjen e këtij inventari me Planin Hapësinor të Kosovës, plane kadastrale në nivel qendror dhe lokal dhe Planet Zhvillimore të Komunave. Përderisa, krijimi i inventarit të trashëgmisë kulturore është në përgjegjësi të Ministrisë së Kulturës (MKRS).³²

³⁰ Ligji nr.04/l-174 për planifikim hapësinor, neni 1.

³¹ Strategjia kombëtare për trashëgmi kulturore 2017-2027.

³² Ligji nr.02/l-88 për trashëgimi kulturore, neni 3, 4; Rregullore nr.05/2008 mbi regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe perzgjedhjen e trashëgimiskulturore për mbrojtje, mkrs.

IKMM, IAK, MMK dhe QRTK-të, përfshirë edhe ato të Prishtinës, janë institucionet përgjegjëse për verifikimin sistematik të inventarizimit (identifikim, dokumentim dhe regjistrim), vlerësimin, përzgjedhjen, propozimin të aseteve të trashëgmisë kulturore për mbrojtje, si dhe për konservim dhe restaurim të tyre. Inventarizimi, vlerësimi, përzgjedhja e aseteve për mbrojtje të përkohëshme dhe të përhershme, konservimi dhe restaurimi duhet zhvilluar sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin të trashëgmisë kulturore, si dhe në përputhje me standarde profesionale. Në këtë kuadër, përcaktohen vlerat atribuese me karakteristikat që duhet mbrojtur dhe deklarata e rëndësishme të aseteve të trashëgmisë kulturore, konturat e perimetrit të hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth perimetrit, gjendja, kushtet dhe kriteret me rezhimin e mbrojtjes. Asetet e trashëgmisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme i përcakton MKRS, të cilat paraqiten në KTKp për shqyrtim dhe vendosje në mbrojtje të përhershme.³³

MPH është përgjegjëse për vendosjen e sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgmisë kulturore dhe klasifikimin e zonave të vecanta në Planin Hapësinor dhe Hartën Zonale të Kosovës, si dhe për përcaktimin e kushteve të zhvillimit të tyre, përfshirë lëshimin e lejeve ndërtimore. Në Planin Zhvillimor, Komunitetet janë përgjegjëse për zbatimin e kushteve të përcaktuara për ruajtjen, përdorimin dhe konservimin e aseteve të trashëgmisë kulturore në mbrojtje, përmes planeve të konservimit dhe të rigjenerimit.

IKMM dhe IAK miraton planet, lëshon lejet dhe mbikqyrë punët e konservimit dhe restaurimit në monumente, si dhe lëshon pëlqimet për ndërtime në mjediset/zonat e mbrojtjes rreth aseteve në mbrojtje. Ndërsa, me qëllim sigurimi të integritetit të aseteve në mbrojtje sipas parametrave ligjorë të trashëgmisë kulturore, inspektimi bëhet nga ITK në kuadër të MKRS.³⁴

Të gjitha institucionet janë përgjegjëse për ndërmarrjen e masave të domosdoshme emergjente në rastet kur asetet janë në shkallë rreziku nga dëmtimi apo rënimi dhe braktisja e monumentit.

1.7.6 MUNDËSITË E RIGJENERIMIT

Në vendet e zhvilluara në Evropë, mjediset jetësore më atraktive janë ato që përmbajnëtribute me vlera të trashëgmisë kulturore. Ndërsa, këtotribute mjedisore tradicionale zhvillohen përmes ruajtjes, mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe rigjenerimit shumë të vëmendshëm të lokacioneve të trashëgmisë kulturore, meqenëse cilësohen potenciali i rëndësishëm për mirëqenien shoqërore dhe shtyllë kryesore e zhvillimit ekonomik të tyre.³⁵

Komuniteti i Lipjanit, në zonat urbane dhe rurale posedon shtet pasur me asete të trashëgmisë kulturore materiale dhe jomateriale të krijuar në kontinuitet nga parahistoria deri me sot. Në këtë kuadër përfshihen 35 asete të trashëgmisë kulturore arkitekturore dhe arkeologjike, ndërsa duhet zgjeruar listen e aseteve me traditat e kulturës jomateriale/shpirtërore, peizazhet, muzika tradicionale, artefaktet popullore, lojërat, ngjarjet dhe performancat, folklori, gojëdhënat dhe historia e vendit.

Sfondi i aseteve të trashëgmisë kulturore të Komunitetit të Lipjanit, paraqet identitetin dhe civilizimin mijëvjeçar të vendit dhe popullatës së saj. Këto asete të trashëguara ndër breza e mileniume, cilësohen kapitali i cmuar me vlera shumëdimensionale për zhvillime të qëndrueshme. Ruajtja dhe rigjenerimi i këtyre aseteve është detyrim kolektiv në interes të shoqërisë bashkëkohore për brezat pasardhës. Natyra e trashëgmisë kulturore është e ndjeshme, kërkon përkujdesje të vecant kolektive dhe institucionale në procese të planifikimit të zhvillimeve bashkëkohore.³⁶

Veprimtaria e mbrojtjes dhe konservimit të qëndrueshëm përfshinë shumë rregulla, akte dhe interese. Asetet të trashëgmisë kulturore duhet vlerësuar dhe konservuar me të gjitha elementet dhe vlerat atribuese të tyre që përbëjnë

³³ Ligji nr.02/l-88 për trashëgimi kulturore, neni 3, 4; Rregullore nr.06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgmisë kulturore, vartëse të ministrisë së kulturës, rinisë, sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente.

³⁴ Ligji nr.02/l-88 për trashëgimi kulturore, neni 4; Rregullore nr.03/2008 mbi aktivitetet konservuese dhe restauruese të trashëgmisë kulturore, mkrs. Rregullore nr.04/2008 mbi autorizimet dhe kompetencat e inspektionit për trashëgimi kulturore, mkrs.

³⁵ *The social and economic value of cultural heritage: literature review by cornelia dümcke and mikhail gnedovsky, eenc paper, july 2013.*

³⁶ *Convention concerning the protection of the world cultural and natural heritage, unesco 1972.*

autenticitetin dhe integritetin hapësinor, kulturor, historik, fizik dhe estetik. Krahas aktiviteteve të cilësimit të aseteve në lista të mbrojtjes apo restaurimit të izoluar të monumenteve dhe gërmime arkeologjike, parashtrihen nevojat për ndërmarrjen e masave të mbrojtjes efektive dhe konservimit aktiv apo rigjenerimit të aseteve në funksion zhvillimi të mjedisit jetësor atraktiv dhe të qëndrueshëm, drejtë turizmit kulturor.

Rigjenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore për nevojat e zhvillimeve bashkëkohore, realizohet përmes vlerësimit dhe planifikimit gjithëpërfshirës ndërmjet institucioneve përgjegjëse të trashëgimisë kulturore, të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit, si dhe popullatës. Mbrojtja efektive dhe konservimi aktiv i aseteve të trashëgimisë kulturore duhet të pozicionohet si objektiv parësor në politikat e zhvillimit dhe planifikimit dhe zhvillimit urban, në funksion krijimi të mjediseve jetësore kualitative dhe perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm shoqëror, kulturor, arkitekturor, ekologjik, turizmi, ekonomik, politik dhe punësimi. Në këtë mënyrë sigurohemi që nevojat aktuale të individëve nuk komprometojnë atributet e pasurisë së cmuar kulturore me vlera thelbësore të rëndësishme për interesin jetik të shoqërisë bashkëkohore dhe brezave pasardhës³⁷.

Si rezultat i vlerësimit gjithëpërfshirës të bazuar në legjislacion dhe standarde profesionale, lokacionet e aseteve të përzgjedhura për mbrojtje përfshihen në të gjitha planet e zhvillimit hapësinor. Në këtë kuadër, lokacionet e trashëgimisë kulturore duhet përcaktuar me kontura legjitime si sipërfaqe të mbrojtura në dimensione hapësinore dhe kushte të arsyeshme që siguron ruajtjen e qëndrueshme tëtributeve të vlerave përbërse të autenticitetit dhe integritetit të tyre në aspektin hapësinor, fizik, kulturor, historik, estetik dhe ekonomik.³⁸

Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore duhet konservuar dhe përdorur sipas kushtetve specifike të ruajtjes dhe mbrojtjes. Zhvillimi dhe menaxhimi i tyre bëhet sipas studimit dhe planit të konservimit dhe zhvillimit apo plane hapësinore të vecanta. Plani i konservimit është platforma zyrtare e cila ofron konceptin dhe zgjidhjet e zhvillimit të harmonizuar ndërmjet nevojave të jetesës bashkëkohore dhe kërkesave të ruajtjes së vlerave atribuese të aseteve të trashëgimisë kulturore, këtu përfshirë edhe mundësitë e ndërtimeve të reja me volume, forma dhe materializime të përshtatshme në raport me vecoritë e asetit të trashëgimisë kulturore në mbrojtje.

Casja e planifikimit të integruar të konservimit të qëndrueshëm, mundëson ri-krijimin e identitetit urban atraktiv, formësimin e mjediseve jetësore të dinjitetshme me perspektivë zhvillimi ekonomik, të punësimit dhe zhdukjes së varfërisë të popullatës si çështje me rëndësi thelbësore në vendin tonë dhe në Botë, qëllimi i Mileniumit. Në këtë mënyrë, me mendje të hapur dhe punë të dëshmuar me përgjegjshmëri të lartë profesionale, padyshim do t'i përafronemi integritetit të vendit në programe, plane, organizma dhe institucione të specializuara për trashëgmi kulturore sic janë UNESCO, ICCROM, ICOMOS, ICOM, etj.

Nisur nga rëndësia dhe detyrimet ligjore të përcaktuara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në politikat e zhvillimit dhe planifikimit urban të Komunës, si objektiv prioritar përcaktohet: ruajtja dhe rigjenerimi i aseteve të trashëgimisë kulturore me të gjitha atributet e vlerave ndërlidhëse të tyre në funksion përmirësimi të mirëqenies shoqërore në aspektin e zhvillimit ekonomik, kulturor, arkitekturor, mjedisor, turizmi dhe punësimi.

Realizimi i objektivit të specifikuar përfshinë ndërmarrjen e masave kryesore paralele sipas përmbajtjes së parashtruar në vijim:

PROPOZIM I MASAVE PRIORITARE	
1	Hartimi i Startegjisë dhe Programit të përbashkët me minsitritë përgjegjëse për trashëgimi kulturore dhe planifikim hapësinor për konservim/rigjenerimin e aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje, në funksion zhvillimi të qëndrueshëm shoqëror, ekonomik, mjedisor dhe të punësimit.
2	Themelimi dhe funksionalizimi i Zyrës së Komunës për Rigjenerimin e Aseteve dhe sipërfaqeve të trashëgimisë Kulturore/trajnimi i personelit.
3	Krijimi i inventarit të aseteve të trashëgimisë kulturore të Komunës së Lipjanit, në ndërlidhje me Inventarin apo DB të MKRS, planet e demarkacionit të perimetrit dhe zonave të mbrojtjes rreth tyre, si dhe kriteret dhe kushtet e mbrojtjes dhe limitet ndaj zhvillimeve bashkëkohore.
4	Vendosja e lokacioneve të aseteve të trashëgimisë kulturore në planet kadastrale, Planin Hapësinor dhe Hartë Zonale të Kosovës dhe të Komunës, me qëllim definimi të sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe përcaktimit të kushteve për përdorim dhe zhvillimin e tyre, si dhe për klasifikim të zonave të vecanta.

³⁷ Heritage as a driver for development-its contribution to sustainable tourism in contemporary society, icomos, paris 2011.

³⁸ Ligji nr.04/l-174 për planifikim hapësinor, neni 1,9,18.

5	Identifikimi dhe ndermarrja e masave të shpëtimit të aseteve të trashëgmisë kulturore në rrezik.
6	Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgmisë kulturore jomateriale/shpirtërore;
7	Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgmisë kulturore të luajtshme e ndërlidhur me territorin e Komunës së Lipjanit/ Krijimi i fondit muzeor public arkeologjik, etnografik, historic, etj. dhe themelimi i Muzeut të Komunës.
8	Organizimi i kampanjave sistematike për vetëdijesimin publik rreth rolit dhe rëndësisë së trashëgmisë kulturore.
9	Krijimi i bashkëpunimit me institucione të specializuara ndërkombëtare për konservim/rigjenerim të trashëgmisë kulturore.
10	Krijimi politikave për investime dhe financim në konservimin/rigjenerimin e trashëgmisë kulturore përmes partneritetit publiko privat dhe lehtësirave fiskale.

Analiza SWOT – Trashëgmia kulturore, menaxhimi dhe zhvillimi ekonomik.

PËRPARSITË	DOBËSITË
Peizazhi historik i pasur me asete të trashëgmisë kulturore në variacione të shumëllojshme arkitekturore dhe arkeologjike të krijuar nga parahistoria deri me sot, të shpërndar në zona rurale dhe urbane dhe në lokacione atraktive natyrore.	Monumentet dhe lokalitete të amortizuara, në gjendje jo të mire teknike për përdorim bashkëkohor dhe infrastrukturë të pazhvilluar për vizitor.
Popullsia e re, ku dominon moshë nën 19 vjeç, të interesuar për identitetin e tyre dhe kultivimin e trashëgmisë kulturore. Në traditën popullore, kultivohen shumë praktika tradicionale të jetesës siç janë ritualet e lindjes, martesës, besimeve të ndryshme, shëndetësia, festa, ushqimi, kënga, agrokultura, etj.	Mungesa e programeve të arsimit profesional për teknikat e ruajtjes dhe promovimit të trashëgmisë kulturore, si perspektivë e punësimit të tyre dhe në të mirën e avancimit të sistemit të mirëmbajtjes së aseteve të trashëgmisë kulturore. Migrimi i të rinjëve jashtë vendit, në mungesën e mundësive të profilizimit dhe punësimit.
Kornizë ligjore dhe strategji nacionalesipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për ruajtjen dhe rigjenerimin e trashëgmisë kulturore në funksion të mirëqenies shoqërore dhe ekonomike. Institucione qendrore profesionale të koncentruara në Prishtinë, dhe programe që mbështeten me buxhet sistematik nga shteti, grantet dhe fonde jo të vogla ndërkombëtare.	Mungesa e përcaktimit të sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgmisë kulturore në Planin Hapësinor dhe Hartë Zonale të Kosovës, si dhe planet e programet të rigjenerimit, me mundësitë përkatëse të zhvillimit të potencialit për nevojat bashkëkohore në dobi të mirëqenies shoqërore, ekonomike, kulturore, arkitekturore, mjedisore, turizmi, punësimi, etj.
Grackë e Vjetër	Rurale	I grumbulluar	242	242.93	27.94	214.99	Shisharkë	Rurale	I grumbulluar		1.32	0.44	0.88
Gumnasellë	Rurale	Linear	122	100.41	52.28	48.13	Silovi	Rurale	I grumbulluar	3425	281.95	117.32	164.63
Hallaq i Madh	Rurale	I grumbulluar	418	38.04	19.2	18.84	Smallushë	Rurale	I grumbulluar	1276	73.18	44.18	29
Hallaq i Vogël	Rurale	I grumbulluar	664	46.83	27.77	19.06	Teqe	Rurale	I grumbulluar	199	20.78	6.21	14.57
Hanroc	Rurale	I grumbulluar	43	17.02	5.93	11.09	Topliqan	Rurale	Linear	1868	144.46	74.7	69.76
Janjevë	Rurale	I grumbulluar	2136	145.43	56.44	88.99	Torinë	Rurale	I grumbulluar	586	44.74	24.59	20.15
Kleçkë	Rurale	I grumbulluar	228	13.69	7.14	6.55	Varigoc	Rurale	I grumbulluar	252	14.31	8.53	5.78
Kojskë	Rurale	I grumbulluar	365	27.64	17.96	9.68	Vërshec	Rurale	I grumbulluar	896	56.2	30.32	25.88
Konjuh	Rurale	I grumbulluar	628	219.91	31.4	188.51	Vogaqicë	Rurale	I grumbulluar		3.31	1.01	2.3
Kosnicë	Rurale	I grumbulluar		1.44	1	0.44	Vrellë e Gadimes	Rurale	I grumbulluar	157	9.68	4.23	5.45
Kraishtë	Rurale	I grumbulluar	1375	88.09	39.47	48.62	Vrellë e Goleshit	Rurale	I grumbulluar		74	36.18	37.82
Krojmir	Rurale	I grumbulluar	1568	68.19	56.78	11.41	Zllakuqan	Rurale	I grumbulluar	270	13.56	10.36	3.2
Leletiq	Rurale	I grumbulluar	350	26.01	11.62	14.39							
Lipjan	Urbane	I grumbulluar	6870	650	201.26	448.74							
Llugaxhi	Rurale	Linear	1157	140.01	42.78	97.23							

Zhvillimi i shpërqendruar ka ndodhë për shkak të ndërtimeve në qytetin e Lipjanit, gjë që ka ndikuar që ndërtimet të kalojnë përtej kufirit aktual të zonës urbane në vendbanimet përreth. Në këtë mënyrë, vendbanimet rurale pothuajse janë bashkëngjitur me zonë urbane duke marr parasysh shkallën e zhvillimit. Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të vendbanimit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi me rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Babush i Muhaxherve- Marec- Llugaxhi, Banllë- Konjuh , pastaj Grackë e Vjetër, Topliqan, Bujan. Për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur, mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve, në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

Procesi i urbanizimit do të përfshijë, më tepër se gjer me tani territoret rurale e për këtë shkak, orientimi i këtij procesi në fshatra është detyrë tepër me rendësi e planeve në tërësi. Shkalla e urbanizimit në pajtim me konceptimin e urbanizimit kompakt në zhvillimin e mëtejshëm të këtij territori, duhet të rritet, në mënyrë të konsiderueshme, Niveli i urbanizimit i shprehur me pjesëmarrjen të popullsisë në vendbanimet urbane dhe gjysmë - urbane në popullsinë e përgjithshme të Lipjanit duhet shumëfishohet gjerë në vitin 2022. Për organizimin hapësinor të zonave rurale/fshatrave dhe të territorit rural në komunën e Lipjanit, pos pozitës gjeografike, ka shumë rendësi tipi i vendbanimit dhe dispersioni i vendbanimeve. Çdo tip vendbanimi kërkon trajtim të ndryshëm në organizimin e hapësirës. Kushtet e aktiviteteve ekonomike, organizimi i aktiviteteve ekonomike, futja e elementeve urbane dhe mënyrës së jetesës, duhet ti përshtatur pozitës, madhësisë dhe tipit të vendbanimit. Rregullimi i fshatrave dhe i territoreve të gjera rurale është bazuar në:

- a) Kufijtë e planifikuar ndërtimor të çdo vendbanimi
- b) Zhvillimin e organizimin e prodhimit bujqësor brenda zonës kadastrale të vendbanimit por edhe zonës ndërtimore në zonat e ashtuquajtura zemra e gjelbër (agroekosistemi),
- c) zgjerimin e përmbajtjeve të industrisë në ato vendbanime të cilat kanë leverdi për këtë;
- d) zhvillimin, ndërtimin dhe renditjen si duhet të veprimtarive shërbyese;
- e) orientimin hapësinor të zgjerimit territorial me specifikim edhe të disa zonave të mundshme për zgjerim dhe në ndërtimin modern të objekteve të banimit dhe objekteve tjera.
- f) Organizimi hapësinor racional dhe pajisja e hapësirës kërkojnë hartimin e planeve përkatëse (bazës) për të gjitha vendbanimet prioritare dhe territoret me një zhvillim më intensiv.

Planet rregulluese do të përgatiten për vendbanimet si zona të interesit të veçantë për Kosovën ku hynë vendbanimi i Kleçkës dhe i Divjakës për nën - qendrat ose qendrat sekondare brenda komunës si Janjeva, Slllovia, Shala, Gadime dhe Magura në kuadër të së cilës mundë edhe të avancohen nevojat e çdo vendbanimi gravitues si pjesë e tërësisë në atë nën – qendër në krahasim me këto të parapara me këtë plane. Shpërndarja hapësinore dhe organizimi i banimit në vendbanimet dhe qytet në të ardhmen do të bëhet konform koncepteve dhe në përputhje me shpërndarjen e popullsisë dhe infrastrukturës mbështetur në parimin bazë për Banim të shëndetshëm (Ngritjen e kushteve për banim të shëndetshëm dhe atraktiv në zonat urbane dhe në zonat fshatare) për të gjithë shtresat, me mundësi dhe zgjedhje më të mëdha banimi, zvogëlojnë varësinë nga veturat dhe krijojnë modele të qëndrueshme banimi.

Konceptet na mundësojnë shfrytëzim racional të tokës, rritje të dendësisë së banimit, e cila do të arrihet edhe me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara, kjo do të ndikonte në zhvillimin të infrastrukturës, uljen e kostos për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlon rrezet e shërbimeve tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë etj, vetëm zhvillimi kompakt i paraparë për vendbanime do të kursej tokën nga ndërtimet e pa kontrolluara, ndërsa në këtë kontekst vendbanimet shndërrohen në zona funksionale, ku duhet vepruar në konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e asaj që mungon.

Sipas parashikimeve demografike, nuk ka nevojë për zgjerimin e sipërfaqes së planifikuar për ndërtim në vendbanime për një kohë të gjatë pasi që në shumicën e vendbanimeve duke filluar nga qyteti i Lipjanit mund të shfrytëzohen sipërfaqet e zbrazëta brenda zonës së planifikuar për ndërtim e cila do plotësohet me përmbajtje në funksion edhe në kompletimi të cilësisë së banimit (infrastrukturë, hapësira publike, parqe, hapësira për sport, rekreacion etj). Në disa fshatrat me strukturë të shpërndarë (kryesisht fshatrat kodrinore malore), është vështirë të arrihet ndonjë dendësim edhe se në këto fshatra si janë Bukovicë, Gllavicë, Hanroc, Lipovicë, Okosnicë, Plitkoviq, Sedllar, Shishare, Zllakuqan edhe disa tjera pasi që në këto vendbanime ka pasë dhe në disa prej tyre ende ka një shkallë të konsideruar të migrimeve me lëvizje drejt zbarazjes së plotë duhet planifikuar projekte zhvillimore në fushat e bujqësisë, turizmit etj, me synim që të rikthehet jeta edhe gjallëria e viteve të mëparshme, të fuqizohet për sa është e mundur këto vendbanime dhe ma vonë edhe të kemi zhvillim sa ma kompakt dhe cilësi banimi.

Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuar, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e lidhjes së mire mes zonës urbane me vendbanimet rurale ;
- Qasja e dobët nga vendbanimet sub- urbane në zonë urbane;
- Shuarja e vendbanimeve malore dhe dyndja e tyre në zonë urbane;
- Mungesa e qasjes në infrastrukturë teknike-ujësjellës e kanalizim për disa nga vendbanimet;
- Mungesa e infrastrukturës përkatëse si dhe shpërndarja jo e balancuar e infrastrukturës publike dhe sociale;
- Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban;
- Numër i lartë i ndërtimeve pa leje, që duhet integruar dhe urbanizuar;
- Zhvillime të paplanifikuara me mungesën konsekuente të shërbimeve dhe hapësirave të gjelbër publike ;
- Morfologji dhe strukturë urbane jo konsistente në pjesët sub- urbane të qytetit;
- Mungesë e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në lagjet sub- urbane;
- Zgjerime të mëdha me densitet të ulët të cilat konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar;

Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuar

- Qyteti i Lipjanit, paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për gjithë territorin e komunës, por edhe për komunat fqinje, si qytet i madh në rajon.
- Qyteti i Lipjanit i takon tipit të koncentruar/grumbulluar të vendbanimeve.
- Aktualisht Lipjani nuk është i organizuar sipas sistemit të lagjeve/nënqendrave, prandaj të gjitha funksionet primare funksionojnë në qendër të qytetit, rrjedhimisht kërkohet të bëhet ndarja/organizimi i zones urbane.
- Propozohet formimi i nën-qendrave të reja si: Janjeva, Gadimja e Poshtme, Banulla, Magura, Shala dhe Sillovia.
- Vendbanimet me vlera të larta të trashëgimisë historike me interes të veçantë për komunën, si Kleçka dhe Divjaka, duke poseduar një potencial të lartë të zhvillimit për të ardhmen.
- Shumica e vendbanimeve janë të tipit të shpërndarë me dendësi të ulët të banimit, dhe mungesë të infrastrukturës, pastaj ato të tipit të grumbulluar dhe të dendur, e që tregon drejtë për drejtë mungesën e një planifikimi të mirëfilltë para zhvillimit të vendbanimeve, dhe në fund në një numër shumë të vogël vendbanimet lineare, që janë vendbanime të zhvilluara për-rreth rrugëve kryesore të komunës.
- Kjo shpërndarje e banimit brenda vendbanimeve ka rezultuar edhe me një dendësi të ulët apo mesatare tek shumica e vendbanimeve, me përjashtim të zonës urbane dhe vendbanimeve rreth saj, që vjen si rezultat i kërkesave të shumta për banim për shkak të zbrazjeve të vendbanimeve rurale drejt zonës urbane.
- Edhe karakteri ekonomik në komunë mund të themi se në një masë dirixhohet nga relievi dhe afërsia me qendër. Zona qendrore që përfshinë zonën urbane me vendbanimet për-rreth zhvillojnë aktivitete të ndryshme ekonomike; zona rurale zhvillon bujqësi.
- Rritja e vogël e dendësisë për shkak se numri i banorëve në zonën urbane është i vogël dhe shihet qartë që një zbehje e qytetit, e kufizon rritjen e zonës urbane.
- Sipas parashikimeve demografike, nuk ka nevojë për zgjerimin e sipërfaqes së planifikuar për ndërtim në vendbanime për një kohë të gjatë pasi që në shumicën e vendbanimeve duke filluar nga qyteti i Lipjanit mund të shfrytëzohen sipërfaqet e zbrazëta brenda zonës së planifikuar për ndërtim e cila do plotësohet me përmbajtje në funksion edhe në kompletimi të cilësisë së banimit (infrastrukturë, hapësira publike, parqe, hapësira për sport, rekreacion etj). Në disa fshatrat me strukturë të shpërndarë (kryesisht fshatrat kodrinore malore), është vështirë të arrihet ndonjë dendësim edhe se në këto fshatra si janë Bukovicë, Gllavicë, Hanroc, Lipovicë, Okosnicë, Plitkoviq, Shishare, Zllakuqan edhe disa tjera pasi që në këto vendbanime ka pasë dhe në disa prej tyre ende ka një shkallë të konsideruar të migrameve me lëvizje drejt zbarazjes së plotë duhet planifikuar projekte zhvillimore në fushat e bujqësisë, turizmit etj me synim që të rikthehet jeta edhe gjallëria e viteve të mëparshme, të fuqizohet për sa është e mundur këto vendbanime dhe ma vonë edhe të kemi zhvillim sa ma kompakt dhe cilësi banimi.

SWOT Analiza - Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet

PËRPARËSITE	DOBËSITË
▪ Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale. ▪ Shpërndarje relativisht e mirë e shërbimeve shkollore dhe shëndetësore ▪ Ekzistimi i vendbanimeve me pozitë të përshtatshme për organizim të subqendrës	▪ Dendësia e ulët e ndërtimit ▪ Përqendrimi i shërbimeve administrative në qendrën komunale ▪ Niveli i pamjaftueshëm i shtrirjes së infrastrukturës teknike në zonat rurale (ujësjellës, kanalizim) ▪ Zgjerimi i ndërtimit në tokë bujqësore ▪
MUNDËSITË	RREZIQET
▪ Hartimi i planeve hapësinore ▪ Krijimi i nënqendrave të zhvillimit të vendbanimeve në raport me qendrën e Lipjanit.	▪ Vazhdimi i trendit të zgjerimit të vendbanimeve pa kritere ▪ Humbja e tokës bujqësore ▪ Kapacitetet e pashfrytëzuara si pasojë e migrimit rural-urban

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
▪ Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore ▪ Ofrimi i kushteve më të mira të planifikuara brenda zonave të ndërtuara ▪ Zhvillimi i vendbanimeve me dendësi adekuate ▪ Menaxhimi i migrimit rural-urban

NEVOJAT ZHVILLIMORE
▪ Përf forcimi i mëtejshëm i karakterit shumëfunksional të qendrës komunale ▪ Konsolidimi i strukturës së ndërtuar të vendbanimeve tjera brenda zonave aktuale të ndërtuara, ▪ duke e ruajtur karakterin e tyre lokal ▪ Ofrimi i shërbimeve adekuate sociale dhe publike në të gjitha vendbanimet rurale ▪ Aktualisht Lipjani nuk është i organizuar sipas sistemit të lagjeve, prandaj nuk ka system administrative të lagjeve dhe të gjitha funksionet primare funksionojnë në qendër të qytetit. ▪ Të bëhet ndarja/organizimi i zones urbane.

1.9 VENDBANIMET JOFORMALE

Në Lipjan nga KK, e sipas Udhëzuesit për Planifikim Hapësinorë për Vendbanime Joformale të Ministrisë për Planifikim Hapësinorë, janë identifikuar 9 (nëntë), vendbanime joformale. Lokacioni i 9-të vendbanimeve joformale, janë në qytet por në pjesën periferike të zonës urbane, ku mënyra e shpërndarë dhe me dendësi të vogël gjë që ndikon në vështirësimin e ofrimit të infrastrukturës. Me PZHK janë trajtuar mundësitë e integritit dhe trajtimit të këtyre vendbanimeve joformale, si pjesë të qytetit.

Për të rregulluar çështjen pronësore të këtyre vendbanimeve joformale, nevojitet koordinim në mes banorëve të VJF-së, autoriteteve dhe përfaqësuesve të pronës, bazuar në ligjet në fuqi deri në trajtimin përfundimtar dhe njohjen e pronësisë për banorët e VJF-së.

Këto vendbanime duhet të trajtohen sipas udhëzimeve të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Vendbanimet Joformale dhe sipas UA 08/2018 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, përkatësisht kapitullit III, neni 2.

Komuna, me qëllim të rregullimit dhe përfshirjes së vendbanimeve joformale parasheh zbatimin e kushteve zhvillimore

dhe ndërtimore të cilat do të përcaktohen me dokumente të nivelit më të ulët të planifikimit hapësinor, si është Harta Zonale e Komunës, përkatësisht, rregullimi dhe zhvillimi i këtyre vendbanimeve do të bëhet në bazë të kushteve zhvillimore të zonës përkatëse në të cilën ndodhet ai vendbanim.

Ky përmirësim i gjendjes ekzistuese do të arrihet pikërisht përmes rregullimit të infrastrukturës rrugore, infrastrukturës teknike, asaj sociale, si dhe do të paraqiten kushte zhvillimore adekuate, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në këto zona. Një prej mundësive të rregullimit të vendbanimeve joformale është edhe zbatimi i bonuseve të ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, ku përcaktohet që komuna pas hartimit dhe miratimit të Hartës Zonale të Komunës të hartojë një rregullore ku do të përcaktojë mënyrën e zbatimit të bonuseve.

Udhëzuesit e planifikimit hapësinor të vendbanimeve joformale, edhe pjesë tjera të vendbanimeve, pa marrë parasysh përbërjen etnike, të cilat shquhen me karakteristikat e cekura më lartë, duhet t'i nënshtrohen rregullimit të çështjeve pronësore si dhe do të përmirësojnë kualitetin e jetës në vendbanim. Vendbanime joformale të cilat duhet ta trajtohen në mënyrë të posaçme, mirëpo mënyra e zhvillimit të disa pjesëve të zonës urbane kërkon një qasje pothuaj identike për hartimin e planeve rregulluese në zonat të cilat janë zhvilluar pa plan dhe ku mungon infrastruktura themelore dhe këto plane rregulluese duhet të përcaktohen në Hartën Zonale të Komunës.

1.9.1 KARAKTERISTIKAT DHE NUMRI I BANORËVE

Vendbanimet joformale karakterizohen me:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë,
- Shërbimet joadekuate të infrastrukturës teknike dhe sociale, si dhe
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje.

Këto vendbanime duhet të trajtohen sipas udhëzimeve të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Vendbanimet Joformale dhe sipas UA 08/2018 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, përkatësisht kapitullit III, neni 2.

Nr. rendor	Vendbanimet joformale	Sipërfaqja (Ha)	Nr. i banorëve (NRBAN)	Nr. i njësive të banimit (NRSHT)	Prioriteti			Planet – PZHK- PZHU-PRrH			Madhësia			Konteksti Urban-Rural		
					ASH	AM	AGJ	PZHK	PZHU	PRrH	V	m	M	U	UR	R
1	Gadime e Ulët	19	400	60	X					X	X			X		
2	Hallaq i Vogël	10	380	65			X			X		X			X	
3	Janjevë	10	380	50		X			X		X			X		
4	Lipjan VJF-1	14	400	125			X			X	X			X		
5	Medvecë	12	420	60			X			X			X			X
6	Sllovi	5,5	200	55		X				X			X			X
7	Vrellë e Magurës	6	180	30		X			X				X			X
8	Dobrajë e Vogël	5	320	55		X				X			X			X
9	Lagja e Allapit – Lipjan	23	450	100	X					X	X			X		

1.9.2 GJENDJEN EKONOMIKE, SOCIALE DHE MJEDISORE TË VENDBANIMEVE JOFORMALE TË IDENTIFIKUARA

Sipas dokumentit të hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapsinor 'Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Rregullimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë 2011-2015', përcaktohet kategorizimi i VBJ-ve dhe atë si vijon:

- Vendbanimi Joformal në kuadër të zonës urbane apo zonës rurale;
- Vendbanimi Joformal në afërsi të ambienteve të rrezikshme për banorët;
- Vendbanimi Joformal në tokën me pronësi të parregulluar;
- Vendbanimi Joformal në afërsi të zonave të mbrojtura me rëndësi për shtetin;
- Vendbanimi Joformal me mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale, ndikim negativ në mjedis;

Konform kategorizimit si më lartë, vendbanimet joformale i përkasin kategorisë së parë dhe të tretë, të zotërimit joformal ose jo i sigurtë i pronësisë, gjersa të gjithë banorët e këtij vendbanimi, gëzojnë qasje adekuate në shërbime elementare, pjesëmarrje adekuate në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi. Sa i përket gjendjes ekonomike, ky vendbanim cilësohet të ketë gjendje relativisht të kënaqeshe ekonomike.

Për ta rregulluar çështjen pronësore të këtyre vendbanimeve joformale, nevojitet koordinim në mes banorëve të VJF-së, autoriteteve, si dhe përfaqësuesve të pronës, bazuar në ligjet në fuqi deri në trajtimin përfundimtar dhe njohjen e pronësisë për banorët e VJF-së.

Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuar, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore.

Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

- Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale, që do të duhej të jetë komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate, të rregullimit të vendbanimeve joformale;
- Mungesa e detyrimeve ligjore për institucionet përgjegjëse, të niveleve të ndryshme.
- Mungesa e legjislacionit, pjesa e cila do ti obligonte banorët e vendbanimeve joformale, që ta iniciojnë dhe vazhdojnë deri në përfundim, rregullimin e statusit të tyre pronësorë.

Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuar

- Drejtoria e Urbanizmit të qytetit të Lipjanit, për hulumtimin e vendbanimeve joformale do të mirret me 9 vendbanimet joformale të identifikuar
- Vendbanimi Joformal në total, përfshinë një sipërfaqe prej 99 ha, me afërsisht 600 shtëpi individuale të identifikuar dhe 3,130 banorë⁴⁹;
- Statusi formal i pronës: prona është në pronësi komunale;
- Këto vendbanime joformale, karakterizohen përmes çështje të pazgjidhura pronësore.
- Gjendja e ndërtesave të banimit, është relativisht e mirë dhe kjo gjendje shihet dhe konfirmohet nga gjendja ekzistuese e objekteve/ndërtesave, që janë marrë për shqyrtim për këtë çështje.
- Vendbanimi Joformal, posedon me objekte arsimore, shkolla fillore e mesme e ulte dhe e lartë, me çerdhe (përmbajtje të arsimit parashkollor, fillor dhe i mesëm).
- Destinimi i sipërfaqeve në këto lagje, është kryesisht banim individual, duke shfrytëzuar hapësira për afarizëm (tregti, prodhim, deponi, servise etj) dhe hapësirat dhe sipërfaqet e dedikuara për rrugë.
- Mungojnë hapësira të mjaftueshme të gjelbërta dhe ato për rekreacion.
- Vendbanimet joformale të identifikuar, janë të përfshira në kuadër të Planit Rregullues Urban të qytetit të Lipjanit.

Nr. rendor	Vendbanimet joformale	Sipërfaqja (Ha)	Nr. i banorëve	Nr. i njësive të banimit
1	Gadime e ulët	19	400	60

⁴⁹ Numri i shtëpive individuale, është përcaktuar, përmes inqizimeve nga Gjeoportali-<http://geoportal.rks-gov.net/search> dhe shënimeve nga Kuvendi Komunal Shtime, respektivisht Plani-Zhvillimor-Komunal-i-Lipjanit-2013-2023

2	Hallaq i Vogël	10	380	65
3	Janjevë	10	380	50
4	Lipjan VJF-1	14	400	125
5	Medvecë	12	420	60
6	Sllovi	5,5	200	55
7	Vrellë e Magurës	6	180	30
8	Dobrajë e Vogël	5	320	55
9	Lagja e Allapit - Lipjan	23	450	100
Totali		99	3130	600

Pronësia mbi tokën - Në kuadër të vendbanimeve joformale të identifikuar, ka pronësi të kombinuar – Komunale, shoqërore, private. Dokumentacioni kadastral adekuat ekziston në Drejtorinë për Kadastër të Komunës së Lipjanit.

Vlerësimi i përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve – Analiza SWOT

Analiza SWOT për vendbanimet joformale

Përparësitë	Dobësitë
- Identifikimi i VBJ - Ekziston dokumentacion kadastral për VBJ; - Sipërfaqja e territorit të identifikuar, 99 ha, rreth 600 shtëpi dhe 3,130 banorë; - Terren i përshtatshëm për ndërtim, duke qenë se kryesisht është terren i rrafshët; - Identifikimi dhe regjistrimi zyrtar i ndërtimeve pa leje gjatë 2004-2018, si dhe regjistrimi i tyre në data-bazë; - Infrastruktura teknike bazike e vendbanimeve në përgjithësi, relativisht e mirë; - Qasje relativisht e mirë e vendbanimit, në shërbime komunale;	- Çështja pronësore e pa zgjidhur, për të gjitha rastet e identifikuar; - Jo të gjithë banorët, kanë tituj të regjistruar të pronës; - Mungesë e menaxhimit efektiv të planifikimit hapësinor dhe kontrollit të zhvillimeve urbane; - Mungesa e planit të hollësishëm rregullativ për vendbanimet e identifikuar joformale, ka bërë që shërbimet themelore të mos jenë në nivelin e kënaqshëm;
Mundësitë	Kërcënimet
- Prona komunale, mundësi kthimi në vendbanim formal; - Ofrimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore; - Zgjidhja e transportit publik; - Angazhimi publik i banorëve të lagjeve; - Krijimi i këshillave nga pjesëtarët e komuniteteve në kuadër të VBJ-ve; - Fuqizimi i rolit të përfaqësuesve, të komuniteteve në vendimmarrje duke përfshirë edhe rolin e gruas; - Inkurajimi i komuniteteve të VBJ, në kryerjen e punëve në përmirësimin e kushteve në VBJ; - Avancimit të kontrollit inspektiv të VBJ - Mundësia e zhvendosjes eventuale e VBJ, në një lokacion më adekuat dhe më të përshtatshëm;	- Implikimet pronësore; - Implikimet buxhetore; - Tej zgjatja e procedurave ligjore, në raport të ndërtimeve pa leje; - Rrezikshmëria deri në diskriminim; - Mungesa e një zgjidhjeje adekuate konkrete; - Mosdefinim i qartë i kompetencave institucionale;

2.1.3. NDËRTIMET PA LEJE

Në Komunën e Lipjanit janë të regjistruara në regjistrin Kombëtar të ndërtimeve pa leje mbi 15,783 raste të ndërtimeve pa leje me ish Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i ndërtimeve pa leje, pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi, Ligji Nr. 06/L-024⁵⁰.

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Autoriteti zyrtar përkatës do ti trajtoj dhe legalizoj shumicën e ndërtimeve të kategorisë I-rë dhe II-të, mirëpo, përsëri do të mbetet një numër i konsiderueshëm i objekteve/ndërtesave, të cilat janë ndërtuar pas 30 Gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, e të cilat tutje do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim.

Duke qenë se për ndërtimet pa leje kemi qeshje të pronësisë së pazgjidhur, respektivisht pronësi me titullar të ndryshëm, atëherë për ndërtimet pa leje, të identifikuar në pronat me pronësi komunale, Komuna e Lipjanit, gjatë trajtimit të VBJ, duhet të bashkëpunojnë me Kuvendin Komunal në Lipjan, në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi komunale, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Për ndërtimet pa leje të identifikuar në pronat me pronësi shoqërore (nëse eventualisht ekzistojnë), Komuna e Lipjanit, gjatë trajtimit të VBJ duhet të bashkëpunojnë me AKP-në (në nivel regional dhe qendror), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi shoqërore, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Ndërtimet pa leje të identifikuar në pronat me pronësi shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, menaxhohen dhe trajtohen nën mandatin e AKP-së.

Tabela 137. Numri i objekteve pa leje sipas vendbanimeve

Vendbanimet	Nr ndërtimeve pa leje	Vendbanimet	Nr ndërtimeve pa leje
Janjevë	792	Vrellë e Gadimes	37
Kraishtë	359	Varigoc	46
Hanroc	22	Vërshëc	250
Vrellë e Goleshit	206	Topliqan	521
Hallaq i Madh	132	Torinë	189
Hallaq i Vogël	207	Smallushë	294
Grackë	113	Teqe	50
Gumnasellë	326	Shisharkë	5
Gadime e Ulët	774	Slovi	906
Glllogoc	462	Resinoc	144
Dobrajë e Vogël	46	Shalë	598
Gadime e Epërme	680	Ribar i Vogël	150
Divjakë	20	Rubofc	290
Dobrajë e Madhe	608	Poturoc	212
Bujan	180	Qylagë	287
Bukovicë	0	Mirenë	120
Breg i Zi	170	Pliitkoviq	11
Brus	60	Marec	235
Babush i Muhaxherëve	362	Medvec	20
Banullë	570	Llugë	91

⁵⁰ MMPH / DPHBN, Numri i ndërtimeve pa leje sipas Komunë së Lipjanit, nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje, Prishtinë 09.09.2015

Ribar i Madh	585	Magurë	441
Akllap	177	Lipjani	1710
Rufc i Vjetër	194	Blinajë	0
Zllakuqan	54	Krojmir	324
Rufc i Ri	163	Leletiq	114
Baicë	239	Konjuh	429
Llugëxhi	390	Kosnicë	0
Grackë e Vjetër	243	Kleçkë	52
Vogaqicë	0	Kojskë	99

1.10 BANIMI

Trendët e ndërtimit në komunën e Lipjanit në 4 vitet e fundit janë si në vijim:

Shenim: ne numrin e ndërtimeve janë përfshirë: shtëpitë, apartamentet, shtëpitë e braktisura, shtëpitë e paklasifikuara dhe shtëpitë e papërfunduara. Të dhënat janë marrë nga shenimet e tatimit në pronë.

Tabela 138. Trendi i ndërtimeve në 4 vitet e fundit

Nr	Vendbanimet	2019	2020	2021	2022	Përqindja e rritjes
1	Akllap	81	81	84	88	8%
2	Babush i Muhaxherve	283	283	283	283	0%
3	Baicë	133	133	133	133	0%
4	Banullë	412	412	412	422	2%
5	Breg i Zi	82	82	82	82	0%
6	Brus	19	19	19	19	0%
7	Bujan	146	144	144	144	-1%
8	Bukovicë	1	1	1	1	0%
9	Divlakë	5	5	6	6	17%
10	Dobrajë e Madhe	396	396	402	417	5%
11	Dobrajë e Vogël	29	29	29	31	6%
12	Gadime e Epërme	455	458	464	470	3%
13	Gadime e Ulët	559	559	566	588	5%
14	Gllanicë	0	0	0	0	0%
15	Gllavicë	0	0	0	0	0%
16	Glllogoc	331	331	331	346	4%
17	Grackë e Vjetër	149	150	150	178	16%
18	Grackë e Vogël	75	78	78	82	9%
19	Gumnasellë	224	227	229	235	5%
20	Hallaç i Madh	70	71	72	72	3%
21	Hallaqi i Vogël	125	127	128	142	12%
22	Hanroc	6	7	7	11	45%
23	Janjevë	701	705	713	929	25%
24	Kleqkë	10	10	10	13	23%


25	Kojuskë	73	74	77	80	9%
26	Konjuh	210	211	211	217	3%
27	Kraishtë	280	283	285	294	5%
28	Krojmir	208	208	208	217	4%
29	Leletiq	59	60	62	66	11%
30	Lipjan	4,606	4,686	4,722	4,730	3%
31	Lipovicë	0	0	0	0	0%
32	Lugaxhi	263	266	266	271	3%
33	Lugë	49	49	50	50	2%
34	Magurë	306	311	318	360	15%
35	Marec	182	183	190	195	7%
36	Medvec	152	155	157	164	7%
37	Mirenë	37	38	40	53	30%
38	Okosnicë	0	0	0	0	0%
39	Plitkoviq	1	1	1	4	75%
40	Poturoc	143	143	143	148	3%
41	Qellopek	0	0	0	0	0%
42	Qylagë	145	145	146	154	6%
43	Resinoc	96	97	102	106	9%
44	Ribar i Madh	430	432	440	447	4%
45	Ribar i Vogël	96	98	99	101	5%
46	Rubofc	180	181	189	199	10%
47	Rufc i Ri	165	165	165	165	0%
48	Rufc i Vjetër	109	110	114	114	4%
49	Silovi	700	703	713	738	5%
50	Smallushë	283	286	289	297	4%
51	Shalë	420	420	427	440	5%
52	Shisharkë	0	0	0	0	0%
53	Teqe	20	20	22	28	29%
54	Tërbuc	0	0	0	0	0%
55	Topliqan	402	405	408	416	3%
56	Torinë	122	124	126	126	3%
57	Varigoc	23	25	25	27	15%
58	Vërshec	169	176	181	184	8%
59	Vogaqicë	2	2	2	2	0%
60	Vrellë	9	9	9	11	18%
61	Vrellë e Goleshit	110	111	114	129	15%
62	Zllakuqan	33	33	33	33	0%
		14,277	14,514	14,677	15,258	8%

Sipas tabelës së mësipërme trendi i ndërtimeve në katër vitet e fundit ka rritje me rreth 8%. Nga 62 vendëbanime, 15

vendbanime nuk kanë ndryshim në numrin e ndërtimeve ndërsa në 12 vendëbanime ka më shumë se 15% ndërtime. Planifikimet infrastrukturore duhet ti përcjellin këto trende në vitet në vijim.

Tabela 139. Projektioni për banim në 8 vitet në vijim

Viti	Nr. i banesave
2011	9,402
2016	12,040
2021	14,677
2026	17,314
2031	19,951



Grafikoni 20. Numri i banesave sipas të dhënave të tatimit në pronë

1.10.1 ANALIZA E TRENDIT TË BANIMIT SIPAS VENDBANIMEVE

Numri i ndërtësive për banim si shtëpitë individuale po ashtu edhe ndërtësat kolektive kanë rritje në sasi. Në një periudhë 10 vjeçare ky numër është rritur rreth 50%. Duke llogaritur që ky trend mund të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, nevojitet që të bëhen planifikime të mirëfillta ashtu që ndërtësat për banim të plotësojnë kriteret kualitative për banim adekuat dhe të përballueshëm.

Sipas trendit të rritjes, pritet që në periudhën 10 vjeçare numri i objekteve të banimit të rritet rreth 5,000 (shtëpi individuale dhe njësi banesore). Nëse për një objekt banimi mesatarisht nevojiten 115 m² atëherë rezulton se për përmbushjen e nevojave të banimit nevojiten rreth:

$$5,000 \text{ objekte banimi} \times 115 \text{ m}^2/\text{objekt banimi} = 575,000 \text{ m}^2$$

- **Trendët sipas vendbanimeve**

Në vijim do të bëhet një analizë e vendbanimeve sipas trendit të objekteve të banimit

- **Vendbanimet e zbrazëta**

Nga 62 vendbanime, 7 vendbanime nuk kanë asnjë objekt banimi (rreth 11%).

- **Vendbanimet e banuara**

Vendbanimet me pritshmëri të rritjes deri 10 %

Nga 55 vendbanime të populluara, në 40 vendbanime pritshmëritë janë që të ketë nga 0 deri 9 % rritje të objekteve të ndërtimit (rreth 73%).

Vendbanimet me pritshmëri të rritjes mbi 10 %

Nga 55 vendbanime të populluara, në 15 vendbanime pritshmëritë janë që të ketë mbi 10 % rritje të objekteve të ndërtimit (rreth 27%)

▪ **Çmimet mesatare të ndërtesave**

Disa vite të pandemisë duke filluar nga fillimi i vitit 2020 si dhe lufta në Ukrainë e filluar në fillim të vitit 2022 kanë ndikuar në rritje të çmimeve në përgjithësi në sferën ndërkombëtare. Kjo kryesisht ka ndodh për shkak të ngritjes së çmimeve të karburantëve të cilët pastaj në mënyrë zingjirë i kanë rritur çmimet e gjithëmbarshme. Edhe tregu i ndërtimit nuk ka mund të jetë imun ndaj këtyre zhvillimeve kryesisht për shkak të ngritjes së çmimeve të materialit ndërtimor. Për shembull gjatë viteve 2019-22 çmimi i armaturës është dyfishuar.

Si pasojë e zhvillimeve të lartëpërmendura, çmimet e ndërtesave në tërë Kosovën kanë pësuar rritje. Çmimet e banesave për metër katror në Lipjan variojnë kryesisht në varësi të lokacionit por mestarisht sillen nga 600 deri 1,000 Euro/m².

Ndërsa çmimet mesatare për dhënie me qera të objekteve variojnë shumë dhe varen nga sipërfaqja, vendndodhja si dhe kualiteti i ndërtimit. Por mesatarisht për dhënie me qera të një njësie banesore 2 dhomëshe është nga 150-300 euro.

Po ashtu çmimet e ndërtimit janë rritur ndjeshëm. Sipas disa kompanive të kontaktuar, çmimi i ndërtimit në tërë Kosaovën ka pas rritje me rreth 20-30% dhe në pjesën e parë të vitit 2023 ndërtimi i një metri katror të një objekti ndërtimor (shtëpi apo njësi banesore) kushton nga 400-450 euro.

1.10.2 NEVOJAT E BANIMIT PËR TË ARDHMEN

Politika e banimit në komunën e Lipjanit duhet të trajtohet në tri nivele:

- Ofrimi i mundësisë së zgjedhjes së mënyrës së banimit në të gjithë qytetin përmes përzierjes së llojeve të banimit⁵¹ për të përmbushur një gamë të plotë të nevojave për strehim për të gjitha komunitetet;
- Lehtësimi i kushteve për t'u mundësuar qytetarëve nga një spektër i gjerë ekonomik dhe demografik të jetojnë brenda qytetit;
- Minimizimi i ndikimit të vendimeve publike në koston e banimit dhe lëvizshmërinë e familjeve;

▪ **Zhvillimi i banimit**

Në vijim është përshkruar se si duhet të zhvillohet banimi në Komunën e Lipjanit:

Hapësirat për zhvillimin e banimit

Zhvillimi i banimit duhet të orientohet në hapësira të identifikuara si Zona Banimi. Detajet për këto zona do të përcaktohen përmes Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit dhe politikave tjera sektoriale.

Programi për banim social dhe të përballueshëm

Komuna e Lipjanit do të angazhohet që të mundësojë banim të përkohshëm dhe të përballueshëm për familje në gjendje socio-ekonomike më të vështirë dhe për kategori të caktuara sipas Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim. Detajet për këtë program do të përshkruhen në Planin Trevjeçar për Banim dhe duhet të jetë në përputhje me strategjinë për banim e cila duhet të krijohet nga niveli qendror.

Shtëpitë për të moshuar

Komuna e Lipjanit duhet të mbështesë zhvillimin e përkujdesjes por edhe të strehimit për të moshuar. Kjo duhet të bëhet në skema të ndryshme, nga buxheti komunal, përmes Partneritetit Publiko Privat, nga sektori jofitimprurës (OJQ) apo edhe tërësisht nga sektori privat. Kjo mund të përfshijë nevojën për të krijuar partneritet me grupe dhe individë që munden në mënyrë aktive të inkurajojnë rritjen e mundësive për strehim të të moshuarve. Vendndodhjet e banesave për të moshuar mund të shpërndahen në lagjet ekzistuese dhe të reja brenda hapësirave që i plotësojnë kriteret ashtu që të moshuarit të kenë qasje të lehtë për të përmbushur nevojat elementare (blerje, shërbimeve mjekësore dhe lehtësira të tjera)

Kriteret për ndërtimin e ndërtesave kolektive të reja

⁵¹ Kryesisht banim individual dhe banim kolektiv.

Lipjani do të inkurajojë zgjerimin e banimit me rreze të gjatë që të bëhet në një mënyrë logjike dhe të qëndrueshme që maksimizon përdorimin efikas të tokës dhe infrastrukturës së disponueshme.

Përbërja e banesave:

Lipjani do të inkurajojë shumëllojshmëri të tipeve të banesave kolektive, formave, niveleve të përballueshmërisë dhe dendësisë në zonat e banuara;

Lipjani do të inkurajojë zhvillime me densitet më të lartë banimi në vende të përshtatshme të mbështetura nga dizajni cilësor, qasja në lehtësitë dhe shërbimet lokale dhe kapaciteti i infrastrukturës. Do të përfillen në përpikëri ruajtja e zonave të gjelbërta në përputhje me planet komunale për ruajtje të mjedisit.

Integrimi i llojit të banesës:

Lipjani do të mbështesë dizajnin e banesave që mbulon me kujdes dhe integron dendësi të ndryshme banimi brenda një lagjeje ose në një bllok apo rrugë të vetme për të krijuar tranzicion të qetë vizual në mes të tipeve të ndryshme të banimit.

Parkingjet:

Lipjani do të sigurojë që projektet e banesave me shumë njësi të sigurojnë parkim nëntokësor si dhe në afërsi të lagjeve apo objekteve afariste për të mundësuar qarkullim sa më të lehtë të këmbësorëve dhe automjeteve.

Siguria në rrugë/lagje:

Siguria e lagjeve qoftë nga keqbërësit apo shkelësit e rregullave të komunikacionit nëpër lagje është shumë me rëndësi për komunën e Lipjanit. Për këtë qëllim në projektet e ardhshme pjesa e sigurisë duhet të inkorporohet dhe nuk mund të merren leje të përdorim it pa e trajtuar temën e sigurisë në lagje. Po ashtu edhe për lagjet ekzistuese duhet të bëhet një studim fisibiliteti ku duhet të inkorporohet siguria për banorët e Lipjanit.

Performanca e energjisë

Ruajtja e enegjisë në objektet për banim e sidomos në ndërtesa kolektive duhet të trajtohet me seriozitet të madh dhe në përputhje me ligjet në fuqi. Duhet të bëhet një studim i fisibilitetit në këtë drejtim dhe të aplikohet për fonde qeveritare dhe ndërkombëtare për zvogëluar nevojën për energji elektrike çoftë përmes izolimit termik, vendosjes së paneleve, apo edhe formave tjera bashkëkohore.

Banimi Inovativ

Lipjani duhet të mbështesë partneritete inovative dhe të eksplorojë modele financimi krijues, rregullore, standarde dhe procese miratimi, si dhe stimuj për sektorin privat për të ofruar projekte banimi ku mund të demonstron se produkti do të jetë mjaft tërheqës dhe funksional në dizajn dhe pamje për të garantuar ndryshime në Standardet ekzistuese të zhvillimit të qytetit. Lipjani do të inkurajojë kompanitë ndërtimore të përdorin metoda ndërtimi efikas dhe me kosto më të ulët në lidhje me elemente të parafabrikuara, materialet e ndërtimit dhe format e ndërtuara që rezultojnë në strehim estetikisht tërheqës dhe të përballueshëm.

Si konkluzion, Komuna e Lipjanit do të përfill në përpikëri kriteret për ndërtimin dhe banimin e familjeve në ndërtesa kolektive në përputhje me ligjet në fuqi që e trajtojnë këtë çështje. Disa nga kriteret bazike janë si në vijim:

- Të ketë shumëllojshmëri të tipeve të banesave për të përmbushur kërkesat për banim dhe nevojat sociale;
- Të ketë projektim adekuat urban (p.sh. parqe, kënde të lojërave, pika qendrore dhe hapësira të hapura të përdorshme) të cilat mundësojnë funksionimin adekuat për të gjitha lagjet përreth;
- Sigurimi i lidhjeve për këmbësorë, çiklistë si dhe qarkullimin e automjeteve në tërë lagjen;
- Kudo që është e mundur të adresojë sigurinë dhe parandalimin e krimit përmes vendosjes së kamerave apo policëve të lagjes;
- Të përfillet me përpikmëri ruajtja e mjedisit;
- Kriteret për ndërtimin e shtëpive individuale dhe shtëpive në rresht
- Disa nga kriteret bazë për ndërtimin e shtëpive individuale dhe shtëpive në rresht në lagje të Lipjanit janë si në vijim:
- Ndërtimi i shtëpive të qytetit duhet të theksojë lidhjen me zonat/lagjet përreth duke përfillur peizazhin adekuat;

- Duhet të inkurajohet ndërtimi i shtëpive në hapësira të zbrazura/vakante për të plotësuar zbrazëtirat;
- Duhet të dekurajohet grumbullimi i shtëpive të qytetit/shtëpive në rresht në sipërfaqe të mëdha si dhe dekurajohet ndërtimi i të njëjtave në qendër të qytetit;
- Ndërtimi i shtëpive duhet të veprojë si tampon ndërmjet ndërtesave kolektive dhe shtëpive ekzistuese, duke siguruar një kalim gradual të lartësive të ndërtesave;

Një sfidë me rëndësi për planifikim të mirëfilltë në fushën e banimit është mungesa e statistikave dhe të dhënave në fushën e banimit banim. Ky problem nuk ekziston vetëm për komunën e Lipjanit por në përgjithësi për tërë Kosovën dhe po shkakton pengesë për planifikim të mirëfilltë. Komuna e Lipjanit duhet ti azhurnon të dhënat lidhur me banim në periudha tre vjeçare që të përputhen me programet trevjeçare për banim. Informatat bazike që nevoiten janë:

- Numri dhe tipet e banesave kolektive;
- Numri dhe tipet e shtëpive;
- Numri i objekteve të palegalizuara;
- Numri i ndërtimeve për nevoja tjera, jashtë banimit (shkolla, objekte administrative, ambulanta, etj);
- Numri i ndërtesave për banim social;

Tabela 140. Nevojat për banim në zonën Rurale

Vendbanimi	Sipërfaqja e nevojshme për Banim (Hektar)	Vendbanimi	Sipërfaqja e nevojshme për Banim (Hektar)
Aklap	21.82	Magurë	136.80
Babush i Muhaxherëve	65.09	Marec	55.38
Baicë	30.59	Medvec	46.58
Banullë	89.46	Mirenë	29.68
Bregu i Zi	18.86	Pliitkoviq	4.40
Brus	4.37	Poturoc	34.93
Bujan	33.12	Qylagë	41.89
Bukovicë	0.23	Resinoc	32.65
Divjakë	1.81	Ribar i Madh	110.86
Dobrajë e Madhe	95.91	Ribar i Vogël	26.26
Dobrajë e Vogël	7.32	Rubofc	51.74
Gadime e Epërme	102.46	Rufc i Ri	42.90
Gadime e Ulët	135.24	Rufc i Vjetër	28.27
Glllogoc	77.50	Shalë	114.40
Grackë	20.83	Shisharkë	0.00
Grackë e Vjetër	52.69	Sllavi	191.88
Gumnasellë	54.05	Smallushë	73.66
Hallaq i Madh	15.70	Teqe	15.34
Hallaq i Vogël	38.62	Topliqan	98.18
Hanroc	5.17	Torinë	29.74
Janjevë	325.15	Varigoc	10.26
Kleçkë	4.39	Vërshhec	54.46
Kojuskë	20.32	Vogaqicë	0.52
Konjuh	47.31	Vrellë e Gadimes	4.58

Kosnicë	0.00	Vrellë e Goleshit	49.02
Kraishtë	67.62	Zllakuqan	8.58
Krojmir	48.61	Llugaxhi	63.96
Leletiq	17.56	Llugë	11.20
Lipjan	1116.28		

Tabela 141. Nevojat për banim në zonën Urbane

Vendbanimi	Sipërfaqja e nevojshme për Banim (Hektar)
Lipjan - Banim me nje njesi	13.274
Lipjan - Banim me shume njesi	100.719

1.10.3 ANALIZA E BANESAVE TË ZBRAZURA

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë informatat lidhur me shtëpitë e zbrazura në të gjitha vendbanimet e komunës së Lipjanit.

Tabela 142. Numri shtëpive/njësive banesore të zbrazëta

Nr	Vendbanimet	Shtëpi e braktisur	Nr	Vendbanimet	Shtëpi e braktisur
1	Akllap	0	32	Llugaxhi	1
2	Babush i Muhaxherve	0	33	Llugë	1
3	Baicë	0	34	Magurë	0
4	Banullë	0	35	Marec	2
5	Breg i Zi	0	36	Medvec	0
6	Brus	0	37	Mirenë	0
7	Bujan	0	38	Okosnicë	0
8	Bukovicë	0	39	Plitkoviq	0
9	Divlakë	0	40	Poturoc	0
10	Dobrajë e Madhe	0	41	Qellopek	0
11	Dobrajë e Vogël	2	42	Qylagë	2
12	Gadime e Epërme	0	43	Resinoc	0
13	Gadime e Ulët	1	44	Ribar i Madh	2
14	Gllanicë	0	45	Ribar i Vogël	2
15	Gllavicë	0	46	Rubofc	1
16	Gllogoc	0	47	Rufc i Ri	0
17	Grackë e Vjetër	0	48	Rufc i Vjetër	0
18	Grackë e Vogël	0	49	Silovi	0
19	Gumnasellë	1	50	Smallushë	0
20	Hallaç i Madh	1	51	Shalë	3
21	Hallaqi i Vogël	0	52	Shisharkë	0
22	Hanroc	0	53	Teqe	0
23	Janjevë	0	54	Tërbuc	0
24	Kleqkë	0	55	Topliqan	0
25	Kojस्कë	0	56	Torinë	0
26	Konjuh	0	57	Varigoc	0
27	Kraishtë	1	58	Vërshec	0

28	Krojmir	1	59	Vogaqicë	0
29	Leletiq	1	60	Vrellë	0
30	Lipjan	8	61	Vrellë e Goleshit	0
31	Lipovicë	0	62	Zllakuqan	0
				Gjithsej	30

Sipas kësaj tablele në komunën e Lipjanit janë 30 shtëpi të braktisura që në krahasim me numrin e gjithmbarshëm të shtëpive është numër shumë i vogël.

Sipas ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim, komunat e Kosovës kanë të drejtë të marrin me qira shtëpitë e individëve të cilat nuk përdoren dhe për të cilat ka akordim me pronarët e atyre shtëpive. Këto shtëpi/banesa të zbrazura mund të përdoren nga komuna e Lipjanit për ti strehuar familjet në nevojë për banim social, nënat vetë ushqyese apo edhe çiftet e reja.

Një analizë e detajuar dhe propozimet konkrete për këtë temë duhet të jepen në Programet trevjeçare për banim.

1.10.4 LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE

Problemi i ndërtimeve pa leje është një ndër problemet më të theksuara në Kosovë. Në tërë Kosovën llogaritet që ka rreth 350 mijë ndërtime ndërsa vetëm në komunën e Lipjanit ky numër është rreth 15,783⁵² objekte të ndërtuara pa leje. Në këtë numër hyjnë të gjitha ndërtimet pra përpos objekteve të ndërtuara për banim, hyjnë edhe objektet përcjellëse dhe afariste.

Kërkesat për legalizim të ndërtimeve pa leje janë shumë të ulta dhe komuna e Lipjanit për këtë qëllim duhet të jetë më aktive. Dy pengesat kryesore për trajtim adekuat të legalizimit të ndërtimeve pa leje janë stafi i pamjaftueshëm në komunë si dhe paqartësitë për trajtimin e lëndëve e sidomos mungesa e një Udhëzimi Administrativ për trajtimin e lëndëve nga lista e pritjes.

Komuna e Lipjanit duhet të bëjë një plan veprimi për legalizimin e ndërtimeve pa leje duke filluar nga analizat e numrit të ndërtesave pa leje si dhe analizës se si të trajtohet kjo temë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe përvojave të ngjashme rajonale.

1.10.5 HAPËSIRAT REKREATIVE:

Si pjesë përbërëse e dizajni mit të lagjeve duhet të jetë edhe ndërtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, këndeve të lojërave, hapësirave të hapura dhe vendkalimeve brenda zonave të banuara. Kriteret dhe standardet e vendndodhjes për zhvillimin e hapësirave të tilla duhet të përfshihen në Hartat Zonale të komunës së Lipjanit apo në planet e detajuara urbane. Në këto plane duhet të trajtohet edhe planifikimi i tokës për këto hapësira.

1.10.6 BANIMI SOCIAL

Sipas ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (Ligji Nr. 03L- 164), institucionet e Kosovës e me theks të veçantë Komunat e Kosovës duhet të ju ndihmojnë me banim të përkohshëm kategorive të ndryshme të familjeve që vet nuk mund të sigurojnë kulm mbi kokë.

Sipas këtij ligji ekzistojnë tri forma të ndihmës: Përmes banesave sociale, përmes pagesës së një pjesë të qerasë dhe përmes adaptimit të banesave komunale duke i shndërruar në ndërtesa për banim social.

Komuna e Lipjanit e ka të aprovuar programin Trevjeçar për Banim për periudhën 2022 deri 2025. Ky program është pasues i programit që ka mbuluar vitet 2016-2019 ku janë për bazë të arriturat dhe sfidat gjatë realizimit të programit të skaduar. Me këtë program për banim komuna e Lipjanit është zotuar që të merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për sigurim të kulmit mbi kokë për vete dhe për familjet e tyre.

Gjendja ekzistuese

⁵² Nga Koncepti Dokumenti i Qeverisë së Kosovës viti 2015

Komuna e Lipjanit posedon ndërtesa të banimit social në Magurë. Ndarja e ndërtesave është si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Vendi	Nr i ndërtesave për banim social	Nr i njësisve banesore	Nr i familjeve të vendosura	Përqindja e shfrytëzimit
	Magurë	1	21	21	100%

Përpos përmes ndërtesave për banim social, komuna e Lipjanit i ndihmon familjet në nevojë për banim të përkohshëm edhe përmes pagesës së një pjese të qerasë ndryshe e quajture edhe si bonus-banimi e paraparë me ligj. Numri i familjeve të ndihmuara përmes këtyre skemave në vitet 2020, 2021 dhe 2022 është **xx**.

Në komunën e Lipjanit në vazhdimësi vijnë kërkesa për ndihmë për banim përmes formularëve komunalë. Këto kërkesa shqyrtohen nga zyrtarë komunal nga drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe nga Zyra për Komunitete dhe Kthim. Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me nevoja për renovime dhe riparime në shtëpi të vjetra apo të dëmtuara. Komuna e Lipjanit i viziton këto familje dhe në bazë të buxhetit në dispozicion dhe në bazë të nevojave të qytetarëve e bën shpërndarjen e ndihmave.

Në komunën e Lipjanit janë të evidentuara rreth 70 familje të cilat kanë nevojë për ndihmë në banim. Nga ky numër rreth 20 % kërkojnë ndihmë për banim social (nuk kanë pronë të vet) ndërsa familjet tjera kërkojnë renovim apo rindërtim të shtëpive në prona private. – te verifikohet

Rastet sociale:

Ndërsa për tre vitet e fundit numri i familjeve në skemë sociale është si në vijim:

Tabela 143. Numri i familjeve në skemë sociale në tre vitet e fundit

Viti	Numri i familjeve
2021	1,308
2020	1,270
2019	1,221

SWOT Analiza - Banim

Në vijim është e prezantuar përmbledhja e Përparësive, Mangësive, Mundësive dhe Rreziqeve lidhur me banimin në komunën e Lipjanit.

Përparësitë	Mangësitë
- Baza ligjore solide në fushën e banimit; - I miratuar programi trevjeçar për banim; - Profilizimi i kërkuarve të banimit social; - Infrastruktura solide në zonat urbane; - Ekzistimi i Hartës Zonale; - Hapësira të mjaftueshme për ndërtime të reja; - Përkushtimi i zyrtarëve komunal për të trajtuar temat e banimit; - Numër i madh i qytetarëve janë posedues/pronarë të objekteve banesore; - Vazhdimi i procesit të legalizimit;	- Mungesa e statistikave të azhurnuara në fushën e banimit; - Mungesa e njësitit institucional brenda komunës së Lipjanit për trajtimin e temave që lidhen me banim; - Buxhet i pamjaftueshëm për trajtim të banimit social; - Mirëmbajtja e pamjaftueshme e hapësirave të përbashkëta në ndërtesa kolektive; - Numri i limituar i programeve për të ndihmuar familjet në nevojë për banim të përbalueshëm; - Numri i madh i ndërtimeve pa leje dhe objekteve pa pranimë teknike; - Pronë e pamjaftueshme komunale për trajtimin e banimit social; - Numri i pamjaftueshëm i inspektorëve;
Mundësitë	Rreziqet
Themelimi i sektorit për banim;	Rritja e numrit të kërkesave jashtë mundësive komunale;

▪ Zhvillimi i programeve për banim të përballueshëm me skemat PPP; ▪ Inventarizimi i banimit në nivel komunal; ▪ Ndihma nga donatorë të ndryshëm në fushën e banimit social; ▪ Pilotimi i projekteve komunale për trajtimin e ndërtimeve pa leje;	▪ Mungesa e përkrahjes nga niveli qendror për krijimin e sektorit të banimit; ▪ Rënia e fuqisë blerëse të banesave kryesisht për shkak të largimit të qytetarëve; ▪ Rritja e mëtejme e çmimeve të banesave; ▪ Jo stabiliteti politik;
--	--

1.11 SHFRYTËZIMI I TOKËS

Territori i Komunës së Lipjanit është i dominuar sipërfaqet e rrafshëta të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore dhe për ngritjen e vendbanimeve, ndërsa pjesa tjetër me sipërfaqe kodrinore-malore që mundëson zhvillimin e ekonomisë pyjore, turizmit dhe blegtorisë. Prej sipërfaqes totale që ka komuna e Lipjanit, vlerësohet se 44.28% e kësaj sipërfaqeje është tokë bujqësore dhe 33.92% e këtyre sipërfaqeve janë Tokë pyjore pa llogaritur zonat e mbrojtura si dhe zonat e veçanta të cilat brenda territorit të tyre kanë zonave pyjore e cekur edhe tek pjesa e profilit.

Vlen të theksohet që në tabelën krahasuese sipërfaqja pyjore është trajtuar si totale shkaku i projeksionit të PZHK 2013 - 2023+ i cili është planifikuar së bashku me zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta.

Në vazhdim është paraqitur një tabelë, në të cilën janë të rreshtuara shfrytëzimet dhe sipërfaqet e tyre sipas shfrytëzimit aktual të Tokës, si dhe sipas shfrytëzimit të Tokës të vitit 2013 sipas Planit Zhvillimor Komunal 2013-2023+.

Në tabelë janë nxjerrë edhe diferencat në hektar dhe në përqindje, në mes shfrytëzimit të tokës të vitit 2013 dhe shfrytëzimit aktual të Tokës.

Gjithashtu pas analizës së krahasimit të projeksioneve të PZHK 2013-2023+ janë nxjerrë prognozatat për të gjitha sipërfaqet.

Tabela 144. Analiza krahasuese bazuar në projeksionet e planifikuara nga Plani Zhvillimor Komunal 2013 – 2023+ si dhe në shfrytëzimin ekzistues të Tokës të punuar në GIS.

Kategoria e shfrytëzimit	Shfrytëzimi i planifikuar i Tokës i Planit Zhvillimor Komunal 2013 – 2023+ sip/ha	Shfrytëzimi ekzistues i tokës bazuar në të dhënat e fundit, digjitalizuar në GIS	Diferenca në ha	Diferenca në %
Sipërfaqe Ujore	98.43	60.31	-38.12	-63.21%
Banim / Banim i përhershëm	3854.66	2113.11	-1741.55	-82.42%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	14124.8	11,327.96	-2796.84	-24.69%
Prodhim parësor/ Bujqësi/ Prodhim bujqësor komercial	14624.47	15138.91	514.44	3.40%
Shfrytëzim tjetër/ Tokë natyrore e cila nuk është në ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik/ Tokë natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik/ Zonë e Veçantë	1107	974.04	-132.96	-13.65%
Shfrytëzim tjetër/ Tokë natyrore e cila nuk është në ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik/Zonë e mbrojtur	2441.31	2477.76	36.45	1.47%
Shfrytëzim tjetër/ Tokë natyrore e cila nuk është në ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik/ Tokë natyrore e cila	2.24	0.56	-1.68	-300.00%

nuk është në funksion tjetër ekonomik /Zonë e veçantë e mbrojtur				
Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar	696.3	303.27	-393.03	-129.60%
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit	191.44	707.47	516.03	72.94%


1.11.1 BANIM / BANIM I PËRHERSHËM

Në vazhdim është paraqitur tabela në të cilën është bërë krahasimi i projeksioneve të PZHK 2013-2023+ me sipërfaqen nga shfrytëzimi ekzistues i Tokës 2023.

Duke u bazuar edhe në UA. MMPH – NR. 11/2015 MBI ELEMENTET DHE KËRKESAT THEMELORE PËR HARTIMIN. ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL, më saktësisht në nenin 8 Vlerësimi i gjendjes dhe pikën 8.10 Shfrytëzimi i Tokës, kemi arritur që ti shqyrtojmë dhe vlerësojmë edhe shfrytëzimet e Tokës për sipërfaqe banimi si dhe njëkohësisht kemi vlerësuar edhe projeksionet e shfrytëzimit të tokës të planifikuara sipas PZHK 2013 – 2023 për të ardhur në përfundim se deri në çfarë pike janë zbatuar ato.

Nëse i referohemi tabelës më poshtë kemi një analizë të projeksioneve e cila është bërë në nivel të zonave kadastrale në të cilën vërejmë për secilin vendbanim se sa kemi sipërfaqe të territorit të pa zbatuar në raport me sipërfaqen e planifikuara me PZHK 2013-2023.

Ndërsa nëse i referohemi sipërfaqeve në hektar, në PZHK 2013 – 2023 është planifikuar 4598.47 hektar për banim, ndërsa ne shfrytëzimin ekzistues të Tokës të digjitalizuar dhe kalkuluar përmes sistemit GIS kemi vetëm 2113.12 hektar, që i bie një diferencë prej -1741.55 pa u shfrytëzuar nga projeksioni i planifikuar.




Grafikoni 21. Krahasimi i sipërfaqeve në hektar, të planifikuara për Banim sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet ekzistuese për banim 2023

Tabela 145. Analiza e zbatimit të sipërfaqes së planifikuar në PZHK 2013-2023 në raport me shfrytëzimin aktual të Tokës 2023


Vendbanimi	Sipërfaqja planifikuar	e Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar	Vendbanimi	Sipërfaqja planifikuar	e Sipërfaqja sipas	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar
------------	------------------------	-------------------------	---------------------	------------	------------------------	--------------------	-----------------------	---------------------

	sipas 2013	PZHK		(Sipërfaqja e pa ndërtuar)		PZHK 2013		
Aklap	72.43	25.24	47.19	Llugë	28.00	12.08	15.92	
Babush i Muhaxherëve	98.81	54.06	44.75	Magurë	69.88	42.32	27.56	
Baicë	37.32	30.84	6.48	Marec	35.70	31.81	3.89	
Banullë	226.29	77.02	149.27	Medvec	42.74	29.8	12.94	
Bregu i Zi	35.61	22.3	13.31	Mirenë	33.91	14.3	19.61	
Brus	51.78	12.05	39.73	Pliitkoviç	15.65	3.56	12.09	
Bujan	47.01	32.73	14.28	Poturoc	54.07	33.84	20.23	
Bukovicë	9.53	1.49	8.04	Qylagë	57.65	36.02	21.63	
Divjakë	5.89	2.39	3.50	Resinoc	49.84	25.38	24.46	
Dobrajë e Madhe	140.80	94.86	45.94	Ribar i Madh	124.03	85.25	38.78	
Dobrajë e Vogël	16.00	9.61	6.39	Ribar i Vogël	38.34	25.16	13.18	
Gadime e Epërme	178.69	87.82	90.87	Rubofc	76.64	48.46	28.18	
Gadime e Ulët	141.32	97.33	43.99	Rufc i Ri	38.89	26.49	12.40	
Gillogoc	134.45	65.13	69.32	Rufc i Vjetër	52.16	41.19	10.97	
Grackë	41.18	18.65	22.53	Shalë	80.75	68.9	11.85	
Grackë e Vjetër	242.93	27.94	214.99	Shisharkë	1.32	0.44	0.88	
Gumnasellë	100.41	52.28	48.13	Silovi	281.95	117.32	164.63	
Hallaq i Madh	38.04	19.2	18.84	Smallushë	73.18	44.18	29.00	
Hallaq i Vogël	46.83	27.77	19.06	Teqe	20.78	6.21	14.57	
Hanroc	17.02	5.93	11.09	Topliqan	144.46	74.7	69.76	
Janjevë	145.43	56.44	88.99	Torinë	44.74	24.59	20.15	
Kleçkë	13.69	7.14	6.55	Varigoc	14.31	8.53	5.78	
Kojskë	27.64	17.96	9.68	Vërshec	56.20	30.32	25.88	
Konjuh	219.91	31.4	188.51	Vogaqicë	3.31	1.01	2.30	
Kosnicë	1.44	1	0.44	Vrellë e Gadimes	9.68	4.23	5.45	
Kraishtë	88.09	39.47	48.62	Vrellë e Goleshit	74.00	36.18	37.82	
Krojmir	68.19	56.78	11.41	Zllakuqan	13.56	10.36	3.20	
Leletiq	26.01	11.62	14.39					
Lipjan	650.00	201.26	448.74					
Llugaxhi	140.01	42.78	97.23					

Nëse i referohemi sipërfaqeve totale të tabelës më poshtë si dhe grafikonit vërejmë që janë bërë diferencat në hektar duke vërejtur që në përgjithësi sipërfaqja e planifikuar për banim në vitin 2013 gjatë hartimit të PZHK e deri në vitin 2023, pra për dhjetë vite ka mbetur pa u zbatuar për 54.05% nga ajo sipërfaqe e planifikuar.



Grafikoni 22. Krahasimi i sipërfaqeve të planifikuara për Banim sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet ekzistuese për banim 2023



Grafikoni 23. Paraqitja e përqindjes së mbetur pa u shfrytëzuar nga sipërfaqet e planifikuara me PZHK 2013– 2023+

■ Prognozat

Bazuar në trendin e zhvillimit të banimit në vendbanimet e komunës së Lipjanit, vijmë në përfundim që nëse vazhdohet ky trend i rritjes edhe për tetë vite të ardhshme, komuna e Lipjanit një zhvillim të ngjashëm pra me një sipërfaqe të planifikuar për banim e cila është më e madhe se sa nevoja për zgjerim ku rezultatet e mësipërme na qojnë deri te një prognozë që mos zbatueshmëria shkon deri në 54.05% apo -1741.55 hektar e sipërfaqes për banim nëse shkojmë me trendin e njëjtë të planifikimit të territorit për banim.

■ Nevojat

1. Duke analizuar trendët dhe prognozat vlerësojmë që në komunën e Lipjanit duhet të merren masa në fushën e

banimit, ku në vendbanimet si Lipjan, Sillovi, Grackë e Vjetër, Banullë, Konjuhë, Topliqan, Dobrajë e Madhe, duhet të tentohet të konceptohen në atë mënyrë që territori për banim të harmonizohet me kërkesat nevoja të sakta të sipërfaqeve për banim si dhe projeksionet demografike, ngaqë vërejmë që nga sipërfaqet e planifikuara me PZHK 2013-2023+ nuk është zbatuar të paktën 50% dhe duke u bazuar në analizën më lartë rekomandohet që të tkurret kufiri ndërtimor.

2. Nevoja për planifikim të ngritjes së nivelit të cilësisë së jetës në vendbanimet në rënie të popullatës dhe të banimit në vendet si : Shisharkë, Bukovicë, Kosnicë, Vrellë e Gadimes, Plitkoviq, ngaqë vërejmë sipërfaqe shumë të vogla për banim.
3. Vendbanimet si : Dobrajë e Madhe, Gadime e Ulët, Krojmir, Bujan, Marec, Baicë, Shalë dhe Zllakuqan duhet të planifikohet sipërfaqja për banim në rritje, ngaqë bazuar në kufijtë ndërtimor me PZHK 2013-2023+ maksimum 30% janë të pa shfrytëzuar dhe minimumi 14%, pra është e kurtë nevoja për rritje edhe për tetë vitet e ardhshme.
4. Nevoja për tkurrje të kufirit ndërtimor për banim është shumë e theksuar në zonën urbane duke i shtuar edhe tendencën për ndërtim të banimit me shumë njësi.
5. Nevoja për banim më cilësor dhe të qëndrueshëm në zona të lartë rurale.
6. Nevoja e banimit në zona urbane për gjelbërim, hapësira të lira dhe terrene sportive dhe të rekreimit.

Bazuar në analizat më lartë vërehen disa nevoja të cilat i kemi listuar, por vlen të theksohet që nëse i referohemi sipërfaqes së përgjithshme për banim në territorin e komunës së Lipjanit të Planifikuar me PZHK 2013-2023+ dhe sipërfaqes ekzistuese për banim vlen të theksohet nevoja për tkurrje sidomos të sipërfaqeve për banim me intensitet të ulët në zonën urbane duke u munduar që këto tkurrje ti bëjmë kryesisht në sipërfaqe të planifikuara mbi tokë bujqësore.

Me tkurrjen e kufijve ndërtimor në toka bujqësore si dhe me rritje të sipërfaqes për banim me intensitet të lartë do të ndikojmë pozitivisht në ruajtje të Tokës bujqësore si aset i rëndësishëm i komunës së Lipjanit.

1.11.2 PRODHIM PARËSOR / BUJQËSI

Në vazhdim kemi paraqitur analizën e gjendjes ekzistuese të sipërfaqeve për Tokë bujqësore, ku vlerësimi kryesisht është i paraqitur sipas kërkesës së UA. MMPH – NR. 11/2015.


Duke u bazuar në gjetjet nga profili i gjendjes ekzistuese ne kemi arritur të nxjerrim të gjitha sipërfaqet me Tokë bujqësore si dhe përqindjen e sipërfaqes me Tokë bujqësore në nivel të gjithë komunës së Lipjanit.

Vlen të theksohet që gjatë këtij procesi është bërë edhe analiza krahasuese në mes projeksioneve që ka pasur PZHK 2013-2023+ i komunës së Lipjanit dhe gjendjes ekzistuese, ku nëse i referohemi kësaj analize kemi rezultatet si në vijim.

Me Planin Zhvillimor Komunal 2013-2023+ është planifikuar 14614.71 hektar Tokë bujqësore, ndërsa gjatë nxjerrjes së sipërfaqeve nga shfrytëzimi i fundit të Tokës i cili kryesisht rrjedh si rezultat i digjitalizimit në sistemin gjeografik të informacionit GIS, aktualisht komuna e Lipjanit ka 15121.84 hektar.

Bazuar në sipërfaqet e lartpërmendura ashtu sikur edhe në shfrytëzimet e tjera pra nuk kemi zhvillim të territorit aq sa është planifikuar me PZHK 2013 dhe rrjedh si rezultat që Toka bujqësore është më e madhe në gjendjen ekzistuese se sa në atë të planifikuarën për 507.13 hektar apo për -3.47% nuk është zbatuar sipërfaqja e planifikuar për Tokë bujqësore sipas PZHK 2013 , duke pasur parasysh që zgjerimet e kufijve ndërtimor janë bërë nëpër Toka bujqësore dhe mos zbatimi i tyre apo thënë ndryshe mos ndërtimi sipas projeksioneve të PZHK 2013 rezulton me Tokë bujqësore më të madhe në gjendjen ekzistuese.

Këtë analizë krahasuese në nivel të tërë territorit të Komunës së Lipjanit mundë të vërejmë edhe tek pjesa ku paraqitet trendi i zhvillimit për 10 vite pra 2013 – 2023.




Grafikoni 24. Krahasoni sipërfaqet në hektar, të planifikuara për Banim sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet ekzistuese për banim 2023

Përveç analizës së krahasimit të sipërfaqeve në mes të PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale e cila është paraqitur në nivel të gjithë territorit të komunës, në tabelën më poshtë është paraqitur e njëjta analizë edhe në nivel të zonave kadastrale, pra për secilën zonë kadastrale janë bërë diferencat në sipërfaqe në mes PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale, ku rezultatet e kësaj analize i kemi paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 146. Analiza e zbatimit të sipërfaqes së planifikuar në PZHK 2013-2023 në raport me shfrytëzimin aktual të Tokës 2023 Bujqësore

Vendbanimi	Sipërfaqja e planifikuar sipas PZHK 2013	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar (Sipërfaqja e pa ndërtuar)	Vendbanimi	Sipërfaqja e planifikuar sipas PZHK 2013	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar
Aklap	284.14	423.94	139.80	Lipjan	594.76	290.8	-303.96
Babush i Muhaxherëve	337.85	342.63	4.78	Llugaxhi	252.83	218.86	-33.97
Baicë	135.65	142.9	7.25	Llugë	128.15	113.49	-14.66
Banullë	259.80	160.18	-99.62	Magurë	160.05	158.9	-1.15
Bregu i Zi	162.45	140.61	-21.84	Marec	249.76	260.87	11.11
Blinajë	0.10	60.53	60.43	Medvec	229.91	242.41	12.50
Brus	50.54	152.72	102.18	Mirenë	436.17	413.83	-22.34
Bujan	185.37	157.31	-28.06	Pliitkoviq	26.27	144.89	118.62
Bukovicë	0.87	54.93	54.06	Poturoc	215.05	182.16	-32.89
Divjakë		50.62	50.62	Qylagë	222.87	155.03	-67.84
Dobrajë e Madhe	534.32	505.24	-29.08	Resinoc	134.74	174.69	39.95
Dobrajë e Vogël	114.19	109.91	-4.28	Ribar i Madh	433.66	410.82	-22.84
Gadime e Epërme	789.44	678.93	-110.51	Ribar i Vogël	169.54	159.96	-9.58


Gadime e Ulët	578.37	425.57	-152.80	Rubofc	620.59	613.12	-7.47
Glllogoc	468.23	403.11	-65.12	Rufc i Ri	260.02	249.74	-10.28
Grackë	137.75	115.21	-22.54	Rufc i Vjetër	244.01	240.98	-3.03
Grackë e Vjetër	396.53	220.23	-176.30	Shalë	273.71	316.82	43.11
Gumnasellë	184.05	149.01	-35.04	Shisharkë	20.23	64.37	44.14
Hallaq i Madh	383.03	325.14	-57.89	Silovi	857.66	737.25	-120.41
Hallaq i Vogël	101.43	92.62	-8.81	Smallushë	652.14	606.56	-45.58
Hanroc	31.23	114.22	82.99	Teqe	101.94	74.24	-27.70
Janjevë	416.06	614.82	198.76	Topliqan	654.29	602.9	-51.39
Kleçkë		104.27	104.27	Torinë	104.64	87.56	-17.08
Kojskë	205.28	199.76	-5.52	Varigoc	48.15	46.83	-1.32
Konjuh	257.64	188.21	-69.43	Vërshec	157.05	138.95	-18.10
Kosnicë	35.80	85.95	50.15	Vogaqicë	10.02	33.29	23.27
Kraishtë	530.23	474.65	-55.58	Vrellë e Gadimes	68.49	97.83	29.34
Krojmir	276.28	310.53	34.25	Vrellë e Goleshit	733.38	716.63	-16.75
Leletiq	157.73	205.27	47.54	Zllakuqan	47.41	51.91	4.50



Grafikoni 25. Krahasimi i sipërfaqeve të planifikuara për Banim sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet ekzistuese për banim 2023

Bazuar në grafikun 6 vërejmë që në shumicën e zonave kadastrale nuk është zbatuar sipërfaqja e cila është planifikuar të mbetet me sipërfaqen bujqësore sipas PZHK 2013 – 2023.

Gjithashtu edhe në grafikun 7 këto sipërfaqe janë të paraqitura edhe në përqindje zbatimi i sipërfaqeve të planifikuar me PZHK 2013 – 2023+ sipas zonave kadastrale.



Grafikoni 26. Përqindja e zbatimit të sipërfaqeve të Tokës bujqësore e planifikuar sipas PZHK 2013–2023+

- Prognozat

1. Bazuar në trendin e Tokës bujqësore, vlerësojmë që nëse vazhdohet me një trend të tillë edhe për tetë vite të ardhshme komuna e Lipjanit do të ketë edhe 507ha më shumë se sa është planifikuar të jetë, duke u bazuar në rëndësinë e Tokës bujqësore ne e shohim si trend pozitiv ruajtjen e Tokës bujqësore në raport me atë se çka është planifikuar me PZHK 2013 – 2023 dhe rekomandojmë që zgjerimet e kufijve ndërtimor të jenë në harmoni me kërkesat për zgjerime dhe të ruhet sa më shumë sipërfaqja e Tokës bujqësore.
2. Bazuar në sipërfaqet e zonave kadastrale, trendët e zhvillimit të ndërtimit, vërehet që sipërfaqja e planifikuar për Toka Bujqësore më së paku është zbatuar në vendbanimet si : Lipjan, Grackë e Vjetër, Banullë, Qylagë dhe Teqe.
3. Bazuar në këtë vërejmë që është ruajtur Toka bujqësore dhe në kufijtë ndërtimor të planifikuar duhet të kemi parasysh zhvillimet e planifikuara si dhe projeksionet demografike, për të qenë në harmoni me kërkesat për zgjerime.

- Nevojat

1. Ruajtja e Tokës bujqësore në vendbanimet në të cilat mendohet zgjerimi i kufijve ndërtimor.
2. Zgjerimi i kufijve ndërtimor të bëhet në harmoni me kërkesat dhe nevojat për zgjerim.
3. Tkurrja e kufijve ndërtimor në vendbanimet ku nuk është zbatuar as 10% e kufijve ndërtimor të planifikuar me PZHK 2013-2023+
4. Zgjerimet e kufijve ndërtimor të bëhen kryesisht në Toka bujqësore të cilat janë mbi kategorinë 4 dhe të tentohet të mos zgjerohen kufijtë ndërtimor në toka të kategorisë nga 1 deri 4.
5. Komascioni i tokave bujqësore, si mënyrë më efektive për shfrytëzimin e tyre.

- ### 1.3 PRODHIM PARËSOR / PYLLTARI / PYLLTARI E BAZUAR NË ROTACION TË MESËM APO TË GJATË

Në vazhdim janë paraqitur zonat pyjore të cilat janë analizuar duke bërë krahasimin në mes sipërfaqeve pyjore të cilat janë planifikuar me PZHK 2013-2023 si dhe sipërfaqeve ekzistuese sipas shfrytëzimit ekzistues të Tokës të punuar në sistemin gjeografik koordinativ GIS.


Vlen të theksohet ashtu si në profil edhe në vlerësim tek zonat pyjore i kemi trajtuar vetëm zonat të cilat janë të veshura me pyje jashtë zonës së mbrojtur “Rezervati i Gjuetisë Blinaja” dhe Zonave me Interes të Veçantë “ Kleçkë dhe Divjakë”.

Pra bazuar në shfrytëzimin ekzistues të Tokës kemi një sipërfaqe pyjore prej 11,327.96 ha, ndërsa me PZHK 2013-2023+ kemi një sipërfaqe me Toka pyjore prej 13936.56 ha (Së bashku me “Rezervati i Gjjetisë Blinaja” dhe Zonat me Interes të Veçantë “ Kleçkë dhe Divjakë”).

Duke u nisur nga ajo që të PZHK 2013-2023+ i kemi të trajtuara si sipërfaqe totale zonat pyjore me “Rezervati i Gjuetisë

Blinaja” dhe Zonave me Interes të Veçantë “ Kleçkë dhe Divjakë” ne i kemi trajtuar edhe në vijim për të pasur një rezultat sa më të saktë për zbatimin e projeksioneve të PZHK 2013-2023+ sa i përket masave për ruajtje dhe ripyllëzim të sipërfaqeve Pyjore.

Pra në Grafikon më poshtë janë të kalkuluar sipërfaqet sipas PZHK 20113-2023+ (13,936.56) dhe sipërfaqet e shfrytëzimit ekzistues të Tokës (14,779.76) së bashku me “Rezervati i Gjuetisë Blinaja” dhe Zonat me Interes të Veçantë “ Kleçkë dhe Divjakë”.




Grafikoni 27. Shfrytëzimi i Tokës ekzistues sipas PZHK 2013-2023+ krahasuar me Shfrytëzimin aktual të Tokës 2023

Përveç analizës së krahasimit të sipërfaqeve në mes të PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale e cila është paraqitur në nivel të gjithë territorit të komunës, në tabelën më poshtë është paraqitur e njëjta analizë edhe në nivel të zonave kadastrale, pra për secilën zonë kadastrale janë bërë diferencat në sipërfaqe në mes PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale, ku rezultatet e kësaj analize i kemi paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 147. Analiza krahasuese e zbatimit të sipërfaqes së planifikuar në PZHK 2013-2023 në raport me shfrytëzimin aktual të Tokës Pyjore ne nivel të vendbanimeve 2023

Vendbanimi	Sipërfaqja planifikuar sipas PZHK 2013	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar (Sipërfaqja e pa ndërtuar)	Vendbanimi	Sipërfaqja planifikuar sipas PZHK 2013	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar
Akllap	633.06	798.61	-165.55	Mirenë	138.88	112.36	26.52
Babush i Muhaxherëve	61.66	60.76	0.90	Pliitkoviq	383.27	495.92	-112.65
Brus	936.4	1115.21	-178.81	Poturoc	77.28	47.33	29.95
Bukovicë	188.59	256.7	-68.11	Qylagë	82.67	21.42	61.25
Gadime e Epërme	1034.35	1049.42	-15.07	Resinoc	352.75	409.25	-56.50
Gadime e Ulët	294.7	131.31	163.39	Ribar i Madh	629.79	331.87	297.92
Janjevë	337.54	582.7	-245.16	Shalë	670.67	619.86	50.81
Kleçkë	538.34	72.14	466.20	Shisharkë	348.47	410.31	-61.84
Kosnicë	1293.38	539.19	754.19	Silovi	1263.14	1181.71	81.43

Kraishtë	412.44	334.29	78.15	Smallushë	179.24	141.4	37.84
Krojmir	563.04	591.98	-28.94	Varigoc	125.51	127.63	-2.12
Vrellë e Gadimes	142.39	178.87	-36.48	Vërshëc	394.79	234.79	160.00
Zllakuqan	47.88	54.89	-7.01	Vogaqicë	479.39	497.31	-17.92




Grafikoni 28. Krahasimi i sipërfaqeve të planifikuara për pyje sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet shfrytëzimin ekzistues të Tokës 2023

Bazuar në grafikun më lartë vërejmë që në disa vendbanime sipërfaqja pyjore është më e madhe se sa ajo e planifikuar me PZHK 2013 – 2023+

Vlen të theksohet që në disa raste sipërfaqja më e madhe është shkaku i mos zbatimit të sipërfaqeve për ndërtim aq sa është planifikuar me kufijtë ndërtimor të planifikuar sipas PZHK 2013-2023 dhe gjithashtu në disa sipërfaqe kemi pyllëzim të Tokës ku me raste kemi edhe ripyllëzim të disa sipërfaqeve.

Gjithashtu edhe në grafikun më poshtë këto sipërfaqe janë të paraqitura edhe në përqindje zbatimi i sipërfaqeve të planifikuar me PZHK 2013 – 2023+ sipas zonave kadastrale.



Grafikoni 29. Përqindja e zbatimit të sipërfaqeve të Tokës pyjore e planifikuar sipas PZHK 2013–2023+

■ Prognozat

1. Bazuar në trendin e zhvillimit të tokave pyjore, vijmë në përfundim që nëse vazhdohet me një planifikimin planifikim të njëjtë të kufijve ndërtimor komuna e Lipjanit do të ketë 843.2 hektar të më shumë se sa janë

planifikuar për 8 vite gjë që ne e shohim si pozitive kur kemi kaq sipërfaqe të madhe të ruajtur të tokës pyjore dhe mendojmë që planifikimet për zhvillime të reja duhet të rishikohen në raport me PZHK – 2013 – 2023.

2. Duke pasur parasysh rritjet e Tokës pyjore nëpër disa vendbanime theksojmë që komuna e Lipjanit ka nevojë për vazhdimësi të rritjes së Tokës pyjore edhe në vendbanimet që i kemi në rënie (Aklap, Brus, Bukovicë, Gadime e Epërme, Janjevë, Krojmir, Vrellë e Gadimës, Zllakuqan, Plitkoviq, Resinoc, Shisharkë, Varigoc, Vogaqicë) si dhe rigjenerimin dhe ripyllëzimin e tokave pyjore të dëmtuara.

▪ **Nevojat**

1. Mbrojtja e sipërfaqes ekzistuese pyjore nga prerja ilegale.
2. Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore nga zjarret masive.
3. Ripyllëzimi dhe rigjenerimi i tokave pyjore të dëmtuara në vendbanimet si Aklap, Brus, Bukovicë, Gadime e Epërme, Janjevë, Krojmir, Vrellë e Gadimës, Zllakuqan, Plitkoviq, Resinoc, Shisharkë, Varigoc, Vogaqicë.


1.2 PRODHIM PARËSOR / MINIERË DHE GURORE / MINIERË E MATERIALEVE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË

Në vazhdim janë paraqitur sipërfaqet për Miniera Sipërfaqësore të cilat janë analizuar duke bërë krahasimin në mes sipërfaqeve Miniera Sipërfaqësore të cilat janë planifikuar me PZHK 2013-2023 si dhe sipërfaqeve ekzistuese sipas shfrytëzimit ekzistues të Tokës të punuar në sistemin gjeografik koordinativ GIS.

Pra bazuar në shfrytëzimin ekzistues të Tokës kemi një sipërfaqe Miniera sipërfaqësore prej 367.09 ha, ndërsa me PZHK 2013-2023+ kemi një sipërfaqe me 294.4 ha.


Vlen të theksohet që kemi një dallim në hektar në mes të sipërfaqeve për miniera sipërfaqësore të planifikuara me PZHK 2013-2023+ dhe shfrytëzimit ekzistues të Tokës prej 72.69 hektar, pra kemi një rritje të dukshme të Minierave sipërfaqësore.

Gjithashtu dallimi në mes të shfrytëzimit ekzistues të Tokës dhe shfrytëzimit të Tokës sipas PZHK 2013-2023+ është i paraqitur edhe në grafikun më poshtë.



Grafikoni 30. Shfrytëzimi i Tokës ekzistues sipas PZHK 2013-2023+ krahasuar me Shfrytëzimin aktual të Tokës 2023 paraqitur në hektar.

Përveç analizës së krahasimit të sipërfaqeve në mes të PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale e cila është paraqitur në nivel të gjithë territorit të komunës, në tabelën më poshtë është paraqitur e njëjta analizë edhe në nivel të zonave kadastrale, pra për secilën zonë kadastrale janë bërë diferencat në sipërfaqe në mes PZHK 2013-2023 dhe sipërfaqeve aktuale, ku rezultatet e kësaj analize i kemi paraqitur në tabelën më poshtë në hektar.



Grafikoni 31. Krahasimi i sipërfaqeve të planifikuara për miniera sipërfaqësore sipas PZHK 2013 - 2023+ me sipërfaqet shfrytëzimin ekzistues të Tokës 2023

Tabela 148. Analiza krahasuese e zbatimit të sipërfaqes së planifikuar në PZHK 2013-2023 në raport me shfrytëzimin aktual të Tokës Pyjore në nivel të vendbanimeve 2023

Vendbanimi	Sipërfaqja e planifikuar sipas PZHK 2013	Sipërfaqja Ekzistuese	Diferenca në hektar (Sipërfaqja ndërtuar)	Diferenca në %
Akllap	9.1	14.1	5	35.46%
Babush i Muhaxherëve	9.5	22.35	12.85	57.49%
Gadime e Ulët	31.5	44.66	13.16	29.47%
Grackë e Vjetër		2.6		
Janjevë		0.04		
Konjuh		1.79		
Kosnicë		1.06		
Leletiq		1.55		
Lipjan		5.26		
Magurë	118	107.28	-10.72	-9.99%
Medvec	75	97.69	22.69	23.23%
Mirenë		13.28		
Pliitkoviq		0.05		
Shalë		7.46		
Silovi	7	45.74	38.74	84.70%
Smallushë		2.18	2.18	100.00%

Kojskë	44.3		-44.3	35.46%
--------	------	--	-------	--------

1.11.4 MODELET E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS

Modeli i shfrytëzimit të banimit në komunën e Lipjanit:

Sa i përket numrit të strukturave të ndërtuara, në Komunë pjesa më e madhe e ndërtimeve prej 71.29% janë ndërtesa banimi me një njësi, pastaj banimi me shumë njësi prej 28.71%.

Ndërsa ndërtesa dyqane janë gjithsej 1224 dhe zyre prej 2422. Për dallim nga shumë komuna tjera komuna e Lipjanit ka një model të shfrytëzimit më kompakt sa i përket shfrytëzimit të Tokës, ku thuajse të gjitha vendbanimet janë kompakte dhe kjo rrjedh si rezultat i precizimit të kufijve ndërtimorë me Planin Zhvillimor komunal 2013 – 2023+ i cili ka shtrirë një kontroll të kufijve ndërtimor.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve ujore:

Në komunën e Lipjanit kemi një sipërfaqe ujore prej 60.31ha apo 0.18% e sipërfaqes, kjo sipërfaqe përbëhet kryesisht nga lumenj dhe prrocka .

Lumenjtë kryesor janë: Lumi Sitnica dhe Lumi Drenica, si dhe prrockat si : Lumi Janjevka, Lumi i Zhegocit, Lumi i Gadimes dhe Lumi i Sazlisë.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve bujqësore:

Toka bujqësore në komunën e Lipjanit shfrytëzohet në mënyrë racionale, pjesa më e madhe e tokës bujqësore përdoret për prodhim bujqësor intensive.

Kultura më të shpeshta të cilat kultivohen dhe mbulojnë sipërfaqet bujqësore janë drithërat, Perimekultura, Pemëtaria, Blegtoria, Bletaria.

Si sipërfaqe Toka bujqësore përfshinë pjesën më të madhe të territorit prej 15138.91 apo 44.28% e gjithë territorit të komunës së Lipjanit.

Modeli i shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore:

Komuna e Lipjanit ka 11,327.96 ha pyje. Drurët më të përhapur në këto pyje janë, Ahu, Dushku, Shkoza, Qarri, Bungu dhe Pisha.

Sa i përket sipërfaqeve për shfrytëzim si pyje i kemi këto kategori:

Prej sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve të kësaj komune:

4. 1621.023ha janë pyje të larta,
5. 2993.21ha pyje të ulëta
6. 11038.16ha janë shkurre.

1.11.5 PËRPARËSITË, DOBËSITË, MUNDËSITË DHE RREZIQET / ANALIZA SWOT

SWOT analiza e shfrytëzimit aktual të Tokës

Përparësitë	Dobësitë
-------------	----------

- Struktura urbane dhe vendbanimet rurale janë kompakte. - Qendra e qytetit është e fuqishme, - Rritje e territorit të zonave komerciale. - Rritje e territorit të sipërfaqeve të infrastrukturës rrugore. - Rritje e territorit të sipërfaqeve të zonave të shërbimeve. - Zgjerim i zonave rekreative turistike. - Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore.	- Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi i efikas në periferi; - Buxheti i ulët për shpronësime, duke marrë parasysh rritjen e vlerës së tokës; - Ndërtimet ilegale në Tokë bujqësore; - Fragmentimi i Tokës bujqësore në parcele të vogla; - Mungesa e konsolidimit të Tokës (komasacionit); - Vendbanime me shtrirje të shpërndarë; - Krijimi i hapësirave për zhvillim komercial në mënyrë të pa kontrolluar; - Mungesa e sistemit të ujitjes dhe infrastrukturës rrugore për tokën bujqësore; - Humbje e tokës bujqësore me sipërfaqe të konsiderueshme. - Zonat industriale pranë zonave të banimit – konflikti i shfrytëzimit të tokës;
Mundësitë	Rreziqet
- Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore - Përcaktimi i zonave urbane dhe për ndërtim të reja në sipërfaqe të përshtatshme për urbanizim. - Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore. - Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore - Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore - Caktimi i zonave turistike verore dhe dimërore - Zhvillim i sipërfaqeve komerciale përgjatë korridorit përgjatë rrugës magjistrale M25.	- Pronësia e paqartë mund të pengojë zhvillimin e duhur; - Ndërtimet pa leje përgjatë rrugës mund ta bllokojnë në zhvillimin e ardhshëm; - Humbja e tokës bujqësore; - Krijimi i vendbanimeve të shpërndara; - Humbje e Tokës pyjore; - Vështirësim deri në pamundësim të aplikimit të masave komasative në tokën bujqësore; - Rritje e pakënaqësisë qytetare;

Identifikimi i Sfidave

Gjatë analizës së profilit të komunës së Lipjanit kemi disa gjetje kyçe të cilat me shume i kemi identifikuar si sfida.

Tabela 149. Identifikimi i sfidave gjatë vlerësimit të shfrytëzimit të Tokës

Nr	Përshkrimi
1	Te fusha e banimit në mes shfrytëzimit të planifikuar të Tokës sipas PZHK 2013-2023+ dhe Shfrytëzimit ekzistues të Tokës, 50% të sipërfaqes së planifikuar për banim nuk është shfrytëzuar.
2	Shtrirja e vazhdueshme e ndërtimit në toka bujqësore, në formë të shpërndara, kjo paraqet një sfidë të veçantë në kompaktësimin e vendbanimeve si dhe në dendësimin e tyre. Këtu bëjnë pjesë vendbanimet si : Baicë, Shalë. Marec, Krojmir, Ruç i Vjetër, Brus, Gadime e ulët.
3	Nevoja për harmonizimin e sipërfaqeve të planifikuara për banim me kërkesën për banim që kanë këto vendbanime për tetë vitet e ardhshme si : Lipjan, Sllavi, Grackë e Vjetër, Banullë, Konjuhë, Topliqan, Dobrajë e Madhe.
4	Nevoja për zgjerim të sipërfaqeve për banim në vendbanimet si : Dobrajë e Madhe, Gadime e Ulët, Krojmir, Bujan, Marec, Baicë, Shalë dhe Zllakuqan.
6	Nevoja për zvogëlim të kufirit ndërtimor për banim në zonën urbane duke pasur parasysh tendencën për banim me shumë njësi si dhe trendet të cilat i kemi analizuar e që rezultojnë me 50% sipërfaqe të pa ndërtuar nga ajo që është planifikuar me PZHK 2013-2023+.
5	Nevoja për ruajtjen e tokave bujqësore në vendbanimet e shpërndara tek të cilat në mes ndërtimeve kemi sipërfaqe të mëdha të tokës bujqësore.
6	Nevoja për rryllëzim dhe rigjenerim të tokave pyjore të dëmtuara në vendbanimet si Akllap, Brus, Bukovicë, Gadime e

	Epërme, Janjevë, Krojmir, Vrellë e Gadimës, Zllakuqan, Plitkoviq, Resinoc, Shisharkë, Varigoc, Vogaqicë.
7	Ritja e zonave miniera sipërfaqësore dhe shtimi i zonave të tilla për dallim nga PZHK 2013-2023+ ne venbanimet si : Grackë e Vjetër, Janjevë, Konjuh, Kosnicë, Leletiq, Lipjan, Mirenëm Plitkoviq, Shalë dhe Smallushë.
8	

1.12 KAPACITETET FINANCIARE TË KOMUNËS LIPJAN



▪ Performanca në të kaluarën


Gjatë analizimit të kapaciteteve investive të kaluara të Komunës së Lipjanit janë konsultuar zyrtarë përkatës komunal. Buxheti i shpenzuar nëpër vite:

Fusha:	Buxheti i shpenzuar- viti:		
	2020	2021	2022
Infrastruktura teknike	3,395,043.00 €	2,087,820.00 €	2,061,232.00 €
Infrastruktura sociale	1,622,000.00 €	1,462,335.00 €	1,278,899.00 €
Arsimi dhe shkenca	380,000.00 €	616,000.00 €	532,280.00 €
Planifikimi urban dhe mjedisi	262,925.00 €	384,000.00 €	609,500.00 €
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	124,500.00 €	115,000.00 €	131,741.00 €
Gjithsej:	5,784,468.00 €	4,665,155.00 €	4,613,652.00 €

Siç mund të shihet nga të dhënat, gjatë viteve 2020-2022 ka pasur një rënie mesatare prej -10% të buxhetit të shpenzuar neper vite, me saktësisht prej -19% (2021) dhe -1% (2022).

Gjatë analizimit të investimeve të trendëve në të kaluarën të fushave të ndryshme në Komunën e Lipjanit mund të vërejmë si në vijim grupet kryesore:





Në përgjithësi mund të vërehet se investimet kapitale ndër vite (2020 – 2022) ishin në fushën infrastrukturën teknike (mesatarisht 49%) dhe infrastrukturën sociale (mesatarisht 29%), dhe më pak në fushat tjera, si arsimi dhe shkenca (mesatarisht 10%), planifikimi urban dhe mjedisi (mesatarisht 9%), si dhe shëndetësia dhe mirëqenia sociale (mesatarisht 2%).

Ndryshimet më të mëdha në investime kapitale ndër vite (2020 – 2022) ishin po ashtu në fushën e infrastrukturës teknike (mesatarisht -20%) dhe infrastrukturës sociale (mesatarisht -11%), kurse në fushat tjera kishte kryesisht rritje, arsimi dhe shkenca (mesatarisht 24%), planifikimi urban dhe mjedisi (mesatarisht 52%), dhe shëndetësia dhe mirëqenia sociale (mesatarisht 3%).

1.12.1.1 SUPOZIMET PARASHIKUESE

Këshilluesi ka marr supozimet në vijim kur ka llogaritur kategoritë për periudhën 2023-2031:

▪ **Infrastruktura teknike:**

Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022: në 2021 ka rënie prej -39% dhe në vitin 2022 ka përsëri rënie prej -1%. Pra, parashikimi vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 5.5% prej 2023 deri 2031.

2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
2,173,025 €	2,291,289 €	2,416,407 €	2,548,784 €	2,688,852 €	2,837,067 €	2,993,912 €	3,159,900 €	3,335,575 €

Parashikimi i investimeve kapitale në këtë fushë për vitet e ardhshme

▪ **Infrastruktura sociale:**

Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022: në 2021 ka rënie prej -10% dhe në vitin 2022 ka përsëri rënie prej -13%. Pra, parashikimi vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 6.2% prej 2023 deri 2031.

2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
1,356,667 €	1,439,569 €	1,527,953 €	1,622,190 €	1,722,676 €	1,829,834 €	1,944,118 €	2,066,009 €	2,196,026 €

Parashikimi i investimeve kapitale në këtë fushë për vitet e ardhshme

▪ **Arsimi dhe shkenca:**

Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022: në 2021 ka rritje prej +62% dhe në vitin 2022 ka përsëri rënie prej -14%. Pra, parashikimi vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 3.3% prej 2023 deri 2031.

2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
563,398 €	579,997 €	597,091 €	614,695 €	632,824 €	651,493 €	670,719 €	690,519 €	710,910 €

Parashikimi i investimeve kapitale në këtë fushë për vitet e ardhshme

▪ **Planifikimi urban dhe mjedisi:**

Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022: në 2021 ka rritje prej +62% dhe në vitin 2022 ka përsëri rënie prej -14%. Pra,

parashikimi vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 3.3% prej 2023 deri 2031.

2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
624,690 €	641,304 €	658,373 €	675,912 €	693,932 €	712,448 €	731,473 €	751,022 €	771,110 €

Parashikimi i investimeve kapitale në këtë fushë për vitet e ardhshme

▪ **Shëndetësia dhe mirëqenia sociale:**


Gjatë tre viteve të kaluara 2020 – 2022: në 2021 ka rënie prej -8% dhe në vitin 2022 ka përsëri rritje prej 15%.

Pra, parashikimi vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 2.4% prej 2023 deri 2031.

2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
624,690 €	641,304 €	658,373 €	675,912 €	693,932 €	712,448 €	731,473 €	751,022 €	771,110 €

Parashikimi i investimeve kapitale në këtë fushë për vitet e ardhshme

Fusha	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
Infrastruktura teknike	2,061,232 €	2,173,026 €	2,291,290 €	2,416,407 €	2,548,785 €	2,688,852 €	2,837,067 €	2,993,912 €	3,159,901 €	3,335,575 €
Infrastruktura sociale	1,278,899 €	1,356,667 €	1,439,569 €	1,527,953 €	1,622,190 €	1,722,676 €	1,829,834 €	1,944,118 €	2,066,009 €	2,196,026 €
Arsimi dhe shkenca	532,280 €	563,398 €	579,997 €	597,091 €	614,695 €	632,824 €	651,493 €	670,719 €	690,519 €	710,910 €
Planifikimi urban dhe mjedisi	609,500 €	624,690 €	641,304 €	658,373 €	675,912 €	693,932 €	712,448 €	731,473 €	751,022 €	771,110 €
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	131,741 €	134,811 €	137,973 €	141,231 €	144,589 €	148,049 €	151,616 €	155,292 €	159,082 €	162,989 €
Total	4,613,652 €	4,852,592 €	5,090,133 €	5,341,057 €	5,606,171 €	5,886,333 €	6,182,458 €	6,495,514 €	6,826,533 €	7,176,610 €



1.12.1.2 KAPACITETET FORMAT E FINANCIMIT

Në përgjithësi, Komuna e Lipjanit ka nevojë për fonde për realizimin e investimeve kapitale për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve tjera për qytetarët e saj. Një pjesë e madhe e fondeve priten të sigurohen nga garantët qeveritare.

Sipas ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, burimet financiare të një komune përbëhen nga:

- të hyrat vetanake të komunës,
- garantët operative,
- garantët për kompetencat e shtuara,
- transferet për kompetencat e deleguara,
- garantët e jashtëzakonshme,
- ndihma financiare nga Republika e Kosovës, dhe
- të hyrat nga huamarrjet e komunës.

Opsionet e financimit të investimeve kapitale për Komunën e Lipjanit janë:

- Huamarrje/ borxh nga tregu kombëtar i kapitalit – Komuna e Lipjanit mund ta përdorë këtë metodë të financimit. Huamarrja për komuna rregullohet me ligjin Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, me saktësisht Neni 30.
- Partneritet Publiko-Private – model i investimeve kapitale ku shërbimi për qytetarët në mënyrë të kontratës koncesionare kalon tek sektori privat për një periudhë afatmesme apo afatgjatë. Sektori ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimit publik për të cilën shfrytëzuesit paguajnë. Nëse Komuna e Lipjanit dëshiron ta ndjek këtë zgjedhje, ka nevojë që t'i shikojë se cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejojë t'i sigurojë sektori privat. Për këtë duhet të ndjekën hapat e nevojshëm sipas ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Private, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.
- Incentiva Private e Financimit – lloj i Partneritetit Publiko Privat, ku sektori privat ka eksperiencë dhe ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimi publik, por nuk mund të kërkojnë pagesë tek shfrytëzuesit të shërbimit, kështu që Komuna paguan për atë shërbim në formë të pagesave vjetore tek sektori privat. Nëse Komuna e Lipjanit dëshiron ta ndjek këtë zgjedhje, ka nevojë që t'i shikojë se cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejojë t'i sigurojë sektori privat. Për këtë duhet të ndjekën hapat e nevojshëm sipas ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.
- Donatorët - Mbajtja dhe kultivimi i komunikimit të mirëfilltë me donatorët. Kjo nënkupton një seri aktiviteteesh përmes së cilave donatorët mund të shohin përmirësim të dukshëm lidhur me ndihmat të cilat dëshirojnë t'i shpërndajnë. Një komunikim i tillë dhe fleksibilitet në punë ndihmon në sigurimin e mjeteve për investime kapitale. Sa më shumë investime kapitale të suksesshme, ndihmon në zgjerimin e rrjetit të donatorëve me të cilët Komuna e Lipjanit do mund të bashkëpunojë. Sidoqoftë, nevojitet kohë për sigurimin e fondeve të tilla dhe Komuna duhet të jetë e angazhuar vazhdimisht në këto lloj përpjekjesh.